Anila Beshaj

Orikela Ndreçka

# LIBËR PËR MËSUESIN
# Historia 11

BOTIME

pegi

# Përmbajtje


| | |
|---|---|
| Hyrje | 5 |
| Planifikimi vjetor dhe ai me 3-mujorë i lëndës histori | 8 |
| Planifikimi i orës mësimore<br>Tematika 1 | 50 |
| Planifikimi i orës mësimore<br>Tematika 2 | 84 |
| Planifikimi i orës mësimore<br>Tematika 3 | 103 |
| Planifikimi i orës mësimore<br>Tematika 4 | 166 |
| Planifikimi i orës mësimore<br>Tematika 5 | 209 |
| Planifikimi i orës mësimore<br>Tematika 6 | 228 |
| Planifikimi i orës mësimore<br>Tematika 7 | 264 |

### *Hyrje*

Lënda e historisë është thelbësore në zhvillimin e qytetarëve, të cilët i kuptojnë çështjet aktuale me zgjuarsi, nëpërmjet kuptimit, analizës dhe përfundimeve të nxjerra nga përvojat e së shkuarës.

Studimi i lëndës së historisë i ndihmon nxënësit të zhvillojnë një ndjenjë humanizmi të gjerë, të kuptojnë zhvillimin e personalitetit të tyre, mënyrën si ata ngjasojnë dhe diferencohen nga të tjerët në raport me kohën dhe me hapësirën, të dallojnë diferencën midis supozimit dhe faktit, të mos besojnë në përgjigjen e paargumentuar dhe të respektojnë vërtetësinë e burimeve historike, duke dalluar analogjinë false, të njohin abuzimet nga "mësimet" historike, të peshojnë pasojat që vijnë prej tyre, si dhe të marrin parasysh se padija për të shkuarën na bën "të burgosurit" e saj. Ndryshimi është aspekti thelbësor i historisë dhe për këtë arsye është dhe një ndër konceptet bazë të studimit në programin e historisë.

Ndërsa lëndë të tjera të fushës "Shoqëria dhe Mjedisi" studiojnë aspekte të ndryshme të jetës së njerëzimit, si: institucionet, traditat kulturore, ekonominë, ligjet etj., lënda e historisë kryesisht, synon të merret me shpjegimin e mënyrës se si të gjitha këto aspekte janë zhvilluar dhe kanë ndryshuar gjatë historisë së tyre. Në këtë mënyrë, nxënësit do të mësojnë rëndësinë që ka ndryshimi për të gjitha

përvojat njerëzore, për kompleksitetin dhe mënyrat e ndryshme në të cilat bashkëveprojnë të gjitha këto përvoja.

Detyra e programit të historisë është të drejtojë nxënësit për t'u bërë pjesëtarë të përgjegjshëm të shoqërisë, të cilët dinë se si të trajtojnë në mënyrë kritike një fenomen të epokës së tyre dhe të së shkuarës. Nëpërmjet programit të historisë, nxënësit kuptojnë se kultura e tyre dhe kulturat e tjera përbëjnë rezultatin e një procesi historik. Programi i historisë i ndihmon nxënësit që të bëhen të ditur, të logjikshëm, kureshtarë, të balancuar, të ndjeshëm dhe individë të aftë për të dhënë argumente dhe vendime të arsyetuara mirë. Këto cilësi mbështesin nxënësit në zhvillimin e qëllimeve, kompetencave kyçe dhe rezultateve të dëshiruara të arsimit parauniversitar, në mënyrë që ata të jenë individë të përgatitur, të aftë për të kontribuar ndaj kombit dhe të aftë për t'iu përgjigjur zhvillimeve globale.

## Korniza konceptuale e programit

Hartimi i programit për lëndën e historisë në arsimin parauniversitar rrjedh nga Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, kurrikulat bërthamë, plani mësimor, dhe Rekomandimet Rek (2001)15 të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropë në shekullin XXI.

Programi i historisë në qendër të tij vendos krijimin e kushteve për ndërtimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to, për të gjithë nxënësit e arsimit bazë.

Programi paraqet temat ndërkurrikulare, ku realizimi i tyre nëpërmjet lëndës së historisë është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e historisë në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Programi përshkruan lidhjen e historisë me fushat e tjera.

Programi i historisë lidh vlerat e të mësuarit të historisë me qëllimet e arsimit parauniversitar, me kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës dhe Rekomandimet Rek (2001)15 të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare, për mësimdhënien e historisë në shekullin XXI, duke ndërtuar te nxënësi konceptet, kompetencat dhe cilësitë historike, nëpërmjet:

- pajisjes me dijet dhe kompetencat e nevojshme historike për të kuptuar të tashmen dhe ndikimin e saj në zhvillimet historike të së ardhmes;
- krijimit të mundësive për të ndërtuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera, për zhvillimin e qytetërimeve antike, mesjetare moderne dhe bashkëkohore në vend, rajon dhe botë;
- angazhimit në mënyrë aktive në kërkimin historik me qëllim që të zhvillojë vetëbesimin, reflektimin dhe mendimin kritik;
- zhvillimit të aftësive/shkathtësive të kërkimit historik, duke u bazuar në burime historike për studimin e ngjarjeve të ndryshme të historisë;
- interpretimit të efektit të kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në marrëdhëniet historike dhe rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes;
- interpretimit të historisë së shoqërisë njerëzore në të kaluarën, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë të sotmen;
- kuptimit se si dhe pse ngjarje dhe çështje të veçanta historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme;
- zhvillimit të aftësive për të analizuar dhe për të interpretuar informacionin historik në mënyrë kritike dhe të përgjegjshme, nëpërmjet dialogut, kërkimit të së vërtetës dhe përmes debatit të hapur, sidomos për çështje të ndjeshme historike;
- ndërveprimit me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme për të njohur të kaluarën dhe për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike;
- mundësimit të ndërtimit të identitetit individual dhe kolektiv përmes njohjes dhe krahasimit së trashëgimisë së tyre historike të përbashkët;
- vlerësimit të pozitës së qytetërimit shqiptar në raport me qytetërimet botërore;
- argumentimit të vlerave të trashëgimisë historike, duke e vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë të përcaktimit të identitetit të një populli;
- zhvillimit të aftësive qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri;
- ndërtimit të aftësive për të kuptuar, organizuar dhe komunikuar dijet e tyre historike përmes mënyrave të ndryshme dhe përdorimit të medieve të ndryshme;
- pajisjes me kompetencat e duhura për të kontribuar në mënyrë aktive dhe me përgjegjësi si qytetarë lokalë dhe globalë në ndërtimin e perspektivës;
- forcimit të ndjenjës së identitetit kombëtar dhe të respektit për historinë kombëtare, me qëllim zgjerimin e përmasave evropiane në studimin e historisë.

## Kompetencat dhe konceptet e lëndës së historisë

Programi nëpërmjet të gjithë tematikave të tij zhvillon dhe ndërton një numër kompetencash dhe konceptesh, të cilat mbështesin studimin e historisë. Kompetencat historike janë procese dhe aftësi thelbësore që përfshihen në të gjithë programin e historisë nëpërmjet tematikave dhe nëpërmjet tematikave dhe veprimtarive të sugjeruara. Nxënësit duhet të kuptojnë, të zhvillojnë dhe të

ndërtojnë kompetencat dhe konceptet historike si dhe të aftësohen për t'i përdorur ato në mënyrë që të thellojnë dhe të zgjerojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e tyre në lëndën e historisë duke arritur progres.

**Kompetenca historike janë:**
1. Kërkimi historik.
2. Përdorimi i burimeve.
3. Analiza shkak - pasojë.
4. Interpretimi historik.
5. Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën.

**Koncepte kyçe historike janë:**
1. Kuptimi kronologjik.
2. Ndryshimi dhe vazhdimësia.
3. Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare.
4. Rëndësia.

**Tabela. Koha mësimore për çdo tematikë dhe temë në klasën e njëmbëdhjetë**

| NR. | PROCESET HISTORIKE, KOHA, NDRYSHIMI DHE VAZHDIMËSIA | 72 |
|---|---|---|
| 1 | **Parahistoria dhe antikiteti në territoret shqiptare** | 10 |
| 2 | **Territoret shqiptare në mesjetë** | 8 |
| 3 | **Shqiptarët në fundin e shekullit XIV deri në fillimin e shekullit XX** | 16 |
| 4 | **Shqipëria dhe shqiptarët 1912 – 1939** | 12 |
| 5 | **Shqiptarët dhe Lufta e Dytë Botërore** | 7 |
| 6 | **Shqipëria gjatë regjimit komunist 1945 – 1990** | 12 |
| 7 | **Rënia e regjimit komunist. Fitorja e demokracisë** | 7 |

*Shkolla*

# Planifikimi i kurrikulës për klasën e XI

# Fusha: SHOQËRIA DHE MJEDISI

**LËNDA: HISTORI**
**MËSUESI:**

**Planifikimi përmban: Planin vjetor; planet 3-mujore mbi bazën e kompetencave**

*Viti shkollor 2017-2018*

## OBJEKTIVAT E MËSIMIT TË HISTORISË NË SHEKULLIN XXI

*Në shekullin ku ne jetojmë, mësimi i historisë synon të:*

- të zërë një vend themelor për formimin e individit si qytetar përgjegjës e aktiv për zhvillimin e respektit për tërë llojet e dallimeve, respekt i mbështetur mbi mirëkuptimin e identitetit kombëtar dhe të parimeve të tolerancës;
- të jetë një faktor vendimtar pajtimi, mirënjohjeje, mirëkuptimi e besimi të ndërsjellë midis popujve;
- të luajë rol kryesor në zhvillimin e vlerave të tilla themelore si toleranca, mirëkuptimi reciprok, të drejtat e njeriut dhe demokracia;
- të përbëjë një nga elementët thelbësorë në ndërtimin e Evropës së bashkuar duke u bazuar në trashëgiminë historike e kulturore të përbashkët, pasuruar me larminë që e karakterizon, qoftë edhe në aspektet e veta konfliktuale dhe shpesh dramatike;
- të jetë pjesë e një politike arsimore e cila luan një rol të drejtpërdrejtë në përparimin dhe zhvillimin e të rinjve, në perspektivën e ndërtimit, së bashku me ta, të një Evrope të së nesërmes, si dhe me zhvillimin paqësor të shoqërive njerëzore në një perspektivë globale, brenda frymës së mirëkuptimit dhe besimit të ndërsjellë;
- të lejojë të zhvillohet tek të rinjtë aftësia intelektuale për të analizuar e interpretuar informacionin në mënyrë kritike dhe me përgjegjshmëri, nëpërmjet dialogut, nëpërmjet kërkimit të dëshmive historike dhe nëpërmjet debatit të hapur e të bazuar në perspektivë të shumëfishta, sidomos për çështje të ndjeshme e të diskutueshme historike;
- t’i lejojë qytetarit evropian të nxjerrë në pah identitetin e vet individual e kolektiv, nëpërmjet trashëgimisë së përbashkët historike në dimensionet e saj lokale, rajonale, kombëtare, evropiane dhe globale.

## PLANI VJETOR I LËNDËS SË HISTORISË

**36 javë x 2 orë në javë = 72 orë gjithsej**

| Nr. | Orët | Shpërndarja e orë ve |
|---|---|---|
| 1 | 51 orë | Njohuri të reja |
| 2 | 21 orë | Përpunimi i njohurive |
| 3 | 3 orë | Përsëritje |
| 4 | 3 orë | TEST |
| 5 | 11 orë | Veprimtari Praktike |
| 6 | 4 orë | Projekt / Vlerësim i dosjes |

**PLANIFIKIMI VJETOR**

| SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES SË LËNDËS | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **SHTATOR – DHJETOR (28 ORË)** | | **JANAR – MARS (25 ORË)** | | **PRILL – QERSHOR (19 ORË)** | |
| **Ora** | **Tematika 1: Parahistoria dhe antikiteti në territoret shqiptare (9 orë)** | **Ora** | **Tematika 3: Territoret shqiptare në mesjetë Shqiptarët në fund të shek. XIV – fillimin e shek. XX** (vazhdim 5 orë) | **Ora** | **Tematika 6: Shqipëria gjatë regjimit komunist (1945-1990)** (11 orë) |
| 1. | 1. Gjurmë të parahistorisë në territoret shqiptare | 29 | Përpjekjet e shqiptarëve për gjuhë dhe për shkollë shqipe gjatë shekullit XIX. | 54 | 1. Vendosja e regjimit komunist |
| 2 | 2. Ilirët: prejardhja dhe shtrirja territoriale e tyre. | 30 | **Veprimtari praktike:** Roli i gruas në Rilindjen Kombëtare Shqiptare. | 55 | 2. Opozita shqiptare kundër vendosjes së regjimit komunist |
| 3 | 3. Jeta ekonomike e shoqërore e ilirëve | 31 | Xhonturqit dhe shqiptarët | 56 | 3. Ekonomia socialiste dhe tiparet e saj |
| 4 | 4. Shteti ilir | 32 | Kuvendi i Vlorës dhe shpallja e pavarësisë së Shqipërisë. | 57 | 4. Arsimi, kultura, shkenca, artet gjatë viteve 1945-1990 |
| 5 | 5. **Projekt: Shteti shqiptar, sa larg dhe afër Evropës (Përcaktimi i temës, ndarja e grupeve)** | 33 | **Veprimtari praktike:** Roli i diasporës në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare. | 58 | 5. Marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë |
| 6 | 6. Shteti i Epirit | | **Tematika 4: Sfidat e shtetit të pavarur shqiptar (1912-1939)** (12 orë) | 59 | 6. Tipare të represionit komunist |
| 7 | 7. Mbretëria Dardane | 34 | 1. Qeveria e përkohshme e Vlorës | 60 | 7. **Veprimtari praktike** Fotomontazh mbi përdorimin e dhunës gjatë regjimit komunist |
| 8 | 8. Konfliktet iliro-romake | 35 | 2. Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe vendimet e saj për Shqipërinë | 61 | 8. Kriza e regjimit komunist |
| 9 | **9. Veprimtari praktike:** Burimet e shkruara greke dhe romake për qytetërimin ilir | 36 | 3. Shqipëria nën regjimin e princ Vidit | 62 | 9. **Veprimtari praktike** Jeta e përditshme |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Tematika 2 Territoret shqiptare në mesjetë (6 orë)** | 37 | 4. Shqipëria gjatë Luftës së Parë Botërore (1914-1918) | 63 | 10. Kosova dhe shqiptarët në Republikën e Jugosllavisë (1945–1989) |
| 10 | 1. Mesjeta e hershme arbërore, vazhdimësia etnokulturore | 38 | 5. Çështja shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris dhe Kongresi i Lushnjës | **64** | **11. Veprimtari praktike** Regjimi i pushtimit serb në Kosovë. Procesi i diferencimit etnik e politik të shqiptarëve |
| 11 | 2. Arbëria midis Lindjes dhe Perëndimit (zhvillimet politike në shek. XI-XIV) | 39 | 6. Shteti shqiptar gjatë viteve 1921-1924 | | **Tematika 7: Rënia e regjimit komunist. Fitorja e demokracisë** (8 orë) |
| 12 | 3. **Veprimtari praktike:** Despotati i Epirit | **40** | **7.** Shqiptarët e Kosovës, Çamërisë dhe viseve të tjera. | 65 | 1. Lëvizja studentore e dhjetorit (1990) dhe rrëzimi i regjimit komunist. |
| 13 | 4. Ekonomia dhe shoqëria në qytetin dhe fshatin mesjetar arbëror | 41 | 8. Republika shqiptare (1925-1928) | 66 | 2. Tranzicioni demokratik në Shqipëri (1990-2014) |
| 14 | 5. Organizimi politik në Arbërinë e shek. XIV-XV. | 42 | 9. Monarkia shqiptare në vitet 1928-1939 | 67 | 3. Procesi i integrimit euroatlantik të Shqipërisë (1990-2014) |
| 15 | 6. Arti, kultura, letërsia, arsimi dhe besimi në Arbërinë mesjetare | 43 | 10. Lëvizjet politiko-shoqërore në Shqipëri në vitet në vitet 1925-1939 | 68 | 4. Shpallja e Pavarësisë dhe ngritja e shtetit demokratik të Kosovës (1990-2014) |
| | **Tematika 3: Shqiptarët në fund të shek. XIV – fillimin e shek. XX** (13 orë – vazhdon tremujorin e dytë | 44 | 11. Shqiptarët në Jugosllavi dhe Greqi në vitet 1925-1941 | 69 | 5. **Veprimtari praktike** Qytetari në demokraci |
| 16 | 1. Ardhja e osmanëve në Ballkan dhe qëndresa ballkano-arbërore (fundi i XIV-fillimi i shek. XV) | 45 | **12. Veprimtari praktike:** Gruaja shqiptare në vitet ‘20–‘30 | 70 | 6. **PËRSËRITJE** |
| 17 | 2. Gjergj Kastriot Skënderbeu dhe Besëlidhja e Lezhës | | **Tematika 5: Shqiptarët dhe Lufta e Dytë Botërore (1939-1944)** (8 orë) | 71 | 7. **TEST** |
| 18 | 3. Qëndresa e shqiptarëve kundër osmanëve dhe diplomacia e shtetit të Skënderbeut | 46 | 1. Shqipëria nën pushtimin fashist italian | 72 | 8. **PROJEKT /Vlerësim i dosjes** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 19 | 4. **Veprimtari praktike** Figura e Gjergj Kastriot Skënderbeut përmes letërsisë dhe artit shqiptar e botëror. | 47 | 2. Rritja e lëvizjes antifashiste në Shqipëri (1941-shtator 1943) | |
| 20 | 5. Territoret shqiptare gjatë sundimit osman (shek. XVI-XVIII). | 48 | 3. Shqipëria nën pushtimin gjerman dhe qëndresa shqiptare (1943-1944) | |
| 21 | 6. Pashallëku i Shkodrës (1757-1831) | 49 | 4. **Veprimtari praktike:** Shqiptarët e Kosovës dhe te Çamërisë gjatë Luftës II Botërore.<br>Hebrenjtë dhe shqiptarë në Luftën e Dytë Botërore. | |
| 22 | 7. Pashallëku i Janinës (1787-1822). Arsimi dhe kultura në shek. XVI-XVII | 50 | 5. Çlirimi i vendit dhe pasojat e luftës (maj-nëntor 1944) | |
| 23 | 8.**PERSERITJE** | 51 | 6. **PËRSËRITJE** | |
| 24 | 9. **TEST** | 52 | 7. **TEST** | |
| 25 | 10. **PROJEKT** (ora e dyte) | 53 | 8. **PROJEKT / Vlerësim i dosjes** | |
| 26 | 11. Rilindja Kombëtare dhe tiparet e programit politik të rilindësve shqiptarë | | | |
| 27 | 12. Shqiptarët në periudhën e tanzimatit (vitet ‘30-‘70 të shek. XIX) | | | |
| 28 | 13. Lidhja shqiptare e Prizrenit dhe veprimtaria e saj | | | |

## PLANIFIKIMI VJETOR I LËNDËS HISTORI NDARË NË TREMUJORË

**Fusha: SHKENCA SHOQËRORE**

**Lënda: HISTORI**

**Shkalla: V**

**Klasa: XI**

**Viti shkollor: 2017-2018**

**PËR TREMUJORIN E PARË** **(Shtator - Dhjetor)**

| |
|---|
| **REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇ**<br>Orët mësimore të zhvilluara gjatë kësaj periudhe tremujore do të kontribuojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e këtyre kompetencave kyç: |
| **KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT**<br>Nxënësi:<br>- shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;<br>- dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;<br>- lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim;<br>- shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm. |
| **KOMPETENCA E TË MENDUARIT**<br>Nxënësi:<br>- shpreh mendimin e tij për një punim letrar apo artistik duke dalluar ndryshimet dhe analogjitë ndërmjet krijimeve të ngjashme;<br>- harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre (letrare), duke përcaktuar hapat kryesorë të zbatimit; |

- përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive ose krijimeve artistike.

**KOMPETENCA E TË NXËNIT**

Nxënësi:
- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.

**KOMPETENCA PËR JETËN, SIPËRMARRJEN DHE MJEDISIN**

Nxënësi:
- përgatit planin e punës për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses;
- bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tij social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

**KOMPETENCA QYTETARE**

Nxënësi:
- zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.

**KOMPETENCA DIGJITALE**

Nxënësi:
- përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar.
- analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedh disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).

**REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE TË FUSHËS**

- **Kërkimi historik**
- Nxënësi:

- fillon të hartojë dhe të përmirësojnë pyetjet e tij për të strukturuar një shqyrtim për zhvillimin e hipotezave, për përzgjedhjen dhe dhënien e fakteve për të nxjerrë dhe për të justifikuar konkluzionet e tij.
- përdor njohuritë e tij të fituara për të sugjeruar hipoteza, ose mund të sugjerojë hipoteza në fillim të temës, bazuar në supozimet dhe vlerat e tij, të cilat ata pastaj i teston kundrejt provave.

**Përdorimi i burimeve**

- Nxënësi:
- njeh të kaluarën bazuar në fakte historike, në prova, të cilat rrjedhin nga burime të sakta historike dhe jo nga supozime paraprake në lidhje me vlefshmërinë dhe me besueshmërinë e burimeve historike të përdorura duke përfshirë vlerësimin e vlerës dhe besueshmërinë e dëshmive, duke studiuar prejardhjen e qëllimeve dhe gjuhën e burimeve.

**Interpretimi historik**

Nxënësi:
- - kupton se si historianët dhe të tjerët formojnë interpretime që reflektojnë rrethanat në të cilat ato bëhen, dëshmitë në dispozicion, si dhe synimet e atyre që i bëjnë këto interpretime (p.sh.: shkrimtarë, arkeologë, historianë dhe film krijues).
- - përdor mënyra të ndryshme, duke përfshirë fotografi, shfaqje, filma, tregime, muze etj.

**Analiza shkak-pasojë**

Nxënësi:
- Përdor analizën shkak-pasojë që përfshin identifikimin dhe vlerësimin e rëndësisë relative të faktorëve të ndryshëm, si dhe bërjen e lidhjeve shpjeguese ndërmjet shkakut dhe pasojës, duke pasur parasysh marrëdhënien ndërmjet argumenteve shkakësore, dëshmive dhe interpretimeve.

**Shpjegimi & komunikimi për të shkuarën**

Nxënësi:
- zhvillon dëgjimin, leximin dhe shkrimin si aftësi për të kujtuar, për të përzgjedhur, për të klasifikuar dhe për të organizuar informacionin historik, duke përdorur me saktësi terminologjinë historike për përshkrimin dhe për shpjegimin e ngjarjeve në të shkuarën.
- - përdor edhe teknologjitë e reja ekzistuese sipas nevojave të tij.

**METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE**

Sugjerohet që gjatë orëve të mësimit do të përdoren metoda, teknika dhe strategji të tilla, si: *stuhi mendimi, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprakë,* diskutim për njohuritë paraprake, *harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, kubimi, diagrame piramidale, , ditarët e të nxënit, pyetja sjell pyetjen, diagrami i Venit, punë në grup, ditari tre pjesësh, INSERT etj.*
Nxënësit do të punojnë në grupe të vogla dhe të mëdha, në çift, në mënyrë të pavarur dhe individuale etj.

**VLERËSIMI**

Disa nga teknikat dhe instrumentet e vlerësimit që do të përdoren gjatë vitit shkollor do të jenë:

- **Vlerësim diagnostikues** : intervistë me një listë treguesish; vetvlerësim me listëkontrolli;
- **Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues)** : vlerësimi i përgjigjeve me gojë; vlerësimi i punës në grup; vlerësim mes nxënësish lasë:vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në klase; vlerësim i detyrave të shtëpisë; vetvlerësim; intervistë me një listë treguesish; vëzhgim me një listë të plotë treguesish; portofol; prezantim me gojë ose me shkrim; projekt kurrikular
- **Vlerësimi i të nxënit (vlerësimi përmbledhës) :** test për një grup temash të caktuara; test në përfundim të një kohe të caktuar;
- **Vlerësim i portofolit**

| Nr. | Java | Tematika | Temat mësimore | Situata e të nxënit | Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve | Vlerësimi (mbështetur në teknikat e | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | vlerësimit të mësipërm) | |
| 1. | Java 1 | **Tematika I Parahistoria dhe antikiteti në territoret shqiptare** **(9 orë)** **1.** | Gjurmë të parahistorisë në territoret shqiptare | Një nxënës lexon në klasë rubrikën "Grimcë historike":<br>"...Pellazgët e kishin zakon t'u flijonin perëndive çdo gjë, sikurse e mësova në, Dodonë, dhe ata nuk kishin për ta ndonjë emër, pasi nuk i ka dëgjuar njeri t'i thërrisnin me emra....." | Diskutim / Punë në grupe/hartë e koncepteve | - *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, e ne bashkëpunimin në grup* | Libri i nxënësit, harte arkeologjike e territorit shqiptar, interneti etj. |
| 2. | | **2.** | Ilirët: prejardhja dhe shtrirja territoriale e tyre | Për të nxitur kureshtjen e nxënësve lexohet në klasë rubrika "Grimcë historike".<br>Mësuesi/ja shfaq ne monitor pamje te gjetjeve të ndryshme arkeologjike që i përkasin kulturës ilire. Shih https://www.youtube.com/watch?v=5HënXxbroTë | *Brainstorming* /Hartë e konceptit | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në aftësinë për të punuar me hartën në shfaqjen e mendimit kritik* | Libri i nxenesit, harte arkeologjike e territorit shqiptar, hartë e fiseve ilire, youtube - https://www.youtube.com/watch?v=5HënXxbroTë etj |
| 3. | Java 2 | **3.** | Jeta ekonomike e shoqërore e ilirëve | Nxënësit prezantojnë detyrën që u ishte dhënë orën e mëparshme: Disa prej tyre identifikojnë fiset ilire që shtriheshin në zonën e tyre të banimit dhe nxënës të tjerë prezantojnë në monitor pamje dhe të dhëna rreth disa prej qyteteve më të rëndësishme ilire. | Prezantim / diskutim / tabela e koncepteve | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e* | libri i nxënësit, harte arkeologjike e territorit shqiptar, interneti etj |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | -Më pas për të nxitur kureshtjen e nxënësve mësuesi/ja shfaq në monitor pemën e gjuhëve indoevropiane. Shih http://www.shqiperia.com/shqiperia/images/Pema%20e%20Gjuheve%20IndoEuropiane%20-%20shqip.jpg | | *dhëna , në pjesëmarrjen në diskutime si dhe në përzgjedhjen e burimeve të informacionit për realizimin e detyrës së dhënë* | |
| 4. | | **4.** | Shteti ilir | Për nxitur kureshtjen e nxënësve mësuesi/ja organizon ne klasë një veprimtari në formën e një quizi. Nëpërmjet pyetjeve rikujtohen njohuri që nxënësit kanë mësuar në temat e mëparshme ose dhe në klasën e dhjetë si dhe bëhet lidhja e tyre me njohuritë e reja. | quiz / punë në grupe | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në pjesëmarrjen në orën e mësimit ,në bashkëpunimin në grup, në argumentet rreth fakteve që u diskutuan.* | Libri i nxënësit, hartë e fiseve ilire, interneti, botime të ndryshme, enciklopedi. |
| 5. | Java 3 | **5.** | **Projekt:**<br>Shteti shqiptar, sa larg dhe afër Evropës (Përcaktimi i temës, ndarja e grupeve) | Mësuesi/ja nxit kureshtjen e nxënësve mbi temën e cila do të trajtohet në projekt duke shfaqur një video të shkurtër rreth ecurisë dhe marrëveshjeve të nënshkruara me B.E. Shih https://www.youtube.com/watch?v=vhFisJ-k7U | Punë në grup,<br>hulumtim | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në bashkëpunimin në grup dhe në efikasitetin e shfrytëzimit të kohës.* | Teksti Historia 11, interneti, materiale të shkruara, materiale audiovizuale, biseda me specialistë etj |
| 6. | | **6.** | .Shteti i Epirit | . Lexohet nga nxënësit rubrika "Grimca historike"<br>"...Gjatë fushatës së Pirros, romakët lidhën edhe një marrëveshje me kartagasit... Ajo përmbante të gjitha pikat e | Diskutim / Lexim dhe mendim i drejtuar. | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në kontributin dhe aktivizimin e tyre* | Libri i nxenesit, hartë e fiseve Epirit, interneti, |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | marrëveshjeve të mëparshme, por i shtohej edhe | | *në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime* | enciklopedi etj |
| 7. | Java 4 | **7.** | Mbretëria Dardane | Mësuesi/ja vendos në tabelë një hartë të shteteve ilire dhe kërkon nga nxënësit të tregojnë kufijtë dhe shtrirjen e këtyre formacioneve shtetërore | Shpjegim/hartë e konceptit | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit..* | Libri i nxënësit , interneti, botime të tjera rreth fiseve ilire, të dhëna arkeologjike |
| 8. | | **8.** | Iliria dhe Roma | Mësuesi/ja për të nxitur kureshtjen e nxënësve shfaq në monitor sekuenca mbi mbretërit ilirë të dinastisë ardiane Teuta dhe Genti. Shih. https://www.youtube.com/watch?v=xN7uBJFX4uE&t=317s , https://www.youtube.com/watch?v=ynQQchbIS-M | Diskutim / INSERT | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit në të kuptuarit e fakteve dhe ngjarjeve* | Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi, botime rreth mbretërve ilirë |
| 9. | Java **5** | **9.** | **Veprimtari praktike:** Burimet e shkruara greke dhe romake për qytetërimin ilir. | Lexohet në klasë pjesë nga poema e Homerit “Odisea” “Unë tani mora vesh kthimin e Odiseut, “diku në tokat pjellore të thesprotëve jeton dhe sjell thesare të shumta dhe të çmueshme. Kështu më tha mbreti i thesprotëve......” | Punë hulumtuese, diskutim në klasë | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet punën hulumtuese, aftësinë për të përzgjedhur burimet e informacionit, në prezantimin e materialit të përgatitur si dhe në pjesëmarrjen në* | Interneti , “Iliada”, “Odisea”, botime të autoreve antikë si Herodoti, Tuqididi Demosten, Hesiodi, Straboni“ Gjeografi, Aristoteli, |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | *diskutim dhe të menduarit kritik* | Cicëroni, Virgjili. |
| 10 | | **Tematika 2**<br>**1. Territoret shqiptare në mesjetë (6 orë)** | Mesjeta e hershme arbërore, vazhdimësia etnokulturore.. | Për të nxitur kureshtjen e nxënësve lexohet në klasë rubrika “Grimcë historike”.<br>“ Në burimet e shkruara, ilirët përmenden me këtë emër deri në shek. VI. Nga shek. XI në dokumentet e shkruara, banorët e Ilirisë së Jugut njihen me emrin arbër, ndërsa vendi Arbëri................”<br>Shfaqen sekuenca nga dokumentari”Ata quheshin arber” Shihëhttps://www.youtube.com/ëatch?v=6GNpaY7xofM . | Diskutim /tabela e koncepteve | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime ,në aftësinë për të punuar me hartën në shfaqjen e mendimit kritik.* | Libri i nxënësit, harta të territorit shqiptar në antikitet dhe në mesjetë, hartë e themave në territorin shqiptar, enciklopedi etj |
| 11 | Java **6** | **2.** | .Arbëria midis Lindjes dhe Perëndimit (zhvillimet politike në shek. XI-XIV). | Shfaqen sekuenca nga<br>dokumentari”. Ata quheshin<br>arbër”<br>Shih<br>https://www.youtube.com/ëatch?v<br>=6GNpaY7xofM | . Rrjeti i diskutimit /lexim dhe mendim i drejtuar | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit dhe në të menduarit kritik.* | Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme ,enciklopedi |
| 12 | | **3.** | **Veprimtari praktike:**<br>Despotati i Epirit | Mësuesi/ja shpjegon si u krijua shteti i Epirit dhe nga kush drejtohej ai.<br>(mund t’i referohet situatës së të nxënit në tekst ose materiale të tjera shtese | Punë në grupe/ përgatitje e një posteri | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në realizimin e detyrave, kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e* | Libri i nxënësit, harta të territoreve të Ballkanit në mesjetë, interneti, |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | *njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime* | enciklopedi etj. |
| 13 | Java **7** | **4.** | Ekonomia dhe shoqëria në qytetin dhe fshatin mesjetar arbëror | Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë rubrikën "Grimcë historike"<br>"Për prodhimet e mira, qytetet kishin fituar emër të mirë përtej tokave arbërore...."<br>Nxiten nxënësit në diskutim nëpërmjet pyetjeve të ndryshme. | Diskutim / pyetje – përgjigje /hartë e mendjes | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime ,në aftësinë për të punuar me hartën në shfaqjen e mendimit kritik.* | Libri i nxënësit, hartë të trojeve shqiptare në mesjetë |
| 14 | | **5.** | Organizimi politik në Arbërinë e shek. XIV-XV... | Mësuesja e nis orën e mësimit me një prezantim të principatave kryesore të shek XIV në Arbëri. Shih: https:/www.youtube.com/ëatch?v=y2aC2PM5-gQ | Shpjegim /tabela e koncepteve | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit dhe në të menduarit kritik* | Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme, enciklopedi hartë e principatave të shek XIV etj. |
| 15 | Java 8 | **6.** | Arti, kultura, letërsia, arsimi dhe besimi në Arbërinë mesjetare | Për të nxitur kureshtjen e nxënësve mësuesi /ja vendos në tabelë ose shfaq në monitor fotografi të kështjellave mesjetare, kishave të besimit katolik dhe | Diskutim / pyetje – përgjigje | *vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja,* | Libri i nxënësit, hartë të trojeve shqiptare në |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ortodoks, të afreskeve dhe ikonave, mozaik bizantinë, dy kodikët e Beratit. | | *në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime* | mesjetë. |
| 16 | | **Tematika 3**<br>**1. Shqiptarët në fund të shek. XIV – fillimin e shek. XX**<br>(10 orë –vazhdon tremujorin e dytë) | Ardhja e osmanëve në Ballkan dhe qëndresa ballkano-arbërore (fundi i shek. XIV- fillimi i shek. XV) | Mësuesi/ja e nis orën e mësimit me një prezantim të principatës së Kastriotëve dhe Arianitëve. Shih[https://www.youtube.com/watch?v=y2aC2PM5-gQ](https://www.youtube.com/watch?v=y2aC2PM5-gQ) . | bashkëbisedim/mësimdhënie e ndërsjelltë | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna në formulimin e pyetjeve dhe në të menduarit kritik* | Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi hartë e principatave të shek XIV etj |
| 17 | Java 9 | **2.** | Gjergj Kastriot Skënderbeu dhe Besëlidhja e Lezhës | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja vendos në tabelë ose shfaq në monitor piktura, skulptura, pamje të Skënderbeut, Kuvendit të Lezhës si dhe një sekuencë nga filmi" Skënderbeu" ku tregohet organizimi i Lidhjes së Lezhës | Diskutim / INSERT | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna në në aktivizimin në orën e mësimit në saktësinë e përgjigjeve dhe të argumenteve të paraqitura në diskutim* | Libri i nxënësit , interneti, enciklopedi, botime Letrare mbi Skëndërbeun si p.sh"Skëndërbeu " i M.Barletit dhe i S.Godos. |
| 18 | | **3.** | Qëndresa e shqiptarëve kundër osmanëve dhe diplomacia e shtetit të Skënderbeut | - Lexohet në klasë rubrika "Grimca historike"<br><br>" 4 maj 1448. Mbasi një nënshtetas yni, njeri praktik dhe i kuptueshëm, e njoftoi zotërinë tonë se mund të gjente mënyrën që mund ta mbyste ose të fuste të | Diskutim / pyetje – përgjigje | - *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në* | Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi, botime letrare për figurën e Skënderbeut |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | tjerë ta mbytnin Skënderbeun,.......” | | *diskutime* | hartë e shtetit të Skënderbeut |
| 19 | Java 10 | **4.** | **Veprimtari praktike**<br>Figura e Gjergj Kastriot Skënderbeut përmes letërsisë dhe artit shqiptar e botëror | Lexohet situata e të nxënit në tekst<br>“Shekulli XV është shekulli i heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeut. Në atë kohë, Shqipëria u bë fushë betejash titanike dhe Kruja, çerdhe e lirisë për njëqind vjet me radhë...................” | Punë në grupe /<br>prezantim në klasë. | *Nxënësit vlerësohen në grup, mbi bazën e materialeve të hulumtuara, qartësisë, estetikës së prezantimit .*<br>- | Libri i nxënësit, interneti enciklopedi vepra të ndryshme të artit, O. J. Shmit “Skënderbeu”, botuar në 2008, “Skënderbeu “ i Sabri Godos, i Marin Barletit etj |
| 20 | | **5.** | Territoret shqiptare gjatë sundimit osman (shek. XVI-XVIII).. | -Mësuesi /ja për të nxitur kureshtjen e nxënësve organizon në klasë një quiz me pyetje të cilat lidhen me informacionin e ri.<br>. | Quiz / punë në grupe /harta e mendjes | *Vlerësimi i nxenësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna* | Libri i nxënësit, hartë ë tokave shqiptare |
| 21 | Java 11 | **6.** | Pashallëku i Shkodrës (1757-1831) | Lexohet në klasë rubrika “Grimca Historike”<br>“Mehmet pashë Bushatlliu krijoi një bibliotekë me vepra të jurisprudencës osmane. Fëmijët e tij e pasuruan atë më tej me libra | Copëzat e përziera /<br>diskutim / tabela e<br>koncepteve | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna në aktivizimin në orën e mësimit. në bashkëpunimin në* | Libri i nxënësit, interneti ,enciklopedi ,hartë e pashallëqev e etj. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | osmanë dhe të Evropës..............” | | *grup etj.* | |
| 22 | | **7.** | Pashallëku i Janinës (1787-1822). Arsimi dhe kultura në shek. XVI-XVII | Mësuesi /ja shfaq në klasë sekuenca nga dokumentar mbi Ali pashë Tepelenën. Interesant është dokumentari i gjetur në adresen https://www.youtube.com/watch?v=rIL8kMH2U3o i cili flet për marrdhëniet e Ali pashës me shtetet e tjera dhe veçanërisht me Napoleon Bonapartin | Diskutim / pyetje – përgjigje/hartë e konceptit | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime* | Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi, botime letrare si p.sh. “Ali pashe Tepelena” i autorit Sabri Godo, "Shtegtimet e Çajd Haroldit”, harta etj. |
| 23 | Java 12 | **8.** | **PËRSËRITJE** | Diskutim i drejtuar nga mësuesi/ja rreth besimeve fetare në vendin tone duke e vënë theksin në tolerancën fetare në shekuj si një virtyt i shqiptarëve. | Diskutim / Kubimi | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen* | Libri i nxënësit, hartë e tokave shqiptare |
| 24 | | **9.** | **TEST** | | Pune me shkrim | *Vlerësimi përmbledhës* | Teksti, fletat e testit |
| 25 | Java **13** | **10.** | **PROJEKT** | Diskutim rreth kritereve për anëtarësimin në B.E si dhe rreth ngjarjeve aktuale që lidhen me këtë qellim | Punë në grup, hulumtim | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në bashkëpunimin në grup dhe në efikasitetin e shfrytëzimit të kohës., ne përcaktimin e* | Teksti Historia 11, interneti, materiale të shkruara, materiale audiovizual e, biseda me |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | *burimeve të besueshme, në pjesëmarrjen në diskutim etj.* | specialistë etj. |
| 26 | | **11** | Rilindja Kombëtare dhe tiparet e programit politik të rilindësve shqiptarë | Mësuesi/ja vendos në tabelë ose shfaq në monitor foto të rilindasve.<br>Prezantimi i fotove mund të shoqërohet me një shpjegim të shkurtër të veprimtarisë së rilindasve të njohur si: Jeronim De Rada, Naum Veqilharxhi, Sami Frashëri, Pashko Vasa etj.<br>Prezantimi i fotove mund të bëhet dhe më interesant i shoqëruar me recitimin e poezisë së Pashko Vasës "O moj Shqypni, e mjera Shqypni" (shih: https://www.youtube.com/watch?v=ZaClJ1iasuw | Diskutim / lexim i drejtuar /hartë e koncepteve | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime dhe në të menduarit kritik.* | |
| 27 | Java 14 | **12** | Shqiptarët në periudhën e tanzimatit (vitet '30-'70 të shek. XIX) | Për të nxitur kureshtjen e nxënësve mësuesi/ja lexon disa prej vargjeve që populli i këndonte për djemtë nizamë:<br>Dolli nje karav nga deti,<br>kërkon ushtarë dovleti:<br>tetëmbëdhjetë vjeç djalë,<br>merr dyfeknë e gjerdanë.<br>Sa qe vanë, asnjë s'u kthie,<br>mbenë nënat kallogrie. | diskutim / tabela e koncepteve | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime ,në aftësinë për të punuar me hartën në shfaqjen e mendimit kritik.* | Libri i nxënësit, harta e kryengritjeve të viteve '40 shek. XIX, interneti etj. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 28 | | **13** | Lidhja shqiptare e Prizrenit dhe veprimtaria e saj | Mësuesi/ja shfaq sekuenca nga dokumentari "Lidhja shqiptare e Prizrenit" shih: https://www.youtube.com/watch?v=I9tafUKI2kA, https://www.youtube.com/watch?v=VqdN4V0QQVE | pyetje- përgjigje / puno në dyshe | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në pjesëmarrjen në orën e mësimit ,në bashkëpunimin në grup, në argumentet e paraqitur rreth fakteve që u dikutuan, në formulimin e pyetjeve etj.* | Libri i nxënësit, harta, biblioteka e shkollës, interneti |

# PLANIFIKIMI VJETOR I LËNDËS HISTORI NDARË NË TREMUJORË

**Fusha: SHKENCA SHOQËRORE**

**Lënda: HISTORI**

**Shkalla: V**

**Klasa: XI**

**Viti shkollor: 2017-2018**

## PLANIFIKIMI I LËNDËS PËR TREMUJORIN E DYTË (Janar - Mars)

| |
|---|
| **REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇ**<br>Orët mësimore të zhvilluara gjatë kësaj periudhe tremujore do të kontribuojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e këtyre kompetencave kyç: |
| **KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT**<br>Nxënësi:<br>- shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;<br>- dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;<br>- lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim;<br>- shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm. |
| **KOMPETENCA E TË MENDUARIT**<br>Nxënësi:<br>- shpreh mendimin e tij për një punim letrar apo artistik duke dalluar ndryshimet dhe analogjitë ndërmjet krijimeve të ngjashme;<br>- harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre (letrare), duke përcaktuar hapat kryesorë të zbatimit;<br>- përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive ose krijimeve artist. |

**KOMPETENCA E TË NXËNIT**

Nxënësi:

- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.

**KOMPETENCA PËR JETËN, SIPËRMARRJEN DHE MJEDISIN**

Nxënësi:

- përgatit planin e punës për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses;
- bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tij social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

**KOMPETENCA QYTETARE**

Nxënësi:

- zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.

**KOMPETENCA DIGJITALE**

Nxënësi:

- përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar.
- analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedh disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).

**REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE TË FUSHËS**

- **Kërkimi historik**

- Nxënësi:

- fillon të hartojë dhe të përmirësojnë pyetjet e tij për të strukturuar një shqyrtim për zhvillimin e hipotezave, për përzgjedhjen dhe dhënien e fakteve për të nxjerrë dhe për të justifikuar konkluzionet e tij.

- përdor njohuritë e tij të fituara për të sugjeruar hipoteza, ose mund të sugjerojë hipoteza në fillim të temës, bazuar në supozimet dhe vlerat e tij, të cilat ata pastaj i teston kundrejt provave.

**Përdorimi i burimeve**

Nxënësi:
- njeh të kaluarën bazuar në fakte historike, në prova, të cilat rrjedhin nga burime të sakta historike dhe jo nga supozime paraprake në lidhje me vlefshmërinë dhe me besueshmërinë e burimeve historike të përdorura duke përfshirë vlerësimin e vlerës dhe besueshmërinë e dëshmive, duke studiuar prejardhjen e qëllimeve dhe gjuhën e burimeve.

**Interpretimi historik**

Nxënësi:
- kupton se si historianët dhe të tjerët formojnë interpretime që reflektojnë rrethanat në të cilat ato bëhen, dëshmitë në dispozicion, si dhe synimet e atyre që i bëjnë këto interpretime (p.sh.: shkrimtarë, arkeologë, historianë dhe film krijues).
- përdor mënyra të ndryshme, duke përfshirë fotografi, shfaqje, filma, tregime, muze etj.

**Analiza shkak-pasojë**

Nxënësi:
- Përdor analizën shkak-pasojë që përfshin identifikimin dhe vlerësimin e rëndësisë relative të faktorëve të ndryshëm, si dhe bërjen e lidhjeve shpjeguese ndërmjet shkakut dhe pasojës, duke pasur parasysh marrëdhënien ndërmjet argumenteve shkakësore, dëshmive dhe interpretimeve.

**Shpjegimi & komunikimi për të shkuarën**

Nxënësi:
- zhvillon dëgjimin, leximin dhe shkrimin si aftësi për të kujtuar, për të përzgjedhur, për të klasifikuar dhe për të organizuar informacionin historik, duke përdorur me saktësi terminologjinë historike për përshkrimin dhe për shpjegimin e ngjarjeve në të shkuarën.
- përdor edhe teknologjitë e reja ekzistuese sipas nevojave të tij.

**METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE**

Sugjerohet që gjatë orëve të mësimit do të përdoren metoda, teknika dhe strategji të tilla, si: *stuhi mendimi, lexim i drejtuar, imagjinata e*

| |
|---|
| *drejtuar, parashikim me terma paraprakë,* diskutim për njohuritë paraprake, *harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, kubimi, diagrame piramidale, , ditarët e të nxënit, pyetja sjell pyetjen, diagrami i Venit, punë në grup, ditari tre pjesësh, INSERT etj.*<br>Nxënësit do të punojnë në grupe të vogla dhe të mëdha, në çift, në mënyrë të pavarur dhe individuale etj. |
| **VLERËSIMI**<br>Disa nga teknikat dhe instrumentet e vlerësimit që do të përdoren gjatë vitit shkollor do të jenë:<br>- **Vlerësim diagnostikues**: intervistë me një listë treguesish; vetvlerësim me listëkontrolli;<br>- **Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues)**: vlerësimi i përgjigjeve me gojë; vlerësimi i punës në grup; vlerësim mes nxënësish vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në klasë; vlerësim i detyrave të shtëpisë; vetvlerësim; intervistë me një listë treguesish; vëzhgim me një listë të plotë treguesish; portofol; prezantim me gojë ose me shkrim; projekt kurrikular<br>- **Vlerësimi i të nxënit (vlerësimi përmbledhës) :** test për një grup temash të caktuara; test në përfundim të një kohe të caktuar;<br>**Vlerësim i portofolit** |

| Nr. | Java | Tematika | Temat mësimore | Situata e të nxënit (të sugjeruara) | Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve | Vlerësimi | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 29 | Java 15 | **Tematika 3: Territoret shqiptare në mesjetë** (vazhdim 5 orë) 1. | Përpjekjet e shqiptarëve për gjuhë dhe për shkollë shqipe gjatë shekullit XIX. | Mësuesi/ja nxit kureshtjen e nxënësve duke shfaqur sekuenca nga filmi shqiptar "Kush vdes në këmbë" (Minuta 17-20 ) Shih: https://www.youtube.com/watch?v=TfAyYmx2_dg | Shpjegim/ punë në grupe/diskutim | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në bashkëpunimin në grup dhe formulimin e saktë të pyetjeve dhe përgjigjet e dhëna si dhe në të menduarit kritik..* | Teksti Historia 11, interneti, materiale të shkruara, materiale audiovizuale, biblioteka e shkollës |
| 30 | | 2. | **Veprimtari praktike:** Roli i gruas në Rilindjen Kombëtare Shqiptare. | Vendosen në monitor disa sekuenca nga filmi shqiptar "Mësonjëtorja" .Shih: https://www.youtube.com/watch?v=JOZai_OJëqo | Punë hulumtuese në grupe / diskutim në klasë | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime* | Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi etj. |
| 31 | Java 16 | 3. | Xhonturqit dhe shqiptarët | Shfaqen në monitor pjesë nga dokumentari mbi Kongresin e Manastirit. Shih : https://www.youtube.com/watch?v=90fcyQHZ45U | Diskutim /Di -Dua të di - Mësoj | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit* | Libri i nxënësit , interneti, studime historike, gjuhësore |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 32 | | 4. | Kuvendi i Vlorës dhe shpallja e pavarësisë së Shqipërisë | Shfaqen në monitor sekuenca nga filmi artistik shqiptar "Nëntori i dytë" ose vendosen në tabelë foto nga shpallja e Pavarësisë. Shih: https://www.youtube.com/watch?v=8SQNToKDFbQ<br><br>https://www.google.al/search?q=shpallja+e+pavaresise. | Diskutim / INSERT/diskutim | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit në të kuptuarit e fakteve dhe ngjarjeve.* | Libri i nxënësit , interneti, enciklopedi, harta, libri i mësuesit etj. |
| 33 | Java 17 | 5. | **Veprimtari praktike:** Roli i diasporës në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare | Mësuesi/ja bën një prezantim duke i njohur nxënësit shkurt me kushtet dhe veprimtarinë e diasporës shqiptare në botë. (Informacioni në tekst "Situata e të nxënit") | Punë në grupe/prezantim | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet punën hulumtuese ,aftësinë për të përzgjedhur burimet e informacionit ,në prezantimin e materialit të përgatitur si dhe në pjesëmarrjen në diskutim dhe të menduarit kritik.* | Interneti, libri i nxënësit, biblioteka e shkollës |
| 34 | | **Tematika 4: Sfidat e shtetit të pavarur shqiptar (1912-1939)** (12 orë) 1. | Qeveria e përkohshme e Vlorës | Qeveria kryesuar nga Ismail Qemali, e dalë nga Kuvendi i Vlorës u përball që në hapat e parë me vështirësi të shumta, si në planin e brendshëm, ashtu edhe në atë të jashtëm............ | Harta e të pyeturit/<br><br>diskutim | *Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore* | Libri i nxënësit, interneti |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 35 | Java 18 | 2. | Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe vendimet e saj për Shqipërinë | Konferenca e Ambasadorëve e Londrës mbetet një ngjarje themelore në historinë e shtetit shqiptar. Shumë nga ngjarjet negative që ka përjetuar Shqipëria si shtet dhe si komb pas vitit 1912 e kanë zanafillën tek kjo konferencë.................... | Diskutim / Lexim dhe mendim i drejtuar | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime* | Libri i nxënësit, harte e kufijve politike të shtetit shqiptar etj. |
| 36 | | **3.** | Shqipëria nën regjimin e princ Vidit | Ardhja në Shqipëri e princit Vilhelm Vid ishte përpjekja e parë serioze për konsolidimin e shtetit të pavarur shqiptar. Vidi bëri disa hapa përpara në fushën e legjislacionit, administratës dhe ......... | Shpjegim/diskutim në klasë | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime .* | Shpjegim/diskutim në klasë |
| 37 | Java 19 | 4. | Shqipëria gjatë Luftës së Parë Botërore (1914-1918) | Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë rubrikën “Grimcë historike”<br>Lufta e Parë Botërore, e ktheu Shqipërinë në një shesh beteje duke rritur rrezikun e copëtimit të mëtejshëm të trojeve shqiptare. .................. | Diskutim / pyetje –përgjigje /hartë e mendjes | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime ,* | Libri i nxënësit, hartë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 38 | | 5. | Çështja shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris dhe Kongresi i Lushnjës | Lexohet para nxënësve pjesë nga fjalimi i at Gjergj Fishtës në Konferencën e Paqes ai p,sh.: *"Tash, zotni, mbasi ju diftova se kush janë dhe çka janë shqiptarët, më duhet t'ju flas për të drejtat e tyne. E po ju tham se shqiptarët kanë të drejtë a) për nji pavarësi politike; b) gjithnjë brenda kufijve gjeografikë e etnikë të Shqipnisë...* | Rrjeti i diskutimit /lexim dhe mendim i drejtuar | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit dhe në të menduarit kritik.* | Libri i nxënësit , interneti, botime të ndryshme, enciklopedi etj. |
| 39 | Java 20 | 6.. | Shteti shqiptar gjatë viteve 1921-1924 | Periudha pas Luftës I Botërore, ishte e mbushur me vështirësi ekonomike dhe mungesë të theksuar stabilitetit politik për shtetin shqiptar. Ndonëse, parimet e ndërtimit të tij mbështeteshin mbi parlamentarizmin perëndimor, ato u ndeshën me normat dhe zakonet tradicionale dhe luftën e paprinciptë dhe për interesa të ngushta politike e vetjake të një pjese të klasës politike | Diskutim / INSERT | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit në të kuptuarit e fakteve dhe ngjarjeve* | Libri i nxënësit , interneti, enciklopedi |
| 40 | | 7. | Shqiptarët e Kosovës, Çamërisë dhe viseve të tjera. | Mësuesja e nis orën e mësimit me një prezantim të figurës së Azem Bejtë | Shpjegim /tabela e koncepteve | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në* | Libri i nxënësit , interneti, botime të ndryshme |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Galicës dhe veprimtarisë së tij patriotike: https://www.youtube.com/watch?v=euBORIeRb5U | | *përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit dhe në të menduarit kritik.* | ,enciklopedi, hartë e Ballkanit Perëndimor në vitet 1912-1924 |
| 41 | Java 21 | 8. | Republika shqiptare (1925-1928) | Lexohet nga nxënësit rubrika "Grimca historike" *"Sipas historianit Joseph Swire, në zgjedhjet e prillit 1925, "qeveria doli fitimtare, por kjo ishte paravendosur, sepse në mungesë të të gjithë udhëheqësve kryesorë të opozitës në mërgim, .......* | Diskutim / Lexim dhe mendim i drejtuar. | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime* | Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi etj. |
| 42 | | 9. | Monarkia shqiptare në vitet 1928-1939 | Për të nxitur interesin e nxënësve, mësuesja/si udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën "Material plotësues" dhe, më pas, nxit diskutimin rreth njohurive që nxënësit kanë në lidhje me figurën e Ahmet Zogut | Shpjegim/hartë e konceptit | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit* | Libri i nxënësit , interneti, botime të tjera |
| 43 | Java 22 | 10. | Lëvizjet politiko-shoqërore në Shqipëri në vitet në vitet 1925-1939 | Për të nxitur kureshtjen e nxënësve lexohet në klasë rubrika "Grimcë historike". *Më 20 shkurt 1931, kur Zogu për arsye mjekësore ndodhej në Vjenë, i vendosur në hotelin luksoz "Imperial", dy anëtarë të shoqërisë "Bashkimi",* | Diskutim /tabela e koncepteve | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në* | Libri i nxënësit, enciklopedi etj. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *kapiten Azis Çami dhe toger Ndoc Gjeloshi e goditën atë disa herë.* | | *diskutime ,në aftësinë për të punuar me hartën në shfaqjen e mendimit kritik.* | |
| 44 | | 11. | Shqiptarët në Jugosllavi dhe Greqi në vitet 1925-1941 | Për nxitur kureshtjen e nxënësve mësuesi/ja organizon ne klasë një veprimtari në formën e një quizi.<br>Nëpërmjet pyetjeve rikujtohen njohuri që nxënësit kanë mësuar në temat e mëparshme ose dhe në klasën e dhjetë si dhe bëhet lidhja e tyre me njohuritë e reja. | quiz / punë në grupe | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në pjesëmarrjen në orën e mësimit, në bashkëpunimin në grup, në argumentet e paraqitur rreth fakteve që u diskutuan.* | Libri i nxënësit, hartë e Shqipërisë dhe Ballkanit, interneti, botime të ndryshme, enciklopedi. |
| 45 | Java 23 | 12. | **Veprimtari praktike:** Gruaja shqiptare në vitet ‘20–‘30 | Shpallja e Pavarësisë në nëntor 1912 e gjeti gruan shqiptare në një pozitë të vështirë, si në familje dhe në shoqëri. Në këtë gjendje ndikonin shumë faktorë si: prapambetja e thellë ekonomike, shoqërore e kulturore ............ | punë individuale /tryezë të rrumbullakët | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në realizimin e detyrave, kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja,* | Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme, romanin “Sikur të isha djalë”, i autorit Haki Stërmilli etj. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 46. | | **Tematika 5: Shqiptarët dhe Lufta e Dytë Botërore (1939-1944)** (8 orë) 1. | Shqipëria nën pushtimin fashist italian | Mësuesi/ja për të nxitur kureshtjen e nxënësve shfaq në monitor sekuenca mbi pushtimin fashist italian në Shqipëri: https://www.youtube.com/watch?v=RTk0tunëtYs | Diskutim / INSERT | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit në të kuptuarit e fakteve dhe ngjarjeve* | Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi etj. |
| 47. | Java 24 | 2. | Rritja e lëvizjes antifashiste në Shqipëri (1941-shtator 1943) | Mësuesi/ja për të nxitur kureshtjen e nxënësve shfaq në monitor sekuenca mbi Konferencën e Mukjes. https://www.youtube.com/watch?v=f5wkXeimzag Mësuesi/ja nxit kureshtjen e nxënësve duke drejtuar pyetje dhe organizuar diskutimin në klasë. | Diskutim / Lexim dhe mendim i drejtuar | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime* | Libri i nxënësit, harte e Shqipërisë, interneti, enciklopedi etj. |
| 48 | | 3. | Shqipëria nën pushtimin gjerman dhe qëndresa shqiptare (1943-1944) | Për të nxitur kureshtjen e nxënësve lexohet në klasë rubrika “Grimcë historike”. Mësuesi/ja shfaq ne monitor pamje të periudhës së pushtimit gjerman. Shih https://www.youtube.com/watch?v=rd97IxcfC44 | *Brainstorming/* Hartë e konceptit | *Vlerësimi i nxenësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime,ne mendimin kritik* | Libri i nxënësit, materiale filmike nga Youtube, foto të ndryshme etj. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 49. | Java 25 | **4.** | **Veprimtari praktike:** Shqiptarët e Kosovës dhe te Çamërisë gjatë Luftës II Botërore. Hebrenjtë dhe shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore | | | | |
| 50. | | **5.** | Çlirimi i vendit dhe pasojat e luftës (maj-nëntor 1944) | Mësuesja e nis orën e mësimit duke bërë një përmbledhje të shkurtër të rrugës së PKSh drejt pushtetit | Shpjegim /tabela e koncepteve | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit dhe në të menduarit kritik* | Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme, enciklopedi, hartë e Shqipërisë |
| 51. | Java 26 | 6. | **PËRSËRITJE** | Diskutim i organizuar ne klase mbi rolin që luajtën forcat e ndryshme politike për çlirimin e vendit. | Diskutim/ hap pas hapi. | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në nje liste te plote treguesish.* | Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme, enciklopedi, hartë e Shqipërisë |
| 52 | | 7. | **TEST** | | Pune me shkrim | *Vlerësim përmbledhës* | Teksti, fletat e testit. |
| 53 | Java 27 | 8. | **PROJEKT / Vlerësim i dosjes** | Diskutim rreth kritereve për anëtarësimin në B.E si dhe rreth ngjarjeve aktuale që lidhen me këtë qellim | Punë në grup | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në bashkëpunimin në grup dhe në efikasitetin e shfrytëzimit të kohës.,* | Teksti Historia 11, interneti, materiale të shkruara, materiale audiovizuale, biseda me specialistë etj. |

**PLANIFIKIMI VJETOR I LËNDËS SË HISTORISË NDARË NË TREMUJORË**

**Fusha: SHKENCA SHOQËRORE**

**Lënda: HISTORI**

**Shkalla: V**

**Klasa: XI**

**Viti shkollor: 2017-2018**

**PLANIFIKIMI I LËNDËS PËR TREMUJORIN E TRETË** **(Prill – Qershor)**

| **REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇ**<br>Orët mësimore të zhvilluara gjatë kësaj periudhe tremujore do të kontribuojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e këtyre kompetencave kyç: |
|---|
| **KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT**<br>Nxënësi:<br>- shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;<br>- dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;<br>- lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim;<br>- shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm. |
| **KOMPETENCA E TË MENDUARIT**<br>Nxënësi:<br>- shpreh mendimin e tij për një punim letrar apo artistik duke dalluar ndryshimet dhe analogjitë ndërmjet krijimeve të ngjashme; |

- harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre (letrare), duke përcaktuar hapat kryesorë të zbatimit;
- përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive ose krijimeve artistike.

**KOMPETENCA E TË NXËNIT**

Nxënësi:

- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.

**KOMPETENCA PËR JETËN, SIPËRMARRJEN DHE MJEDISIN**

Nxënësi:

- përgatit planin e punës për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses;
- bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tij social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

**KOMPETENCA QYTETARE**

Nxënësi:

- zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.

**KOMPETENCA DIGJITALE**

Nxënësi:

- përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar.
- analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedh disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).

**REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE TË FUSHËS**

- **Kërkimi historik**
- Nxënësi:

- fillon të hartojë dhe të përmirësojnë pyetjet e tij për të strukturuar një shqyrtim për zhvillimin e hipotezave, për përzgjedhjen dhe dhënien e fakteve për të nxjerrë dhe për të justifikuar konkluzionet e tij.
- përdor njohuritë e tij të fituara për të sugjeruar hipoteza, ose mund të sugjerojë hipoteza në fillim të temës, bazuar në supozimet dhe vlerat e tij, të cilat ata pastaj i teston kundrejt provave.

**Përdorimi i burimeve**

Nxënësi:

- njeh të kaluarën bazuar në fakte historike, në prova, të cilat rrjedhin nga burime të sakta historike dhe jo nga supozime paraprake në lidhje me vlefshmërinë dhe me besueshmërinë e burimeve historike të përdorura duke përfshirë vlerësimin e vlerës dhe besueshmërinë e dëshmive, duke studiuar prejardhjen e qëllimeve dhe gjuhën e burimeve.

**Interpretimi historik**

Nxënësi:

- kupton se si historianët dhe të tjerët formojnë interpretime që reflektojnë rrethanat në të cilat ato bëhen, dëshmitë në dispozicion, si dhe synimet e atyre që i bëjnë këto interpretime (p.sh.: shkrimtarë, arkeologë, historianë dhe film krijues).
- përdor mënyra të ndryshme, duke përfshirë fotografi, shfaqje, filma, tregime, muze etj.

**Analiza shkak-pasojë**

Nxënësi:

- Përdor analizën shkak-pasojë që përfshin identifikimin dhe vlerësimin e rëndësisë relative të faktorëve të ndryshëm, si dhe bërjen e lidhjeve shpjeguese ndërmjet shkakut dhe pasojës, duke pasur parasysh marrëdhënien ndërmjet argumenteve shkakësore, dëshmive dhe interpretimeve.

**Shpjegimi & komunikimi për të shkuarën**

Nxënësi:

- zhvillon dëgjimin, leximin dhe shkrimin si aftësi për të kujtuar, për të përzgjedhur, për të klasifikuar dhe për të organizuar informacionin historik, duke përdorur me saktësi terminologjinë historike për përshkrimin dhe për shpjegimin e ngjarjeve në të shkuarën.
- përdor edhe teknologjitë e reja ekzistuese sipas nevojave të tij.

**METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE**

Sugjerohet që gjatë orëve të mësimit do të përdoren metoda, teknika dhe strategji të tilla, si: *stuhi mendimi, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprakë,* diskutim për njohuritë paraprake, *harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, kubimi, diagrame*

*piramidale, , ditarët e të nxënit, pyetja sjell pyetjen, diagrami i Venit, punë në grup, ditari tre pjesësh, INSERT etj.*
Nxënësit do të punojnë në grupe të vogla dhe të mëdha, në çift, në mënyrë të pavarur dhe individuale etj.

**VLERËSIMI**

Disa nga teknikat dhe instrumentet e vlerësimit që do të përdoren gjatë vitit shkollor do të jenë:

- **Vlerësim diagnostikues** : intervistë me një listë treguesish; vetvlerësim me listëkontrolli;
- **Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues)** : vlerësimi i përgjigjeve me gojë; vlerësimi i punës në grup; vlerësim mes nxënësish vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në klasë; vlerësim i detyrave të shtëpisë; vetvlerësim; intervistë me një listë treguesish; vëzhgim me një listë të plotë treguesish; portofol; prezantim me gojë ose me shkrim; projekt kurrikular
- **Vlerësimi i të nxënit (vlerësimi përmbledhës) :** test për një grup temash të caktuara; test në përfundim të një kohe të caktuar;
- **Vlerësim i portofolit**

| Nr. | Jav a | Tematika | Temat mësimore | Situata e të nxënit (të sugjeruara) | Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve | Vlerësimi | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 54. | **27** | **Tematika 6: Shqipëria gjatë regjimit komunist (1945-1990)** (11 orë) 1. | Vendosja e regjimit komunist | Për të zhvilluar iniciativën e masave punonjëse në fushën e organizimit dhe aktivitetin e tyre politik, shteti u siguron shtetasve të drejtën që të bashkohen në organizata shoqërore:.., kooperativa, organizata sportive, shoqata kulturore etj. ............ Mësuesi/ja nxit kureshtjen e | shpjegim / punë në grupe | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit* | Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme, enciklopedi |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | nxënësve duke drejtuar pyetje dhe organizuar punën në grupe në klasë. | | | |
| 55. | Java 28 | 2. | Opozita shqiptare kundër vendosjes së regjimit komunist | Mësuesi/ja lexon pjesën “Grimcë historike” dhe, për të nxitur mendimin dhe reflektimin e nxënësve, shfaq sekuenca nga video e mëposhtme: [https://www.youtube.com/watch?v=9Ez6hqU7hog](https://www.youtube.com/watch?v=9Ez6hqU7hog) | Shpjegim/hartë e konceptit | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit* | Libri i nxënësit, interneti, botime të tjera |
| 56. | | 3. | Ekonomia socialiste dhe tiparet e saj | “Planifikimi ishte thellësisht i centralizuar dhe ekonomia rreptësisht e kontrolluar. Çdo dyqan, fabrikë, kooperativë, bankë dhe profesion ishte pronë e shtetit. Çdo doktor, avokat, mësues dhe artist ashtu sikurse çdo kasap, bukëpjekës, zgjidhej, përgatitej dhe punësohej nga shteti, si edhe duhet të jepte llogari para tij......”. Edwin Jacques, Shqiptarët, | Diskutim / pyetje – përgjigje /hartë e mendjes | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime, dhe në shfaqjen e mendimit kritik.* | Libri i nxënësit, interneti, botime të tjera. |
| 57. | Java 29 | 4. | Arsimi, kultura, shkenca, artet gjatë viteve 1945-1990 | Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë rubrikën “Grimcë historike”:<br>Gjatë epokës 40-vjeçare të Hoxhës, analfabetizmi u zhduk plotësisht. Shqipëria kishte arritur të nxirrte një numër të madh kuadrosh teknikë, të cilët | Diskutim / pyetje – përgjigje | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në* | Libri i nxënësit, botime të ndryshme, internet etj. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ishin në gjendje të drejtonin çdo aspekt të jetës.. | | *pjesëmarrjen në diskutime* | |
| 58. | | 5. | Marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë | Mësuesja për të nxitur kureshtjen e nxënësve, shfaq sekuenca materialesh filmike që trajtojnë tematikën e orës së mësimit si p.sh: https://www.youtube.com/watch?v=71qf-mFxDaë https://www.youtube.com/watch?v=ed1SsJnJdqg Më pas, mësuesja drejton pyetje për nxënësit. | Diskutim / pyetje – përgjigje | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime* | Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi, botime të ndryshme |
| 59. | Java 30 | 6. | Tipare të represionit komunist | Shfaqen sekuenca nga filmime lidhur me tematikën e mësimit https://www.youtube.com/watch?v=DOOwU2W_Z5U Në vazhdim, mësuesja nxit diskutimin e nxënësve me pyetje të ndryshme | i diskutimit /lexim dhe mendim i drejtuar | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit dhe në të menduarit kritik* | Libri i nxënësit , interneti, botime të ndryshme, enciklopedi etj. |
| 60. | | **7.** | **Veprimtari praktike** Fotomontazh mbi përdorimin e dhunës gjatë regjimit komunist | Dhuna dhe terrori janë dy prej karakteristikave më tipike të çdo regjimi diktatorial. Ato janë mjete të rëndësishme për të kontrolluar popullsinë dhe për të mbytur çdo tentativë disidence apo kundërshti ndaj regjimit. Edhe në Shqipëri, dhuna dhe terrori ishin prezente duke filluar menjëherë pas ardhjes në | punë në grupe/ tryezë e rrumbullakët | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në realizimin e detyrave, kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në* | Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme etj. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | pushtet të Partisë Komuniste *pas Luftës së Dytë Botërore. .....* | | *pjesëmarrjen në diskutime* | |
| 61. | Java 31 | **8.** | Kriza e regjimit komunist | Mësuesi/ja për të nxitur kureshtjen e nxënësve shfaq në monitor sekuenca mbi Shqipërinë e viteve 1981 - 1989. https://www.youtube.com/watch?v=kbaOs_2Së24 | Diskutim / INSERT | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit në të kuptuarit e fakteve dhe ngjarjeve* | Libri i nxënësit , interneti, enciklopedi |
| 62. | | **9.** | **Veprimtari praktike** Jeta e përditshme Ne regjimin komunist. | Pas viteve '90, jeta e përditshme në Shqipëri ka ndryshuar diametralisht krahasuar me atë të periudhës komuniste. Shkolla, koha e lirë por edhe gjërat e rutinës së përditshme kanë marrë tashmë një karakter dhe tipare të tjera si pasojë e ndryshimit të kushteve politike, ekonomike dhe shoqërore pas vendosjes së pluralizmit politik. ......... https://www.youtube.com/watch?v=o_38xpC6CrQ *https://www.youtube.com/watch?v=888VajYfefk* | Rrjeti i diskutimit/ Vështrim krahasues | *Vlerësimi i nxënësit mbështete në realizimin e detyrave, kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime* | Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme ,shtypi i kohës. |
| | Java | 10. | Kosova dhe | Mësuesi /ja shfaq në klasë | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 63. | 32 | | shqiptarët në Republikën e Jugosllavisë (1945–1989) | sekuenca nga dokumentarë që trajtojnë tematikën e Kosovës në periudhën e pas luftës II Botërore. https://www.youtube.com/watch?v=mKjDmMslRmI<br><br>https://www.youtube.com/watch?v=wsrnKJVOwBw (min. 6:19 – 9.46) | Diskutim / pyetje – përgjigje/hartë e konceptit | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime* | Diskutim / pyetje – përgjigje/hartë e konceptit |
| 64. | | 11. | **Veprimtari praktike**<br>Regjimi i pushtimit serb në Kosovë.<br>Procesi i diferencimit etnik e politik të shqiptarëve | Pas vitit 1981, qeveria jugosllave e forcoi dhunën dhe represionin ndaj shqiptarëve. Ajo tkurri në vijimësi liritë politike dhe të drejtat njerëzore e kombëtare të tyre. Për diskriminimin etnik të tyre u iniciua i ashtuquajturi "proces i diferencimit ideopolitik". Qëllimi i tij ishte likuidimi i institucioneve vetëqeverisëse të tyre....... | harta e mendimeve | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në realizimin e detyrave, kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime* | Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme etj. |
| 65. | Java 33 | **Tematika 7: Rënia e regjimit komunist. Fitorja e demokracisë** (8 ore)<br>**1.** | Lëvizja studentore e dhjetorit (1990) dhe rrëzimi i regjimit komunist | Mësuesja e nis orën e mësimit me një material filmik mbi protestat studentore të dhjetorit 1990: https://www.youtube.com/watch?v=Ohww934D3pA | Shpjegim /tabela e koncepteve | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit* | Libri i nxënësit , interneti, botime të ndryshme, enciklopedi etj. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 66. | | 2. | Tranzicioni demokratik në Shqipëri (1990-2014) | Për të nxitur reflektimin dhe interesin e nxënësve, mësuesja shfaq materiale filmike lidhur me tematikën e orës së mësimit si p.sh: https://www.youtube.com/watch?v=1l1Q1iËPg0I (min. 11:00 – 17:00 | Diskutim / Lexim dhe mendim i drejtuar | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskut* | Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi, botime të ndryshme etj. |
| 67. | Java 34. | 3. | Procesi i integrimit euroatlantik të Shqipërisë (1990-2014 | Mësuesi/ja lexon grimcën historike dhe nxit diskutimin e nxënësve nëpërmjet pyetjeve të ndryshme. | Shpjegim/hartë e konceptit | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit* | Libri i nxënësit, interneti, botime të tjera |
| 68. | | 4. | Shpallja e Pavarësisë dhe ngritja e shtetit demokratik të Kosovës (1990-2014) | Shfaqen sekuenca nga dokumentarë për luftën e Kosovës 1998 – 1999. Shih: https://www.youtube.com/watch?v=YAT0oWdogtU https://www.youtube.com/watch?v=x0OpYoDbI-I | Rrjeti i diskutimit /lexim dhe mendim i drejtuar | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit dhe në të menduarit kritik.* | Libri i nxënësit , interneti, botime të ndryshme, enciklopedi etj. |
| 69. | Java 35. | 5. | **Veprimtari praktike** Qytetari në demokraci | *Demokracia është një sistem që* nxjerr në plan të parë lirinë e individit. Në këtë kuadër, roli i këtij të fundit si qytetar është esencial në dy drejtime kryesore: | Punë në grup/Vështrim krahasues | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në realizimin e detyrave, kontributin dhe* | Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme etj. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | qytetari duhet të japë kontributin e tij në respektimin e rregullave dhe ligjeve që hapësira e lirisë *të mos kthehet në anarki* | | *aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime* | |
| 70. | | 6. | **PËRSËRITJE** | Mësuesi/ja shfaq në monitor pamje nga jeta në komunizëm Shih: muzeuimemories.info | Hap pas hapi | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në nje liste te plote treguesish* | Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme, enciklopedi, hartë e Shqipërisë |
| 71. | Java 36 | 7. | **TEST** | | Pune me shkrim | *Vlerësimi përmbledhës* | Teksti, fletat e testit |
| 72. | | 8. | **PROJEKT /Vlerësim i dosjes** | Prezantimi i projektit | Punë në grup, hulumtim | *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në bashkëpunimin në grup dhe në efikasitetin e shfrytëzimit të kohës.* | Teksti Historia 11, interneti, materiale të shkruara, materiale audiovizuale, biseda me specialistë etj. |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Gjurmë të parahistorisë në territoret shqiptare | | **Situata e të nxënit:**<br>Një nxënës lexon në klasë rubrikën "Grimcë historike":<br>"...Pellazgët e kishin zakon t'u flijonin perëndive çdo gjë, sikurse e mësova në, Dodonë, dhe ata nuk kishin për ta ndonjë emër, pasi nuk i ka dëgjuar njeri t'i thërrisnin me emra. Ata i thërrisnin në përgjithësi si perëndi, për arsye se pasi kishin vënë të gjitha gjërat në rregull, mbanin ligjet e gjithësisë..." | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**<br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës që janë të diskutueshme.<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br><br>**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**.<br>Nxënësi:<br>➢ identifikon ekzistencën e kulturave parahistorike dhe avancimin e këtyre kulturave; | | **Fjalët kyçe:**<br>- *era parahistorike;*<br>- *era historike;*<br>- *epoka e gurit;*<br>- *paleoliti;*<br>- *mezoliti;*<br>- *neoliti;*<br>- *epoka e metaleve,*<br>- *periudha e bakrit;*<br>- *periudha* **e** *bronzit;*<br>- *periudha e hekurit;*<br>- *tuma;*<br>- *ndërgjegje e përbashkët kulturore.* | |

| | |
|---|---|
| ➢ përcakton në hartë qendrat e banuara parahistorike;<br>➢ evidenton veçoritë e organizimit shoqëror në parahistori;<br>➢ shpjegon shkaqet dhe pasojat e ndryshimit të shoqërisë në parahistori;<br>➢ shpjegon procesin e kalimit nga epoka e gurit në atë të metaleve;<br>➢ gjykon ndryshimet që solli lindja e bujqësisë dhe zbulimi i metaleve në jetën e njeriut. | |
| **Burimet:**<br>• libri i nxënësit, hartë arkeologjike e territorit shqiptar, interneti etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- arkeologjia;<br>- gjeografia etj. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** diskutim, punë në grupe, hartë e koncepteve.

**Organizimi i orës së mësimit**

- Mësuesi/ja për të nxitur kureshtjen e nxënësve cakton një nxënës që të lexoje rubrikën “Grimcë historike”
- Nxiten nxënësit në diskutim nëpërmjet pyetjeve.
  - Çfarë dini ju rreth pellazgëve?
  - Ku jetonin ata?
  - Cilët janë pasardhësit e tyre?
- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin, duke i ndarë në grupe si më poshtë:

  *Grupi i parë*
  - Si ndahet historia e zhvillimit të shoqërisë njerëzore?
  - Cili është harku kohor në të cilin shtrihen këto ndarje te historisë?

  *Grupi i dytë*
  - Kur janë dokumentuar gjurmët e njeriut të parë në vendin tonë?
  - Cili ishte njeriu me i hershem që ka banuar në territoret e vendit tonë? A kemi gjetje të fosileve të tij?
  - Cilat janë periudhat në të cilat ndahet epoka e gurit?
  - Evidentoni veçori të secilës prej tyre.

*Grupi i tretë*

- Cilat janë periudhat në të cilat ndahet epoka e metaleve?
- Evidentoni veçori të secilës prej tyre.

- Caktohen më shumë nxënës në grupin e dytë dhe të tretë me qëllim që të ndahen në nëngrupe për të identifikuar veçori të secilës periudhë.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja orienton nxënësit, duke ndërtuar skicën në tabelë, e cila plotësohet sipas detyrave të përcaktuara për secilin grup.




- Nxënësit i përgjigjen pyetjeve rreth veçorive të secilës periudhë dhe plotësohet tabela e mëposhtme:

| **Paleoliti** | **Mezoliti** | **Neoliti** | Periudha e bakrit (Eneoliti 4000 – 3000 p.e.s.) | Periudha e bronzit | Periudha e hekurit |
|---|---|---|---|---|---|
| - Për Paleolitin e ulët kemi shumë pak të dhëna.<br>- Në periudhën e Paleolitit të mesëm ka jetuar njeriu i Neandertalit.<br>- Paleoliti i lartë dallohet për:<br>- vendqëndrime të hapura, shpella karstike;<br><br>- shfaqjet e para të artit në histori. | - karakterizohet nga disa ndryshime të rëndësishme klimatike;<br>- krijohen veglave të reja prej stralli;<br>- shpikja e harkut dhe e shigjetës;<br>- mbjellja e bimëve dhe zbutja e kafshëve të para. | - zëvendësim i veglave me ato prej guri të lëmuar;<br>-vendbanime të qëndrueshme;<br>- praktikimi i bujqësisë dhe i blegtorisë;<br>- filloi prodhimi i qeramikës;<br>- krijimi i objekteve artistike;<br>- kultura neolitike konsiderohet "qytetërim neolitik";<br>- u krijuan kushtet për zhvillimin e endjes, tjerrjes.<br>- vendbanimet janë të hapura, shpellore, palafite. | - Guri vazhdoi të ishte materiali kryesor i veglave, por filloi dhe shfaqja e bakrit.<br>- Ndryshimet që vihen re i përkasin fushës së kulturës materiale.<br><br>- Shfaqen forma të reja enësh dhe zbukurime kryesisht në reliev.<br>- Popullsia neo-eneolitike e vendit tonë ishte paleoindoeuropiane dhe njihej si popullsia pellazge. | - shfaqet punimi i bronzit dhe njohuritë teknologjike për të;<br><br>- shfaqen vendbanimet e fortifikuara me mure rrethuese;<br><br>- shfaqjet riti i varrimit me tuma;<br><br>- vihen re ndryshime të mëdha edhe në prodhimin e qeramikës. | - futet në përdorim metali i hekurit;<br>-vendbanimet vendoseshin në maja kodrash;<br>- tumat ishin mënyra e varrimit;<br>- përdorej riti i vendosjes së trupit në varr si dhe me djegie të trupit;<br>- nga fundi i epokës së hekurit krijohen tiparet dhe territoret e shtrirjes së fiseve ilire. |

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. identifikon kufirin ndarës mes historisë dhe parahistorisë;
2. evidenton në një shkallë kohe, epokat e ndryshme të parahistorisë;
3. tregon ndryshimet që karakterizojnë epokën e bakrit nga pikëpamja shoqërore dhe ekonomike;
4. identifikon dukje periudhën kur nis të formohet ndërgjegjja ilire në territoret e Ballkanit Perëndimor.

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna, në pjesëmarrjen në diskutime dhe në bashkëpunimin në grup.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

- Nxënësve u jepet si detyrë rubrika " Mendoni në mënyrë kritike".

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkolla: | Klasa: 11 |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Ilirët, prejardhja dhe shtrirja territoriale e tyre. | | **Situata e të nxënit:**<br><br>Për të nxitur kureshtjen e nxënësve lexohet në klasë rubrika "Grimcë historike".<br>Mësuesi/ja shfaq në monitor pamje të gjetjeve të ndryshme arkeologjike që i përkasin kulturës ilire. Shih:<br>https://www.youtube.com/watch?v=5HwnXxbroTw | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme.<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>**Kompetenca personale.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, për të vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve qofshin këto dhe të ndryshme nga të tijat. | | **Fjalët kyçe:**<br>- *etnogjeneza e ilirëve;*<br>- *autoktonë;*<br>- *bashkësi etnike;*<br>- *hapësirë territoriale;*<br>- *Ballkani perëndimor;*<br>- *epirotë.* | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.**<br>Nxënësi:<br>➢ evidenton tezat e ndryshme për etnogjenezën e ilirëve;<br>➢ përcakton në hartë shtrirjen e fiseve kryesore ilire;<br>➢ evidenton tiparet e qytetërimit ilir; | | | |

| **Burimet:** | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| • Libri i nxënësit, hartë arkeologjike e territorit shqiptar, hartë e fiseve ilire, youtube - https://www.youtube.com/watch?v=5HwnXxbroTw etj. | - arkeologjia;<br>- gjeografia etj. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** stuhi mendimesh, hartë e konceptit.

**Organizimi i orës së mësimit**

- Mësuesi/ja për të nxitur kureshtjen e nxënësve cakton një nxënës që të lexoje rubrikën "Grimcë historike".
- Shfaqen në monitor pamje te gjetjeve të ndryshme arkeologjike që i përkasin kulturës ilire. Shih https://www.youtube.com/watch?v=5HwnXxbroTw .
- Nxiten nxënësit të marrin pjesë në mësim duke i pyetur se ç'dinë rreth popullsisë ilire. Mendimet që shfaqin nxënësit shkruhen në tabelë pa i paragjykuar ato.




**Ndërtimi i njohurive:**
- Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë mësimin, duke nënvizuar pjesët kryesore.
- Ndërtohet në tabelë harta e konceptit "Ilirët" dhe mësuesi/ja e plotëson atë me përgjigjet e nxënësve/eve.
  - Kur shfaqet për herë të parë emri i ilirëve?
  - Kur është krijuar etnogjeneza ilire?
  - Ku janë evidentuar tipare të përbashkëta të fiseve ilire?

- Cilat janë teoritë për sa i përket prejardhjes ilire?
- Përcaktoni në hartë shtrirjen e territoreve ilire.
- Përcaktoni në hartë shtrirjen e fiseve kryesore ilire dhe epirote.



- Për të përcaktuar shtrirjen e fiseve ilire dhe territoret ilire punohet me hartë e tekstit, me hartë murale ose shfaqet në projektor harta e fiseve ilire.

- Për të nxitur të menduarit kritik të nxënësve mësuesi/ja shtron pyetjet për diskutim.

- Pse kufijtë jugorë të ilirëve janë të diskutueshëm? Argumentoni mendimin tuaj.
- Cili është shkaku i përpjekjes së madhe që është bërë dhe bëhet për mohimin e karakterit autokton të popullsisë ilire në Ballkanin Perëndimor.

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. tregon popullsitë antike fqinje të ilirëve në gadishullin e Ballkanit;
2. identifikon periudhën kur u konsolidua ndërgjegjja kulturore dhe etnike ilire;
3. evidenton gjeografikisht shtrirjen e hapësirës etnike ilire;
4. evidenton në hartë shtrirjen e fiseve kryesore ilire

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tij në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime, në aftësinë për të punuar me hartën në shfaqjen e mendimit kritik.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

- Hulumtoni mbi fiset ilire që kanë pasur shtrirje në zonën tuaj, duke evidentuar elemente të ndryshme të tyre si dhe mbi disa prej qyteteve me të rëndësishme ilire.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkolla: | Klasa: 11 |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Jeta ekonomike e shoqërore e ilirëve | | **Situata e të nxënit:**<br><br>- Nxënësit prezantojnë detyrën që u ishte dhënë orën e mëparshme:<br>Disa prej tyre identifikojnë fiset ilire që shtriheshin në zonën e tyre të banimit dhe nxënës të tjerë prezantojnë në monitor pamje dhe të dhëna rreth disa prej qyteteve më të rëndësishme ilire.<br>-Më pas për të nxitur kureshtjen e nxënësve mësuesi/ja shfaq në monitor pemën e gjuhëve indoevropiane.Shih http://www.shqiperia.com/shqiperia/images/Pema%20e%20Gjuheve%20IndoEuropiane%20-%20shqip.jpg. | |

| | |
|---|---|
| **<u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u>**<br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi:<br>• përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi:<br>• përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.<br>**Kompetenca digjitale.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë digjitale për të kërkuar, për të përzgjedhur, për të analizuar dhe për të komunikuar informacion historik. | **Fjalët kyçe:**<br>- *periudha proto-urbane;*<br>- *artizanati;*<br>- *qeramika;*<br>- *besimet;*<br>- *mitet;*<br>- *gjuhë indo-evropiane;*<br>- *antroponimi;*<br>- *toponimi.* |
| **<u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>**.<br>Nxënësi:<br>➢ dallon tiparet ekonomike e shoqërore të fiseve ilire nga shekullin V deri në shekullin II para Krishtit;<br>➢ evidenton procesin e lindjes së qyteteve ilire;<br>➢ analizon rolin e qyteteve në jetën e popullsisë ilire;<br>➢ tregon rrugët e zhvillimit të zejtarisë në qytetet ilire;<br>➢ identifikon prejardhjen e gjuhës ilire dhe lidhjet e saj me gjuhën shqipe. | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, hartë arkeologjike e territorit shqiptar, interneti etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- arkeologjia;<br>- gjuha dhe letërsia;<br>- gjeografia etj. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** prezantim, diskutim, tabela e koncepteve.

**Organizimi i orës së mësimit**

- Nxënësit prezantojnë detyrën që u ishte dhënë orën e mëparshme:
- Disa prej tyre identifikojnë fiset ilire që shtriheshin në zonën e tyre të banimit dhe nxënës të tjerë prezantojnë në monitor pamje dhe të dhëna rreth disa prej qyteteve më të rëndësishme ilire.
- Më pas për të nxitur kureshtjen e tyre mësuesi/ja shfaq në monitor pemën e gjuhëve indoevropiane.
  Shih http://www.shqiperia.com/shqiperia/images/Pema%20e%20Gjuheve%20IndoEuropiane%20-%20shqip.jpg .
- Mësuesi/ja nxit diskutimin duke pyetur nxënësit: - Cilët janë disa prej qyteteve me të njohura ilire?
  Nxënësit i gjejnë në hartë dhe tregojnë se ku shtrihen këto qytete në ditët e sotme.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë mësimin dhe ndërton tabelën e koncepteve.
- Për të plotësuar tabelën mësuesja aktivizon nxënës të ndryshëm.

| Koncepti | Komenti |
|---|---|
| Veçori të qyteteve ilire | - Qytetet e para u krijuan që në fundin e shekullit V p.e.s.<br>- Parakushtet për lindjen e qyteteve ilire ishin: ⇒ - zhvillimi i bujqësisë, - zhvillimi i artizanatit, - zhvillimi i blegtorisë, - intensifikimi i këmbimeve me botën.<br>- Ngriheshin në maja kodrash të larta.<br>- Hapësira e brendshme ishte e organizuar si: ⇒ zonë banimi; zonë për aktivitete publike; zonë për aktivitete fetare dhe kulti; zonë për aktivitete ekonomike dhe tregu, zonë ushtarake |

| | |
|---|---|
| | - Arkitektura: ⟹ - u ngritën shëtitore;<br>- u ndërtuan teatro;<br>- u ndërtua stadiumi;<br>- tempuj;<br>- ndërtesa administrative,<br>depozita uji,<br>banesa të tipave të ndryshme.<br><br>- Jetë aktive shoqërore: organizim administrativ, shtresëzim shoqëror, organizimin e edukimit, përgatitjes ushtarake, e të tjera elemente që shënuan ndryshime cilësore në jetën e popullsive ilire. |
| Zhvillimi i veprimtarive ekonomike | Prodhimet zejtare →<br>**Qeramika:** - për përdorim të gjerë;<br>- si material ndërtimi;<br>- si objekte të përdorimit të përditshëm shtëpiak;<br>- si dhe objekte artistike.<br><br>**Punimi i gurit** vihet re:<br>- në ndërtimet e mëdha publike e private;<br>- në përdorimin e shumë veglave të punës si:<br>për nxjerrjen e blloqeve në gurore<br>për ngritjen e muraturës.<br><br>**Punimi i metaleve** ishte një proces i koklavitur pasi nënkuptonte: --<br>aftësinë për të siguruar mineralet metalike,<br>- importimin nga larg të metaleve,<br>- derdhjen dhe punimin e metaleve<br>- si dhe organizimin e komplikuar dhe ndarjen shoqërore të punës |

| | |
|---|---|
| | Zeje të tjera ⇒ punimi i drurit,<br>i lëkurës,<br>i tekstileve. |
| Edukimi tek ilirët | - u ngritën institucione të veçanta për;<br>- edukimin dhe arsimimin e qytetarëve të rinj;<br>- për përhapjen e shkrimit dhe këndimit;<br>- për përhapjen e edukatës qytetare,<br>- për përgatitjen fizike e ushtarake. |
| Besimi ilir | - Perënditë kryesore si Zeusi, Artemisi, Poseidoni, Afërdita, Asklepi, plotësoheshin dhe shpreheshin me elemente lokale ilire;<br>- ekzistenca e shumë miteve ilire lidhej:<br>me prejardhjen e fiseve,<br>me themelimin e qyteteve të ndryshme ilire,<br>me admirimin e veçantë për kafshë (gjarpri), objekte dhe fenomene natyrore (dielli). |
| Gjuha ilire | - Ilirët flisnin gjuhën e tyre, ilirishten.<br>- Ilirishtja ishte një gjuhë indoevropiane.<br>- Gjurmë të ilirishtes ruhen në shqipen e sotme.<br><br>- Argumentet që vërtetojnë lidhjen e ilirishtes me shqipen: ⇒<br>- trualli i njëjtë historik;<br>- shpjegimi me anë të shqipes i shumë fjalëve ilire të trashëguara;<br>- marrëdhëniet aktive të ilirishtes me format arkaike të greqishtes së vjetër dhe latinishtes;<br>- terminologjia e hershme detare e ilirishtes;<br>- emrat ilirë shkruhen me alfabetin grek ose latin, sepse nuk kemi gjurmë të shkruara të ilirishtes. |

**Pyetje për diskutim**
Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:
1. evidenton procesin e lindjes së qyteteve ilire;
2. analizon rolin e qyteteve në jetën e popullsisë ilire. përshkruani organizimin tipik të një qyteti ilir;
3. tregon rrugët e zhvillimit të zejtarisë në qytetet ilire;
4. identifikon emra ilirë që janë në përdorim deri në ditët tona.

***Vlerësimi:***
*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna, në pjesëmarrjen në diskutime si dhe në përzgjedhjen e burimeve të informacionit për realizimin e detyrës së dhënë.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**
- Krahasoni elemente të qytetërimit grek me atë ilir.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkolla: | Klasa: 11 |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Shteti ilir | | **Situata e të nxënit:**<br>Për të nxitur kureshtjen e nxënësve mësuesi/ja organizon në klasë një veprimtari në formën e një kuici.<br>Nëpërmjet pyetjeve rikujtohen njohuri që nxënësit kanë mësuar në temat e mëparshme ose dhe në klasën e dhjetë si dhe bëhet lidhja e tyre me njohuritë e reja. | |

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**

**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi:

• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme.

**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi:

- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.

**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.** Nxënësi:

• zhvillon aftësitë për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin për të identifikuar dhe vlerësuar burimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjes historike.

**Fjalët kyçe:**

- *formacione shtetërore;*
- *shteti ilir;*
- *shteti i Epirit;*
- *mbretëria Dardane;*
- *kolonitë helene.*

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**

Nxënësi:

- evidenton tiparet e qytetërimit ilir;
- përcakton format kryesore të organizimit shtetëror në territoret ilire;
- vlerëson kontributin e mbretërive ilire dhe drejtuesve të tyre në zhvillimin e qytetërimit ilir;
- përcakton në hartë shtrirjen e kolonive greke në territorin ilir;
- gjykon rolin që luajtën kolonitë greke në shkëmbimin kulturor ndërmjet dy qytetërimeve.

**Burimet:**

- Libri i nxënësit, hartë e fiseve ilire, interneti, botime të ndryshme, enciklopedi.

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**

- gjeografia;
- temat e mëparshme etj.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** kuic, punë në grupe.

**Organizimi i orës së mësimit:**

- Për nxitur kureshtjen e nxënësve mësuesi/ja organizon ne klasë një veprimtari në formën e një kuici.
- Nëpërmjet pyetjeve rikujtohen njohuri që nxënësit i kanë mësuar në temat e mëparshme ose në klasën e dhjetë dhe bëhet lidhja e tyre me njohuritë e reja. Pyetjet që mund të drejtohen:

- Kur mendohet se është shfaqur popullsia ilire në Ballkanin Perëndimor?
- Cili autor na sjell të dhënat e para rreth popullsisë ilire?
- Kur u krijuan qytetet e para ilire?
- Cilët ishin disa nga qytetet me të njohura të ilirëve?
- Si quhej fisi që shtrihej rreth liqenit të Ohrit dhe Prespës?
- Po fisi që jetonte rreth liqenit të Shkodrës?
- Cili fis jetonte në prapatokën e Durrahut dhe Apolonisë?
- Paraardhës të cilës popullsi janë helenët?
- Kujtoni ç'ishin kolonitë helene? Ku shtriheshin ato?

- Mësuesi/ja organizon nxënësit në tri grupe dhe i udhëzon të lexojnë, duke i caktuar secilit grup nga një çështje të mësimit.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Nga secili prej grupeve një nxënës/e del në tabelë ku shpjegon dhe shkruan informacionin kryesor të pjesës përkatëse, nxënësit e tjerë të grupit plotësojnë ose korrigjojnë shokun.
- Mësuesi/ja ndjek veprimtarinë në klasë, duke pasur kujdes që të prezantohen dhe sqarohen të gjitha njohuritë e reja.
- *Grupi i parë*. Lindja dhe zhvillimi i shtetit ilir

Lindja dhe zhvillimi i shtetit ilir

- formacioneve të para shtetërore te ilirët u krijuan nga mesi i shekullit V p.e.s.
- këto formacione ishin:
  - Mbretëria Ilire;
  - Shteti i Epirit nga gjiri i Artës - në luginën e Vjosës;
  - Mbretëria Dardane shtrihej në territoret e brendshme (Kosova e sotme);
  - Qytet-shtete si Dyrrahu dhe Apolonia.
- Veçori të shtetit ilir
  - Fiset ruajtën njëfarë pavarësie dhe autoritetin e prijësit të tyre lokal.
  - Problemet ushtarake dhe ato të politikës së jashtme u trajtuan nga mbretëria.
  - Shtrirja e territorit të ndikimit të mbretërive ilire ka qenë e ndryshme në kohë të ndryshme. Mbretëria ilire u zhvendos nga fisi i enkelejve te fisi i taulantëve dhe në fiset e labeatëve dhe ardianëve.

- *Grupi i dytë*. Mbretëritë ilire

**Mbretëritë ilire**

**Mbretëria e parë** →

- U formua që në fundin e shekullit V p.e.s.
- U drejtua nga Dinastia e Bardhylit deri në mesin e shekullit IV p.e.s. (350 p.e.s.).
- Qendra politike ishte territori i fisit të enkelejve.
- Pati konflikte të vazhdueshme territoriale me Maqedoninë.
- U dobësua pas vdekjes së Bardhylit si dhe pas ardhjes në pushtet të Aleksandrit të Madh dhe sulmeve maqedonase.

**Mbretëria e dytë** →

- Rimëkëmbja e saj u bë në çerekun e fundit të shekullit IV p.e.s.
- Dinastia e re ilire ishte ajo e Glaukisë.
- Qendra politike ilire u zhvendos te taulantët.
- Mbretëria ilire shtriu zotërimin e vet edhe mbi Durrësin e Apoloninë.
- Ndërhyri në punët e brendshme të shtetit të Epirit, duke vënë në fron Pirron në 309 p.e.s.
- Në mesin e shekullit III p.e.s., mori fund sundimi i dinastisë së Glaukisë.

**Mbretëria e tretë** →

- Qendra politike shkon, në territorin e fisit të forcuar të Ardianëve dhe Labeatëve.
- Shkodra bëhet kryeqendra e mbretërisë.
- Mbretërit më të njohur ishin Pleurati, Agroni, Teuta, Genti.
- U forcua ushtria dhe i flota ilire.
- Ky fuqizim i Mbretërisë Ilire dhe kontrolli i Adriatikut u bënë shkak i konflikteve të mëdha iliro-romake.
- Fundi i mbretërisë u shënua në vitin 168 p.e.s pas luftrave iliro-romake.

- *Grupi i tretë.* Kolonitë helene në bregdetin ilir

**Kolonitë helene në bregdetin ilir**

- U krijuan në fundin e shekullit VII p.e.s.
- Fillimisht korintasit themeluan koloninë e Korkyrës.
- Rreth 627 p.e.s. themeluan Dyrrahun dhe pak më vonë edhe Apoloninë.
- Nga mesi i shekullit VI p.e.s. u themelua edhe Oriku.
- Këto koloni u themeluan në territore të banuara më parë nga ilirët, elementi ilir i popullsisë së tyre ishte dominues.
- Kolonitë ruajtën një status pak a shumë të pavarur në gjirin e shtetit ilir.

| |
|---|
| **Pyetje për diskutim**<br>Situata quhet e realizuar nëse nxënësi /ja:<br>1. evidenton formacionet kryesore politiko-territoriale ilire;<br>2. analizon raportet mes fiseve ilire dhe Mbretërisë Ilire;<br>3. shpjegon arsyet e ndryshimit të qendrës politike të Mbretërisë Ilire në periudha të ndryshme;<br>4. evidenton periudhën e fuqizimit më të madh të Mbretërisë Ilire;<br>5. tregon pozicionin e kolonive greke në raport me Mbretërinë Ilire. |
| ***Vlerësimi:***<br>*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në pjesëmarrjen në orën e mësimit, në bashkëpunimin në grup, në argumentet e paraqitura rreth fakteve që u diskutuan.* |
| **Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>• Analizoni elementet që i japin karakter shtetformues formacioneve të ndryshme shtetërore te ilirët. |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Historia** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Projekt :Shteti shqiptar, sa larg dhe afër Evropës<br>(Përcaktimi i temës, ndarja e grupeve) | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja nxit kureshtjen e nxënësve mbi temën e cila do të trajtohet në projekt duke shfaqur një video të shkurtër rreth ecurisë dhe marrëveshjeve të nënshkruara me B.E. Shih https://www.youtube.com/watch?v=vhFisJ-k7U | |

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**

**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi:

- zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë;

**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi:

- parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime.

**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.** Nxënësi:

- harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë.

**Kompetenca personale.** Nxënësi:

- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave.

**Fjalët kyçe:**

- *Bashkimi Evropian;*
- *liberalizim i vizave;*
- *Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit,*
- *Parlamenti Evropian;*
- *reforma në drejtësi.*

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**.

Nxënësi/ja:

- evidenton rrethanat historike dhe pozitën e trojeve shqiptare në fillim të shek. XX;
- analizon qëndrimet e Fuqive të Mëdha ndaj procesit të krijimit të shtetit të pavarur shqiptar;
- vë në dukje përpjekjet e qarqeve patriotike shqiptare për konsolidimin e pozitës së shtetit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris dhe qëndrimin e Fuqive të Mëdha;
- vlerëson politikën e jashtme të monarkisë shqiptare;
- evidenton pozitën e Shqipërisë dhe shtetit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore;
- analizon aleancat dhe pozicionin ndërkombëtar të shtetit komunist shqiptar pas luftës;
- përshkruan politikën e izolimit në marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë komuniste;
- identifikon hapat e Shqipërisë në procesin e integrimit evropian.

| **Burimet:** | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| • teksti "Historia 11", interneti, materiale të shkruara, materiale audiovizuale, biseda me specialistë etj. | - qytetaria;<br>- TIK;<br>- gjeografia etj. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** punë në grup, hulumtim.

**Organizimi i orës së mësimit:**

- Mësuesi/ja nxit kureshtjen e nxënësve mbi temën e cila do të trajtohet në projekt duke shfaqur një video të shkurtër rreth ecurisë dhe marrëveshjeve të nënshkruara me B.E. Shih https://www.youtube.com/watch?v=vhFisJ-k7U.
- Mësuesi/ja shkruan temën në tabelë.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Nxënësit/et ndahen në grupe nga mësuesi/ja, duke u orientuar nga periudhat e ndryshme të historisë së marrëdhënieve ndërkombëtare të shtetit shqiptar. Përveç prezantimit të punës në grup, synohet të ndërtohet një vështrim krahasues në kohë i politikës së jashtme të shtetit shqiptar.

Grupi i parë: • Shpjegon i rrethanave historike të trojeve dhe popullsisë shqiptare në përfundim të procesit të shpërbërjes së Perandorisë Osmane dhe rreziqet me të cilat përballeshin ato.

Grupi i dytë: • Evidentimi i rolit të Fuqive të Mëdha evropiane dhe qëndrimet në favor apo kundër shtetit shqiptar duke analizuar përplasjet e interesave mes tyre.

Grupi i tretë: • Arsyetimi i raportit mes përpjekjeve të faktorit të brendshëm dhe konjukturave ndërkombëtare, në konsolidimin e pozitave ndërkombëtare të Shqipërisë.

Grupi i katërt: • Analizimi i koncepteve "bashkim personal", "Shqipëri e Madhe", "pavarësi relative", në kuadër të pozitës së shtetit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Grupi i pestë • Hulumtimi i ndryshimeve në politikën e jashtme të shtetit komunist shqiptar, orientimin e tij në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe ndryshimet e aleancave

- Mësuesi/ja informon nxënësit që në fazën përfundimtare do të organizohet debat mbi tiparet, ngjarjet kryesore dhe politikat përcaktuese të pozicionit të Shqipërisë në raport me marrëdhëniet ndërkombëtare drejt një izolimi progresiv.
- Pas njohjes mbi temën e projektit nxënësit/et:

| |
|---|
| - grupohen sipas grupeve;<br>- zgjedhin liderin e grupit;<br>- caktojnë detyrat për secilin anëtar të grupit;<br>- vendosin paraprakisht se në çfarë mënyre do të prezantohet projekti.<br>**Pyetje për diskutim**<br>Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:<br>1. njeh temën e projektit dhe kërkesat për realizimin e saj;<br>2. identifikon burimet e informacionit të nevojshëm për realizimin e projektit;<br>3. përcakton detyrat dhe afatin e realizimit të tyre. |
| ***Vlerësimi:***<br>*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në bashkëpunimin në grup dhe në efikasitetin e shfrytëzimit të kohës.* |
| **Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>• Hulumtoni dhe përzgjidhni materialin sipas detyrave të caktuara brenda grupit. |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Shteti i Epirit | | **Situata e të nxënit:**<br>Lexohet nga nxënësit rubrika "Grimca historike":<br>"...Gjatë fushatës së Pirros, romakët lidhën edhe një marrëveshje me kartagasit... Ajo përmbante të gjitha pikat e marrëveshjeve të mëparshme, por i shtohej edhe kjo: "Në qoftë se njëri ose tjetri nga të dy shtetet bënte aleancë me Pirron, ai duhej të shënonte me shkrim këtë kusht:.."<br>Mësuesi/ja nxit kureshtjen e nxënësve, duke drejtuar pyetje dhe duke organizuar diskutimin në klasë. | |

<table>
<tr><td>

<u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Nxënësi:<br>
• përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.<br>
Kompetenca e të menduarit. Nxënësi:<br>
• zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.<br>
Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. Nxënësi:<br>
• diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e të tashmes dhe perspektivat e të ardhmes.<br>
Kompetenca personale. Nxënësi:<br>
• përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.

</td><td rowspan="2">

Fjalët kyçe:<br>
- shtet federativ;<br>
- Lidhje molose;<br>
- Aleanca epirote;<br>
- Lidhja Epirote.

</td></tr>
<tr><td>

<u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>.<br>
Nxënësi:<br>
➢ përcakton në hartë shtrirjen e shtetit të Epirit;<br>
➢ shpjegon format kryesore të organizimit politik, ekonomik dhe shoqëror të shtetit të Epirit;<br>
➢ analizon rrugët se si Pirroja e konsolidoi pushtetin e tij mbretëror;<br>
➢ vlerëson rolin e shtetit të Epirit në qytetërimin ilir.

</td></tr>
<tr><td>

Burimet:<br>
• Libri i nxënësit, hartë e fiseve Epirit, interneti, enciklopedi etj.

</td><td>

Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>
- gjuha dhe letërsia;<br>
- gjeografia;<br>
- arkeologjia etj.

</td></tr>
<tr><td colspan="2" align="center">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

**Metodologjia:** diskutim, lexim dhe mendim i drejtuar.

**Organizimi i orës së mësimit:**

- Lexohet nga nxënësit rubrika “Grimca historike”
- Mësuesi/ja nxit kureshtjen e nxënësve duke drejtuar pyetje dhe organizuar diskutimin në klasë.
  - Cilat ishin formacionet e para shtetërore në popullsinë ilire?
  - Pse kufijtë jugorë te ilirëve ishin të diskutueshëm?
  - Cilët ishin fiset kryesore te Epirit?
  - Keni dëgjuar të përdoret edhe në ditët e sotme termi Epir ?Kujt i referohet ky term?
  - A keni përmendur në ndonjë vepër letrare ndonjë prej fiseve ilire? (Bëhet fjalë për thesprotët në veprën “Odisea” të Homerit.) etj.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë pjesën e pare të mësimit dhe shkruan në tabelë pyetjet që nxënësit duhet ti përgjigjen pas leximit.
- Pyetjet: - Ku shtrihej Epiri?
  - Cili ishte kuptimi i fjalës “Epir”?
  - Cilët ishin fiset kryesore të Epirit?
  - Kur u krijuan qytetet e para? Cilët ishin disa nga qytetet më të përmendura?
  - Cilat ishin formacionet shtetërore në Epir dhe udhëheqësit më të përmendur të tyre?

- Përgjigjet e nxënësve mund të shënohen në mënyrë skematike në tabelë.

Epiri tokë përballë ishujve të detit Jon — shtrihej — - nga gjiri i Ambrakisë në jug deri në Qafën e Llogorasë luginën e Vjosës në veri; - nga malet e Pindit në lindje e deri në brigjet e Jonit në perëndim.

Fiset kryesore — ishin — - Kaonët - Thesprotët - Molosët — Qytetet kryesore gjysma e dytë të shek. IV p.e.s. — Gitana, Foinike, Himara,Teqeja e Melanit

Formacionet shtetërore (fundi shekullit V p.e.s. - 234 p.e.s.) — ishin — - Mbretëria Molose kryesuar nga mbreti Tharypa dhe nga i biri, Alketa; - Lidhja e Molosë, në krye të saj erdhi Aleksandri Molos; - Aleanca Epirote ishte një shtet federativ që kulmin e arriti në udhëheqjen e Pirros.

- Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë pjesën e dytë të mësimit dhe shkruan në tabelë pyetjet që nxënësit duhet t'i përgjigjen pas leximit.
- Pyetjet: - Si dhe kur erdhi në fron Pirro i Epirit?
  - Cilat ishin disa veçori të Aleancës epirote nën udhëheqjen e Pirros?
  - Cilët ishin rivalët kryesorë të shtetit të Epirit nën kryesimin e Pirros?
  - Cilat ishin betejat kryesore të zhvilluara nën drejtimin e Pirros?
- Përgjigjet e nxënësve mund te shënohen në mënyrë skematike në tabelë.
- Po kështu vazhdohet dhe me pjesën tjetër të mësimit.

Epiri në kohën e sundimit të Pirros (297-272 p.e.s.)

**Veçori të Epirit nën drejtimin e Pirros**
- sukses në fushat ekonomike, ushtarake dhe politike;
- Pirroja forcoi shumë edhe pushtetin e tij mbretëror;
- pati lidhje të forta diplomatike me shtete fqinje.
- ndoqi një politikë të jashtme të pavarur;
- u tregua mjaft ambicioz ndaj territoreve Ilire dhe asaj Maqedonase.
- zhvillimi i mëtejshëm i jetës qytetare, ndërtimeve

**Rivalët e shtetit të Pirros**
- Roma;
- Kartagjena;
- Maqedonia;
- Sparta;
- Argosi.

**Betejat kryesore:**
- e Herakleas në 280 p.e.s.;
- e Askulit në 277 p.e.s.;
- e Sirakuzës kundër Kartagjenës;
- e Beneventos ku pësoi humbje;
- e Argosit, e cila ishte beteja e fundit.

Lidhja Epirote — veçoritë
- karakter republikan;
- siguroheshin të drejta të barabarta për të gjitha fiset;
- Epiri mëkëmbet në kufijtë e tij të periudhës para sundimit të Pirros;
- u zhvilluan shumë qytetet e Kaonisë;
- në 167 p.e.s., Epiri hyri nën autoritetin e Romës.

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:
1. përcakton në hartë shtrirjen e shtetit të Epirit;
2. shpjegon format kryesore të organizimit politik, ekonomik dhe shoqëror të shtetit të Epirit;

| |
|---|
| 3. identifikon formacionet shtetërore në Epir dhe udhëheqësit më të përmendur të tyre;<br>4. analizon veçori të Lidhjes Epirote. |
| ***Vlerësimi:***<br>*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime..* |
| **Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>• Mblidhni fakte, kuriozitete dhe fotografi për jetën e Pirros së Epirit dhe përdorini ato për të shkruar biografinë e tij.<br>• Mblidhni fakte rreth pikëpamjeve të ndryshme për karakterin etnik të fiseve epirote. Argumentoni mendimin që ju mbështesni. |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Mbretëria Dardane | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja vendos në tabelë një hartë të shteteve ilire dhe kërkon nga nxënësit të tregojnë kufijtë dhe shtrirjen e këtyre formacioneve shtetërore. | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**<br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës.<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;<br>trashëgiminë materiale dhe shpirtërore. | | **Fjalët kyçe:**<br>- *Dardani;*<br>- *Paioni;*<br>- *falanga;*<br>- *pushteti mbretëror;*<br>- *pozitë strategjike;*<br>- *aristokraci fisnore.* | |

| | |
|---|---|
| **<u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>.**<br>Nxënësi:<br>➢ përcakton në hartë shtrirjen e mbretërisë dardane;<br>➢ shpjegon tiparet kryesore të organizimit politik, ekonomik dhe shoqëror të mbretërisë dardane;<br>➢ vlerëson rolin e mbretërisë së Dardanisë në qytetërimin ilir. | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, interneti, botime të tjera rreth fiseve ilire, të dhëna arkeologjike. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- arkeologjia;<br>- gjeografia etj. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** shpjegim, hartë e konceptit.

**Organizimi i orës së mësimit:**

- Mësuesi/ja vendos në tabelë një hartë të shteteve ilire dhe kërkon nga nxënësit të tregojnë kufijtë dhe shtrirjen e këtyre formacioneve shtetërore.
- Lexohet në klasë pjesa "Grimca Historike" dhe diskutohet rreth njohurive që nxënësit kanë rreth fisit të Dardanëve.
- Mësuesja udhëzon nxënësit dhe ndërkohë ndërton në tabelë hartën e konceptit " Mbretëria Dardane".
- Shpjegimi i mësimit realizohet nga mësuesi, duke e ndërthurur me pyetje, të cilat u drejtohen nxënësve.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Shpjegimi i mësimit realizohet nga mësuesi duke e ndërthurur me pyetje të cilat u drejtohen nxënësve. Si p.sh.:
  - Ku shtrihej Dardania?
  - Cilat ishin disa veçori të popullsisë së Dardanisë?
  - Cilët ishin mbretërit më të njohur Dardanë?
  - Shpjegoni marrëdhëniet e mbretërisë Dardane më Romën.
  - Cilat ishin territoret ku shtrihej mbretëria dardane ne kohën lulëzimit të saj?
  - Cilët ishin disa prej qyteteve më të njohura të Dardanisë?




**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. identifikon shtrirjen gjeografike të mbretërisë dardane;
2. rendit disa prej qendrave kryesore urbane të Dardanisë, duke vënë në dukje lidhjen e tyre me qendrat e sotme në rajon;
3. shpjegon kushtet që çuan në krijimin e shtetit dardan dhe tregon formën e tij;
4. analizon marrëdhëniet e Dardanisë me Romën dhe përshkruan interesat e palëve në këtë marrëdhënie.

**Vlerësimi:**

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit.*

**Detyrat dhe puna e pavarur**:

- Hulumtoni dhe sillni në klasë informacion rreth qendrave qytetare dardane.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkolla:</td><td>Klasa: 11</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Konfliktet iliro-romake</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Mësuesi/ja për të nxitur kureshtjen e nxënësve shfaq në monitor sekuenca mbi mbretërit ilirë të dinastisë ardiane Teuta dhe Genti . Shih: https://www.youtube.com/watch?v=xN7uBJFX4uE&t=317s, https://www.youtube.com/watch?v=ynQQchbIS-M</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Nxënësi/ja:<br>• përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.<br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi/ja:<br>• parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime<br>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. Nxënësi/ja:<br>• zhvillon aftësitë për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin për të identifikuar dhe vlerësuar burimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjes historike.<br>Kompetenca personale :Nxënësi/ja<br>• përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.</td><td colspan="2" rowspan="2">Fjalët kyçe:<br>- luftërat iliro-romake,<br>- pax romana,<br>- provinca,<br>- rruga Egnatia.</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>.<br>Nxënësi/ja:<br>➢ shpjegon shkakun e luftërave iliro-romake;<br>➢ përshkruan zhvillimin e tri luftërave iliro-romake.<br>➢ tregon përpjekjet e vazhdueshme të ilirëve për t'i bërë ballë Romës;</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| ➢ shpjegon ndryshimet që solli vendosja e plotë e sundimit romak në Iliri;<br>➢ identifikon disa prej risive në fushën e artit dhe arkitekturës si pasojë e ndikimit romak. | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi, botime rreth mbretërve ilirë. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- arkeologjia;<br>- gjeografia etj. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** diskutim, INSERT.

**Organizimi i orës së mësimit:**

1. Mësuesi/ja për të nxitur kureshtjen e nxënësve shfaq në monitor sekuenca mbi mbretërit ilirë të dinastisë ardiane Teuta dhe Genti.

   Shih: https://www.youtube.com/watch?v=xN7uBJFX4uE&t=317s , https://www.youtube.com/watch?v=ynQQchbIS-M.

2. Organizohet në klasë diskutimi lidhur me faktet që nxënësit njohin rreth mbretërve ilirë si Teuta, Agroni, Genti, si dhe pushtimit romak të territoreve ilire.

**Ndërtimi i njohurive:**

3. Mësuesja udhëzon nxënësit të lexohet mësimi duke i kërkuar te vendosin përbri secilës pjesë të lexuar shenjat, të cilat kanë kuptimin e mëposhtëm:

   √ —— vendoset përbri informacionit që për ju është i njohur;
   \- —— vendoset përbri informacionit që ju e dinit ndryshe;
   \+ —— vendoset përbri informacionit që është i ri për ju;
   ? —— vendoset përbri informacionit që është i paqartë ose doni të dini më shumë.

4. Pas leximit organizohet në klasë bashkëbisedim ku nxënësit krahasojnë shenjat e vendosura dhe diskutojnë rreth fakteve të reja. (Këto veprimtari mund të zhvillohen në 20 minutat e para të mësimit dhe pjesën tjetër plotësohet tabela nga përgjigjet e nxënësve.)

| √ | — | + | ? |
|---|---|---|---|
| - Në mesin e shekullit III p.e.s., qendra e mbretërisë ilire u zhvendos në territorin e labeatëve dhe ardianëve me kryeqendër Shkodrën.<br><br>- Teuta, mbretëreshë ilire.<br><br>- Periudha e paqes romake.<br><br>- Rruga Egnatia, e ndërtuar për të lidhur Romën me Kostandinopojën.<br><br>- Roma kishte synime territoriale në Ballkan.<br><br>(nxënësit mund të kenë dhe informacione të tjera të njohura) | - Nxënësit mund ta dinë ndryshe përfundimin e luftës së parë iliro-romake.<br><br>- Nxënësit mund të dinë ndryshe dhe informacione të tjera, të cilat shënohen nga mësuesja në kolonën përkatëse të tabelës. | - Dinastia e Agronit, pati shumë sukses në fuqizimin ekonomik, politik dhe ushtarak të mbretërisë.<br>- Fitorja e bujshme e Agronit ndaj ushtrisë etole në qytetin Medion në 231 p.e.s.<br>-Vdekja e papritur e mbretit Agron,i cili i u pasua në fronin ilir nga Teuta, bashkëshortja e tij.<br>- <u>Shkaku</u> i konflikteve iliro-romake ishin synimet territoriale që kishte Roma në Ballkan.<br>- Luftërat zgjatën më shumë se 60 vjet (nga 229 p.e.s. deri në 168 p.e.s.).<br><br>Lufta e parë (229-228 p.e.s.)<br><u>Arsyet e humbjes së ilirëve ishin</u>:<br>- qëndrimi pro-romak i qyteteve të rëndësishme si Dyrrahu, Apolonia.<br>- Tradhtia e Dhimitër Farit.<br><u>Kushtet e paqes, të rënda për mbretërinë ilire</u>:<br>- Detyrohej t'i paguante tribut me këste romakëve.<br>- Të mos lundronte në jug të Lisit me më shumë se dy anije të paarmatosura.<br>- Të hiqte dorë nga një pjesë e madhe e territorit.<br>- Teuta u largua nga froni ilir, u zëvendësua nga Dhimitër Fari.<br><br>Lufta e dytë 219 p.e.s.<br>- Dh. Fari ndoqi një politikë të pavarur nga Roma.<br>- Sulmi i qyteteve kryesore që ishin Dimali dhe Fari përfundoi me rënien e tyre.<br>- Dh. Farit u largua në mbretërinë maqedonase.<br><br>Lufta e tretë<br>- <u>Shkaku</u>: mbretëria e Gentit mbajti hapur krahun e Maqedonisë në konfliktin me Romën.<br>- Genti ishte përgatitur të luftonte në det ashtu edhe në qytetet pro-romake të Ilirisë.<br>- Ushtria romake ishte pothuajse dy herë më e madhe. | Informacion shtesë:<br><u>Ushtria e mbretit Gent</u><br>Mbreti ishte kryekomandant i forcave të armatosura tokësore dhe detare. Veprimet ushtarake i drejtonte vetë ose ua besonte komandantëve të veçantë. Bërthamën kryesore të ushtrisë që ishte mbështetja kryesore e pushtetit mbretëror e përbënin kontingjentet e rregullta, të cilat sipas rastit qëndronin si garnizone në qytete ose përqendroheshin për të ndërmarrë një ekspeditë apo për të përballuar luftimet në një front të caktuar.<br>Burimet nuk bëjnë fjalë për forca ndihmëse në përbërjen e ushtrisë ilire, por nuk duhet përjashtuar mundësia që fiset malore të kenë ushqyer ushtrinë mbretërore me forca të tilla, sa herë që i thërriste |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | 168 p.e.s.<br><br>Paqja romake<br><br><u>Ndryshimet që solli vendosja e sundimit romak:</u><br>1-Ndarje të re administrative (tregohet në hartë)<br>2-Reformë të thellë agrare (vendosja e kolonëve)<br>3-Disa qytete ilire u rrënuan.<br>4-Disa qytete morën statusin e kolonive romake.<br>5-U krijuan qytete të reja.<br>6-Filloi ndërtimi i rrugës Egnantia<br>7-Përhapje e kulturës romake në provincat ilire.<br>8-Ndërtime të reja me natyrë shoqërore, fetare.<br><br>-Periudha e shekujve IV – VI p.e.s., e cila njihet edhe si periudha e antikitetit të vonë, shënon fillimin e ndikimeve kulturore të Perandorisë Romake të Lindjes (Bizantit). | mbreti, duke qenë të komanduara nga krerët e tyre.<br>Njësi e flotës ilire është lembi, një anije e vogël, por e shpejtë dhe e manovrueshme. Çdo lemb, përveç rremtarëve, kishte edhe 50 luftëtarë që përbënin njësinë bazë të forcave ushtarake detare dhe mbase edhe tokësore ilire.<br><br>(Mësuesi mund të përzgjedhë informacione të ndryshme) |

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Shpjegon shkakun e luftërave iliro-romake.
2. Përshkruan zhvillimin e tri luftërave iliro-romake.
3. Rendit kushtet e paqes së nënshkruar mes mbretëreshës Teuta dhe romakëve.
4. Tregon përpjekjet e vazhdueshme të ilirëve për t'i bërë ballë Romës.
5. Shpjegon ndryshimet që solli vendosja e plotë e sundimit romak në Iliri.
6. Identifikon disa prej risive në fushën e artit dhe arkitekturës si pasojë e ndikimit romak.

**Vlerësimi:**

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit në të kuptuarit e fakteve dhe ngjarjeve.*

**Detyrat dhe puna e pavarur**:

- Zhvilloni hulumtime paraprake për të dhënat që vijnë nga burime të ndryshme lidhur me aspekte të jetës dhe veprimtarisë së ilirëve (shtrirja territoriale, jeta e përditshme, marrëdhëniet me popullsitë fqinje etj.)

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Histori</th><th>Shkolla:</th><th>Klasa: 11</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Veprimtari praktike: Burimet e shkruara greke dhe romake për qytetërimin ilir.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Lexohet në klasë pjesë nga poema e Homerit “Odisea”:<br>“Unë tani mora vesh kthimin e Odiseut,<br>diku në tokat pjellore të thesprotëve<br>jeton dhe sjell thesare të shumta dhe të çmueshme.<br>Kështu më tha mbreti i thesprotëve...”</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>Kompetenca e të menduarit. Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës.<br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>Kompetenca qytetare. Nxënësi:<br>• shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar, duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore.<br>Kompetenca digjitale. Nxënësi:<br>• komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>- Ilirë;<br>- koloni helene;<br>- maqedonas;<br>- Homeri;<br>- konfliktet iliro-romak.</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| **<u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>**. Nxënësi:<br>➢ evidenton rolin dhe pozitën e popullsisë ilire në raport me popullsitë e tjera<br>➢ fqinje;<br>➢ identifikon shtrirjen territoriale të viseve të banuara nga popullsia ilire dhe<br>➢ tipare të jetës dhe organizimit të saj;<br>➢ analizon marrëdhëniet e ilirëve me fqinjët, aleancat dhe luftrat mes tyre;<br>➢ argumenton karakterin autokton të ilirëve në trojet e gadishullit të Ballkani | |
| **Burimet:**<br>• Interneti, "Iliada", "Odisea", botime të autorëve antikë si Herodoti, Tuqididi,Demosteni, Hesiodi, Straboni "Gjeografia", Aristoteli, Cicëroni, Virgjili.<br>• Shih: https://sq.wikipedia.org/wiki/Ilir%C3%ABt, https://sq.wikipedia.org/ëiki/Q%C3%ABndresa_e_Ilir%C3%ABve_kund%C3%ABr_pushtuesve_romak https://www.shqiperia.com/Mbreter-Ilire-2400-vjet-me-pare-ne-Maqedonine-e-sotme.6242/ etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- arkeologjia;<br>- gjeografia;<br>- letërsia etj. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Punë hulumtuese, diskutim në klasë.

**Organizimi i orës së mësimit:**

- Lexohet në klasë pjesë nga poema e Homerit "Odisea".

"Unë tani mora vesh kthimin e Odiseut,
diku në tokat pjellore të thesprotëve
jeton dhe sjell thesare të shumta dhe të çmueshme.
Kështu më tha mbreti i thesprotëve..."

- Mësuesi/ja nxit nxënësit në diskutim duke drejtuar pyetje si p.sh
  - Çfarë të dhëne na sjell Homeri mbi thesprotët?

- Ku shtihej fisi i thesprotëve ?
- Cilat ishin marrëdhëniet me botën helene? etj.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Nxënësit zhvillojnë (në mënyrë individuale ose në grupe, sipas zgjedhjes së mësuesit) hulumtime paraprake për të dhënat që vijnë nga burime të ndryshme lidhur me aspekte të jetës dhe veprimtarisë së ilirëve (shtrirja territoriale, jeta e përditshme, marrëdhëniet me popullsitë fqinje etj.).
- Për këtë mund të shfrytëzohen citimet e dhëna në tekstin e nxënësit ose burime të tjera. P.sh.:
- Botime të autoreve antikë si Herodoti, Tuqididi, Demosteni, Hesiodi, Straboni "Gjeografia", Aristoteli, Ciceroni, Virgjili.
  Shih: https://sq.wikipedia.org/wiki/Ilir%C3%ABt,
  https://sq.wikipedia.org/wiki/Q%C3%ABndresa_e_Ilir%C3%ABve_kund%C3%ABr_pushtuesve_romak
  https://www.shqiperia.com/Mbreter-Ilire-2400-vjet-me-pare-ne-Maqedonine-e-sotme.6242/ etj.

- Një vëmendje e veçantë sugjerohet t'i kushtohet marrëdhënieve dhe konflikteve iliro-romake, si një periudhë më e dokumentuar, sidomos nga historianët romakë.
- Nxënësit prezantojnë materialin e përgatitur.
- Nxitet një diskutim në klasë duke u përqendruar në pikat e mëposhtme:
  - shkaqet e konfliktit mes Mbretërisë Ilire dhe Romës;
  - gjendja e brendshme e Mbretërisë Ilire dhe marrëdhëniet e saj me fqinjët (kryesisht maqedonasit dhe helenët);
  - ecuria e konfliktit dhe shkaqet e mbizotërimit të Romës;
  - rrjedhojat afatgjata të sundimit romak në trojet ilire.

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. evidenton shkaqet e konfliktit mes Mbretërisë Ilire dhe Romës;
2. përshkruan gjendjen e brendshme e Mbretërisë Ilire dhe marrëdhëniet e saj me fqinjët;
3. njeh figurat kryesore të mbretërve ilirë dhe rolin e tyre;
4. analizon rrjedhojat afatgjata të sundimit romak në trojet ilire.

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet punën hulumtuese, aftësinë për të përzgjedhur burimet e informacionit, në prezantimin e materialit të përgatitur si dhe në pjesëmarrjen në diskutim dhe të menduarit kritik.*

**Detyrat dhe puna e pavarur**:

- Përgatit një ese me temë "Iliria, vend i pasur dhe i begatë në shekuj".

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Histori</th><th>Shkolla:</th><th>Klasa: 11</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Mesjeta e hershme arbërore, vazhdimësia etnokulturore.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Për të nxitur kureshtjen e nxënësve lexohet në klasë rubrika “Grimcë historike”.<br>“Në burimet e shkruara, ilirët përmenden me këtë emër deri në shek. VI. Nga shek. XI në dokumentet e shkruara, banorët e Ilirisë së Jugut njihen me emrin arbër, ndërsa vendi Arbëri...”<br>Shfaqen sekuenca nga dokumentari: “Ata quheshin arbër”.<br>Shih: https://www.youtube.com/watch?v=6GNpaY7xofM.</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e të menduarit. Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme.<br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>Kompetenca personale. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, për të vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve qofshin këto dhe të ndryshme nga të tijat.<br>Kompetenca qytetare. Nxënësi:<br>• shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar, duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore.<br><br><u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</u><br>Nxënësi:<br>➢ shqyrton të dhënat arkeologjike dhe historike që tregojnë vazhdimësinë ilire-arbërore-shqiptare;</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>- dyndjet sllave,<br>- ilir,<br>- arbër,<br>- shqiptar,<br>-autokton,<br>-perandoria Bizantine.</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| ➢ gjykon për pasojat e dyndjeve sllave në Ballkan dhe në territoret shqiptare;<br>➢ evidenton ndryshimet që pësuan territoret shqiptare në Perandorinë Bizantine. | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, harta të territorit shqiptar në antikitet dhe në mesjetë, hartë e themave në territorin shqiptar, enciklopedi etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- arkeologjia;<br>- gjeografia<br>- gjuha. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** diskutim, tabela e koncepteve.

**Organizimi i orës së mësimit:**

- Mësuesi/ja për të nxitur kureshtjen e nxënësve cakton një nxënës që të lexoje rubrikën "Grimcë historike".
- Për të nxitur nxënësit në një diskutim paraprak mësuesi/ja shkruan në tabelë:
  Perandori Romake - Perandori Bizantine - thema - ilir - arbër - shqiptar - dyndjet sllave.
- Mësuesi/ja pyet nxënësit:
  - A mund të shpjegoni termat e mëposhtëm?
  - Ç'ju kujton viti 395?
  - Cila është lidhja mes shqiptareve – arbërve dhe ilirëve? etj.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë mësimin, duke i ndarë në grupe sipas pjesëve, në të cilat është organizuar informacioni i ri.
- Ndërtohet tabela e koncepteve si më poshtë, mësuesi/ja pyet nxënësit sipas çështjeve përkatëse ose i ngre për të plotësuar në tabelë.

| Koncepti | Komenti |
|---|---|
| Iliria nën Perandorinë Bizantine | - Iliria u përfshi në prefekturën e Ilirikut dhe përfshinte katër provinca:<br>1- Prevalin ( veriu i Ilirisë deri në lumin Shkumbin);<br>2- Dardaninë ( (Dardania përfshinte përafërsisht territoret e Kosovës);<br>3- Epirin e Vjetër (nga lumi Vjosa deri në Gjirin e Ambrakisë);<br>4- Epirin e Ri (territoret midis lumenjve Shkumbin dhe Vjosë). |
| Dyndjet e fiseve barbare | - Gotët<br>- Hunët → Plaçkitën vendin, dogjën fshatra, rrënuan qytete, rrëmbyen njerëz e më pas u larguan.<br>- Sllavët → Siguruan leje nga perandorët bizantinë për t'u ngulur Ballkan. |
| Iliria e Jugut i bëri ballë asimilimit sllav sepse: | 1- Iliria e Jugut ishte zonë ekonomike e zhvilluar.<br>2- Popullsia ishte më kompakte dhe kishte nivel më të lartë kulturor.<br>3- Terreni ishte malor dhe bregdeti kishte shumë baza të fortifikuara.<br>4- Sllavët që depërtuan në Ilirinë e Jugut u asimiluan me kalimin e kohës. |
| Të dhënat që vërtetojnë vazhdimësinë etnokulturore të vendit tonë. | 1 - Të dhëna arkeologjike → - në disa relieve pasqyrohen njerëzit e punës me veshje tipike ilire; - muret e kështjellave mesjetare janë ngritur mbi muret antike.<br>2 - Të dhëna gjuhësore → - emra njerëzish e sendesh; - emra qytetesh, malesh e lumenjsh.<br>3 - Të dhëna etnografike → - elemente të veshjes ilire dëshmojnë se trevat e banuara nga iliro-arbrit (shek. V-VI) kishin një kulturë materiale të përbashkët. |
| Kultura e Komanit | Ka dy karakteristika. → E para lidhet me trashëgiminë e vjetër. → E dyta lidhet me kushtet e reja historike. |
| Jeta politike në Arbëri (shek. VIII-X) | - Sundimi bizantin në tokat arbërore u dobësua.<br>- Drejtimin politik e kishin marrë në dorë forcat lokale.<br>- Riorganizim administrativo-ushtarak, në bazë theme.<br>- Në krye të themës qëndronte strategu, i cili kishte pushtetin ushtarak dhe civil.<br>- Në konfliktin ndërmjet Bizantit dhe Bullgarisë, arbrit mbajtën një qëndrim armiqësor ndaj Bizantit. |

| |
|---|
| **Pyetje për diskutim**<br>Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:<br>1. evidenton arsyet e mosasimilimit të ilirëve në Ilirinë e Jugut;<br>2. përshkruan mënyrën e organizimit administrativ në trevat shqiptare në fillim të shek. IX;<br>3. tregon problemin kryesor politik në shek. IV-IX;<br>4. analizon konceptin e "kulturës materiale unitare" në kontekstin e vazhdimësisë etnokulturore shqiptare;<br>5. argumenton pasojat e dyndjeve barbare në territoret e banuara nga ilirë. |
| ***Vlerësimi:***<br>*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime, në aftësinë për të punuar me hartën në shfaqjen e mendimit kritik.* |
| **Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>• Mblidhni dëshmi nga krahina juaj për vazhdimësinë iliro-shqiptare. |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Arbëria midis Lindjes dhe Perëndimit<br>(zhvillimet politike në shek. XI-XIV) | | **Situata e të nxënit:**<br>Shfaqen sekuenca nga dokumentari "Ata quheshin arbër".<br>Shih: https://www.youtube.com/watch?v=6GNpaY7xofM.<br>(minuta 19). | |
| **<u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u>**<br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës. | | **Fjalët kyçe:**<br>- *bullgarët;*<br>- *serbët;*<br>- *normanët;*<br>- *Principata e Arbrit;* | |

<table>
<tr><td>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit; trashëgiminë materiale dhe shpirtërore.</td><td rowspan="2">- vasal.</td></tr>
<tr><td><u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>.<br>Nxënësi:<br>➢ përshkruan marrëdhëniet e arbërve me pushtetin qendror bizantin dhe raportet me pushtuesit e tjerë;<br>➢ përshkruan tiparet kryesore të organizimit politik e shoqëror të Principatës së Arbrit;<br>➢ vlerëson rolin e Principatës së Arbrit si organizim shtetëror.</td></tr>
<tr><td>Burimet:<br>• Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme, enciklopedi etj.</td><td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>- gjeografia.</td></tr>
<tr><td colspan="2" align="center">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td colspan="2">Metodologjia: rrjeti i diskutimit, lexim dhe mendim i drejtuar.<br><br>Organizimi i orës së mësimit:<br>• Shfaqen sekuenca nga dokumentari “Ata quheshin arbër”.<br>Shih: https://www.youtube.com/watch?v=6GNpaY7xofM (minuta 19).<br>• Nxënësve u drejtohen pyetje, duke i nxitur në diskutim:<br>-Cilat ishin marrëdhëniet e arbërve me pushtetin bizantin?<br>-Si u quajt shteti i parë i arbrit? Ku shtrihej ai ? etj. (Nxënësi e njeh nga dokumentari informacionin për t’iu përgjigjur pyetjeve.)<br><br>Ndërtimi i njohurive:<br>• Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën e parë të mësimit dhe të rendisin sipas një radhe kronologjike pushtimet e huaja në vendin tonë.</td></tr>
</table>

☒ Mund të ndërtohet një tabelë si më poshtë nga mësuesi/ja dhe një nxënës ngrihet për ta plotësuar. Tregohet në hartë shtrirja e zonave të pushtimit.

| Koha | Pushtimi | Veçori |
|---|---|---|
| Mesi i shekullit IX | Bullgar | - Pushtuan luginat e Devollit, të Shkumbinit dhe të Vjosës në Durrës e Vlorë.<br>- Durrësi shpëtoi nga Gjon Krisili, i cili lidhi aleancë me mbretin bullgar.<br>- Bullgarët u tërhoqën pas disfatës afër Beratit (1018).<br>- Pushtimi bullgar zgjati 150 vjet. |
| Shek. XI | Serb | - Në lindje u shtri në Prizren e në Shkup, kurse në jug deri në Durrës.<br>- Qendra Shkodra.<br>- U shoqërua me dhunë politike, ekonomike e kishtare. |
| Viti 1081 | Norman | 1 - Robert Guiskardi dhe Boemundi pushtuan Vlorën, Kaninën, Orikumin, Bylisin, Butrintin dhe Korfuzin.<br>- Durrësin nuk e morën dot, pasi e shpëtoi flota venedikase.<br>- Pas tre vjetësh, Guiskardi u tërhoq nga Arbëria.<br>2 - Në tetor 1107 Boemundi pushtoi për herë të dytë bregdetin arbëror.<br>- Normanët u shtrinë në Lindje deri në grykat e Arbanonit, midis Krujës e Dibrës, kurse në jugperëndim në Orikum.<br>- Në veri u shfaq shteti serb i Zetës.<br>3 - Në verën e vitit 1185, mbreti i normanëve zbarkoi përsëri në brigjet shqiptare.<br>- Po atë vit normanët u tërhoqën në Itali. |

☒ Lexohet pjesa e dytë e mësimit dhe nxënësit plotësojnë në tabelë.

Principata e Arbrit:

- Në vitin 1166, përmendet për herë të parë një funksionar i lartë vendas.
- Në vitet 1190 sundonte dinastia e Skurajve-Progoni.
- Gjini sundoi në vitet 1198-1208.
- Gjatë sundimit të Dhimitrit (1208-1216 ) principata arriti kulmin e fuqisë së saj.
- Principata e Arbrit kishte tiparet e një shteti mesjetar.
- Atë e rrezikonin tri shtete kundërshtare Mbretëria serbe e Rashës, Dukati Venedikas rreth qytetit dhe despotati i Epirit.
- Më 1209 nënshkroi një traktat me Republikën e Raguzës-Po atë vit, ai u afrua me Papën Inocenti III.
- Më 1216, pushtetin në principatë e mori e veja e tij dhe Grigor Kamona, bashkëshorti tjetër i saj.

- Më 1257, në krye të principatës u emërua një feudal bizantin, çka shënoi nënshtrimin e plotë të shtetit të Arbrit.

- Mësuesja nxit të menduarit kritik te nxënësit duke drejtuar kërkuar nga nxënësit:
  - të argumentojnë pse Principata e Arbrit konsiderohet një shtet;
  - të krahasojnë pushtimet e huaja dhe të evidentojnë se cili ishte pushtimi më i egër dhe që shkaktoi më shumë pasoja në trojet e Arbrit gjatë shek. IX – XIII?

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. përshkruan marrëdhënien e arbërve me pushtetin qendror bizantin dhe si ndikonte ajo në raport me pushtuesit e tjerë;
2. tregon si u shmang pushtimi bullgar i Durrësit;
3. evidenton rëndësinë e Principatës së Arbrit si formacion shtetëror;
4. argumenton pse Principata e Arbrit konsiderohet një shtet;
5. evidenton palën me të cilën Dhimitri lidhi aleancë dhe shpjegon se çfarë i mungonte kësaj aleance.

**Vlerësimi:**

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit dhe në të menduarit kritik.*

**Detyrat dhe puna e pavarur**:

- Mësuesi/ja u jep nxënësve si detyrë të hulumtojnë dhe sjellin informacion rreth despotatit të Epirit. (Për ndarjen në grupe shih orën pasardhëse.)

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Veprimtari praktike: Despotati i Epirit | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja shpjegon si u krijua shteti i Epirit dhe nga kush drejtohej ai.<br>(Mund t'i referohet situatës së të nxënit në tekst ose materialeve të tjera shtesë.) | |

<table>
<tr>
<td>
<u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Nxënësi:<br>
• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>
Kompetenca e të menduarit. Nxënësi:<br>
• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës.<br>
Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>
• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>
Kompetenca qytetare. Nxënësi:<br>
• shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore.<br>
Kompetenca digjitale. Nxënësi:<br>
komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet
</td>
<td rowspan="2">
Fjalët kyçe:<br>
- Kryqëzata e Katërt;<br>
- Despotatit të Epirit;<br>
- Perandorisë Bizantine;<br>
- Engjëllorët.
</td>
</tr>
<tr>
<td>
<u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>.<br>
Nxënësi:<br>
➢ shpjegon rrethanat historike të krijimit të despotatit të Epirit;<br>
➢ identifikon kufijtë e tij në periudha të ndryshme, duke treguar veçanërisht shtrirjen e tij në territoret shqiptare;<br>
➢ vlerëson rolin e familjes së Engjëllorëve në krijimin e Despotatit të Epirit;<br>
➢ evidenton vendin e Despotatit në përpjekjet për ringritjen e Perandorisë Bizantine;<br>
➢ analizon rolin e elementit shqiptar në jetën e brendshme të Despotatit dhe në konfliktet me formacione të tjera shtetërore konkurrente;<br>
➢ analizon faktorët e rënies së Despotatit dhe situatën e popullsisë shqiptare në ngjarjet që shoqëruan shembjen e tij dhe rivendosjen e sundimit bizantin.
</td>
</tr>
</table>

| **Burimet:** | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| • Libri i nxënësit, harta të territoreve të Ballkanit në mesjetë, interneti, enciklopedi etj. | - gjuha dhe letërsia;<br>- gjeografia. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** punë në grupe, përgatitje e një posteri.

**Organizimi i orës së mësimit**

1. Mësuesi/ja shpjegon si u krijua shteti i Epirit dhe nga kush drejtohej ai (mund t'i referohet situatës së të nxënit në tekst ose materialeve të tjera shtesë).
2. Nxënësit janë ndarë në grupe që në orën paraardhëse dhe janë përgatitur për veprimtarinë praktike, sipas detyrave të caktuara më poshtë.

Grupi I: Formimi i shtetit të Despotatit të Epirit

- rrethanat historike të krijimit dhe fillimeve të despotatit;
- shtrirja territoriale e tij;
- marrëdhëniet e despotatit me shtetet e tjera rivale të së njëjtës periudhë.

Grupi II: Shqiptarët dhe Despotati i Epirit

- marrëdhëniet mes popullsisë shqiptare dhe sundimtarëve të despotatit;
- autonomia e shqiptarëve në kuadër të despotatit;
- marrëdhëniet e elementit shqiptar me grupet e tjera etnike që përbënin popullsinë e despotatit.

Grupi III: Faktorët e shkatërrimit të Despotatit të Epirit

- roli i Despotatit të Epirit në përpjekjet për ringritjen e Perandorisë Bizantine;
- konfliktet e despotatit me shtete të tjera sidomos me Perandorinë bullgare dhe atë të Nikesë;
- ndikimi i pakënaqësive të shqiptarëve në rënien e despotatit dhe situata e tyre nën sundimin e ri bizantin.

**Ndërtimi i njohurive:**
Mësuesi/ja e organizon orën e mësimit në dy pjesë.

| |
|---|
| Pjesa I (20 min.) – Organizohet në klasë diskutim rreth materialeve të sjella nga nxënësit sipas çështjeve përkatëse.<br>Pjesa II (20 min.) – Organizohen nxënësit për përgatitjen e një posteri ku të pasqyrohen aspektet e ndryshme të historisë së Despotatit të Epirit.<br><br>**Pyetje për diskutim**<br>Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:<br>**1.** shpjegon rrethanat historike të krijimit të despotatit të Epirit;<br>**2.** identifikon kufijtë e tij në periudha të ndryshme;<br>**3.** vlerëson rolin e familjes së Engjëllorëve në krijimin e Despotatit të Epirit;<br>**4.** analizon rolin e elementit shqiptar në jetën e brendshme të Despotatit dhe në konfliktet me formacione të tjera shtetërore konkurrente;<br>**5.** analizon faktorët e rënies së Despotatit dhe situatën e popullsisë shqiptare në ngjarjet që shoqëruan shembjen e tij dhe rivendosjen e sundimit bizantin. |
| ***Vlerësimi:***<br>*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në realizimin e detyrave, kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime.* |
| **Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>• Nxënësit përfundojnë në shtëpi posterin mbi Despotatin e Epirit. |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Ekonomia dhe shoqëria në qytetin dhe fshatin mesjetar arbëror. | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë rubrikën “Grimcë historike”.<br>Për prodhimet e mira, qytetet kishin fituar emër të mirë përtej tokave arbërore. Shkodra ishte e njohur për shpatat, derdhjen e kambanave, për përpunimin e arit dhe të argjendit dhe për zbukurimin e veshjeve me ar e argjend...<br>Nxiten nxënësit në diskutim nëpërmjet pyetjeve të ndryshme. | |

<table>
<tr><td></td><td></td></tr>
<tr><td><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e të menduarit. Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme.<br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>Kompetenca personale. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve qofshin këto dhe të ndryshme nga të tijat.<br>Kompetenca qytetare. Nxënësi:<br>• shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar, duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore.<br><br><u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</u><br>Nxënësi:<br>➢ analizon faktorët që ndikuan në lindjen e marrëdhënieve feudale;<br>➢ përcakton karakteristikat e qytetit dhe fshatit mesjetar arbëror dhe përshkruan mënyrat e jetesës në to.</td><td>Fjalët kyçe:<br>- korporata;<br>- Fisnikët;<br>- Popullorët;<br>- Komunat;<br>- Pronia.</td></tr>
<tr><td>Burimet:<br>• Libri i nxënësit, hartë e trojeve shqiptare në mesjetë.</td><td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>- arkeologjia;<br>- gjeografia.</td></tr>
<tr><td colspan="2" align="center">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td colspan="2">Metodologjia: diskutim, pyetje-përgjigje, hartë e mendjes.<br><br>Organizimi i orës së mësimit<br>• Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë rubrikën “Grimcë historike”.<br>• Nxiten nxënësit në diskutim nëpërmjet pyetjeve të ndryshme, si p.sh.:</td></tr>
</table>

- Cili prej jush ka vizituar kështjella të periudhës së mesjetës? Çfarë ju ka bërë përshtypje tek ato?
- Cilat janë disa prej qyteteve mesjetare në vendin tonë?
- Në cilën periudhë u zhvillua feudalizmi ?
- Ku mbështetej rendi feudal? Si e kuptoni ju sistemin e vasalitetit? etj.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin rreth 10 minuta dhe ndërkohë shkruan në tabelë pyetjet, të cilave nxënësit do t'u përgjigjen lidhur me informacionin e ri, p.sh.:
  - Cilat ishin qytetet e trashëguara nga antikiteti? (Gjenden në hartë.)
  - Cili ishte funksioni i qyteteve?
  - Cilat ishin qendrat e reja qytetare në vendin tonë?
  - Cilat ishin veprimtaritë kryesore ekonomike në mesjetë?
  - Si ndahej popullsia në qytete?
  - Si qeveriseshin qytetet shqiptare?
  - Si ishte i organizuar fshati në mesjetë?
  - Cilat ishin kategoritë e pronave dhe të zotëruesve të tyre në fshatin shqiptar?
- Pasi nxënësit u përgjigjen pyetjeve, mësuesi/ja bën një përsëritje të koncepteve, duke ndërtuar skemën në tabelë.



- Ndërtohet në të njëjtën mënyrë dhe skema për fshatin në mesjetë.




**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. evidenton zejet kryesore dhe zhvillimin e tyre në disa qytete;
2. krahason korporatat e qyteteve arbërore me ato perëndimore;
3. tregon strukturën shoqërore të popullsisë qytetare në Arbëri;
4. argumentoni pse qytetet arbërore nuk u kthyen në qytet-shtete si Venediku.

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime, në aftësinë për të punuar me hartën në shfaqjen e mendimit kritik.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

- Hulumtoni materiale rreth neneve të statutit të Shkodrës, duke argumentuar vlerën e tyre.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkolla:</td><td>Klasa: 11</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Organizimi politik në Arbërinë e shek. XIV-XV</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Mësuesja e nis orën e mësimit me një prezantim të principatave kryesore të shek. XIV në Arbëri. Shih:<br>https:/www.youtube.com/watch?v=y2aC2PM5-gQ.</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>Kompetenca e të menduarit. Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës.<br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit; trashëgiminë materiale dhe shpirtërore.</td><td colspan="2" rowspan="2">Fjalët kyçe:<br>- anzhuinët;<br>- kryengritje;<br>- principata e Shkodrës;<br>- principata e Durrësit;<br>- principata e Muzakajve.</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>.<br>Nxënësi:<br>➢ evidenton pushtimet e huaja në Arbërinë e shek. XIV-XV dhe shtrirjen e tyre;<br>➢ përcakton në hartë shtrirjen e principatave Arbërore (shek. XIVXV);<br>➢ analizon veçoritë ekonomike, politike dhe shoqërore të principatave shqiptare gjatë shekujve XIV-XV.</td></tr>
</table>

| **Burimet:** | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| • Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme, enciklopedi, hartë e principatave të shek. XIV etj. | - gjeografia. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** shpjegim, tabela e koncepteve.

**Organizimi i orës së mësimit**

- Mësuesja e nis orën e mësimit me një prezantim të principatave kryesore të shek. XIV në Arbëri. Shih : https://www.youtube.com/watch?v=y2aC2PM5-gQ.
- Mësuesi/ja shpjegon shkurt se cilat ishin pushtimet e huaja në Arbëri si dhe shtrirjen e principatave kryesore, duke demonstruar në hartën murale.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin dhe ndërton në tabelë ditarin dypjesësh. Për plotësimin e tij aktivizon nxënës të ndryshëm.
-

| Fjala /fjalia | Komenti |
|---|---|
| Pushtimet e huaja në Arbëri | - Në veri ishin nën Serbët.<br>- Në jug ishin nën despotatin e Epirit<br>- Krahinat e brendshme, nën Bizantin. Kundërshtitë u shprehën nëpërmjet një kryengritjeje që u shtri në krahinat e Ohrit, të Devollit, të Kolonjës, të Epirit. Arbëria u shkëput përfundimisht nga sundimi bizantin më 1341.<br>- Durrësi, Kruja dhe Butrinti nën sundimin anzhuin deri në vitin 1258.<br>- Në vitin 1336 mbreti serb Stefan Dushani pushtoi tokat deri në Thesali.<br><br>- Pasojat e pushtimit serb → - u burgosën dhe u shpronësuan krerët arbër;<br>- pronat iu kaluan feudalëve serbë;<br>- konvertim i dhunshëm në fenë ortodokse serbe;<br>- përdorimi i gjerë i emrave sllavë. |

| | |
|---|---|
| Principata e Shkodrës | - nën drejtimin e familjes së Balshajve, Balsha Plaku me tre djemtë e tij: Strazimirin, Gjergjin I dhe Balshën II;<br>- kishte aparat shtetëror, në krye të tij ishin tre vëllezërit Balsha;<br>- kishin nëpunës të doganës dhe funksionarë të tjerë;<br>- secili nga djemtë qeveriste një krahinë të caktuar, në arenën ndërkombëtare principata paraqitej unike;<br>- u njihnin qyteteve statutet;<br>- të ardhurat siguroheshin nga taksat, si: e dhjeta, nga doganat, tregtia e kripës dhe pasuritë tokësore. |
| Principata e Durrësit | - u themelua nga Tanush Topia;<br>- Principata e arriti kulmin gjatë qeverisjes së Karl Topisë. |
| Principata e Muzakajve | - u themelua nga Andrea II Muzaka;<br>- arriti shtrirjen më të madhe gjatë qeverisjes së Teodor II Muzaka. |
| Tiparet e shtetit në principatat e shek XIV. | - kishin organet drejtuese;<br>- kishin simbolet e tyre shtetërore;<br>- kishin vulat dhe monedhat. |
| Shkaqet e dështimit të principatave. | - Dështuan, sepse kishin përballë shtete të mëdha.<br>- Ndeshjet me njëra-tjetrën sollën dobësimin e tyre.<br>- Shpesh pronat e familjes sunduese ndaheshin midis trashëgimtarëve. |

- Mësuesi/ja nxit nxënësit në të menduarit kritik duke drejtuar pyetjen:
  - Nga fillimi i shek. XIV, arbrit patën konfliktet e para me turqit osmanë. Analizoni rrethanat historike të shfaqjeve të para të osmanëve në Ballkan.

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. analizon pasojat negative të pushtimeve të huaja në shek. XIII-XIV;
2. tregon shtrirjen më të madhe të tri principatave më të mëdha arbërore, duke u bazuar te harta;
3. evidenton përfaqësuesit më në zë të principatave arbërore;
4. shpjegon qëndrimin e familjes së Balshajve ndaj qyteteve që bënin pjesë në principatën e tyre;
5. analizon shkaqet e dështimit të principatave arbërore, duke dalluar ato të brendshme dhe të jashtme.

**Vlerësimi:**

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit dhe në të menduarit kritik.*

**Detyrat dhe puna e pavarur**:

- Hartoni një përmbledhje mbi principatën që ka vepruar në krahinën tuaj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkolla: | Klasa: 11 |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Arti, kultura, letërsia, arsimi dhe besimi në Arbërinë mesjetare | | **Situata e të nxënit:**<br>Për të nxitur kureshtjen e nxënësve mësuesi /ja vendos në tabelë ose shfaq në monitor fotografi të kështjellave mesjetare, kishave të besimit katolik dhe ortodoks, të afreskeve dhe ikonave, mozaikë bizantinë, dy kodikët e Beratit. | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>**Kompetenca personale.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, për të vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve, qofshin këto dhe të ndryshme nga të tijat.<br>**Kompetenca qytetare.** Nxënësi:<br>• shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar, duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore. | | **Fjalët kyçe:**<br>- *epitaf;*<br>- *ikonë;*<br>- *afreske;*<br>- *metropol i Ilirikut;*<br>*-toponim;*<br>*-kodikë;*<br>- *ortodoks.* | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi:<br>➢ tregon disa nga aspektet e zhvillimit të artit, kulturës, letërsisë dhe arsimit në Arbërinë mesjetare;<br>➢ përcakton kushtet e përhapjes dhe organizimit të besimit të krishterë në Arbërinë mesjetare. | | | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, hartë e trojeve shqiptare në mesjetë. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- arkeologjia;<br>- gjeografia. | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** diskutim, pyetje-përgjigje.

**Organizimi i orës së mësimit**

- Mësuesi/ja vendos në tabelë ose shfaq në monitor pamje të kështjellave mesjetare, kishave të besimit katolik dhe ortodoks, të afreskeve dhe ikonave, mozaik bizantinë, dy kodikët e Beratit dhe u drejton nxënësve pyetjen:

  - Çfarë paraqesin këto foto?

  - Çfarë kuptoni ju ndërmjet tyre?

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin, duke i ndarë në grupe sipas pjesëve kryesore të mësimit.
- Secili pre grupeve cakton një ose dy përfaqësues për të ndërtuar në tabelë një skice përmbledhëse.
- Punohet në mënyrë të tillë që puna e secilit grup të ruhet në tabelë me qëllim që pas përfundimit të përsëritet edhe njëherë informacioni nga nxënësit.






**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. evidenton disa nga shkollat e para në Arbëri;
2. identifikon disa nga veprat mesjetare me të cilat mund të krenohemi;
3. përshkruan tipat e ndërtimeve mesjetare;
4. shpjegojnë pse letërsia kishte kryesisht karakter fetar.

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

- Hartoni një ese të shkurtër mbi monumentet kulturore në krahinën tuaj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Histori</th><th>Shkolla:</th><th>Klasa: 11</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Ardhja e osmanëve në Ballkan dhe qëndresa ballkano-arbërore (fundi i shek. XIV – fillimi i shek. XV)</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Mësuesi/ja e nis orën e mësimit me një prezantim të principatës së Kastriotëve dhe Arianitëve. Shih:<br>https://www.youtube.com/watch?v=y2aC2PM5-gQ.</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>Kompetenca e të menduarit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të menduarit për realizimin e kërkimit historik.<br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit; trashëgiminë materiale dhe shpirtërore.<br><br><u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>.<br>Nxënësi:<br>➢ përcakton arsyet e ardhjes së osmanëve në Ballkan dhe territoret shqiptare;<br>➢ evidenton përpjekjet e ballkanasve për qëndresë ndaj osmaneve;<br>➢ shpjegon format e para të qëndresës në territoret shqiptare.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>- vasalitet;<br>- koalicioni ballkanik;<br>- osmanëve;<br>- Sanxhak;<br>- principatë;<br>- kryengritje.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>• Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme, enciklopedi, hartë e principatave të shek. XIV, hartë e pushtimeve të para osmane etj.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>- gjeografia;<br>- letërsia.</td></tr>
</table>

| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve |
|---|
| **Metodologjia:** bashkëbisedim, mësimdhënie e ndërsjellë.<br><br>**Organizimi i orës së mësimit**<br>• Mësuesja e nis orën e mësimit me një prezantim të principatave kryesore të shek. XIV në Arbëri, duke u përqendruar te ajo e Kastriotëve dhe e Arianitëve. Shih: https://www.youtube.com/watch?v=y2aC2PM5-gQ.<br>• Pasi ndjekin prezantimin mësuesi/ja organizon një bashkëbisedim me nxënësit, duke rikujtuar njohuri nga temat e mëparshme si dhe njohuri të mësuara në klasën e 10 mbi Perandorinë Osmane, p.sh.:<br>- Cilat ishin principatat kryesore në vendin tonë?<br>- Nga kush drejtoheshin?<br>- Cilat ishin ato tipare që tregojnë për organizimin e tyre si dhe shtetet e tjera të mesjetës?<br>- Kur u krijua shteti osman?<br>- Ku shtrihej ai në periudhën e lulëzimit të tij?<br>- Kujtoni se cilat ishin arsyet që osmanët pushtuan lehtë Ballkanin?<br>**Ndërtimi i njohurive:**<br>•Mësuesi/ja e ndan klasën në grupe, sipas pjesëve të mësimit dhe udhëzon të lexohet mësimi.<br><br>•Nga secili grup mësuesi cakton një nxënës, i cili do të luajë rolin e mësuesit. Detyra e tij është të shpjegojë përmbajtjen e mësimit, të shpjegojë paqartësitë e nxënësve të tjerë si dhe të drejtojë pyetje për nxënësit e grupit për të kontrolluar nëse është kuptuar mësimi.<br>•Grupi i parë: Qëndrimi i klasës feudale ballkanike dhe shqiptare ndaj osmanëve.<br>•Grupi i dytë: Koalicionet ballkanike.<br>•Grupi i tretë: Ndarja e tokave shqiptare.<br><br>•Mësuesi /ja tregon kujdes që të mos ngelen informacione te mësimit pa u shpjeguar për këtë arsye në përfundim të veprimtarisë ndërton njohuritë e reja në mënyrë të përmbledhur në tabelë. |




- Mësuesi nxit të menduarit kritik të nxënësve duke drejtuar pyetjen:
  Duke vështruar në hartë shtrirjen e principatës së Gjon Kastriotit evidentoni faktet që dëshmojnë se kjo principatë kishte potencial ekonomik.

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:
1. analizon shkaqet e përparimit të shpejtë të osmanëve në Ballkan;
2. shpjegon pjesëmarrjen e gjerë të shqiptarëve në koalicionin e vitit 1389;
3. evidenton copëtimin e tokave shqiptare;
4. analizon politikën e Gjon Kastriotit dhe Gjergj Arianitit kundrejt osmanëve.

**Vlerësimi:**

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna në formulimin e pyetjeve dhe në të menduarit kritik.*

**Detyrat dhe puna e pavarur**:
- Rendit koalicionet ballkanike dhe pjesëmarrësit e tyre si dhe përparimin e osmanëve në Ballkan duke ndërtuar hartën e Ballkanit ku të paraqiten me ngjyra të ndryshme pushtimet e realizuara pas çdo koalicioni.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkolla: | Klasa: 11 |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Gjergj Kastriot Skënderbeu dhe Besëlidhja e Lezhës | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja vendos në tabelë ose shfaq në monitor piktura, skulptura, pamje të Skënderbeut, Kuvendit të Lezhës si dhe një sekuencë nga filmi "Skënderbeu" ku tregohet organizimi i Lidhjes së Lezhës. | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**<br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi/ja<br>• përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi/ja:<br>• parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime.<br>**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.** Nxënësi/ja:<br>• zhvillon aftësitë për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin për të identifikuar dhe vlerësuar burimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjes historike.<br>**Kompetenca personale**: Nxënësi/ja:<br>• përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij. | | **Fjalët kyçe:**<br>- *Kastriotët;*<br>- *Skënderbeu;*<br>- *Besëlidhja e Lezhës;*<br>- *Principatat shqiptare;*<br>- *Venediku.* | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**.<br>Nxënësi/ja:<br>➢ përcakton momentet kryesore të jetës dhe veprimtarisë së Gjergj Kastriot Skënderbeut;<br>➢ shpjegon shkaqet e thirrjes së Kuvendit të Lezhës;<br>➢ analizon vendimet e Kuvendit të Lezhës duke vlerësuar rëndësinë e tyre. | | | |

| | |
|---|---|
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi, botime letrare mbi Skënderbeun, si p.sh.: “Skënderbeu” i M. Barletit dhe i S. Godos. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- letërsia;<br>- gjeografia etj. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** diskutim, INSERT.

**Organizimi i orës së mësimit**

- Mësuesi/ja vendos në tabelë ose shfaq në monitor piktura, skulptura, pamje të Skënderbeut, kuvendit të Lezhës si dhe një sekuencë nga filmi “Skënderbeu” ku tregohet organizimi i Lidhjes së Lezhës.

- Organizohet diskutim në klasë, duke kërkuar nga nxënësit të sjellin fakte që njohin nga jeta e heroit tonë kombëtar, nxënësit mund të sjellin informacion nga jeta dhe shkollimi i Skënderbeut.

**Ndërtimi i njohurive:**

Mësuesja udhëzon nxënësit të lexohet mësimi, duke i kërkuar te vendosin përbri secilës pjesë të lexuar shenjat, të cilat kanë kuptimet e mëposhtme:

√ —— vendoset përbri informacionit që për ju është i njohur;
- —— vendoset përbri informacionit që ju e dinit ndryshe;
+ —— vendoset përbri informacionit që është i ri për ju;
? —— vendoset përbri informacionit që është i paqartë ose doni të dini më shumë.

- Pas leximit organizohet në klasë bashkëbisedim ku nxënësit krahasojnë shenjat e vendosura dhe diskutojnë rreth fakteve të reja. (Këto veprimtari mund të zhvillohen në 20 minutat e para të mësimit dhe pjesën tjetër plotësohet tabela nga përgjigjet e nxënësve.)

| √ | — | + | ? |
|---|---|---|---|
| - Në moshën 9-vjeçare u dorëzua peng tek osmanët së bashku me dy vëllezërit e tjerë.<br><br>- Ai u dallua për zgjuarsinë dhe shkathtësinë e tij.<br><br>- Atij iu vu emri Skënder (Aleksandër).<br>- U shqua si një ushtarak i zoti dhe shumë shpejt mori titullin bej.<br><br>- Kuvendi i fisnikëve shqiptarë u mbajt në Lezhë.<br><br>- Futja në Krujë nëpërmjet një fermani të rremë. | - Nxënësit mund të dinë ndryshe mbi zotërimin e Lezhës.<br><br>- Nxënësit mund të dinë ndryshe përfundimin e betejës me Huniadin. | - Më 3 nëntor 1443 u zhvillua beteja kundër Huniadit, e cila shënoi dështimin osman.<br>- Skënderbeu së bashku me qindra bashkatdhetarë morën rrugën për në trojet shqiptare.<br>- Më 28 nëntor 1443, ai u shpall “zot i principatës së pavarur të Kastriotëve me qendër Krujën.<br>- U çliruan Kështjellat e Petrelës, të Gurit të Bardhë, të Stelushit e të Stefigradit.<br>- Skënderbeu ndoqi një politikë të brendshme e të jashtme shumë aktive.<br><br>Arsyet që kuvendi u thirr në Lezhë ⇨<br>1- Lezha kishte një pozicion gjeografik të favorshëm, ajo ndodhej afër zotërimeve të pjesëmarrësve kryesorë të Kuvendit.<br>2- Ajo ishte nën zotërimin venecian, çka mënjanonte pakënaqësitë ndërmjet sundimtarëve shqiptarë.<br>3- Ishte një thirrje miqësore për bashkëpunim me Republikën e Venedikut.<br><br>- Kuvendi u mbajt më 2 mars 1444, në Katedralen e Shën Kollit në Lezhë.<br><br>Vendimet ⇨<br>- U krijua Besëlidhja Shqiptare e Lezhës.<br>- U krijua një ushtri e përbashkët.<br>- U krijua një arkë e përbashkët.<br><br>- Në të morën pjesë udhëheqës të kryengritjeve të mëparshme antiosmane dhe përfaqësues të aristokracisë shqiptare.<br><br>- U hodh një hap i madh drejt bashkimit politik të vendit.<br>- Anëtarët e Besëlidhjes Shqiptare synonin të ruanin autonominë e | - Nxënësit mund të pyesin rreth besimit fetar të Skënderbeut.<br><br>- Sa fëmijë kishte Gjon Kastrioti?<br><br>- Djali i kujt ishte Hamzai?<br><br>- Si pranuan princërit të bashkoheshin me Skënderbeun? etj. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | tyre dhe Skënderbeu, të ishte si "i parë ndërmjet të barabartëve".<br><br>Faktorët që ndikuan në zgjedhjen e Skënderbeut në krye të Besëlidhjes. ⇨ 1. roli i tij në organizimin e Kryengritjes së Përgjithshme të vitit 1443;<br>2. pozita gjeografike e shtetit të Kastriotëve;<br>3. lidhjet e shumta farefisnore e martesore të Kastriotëve;<br>4. personaliteti i Skënderbeut. | |

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. evidenton rrugën e zgjedhur nga Skënderbeu për të realizuar projektin e tij për një kryengritje të përgjithshme;
2. shpjegon arsyet që çuan në organizimin e kuvendit në qytetin e Lezhës;
3. analizon shprehjen: "I pari midis të barabartëve";
4. shpjegon nëse Kuvendi i Lezhës shënon krijimin e një shteti shqiptar unitar.

**Vlerësimi:**

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna, në aktivizimin në orën e mësimit, në saktësinë e përgjigjeve dhe të argumenteve të paraqitura në diskutim.*

**Detyrat dhe puna e pavarur**:

Shkruani një ese me temë "Skënderbeu heroi ynë kombëtar".

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Qëndresa e shqiptarëve kundër osmanëve dhe diplomacia e shtetit të Skënderbeut | | **Situata e të nxënit:**<br>Lexohet në klasë rubrika "Grimca historike".<br>"4 maj 1448. Mbasi një nënshtetas yni, njeri praktik dhe i kuptueshëm, e njoftoi zotërinë tonë se mund të gjente mënyrën që mund ta mbyste ose të fuste të tjerë ta mbytnin Skënderbeun..." | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>**Kompetenca personale.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit.<br>**Kompetenca qytetare.** Nxënësi:<br>• shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar, duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore.<br>**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.**<br>Nxënësi:<br>➢ analizon tiparet e shtetit nën drejtimin e Gjergj Kastriot Skënderbeut;<br>➢ shpjegon marrëdhëniet e shtetit të Skënderbeut me shtetet e tjera;<br>➢ vlerëson rëndësinë historike të periudhës së Skënderbeut për kohën dhe të ardhmen. | | **Fjalët kyçe:**<br>- *shtet i përqendruar;*<br>- *monarki feudale;*<br>- *kurorëzim;*<br>- *rrethimet e Krujës;*<br>- *taktikë luftarake.* | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi, botime letrare për figurën e Skënderbeut, hartë e shtetit të Skënderbeut. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- letërsia;<br>- gjeografia. | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** diskutim, pyetje-përgjigje.

**Organizimi i orës së mësimit**

- Lexohet në klasë rubrika "Grimca historike".
- Shfaqet në projektor pjesë, të cilat përzgjidhen nga mësuesja nga dokumentarët e mëposhtëm. Shih: https://www.youtube.com/watch?v=8SXkpmCDx04, https://www.youtube.com/watch?v=rdNCCKUsphU.
- Mësuesi/ja organizon diskutimin në klasë, duke i nxitur nxënësit të marrin pjesë nëpërmjet pyetjeve:

- Cilat ishin kështjellat kryesore të Kastriotëve? Gjejini ato në hartë.
- Pse ishte e domosdoshme të kalohej nga Lidhja e Lezhës në shtetin e përqendruar?
- Me cilat shtete kishte marrëdhënie Skënderbeu?
- Pse Skënderbeu u quajt "atleti krishterimit"?

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin, duke i ndarë në dy grupe sipas pjesëve kryesore të mësimit. Nxënësit sipas grupeve organizohen për të prezantuar mësimin në tabelë, duke ndarë pjesë të ndryshme sipas problemeve të trajtuara në pjesën përkatëse. Ndarjen brenda grupit mund ta organizojë dhe mësuesja sipas skemës së mëposhtme:

*Grupi i parë*: Kalimi nga Lidhja në shtetin e përqendruar.

Problemet që po kalonte Lidhja e Lezhës ⇒
- disa krerë nuk merrnin pjesë rregullisht në luftë;
- të tjerë nuk jepnin kuotën e caktuar;
- grindeshin me njëri-tjetrin dhe dilnin nga Lidhja e Lezhës.

Rrugët që ndoqi Skënderbeu për të kaluar në shtetin e përqendruar ⇒
- nëpërmjet lidhjeve martesore;
- nëpërmjet vullnetarizmit,
- nëpërmjet forcës.

❖ Shtetit i Skënderbeut ishte i organizuar në formën e monarkisë feudale: ⇒

- Pushteti i Skënderbeut ishte i trashëgueshëm.
- Skënderbeu mbante titullin “zot i Shqipërisë”
-Kishte organet e qeverisjes që ishin:
1-Kuvendi i Princave Shqiptarë;
2-Këshilli i Lartë;
3-Këshilli i Luftës.
- Kishte arkën, financat, ushtrinë.
- Kishte aparatin administrativ.
- Kishte simbolet e veta, si flamurin, stemën dhe vulën zyrtare.

⇓ shtrihej ⇓

- nga Malësia e Dukagjinit në veri deri në lumenjtë Devoll e Seman në jug;
- nga brigjet e Adriatikut në perëndim deri në luginën e Drinit të zi në lindje.

❖ Skënderbeu si monark ⇒

- Nxirrte dekrete për: mobilizimin e përgjithshëm të popullsisë;
  për caktimin e taksave;
  për caktimin e doganave.
- U shpërndante zotërime tokësore bujarëve besnikë.
- Dënonte krimet e rënda ndaj shtetit.

❖ Organizimi i ushtrisë ⇒

- Përgatiti një ushtri prej 15000 vetash.
- U meremetuan kështjellat.
- U vendosën reparte të zgjedhura.
- Krijoi një sistem mbrojtës në pjesën lindore të vendit.
- Përgatiti strategjinë e mbi 23 betejave ushtarake kundër osmanëve dhe Venedikut.

❖ Betejat kryesore (23 beteja) ⇒

në Torvioll;
në Kashar;
në Oranik;
në Mokër;
beteja me Venedikun për çlirimin e Dejës,
tre rrethimet e Krujës.

Grupi i dytë: Marrëdhëniet ndërkombëtare të Skënderbeut

- Me Papatin → 
  - Papët ndihmuan në njohjen e shqiptarëve dhe të Skënderbeut në Evropë.
  - Papët ndërhynë për forcimin e lidhjeve ndërmjet Skënderbeut dhe Dukagjinëve.

- Me Mbretërinë e Napolit → 
  - Traktati i Gaetës.
  - Më 1455 erdhën qindra ushtarë napolitanë.

- Me Venedikun → 
  - Mbajti qëndrim armiqësor ndaj tij deri në vitin 1463.
  - Venediku zotohej t'i jepte Skënderbeut ndihma ushtarake në 1000 veta.

- Me Huniadin → 
  - Secili në frontin e vet, ndihmuan njëri-tjetrin për dobësimin e shtetit osman.

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. rendit tiparet e shtetit të Skënderbeut;
2. evidenton rrugët e formimit të shtetit prej tij;
3. shpjegon taktikat e ndjekura nga Skënderbeu në përballjet me turqit;
4. argumenton arsyet e kalimit nga Aleanca politike në një shtet të përqendruar;
5. analizon rëndësinë e epokës së Skënderbeut.

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

- Hulumto dhe siguro informacion shtesë rreth marrëdhënieve të Skënderbeut me Venedikun.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Histori</th><th>Shkolla:</th><th>Klasa: 11</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Veprimtari praktike: Figura e Gjergj Kastriot Skënderbeut përmes letërsisë dhe artit shqiptar e botëror</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Lexohet situata e të nxënit në tekst.<br>“Shekulli XV është shekulli i heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeut. Në atë kohë, Shqipëria u bë fushë betejash titanike dhe Kruja, çerdhe e lirisë për njëqind vjet me radhë...”</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>Kompetenca e të menduarit. Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës.<br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat, për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>Kompetenca qytetare. Nxënësi:<br>• shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar, duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore.<br>Kompetenca digjitale. Nxënësi:<br>- komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>- Gjergj Kastrioti Skënderbeu;<br>- hero kombëtar;<br>- vepra historike;<br>- vepra letrare;<br>- arbër;<br>- kulturë popullore;<br>- arte figurative;</td></tr>
</table>

<table>
<tr>
<td><u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>. Nxënësi:<br>➢ shpjegon në mënyrë të përmbledhur rrethanat historike dhe figurën e Skënderbeut;<br>➢ vlerëson rolin e folklorit si mjet për përcjelljen në kohë dhe hapësirë të epopesë së Skënderbeut;<br>➢ identifikon veprat kryesore me karakter historik që trajtojnë figurën dhe bëmat e Skënderbeut;<br>➢ evidenton pasqyrimin e figurës së Skënderbeut në letërsi si në veprat e autorëve shqiptarë, ashtu edhe ata të huaj;<br>➢ tregon vendin që zë arti pamor, muzikor apo kinematografia në evidentimin e figurës së Skënderbeut;<br>➢ analizon debatet që ngjallin vepra të ndryshme rreth aspekteve të ndryshme të jetës dhe veprimtarisë së Skënderbeut.</td>
<td>- arti muzikor;<br><br>- artet kinematografike.</td>
</tr>
<tr>
<td>Burimet:<br>• Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi, vepra të ndryshme të artit, O. J. Shmit “Skënderbeu”, botuar në 2008, “Skënderbeu “ i Sabri Godos, i Marin Barletit etj.</td>
<td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>- gjuha dhe letërsia, artet;<br>- TIK.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Metodologjia: punë në grupe, prezantim në klasë.<br><br>Organizimi i orës së mësimi<br>• Lexohet situata e të nxënit në tekst.<br>“Shekulli XV është shekulli i heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeut. Në atë kohë, Shqipëria u bë fushë betejash titanike dhe Kruja, çerdhe e lirisë për njëqind vjet me radhë...”<br>• Mësuesi/ja ka udhëzuar nxënësit një orë më parë, duke e ndarë klasën në katër grupe, të cilat do të kenë për objekt të punës së tyre:<br>Grupi I: Veprat me karakter historik që trajtojnë figurën e Skënderbeut<br>• Evidentohen, nisur nga aspekti kronologjik, disa prej veprave kryesore që kanë si subjekt jetën dhe veprën e Skënderbeut.</td>
</tr>
</table>

- Vihen në dukje informacione rreth rrethanave të krijimit dhe objektivitetit të veprave të ndryshme historike lidhur me Skënderbeun.

*Grupi II:* Folklori dhe kultura popullore me tematikë Skënderbeun
- Identifikohen krijime të natyrës folklorike që trajtojnë figurën e Skënderbeut, duke u përqendruar te burimet e qytetit apo zonës së tij.
- Analizohen disa prej formave të shprehjes së kulturës popullore ku zë vend tematika e jetës dhe veprës së Skënderbeut.

*Grupi III*: Arti pamor (piktura, skulptura, kinematografia, teatri)
- Evidentohen disa vepra të autorëve të huaj, që janë përgjithësisht edhe të parat, lidhur me Skënderbeun.
- Analizohen disa prej veprave të autorëve shqiptarë, duke u përqendruar në veprat monumentale të vendosura në qytete të ndryshme të Shqipërisë.
- Prezantohet një shikim i përmbledhur i vlerave të Muzeut të Skënderbeut në Krujë.

*Grupi IV:* Letërsia për Skënderbeun
- Tregohen veprat dhe autorët kryesorë që kanë krijuar letërsi me tematikën e Skënderbeut.
- Vihet në dukje roli i poetëve dhe shkrimtarëve arbëreshë në lëvrimin në letërsi të figurës së Skënderbeut.
- Shpjegohet vendi që zënë autorët e huaj, të cilët kanë krijuar vepra letrare lidhur me Skënderbeun.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Secili grup duhet të paraqesë punën e bërë nëpërmjet një prezantimi në klasë. Ky prezantim mund të marrë forma të ndryshme, si: material në *Power Point,* krijimi i një albumi ose ekspozite me foto a materiale të tjera të grumbulluara dhe të përdorura gjatë punës së grupit.

- Secili prej grupeve merr pjesë në diskutimin e organizuar pas prezantimit, si p.sh.:

*Grupi I:* Debaton rreth veprës së Oliver Shmitit për Skënderbeun, duke vënë në dukje aspektet e diskutueshme të saj.
*Grupi II:* Diskuton duke iu referuar folklorit dhe kulturës popullore për Skënderbeun.
*Grupi III*: Diskuton elemente të ndryshme të filmit emblemë “Skënderbeu”, duke u përqendruar te pasqyrimi i ngjarjeve historike të kohës në të.
*Grupi IV: Diskuton* vendin që zënë autorët e huaj, të cilët kanë krijuar vepra letrare lidhur me Skënderbeun.

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:
- ➢ shpjegon në mënyrë të përmbledhur rrethanat historike dhe figurën e Skënderbeut;
- ➢ vlerëson rolin e folklorit si mjet për përcjelljen në kohë dhe hapësirë të epopesë së Skënderbeut;

- identifikon veprat kryesore me karakter historik që trajtojnë figurën dhe bëmat e Skënderbeut;
- evidenton pasqyrimin e figurës së Skënderbeut në letërsi si në veprat e autorëve shqiptarë, ashtu edhe të atyre të huaj.
- analizon debatet që ngjallin vepra të ndryshme rreth aspekteve të jetës dhe veprimtarisë së Skënderbeut.

***Vlerësimi:***
*Nxënësit vlerësohen në grup, mbi bazën e materialeve të hulumtuara, qartësisë, estetikës së prezantimit të paraqitur dhe angazhimit që kanë treguar në gjetjen dhe mbledhjen e materialit, si edhe në paraqitjen e tij para klasës.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**
- Nxënësit përfundojnë në shtëpi ndërtimin e një albumi mbi figurën e Skënderbeut në arte dhe letërsi.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Territoret shqiptare gjatë sundimit osman (shek. XVI-XVIII) | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi /ja për të nxitur kureshtjen e nxënësve organizon në klasë një kuic me pyetje që lidhen me informacionin e ri. | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi:<br>• parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime.<br>**Kompetenca personale.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, për të vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve, qofshin këto dhe të ndryshme nga të tijat.<br>**Kompetenca qytetare.** Nxënësi:<br>• kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave. | | **Fjalët kyçe:**<br>- sanxhak;<br>- timar;<br>- kodet;<br>- çiflig;<br>- krahina të vetëqeverisura;<br>- esnafe;<br>- procesi i islamizimit. | |

| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.** | |
|---|---|
| Nxënësi:<br>➢ Evidenton hapat që u ndoqën për përhapjen e islamizmit në vendin tonë.<br>➢ Analizon ndarjet kryesore në fshatin shqiptar.<br>➢ Shpjegon organizimin administrativ dhe atë ekonomik gjatë pushtimit osman.<br>➢ Shpjegon dy prirjet politike të shoqërisë shqiptare. | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, hartë e tokave shqiptare. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- gjeografia;<br>- qytetaria. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** kuic, punë në grupe, harta e mendjes.

**Organizimi i orës së mësimit:**

- Mësuesi /ja për të nxitur kureshtjen e nxënësve organizon në klasë një kuic me pyetje që lidhen me informacionin e ri, p.sh.:

- Sa besim fetar ka sot në vendin tonë?
- Ku besonin ilirët?
- Kur u përhap krishterimi në vendin tonë? Pse?
- Cili prej besimeve fetare është më i përhapur sot në Shqipëri?
- Si u përhap myslimanizmi në vendin tonë?

- Mësuesi/ja u drejtohet nxënësve: "Për të pasur më të qartë se si u përhap islamizmi në Shqipëri do të mësojmë se si ishte e organizuar jeta shoqërore dhe ekonomike në tokat shqiptare nën pushtimin osman në shek. XVI-XVIII".

**Ndërtimi i njohurive:**

- Nxënësit lexojnë mësimin të ndarë në grupe sipas udhëzimit të mësuesit. Secili prej grupeve ndërton hartën e mendjes rreth informacionit të ri.

*Grupi I* - Organizimi administrativ
*Grupi II* - Organizimi ekonomik
*Grupi III* - Qyteti shqiptar
*Grupi IV*- Prirjet shoqërore politike
*Grupi V* - Faktorët e përhapjes së fesë islame në tokat shqiptare.


Ejaleti i Rumelisë
(Në krye valiu.)
ndahej në
Nëntë sanxhakë
(Në krye sanxhakbeu)
ndahej në
Kaza
Nahije
Organizimi ekonomik i fshatit
Zona e parë
Timari
Spahinjtë shfrytëzonin token kundrejt kushtit ushtarak
Fshatarët
shlyenin
Taksa shtetit si:
- taksën për kokë;
- për bagëtitë.
Taksa spahiut si:
- të dhjetën;
- të pendës e të tjera.
pronar i tokës ishte shteti e ndante tokën në:
Hase
Timare
Ziamete
Zona e dytë
Krahina të vetëqeverisura
Paguanin shtetit një tribut vjetor
në të holla
në ushtarë
Qytetet shqiptare
u mbuluan me një "vello"
Ishin qendra tregtare.
Zejtarët e tregtarët shqiptarë u bashkuan në
Në krye të esnafit qëndronte llonxha.
Kishin statutet e tyre që :
- përcaktonin shtrirjen e punishteve, lëndën e parë,
- merrnin pjesë detyrimisht në fushatat ushtarake;
- jepnin ndihma financiare për institucionet fetare dhe ndihmonin në hapjen e shkollave
Prirjet shoqërore politike
(shek. XVI-XVII)
Dy prirje
1-Ngjitja e shkallëve të hierarkisë shtetërore.
2- E dyta ishte qëndresa me armë (kryengritje).
u thirrën disa kuvende
Ballkanike:
Dy në Kuç,
Dy në Serbi (1616-1620)
Shqiptare:
në Mat (7 nëntor 1594),
në Blinisht (1599)
Dukagjin të Matit (1601, 1602)

Gjatë shekujve XVII-XVIII shpërthyen një varg kryengritjesh

- kryengritja e Andrea Manesit, (1607),
- kryengritjet në Vlorë dhe Shkodër gjatë Luftës Austro-Osmane (1683-1690), në Kosovë dhe në Rrafshin e Dukagjinit,
- në Lumë e në Maqedoninë Perëndimore, e udhëhequr nga Pjetër Bogdani.

Faktorët e përhapjes së fesë islame

Me anë të vullnetarizmit

- Atyre që përqafonin fenë islame, u jepeshin dhurata.
- Tregtia ishte monopol i myslimanëve.
- Ngjitnin shkallët e karrierës ushtarake vetëm myslimanët etj.

Me anë të dhunës

- në forma format indirekte;
- me dhunë të drejtpërdrejtë.

- Pas prezantimit të informacionit të ri mësuesi/ja nxit nxënësit drejt të menduarit kritik nëpërmjet diskutimit:
  - Pavarësisht pranisë së feve të ndryshme, në gjirin e popullsisë shqiptare nuk kishte konflikte të dukshme apo të mëdha mbi baza fetare. Sipas mendimit tuaj, kjo situatë vinte për shkak të tolerancës apo të indiferentizmit fetar?

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:
1. rendit kryengritjet dhe kuvendet shqiptare e ballkanike;
2. evidenton mbulesën fetare islame të qyteteve shqiptare;
3. përcakton fushën e veprimit të esnafeve në veprimtarinë e tyre;
4. analizon ndarjet kryesore në fshatin shqiptar;
5. shpjegon dy prirjet politike të shoqërisë shqiptare dhe me se lidhen ato.

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre, në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime, në të menduarit kritik dhe në analizën që bën rreth fakteve të ndryshme.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

- Mblidhni materiale për prirjet shoqërore dhe politike të krahinës suaj në shekullin XVI.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE**

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Pashallëku i Shkodrës (1757-1831) | | **Situata e të nxënit:**<br>Lexohet në klasë rubrika "Grimca Historike".<br>"Mehmet pashë Bushatlliu krijoi një bibliotekë me vepra të jurisprudencës osmane. Fëmijët e tij e pasuruan atë më tej me libra osmanë dhe të Evropës..." | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**<br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të menduarit për realizimin e kërkimit historik.<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit; trashëgiminë materiale dhe shpirtërore.<br><br>**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.**<br>Nxënësi:<br>➢ rendit kohën e qeverisjes me ngjarjet përkatëse të secilit prej pashallarëve;<br>➢ evidenton rrugët që ndoqi Mehmet pasha për formimin e pashallëkut;<br>➢ shpjegon qëllimet e Mahmutit dhe rrugët që ndoqi ai. | | **Fjalët kyçe:**<br>- *pashallëk;*<br>- *familja e Bushatllinjve;*<br>- *pashë;*<br>- *"Konfederata ilirike";*<br>- *Porta e Lartë.* | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi, hartë e pashallëqeve etj. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- gjeografia;<br>- qytetaria | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** copëzat e përziera, diskutim, tabela e koncepteve.

**Organizimi i orës së mësimit:**

- Lexohet në klasë rubrika "Grimca Historike".

"Mehmet pashë Bushatlliu krijoi një bibliotekë me vepra të jurisprudencës osmane. Fëmijët e tij e pasuruan atë më tej me libra osmanë dhe të Evropës..."

- Mësuesja u jep nxënësve fleta të përgatitura më parë, në të cilat janë shkruar fjalë të ngatërruara që përmbajnë koncepte të mësimit. Nxënësit gjejnë kuptimin e fjalisë dhe e shkruajnë në tabelë, p.sh., fjalitë që mund të përdoren janë:

- *Pashallëku i Shkodrës u krijua nga Mehmet Bushatlliu në vitin 1771 kur Porta e Lartë i dha gradën e vezirit dhe qeverisjen e sanxhakëve të Shkodrës, të Dukagjinit, të Ohrit dhe të Elbasani*
- *Mahmut pasha në pranverën e vitit 1780 i thirri në Podgoricë një kuvend të krerëve shqiptarë, malazezë, boshnjakë dhe hercegovinasdhe krijoi aty një lidhje të quajtur "Konfederata ilirike".*
- *Ibrahim pasha e mbante veten për princ sovran, por mbeti vasal i sulltanit dhe për këtë qëndrim, në vitin 1804, u emërua vali i Rumelisë.*
- *Mustafa pasha u mbështet te sulltani dhe mori pjesë në shtypjen e Pashallëkut të Janinë.*

- Pasi shkruhen fjalitë në tabelë mësuesja pyet nxënësit:

- Cila ishte familja që drejtonte pashallëkun e Shkodrës?
- Sa pashallarë dolën nga kjo familje?
- A ishin të gjithë ata të bindur ndaj sulltanit?

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin, duke e ndarë klasën në tri grupe, sipas pjesëve përkatëse. Ndërkohë ndërton tabelën e koncepteve, e cila plotësohet nga përgjigjet e nxënësve.

| Drejtuesi i pashallëkut | Veçori të qeverisjes |
|---|---|
| Mehmet pashë Bushati | - Më 1757 mori nga sulltani titullin pashë.<br>- Vendosi qetësinë e rregullin në sanxhak.<br>- Zbatoi politikën e tolerancës fetare për katolikët.<br>- Përkrahu tregtarët, zejtarët. |

| | |
|---|---|
| | - Luftoi piraterinë në det.<br>- Njohu privilegjet e  krahinave malore.<br>- Zgjeroi territoret  me  Lezhën e Zadrimën, Mirditën, Durrësin dhe të Tiranën.<br>- Në vitin  1771, Porta e Lartë i dha gradën e vezirit dhe qeverisjen e sanxhakëve të Shkodrës, të Dukagjinit, të Ohrit dhe të Elbasanit. |
| Mahmut pashë  Bushatlliu | - Me qeverisjen e tij jeta ekonomike u gjallërua shumë shpejt.<br>- Ai i siguroi të vëllait, Ahmet beut, qeverisjen e sanxhakut të Ohrit.<br>-  Sulejman pashë Vërlacit, i siguroi qeverisjen e sanxhakut të Elbasanit.<br>- Gjatë viteve 1780-1785, Pashallëku i Shkodrës u ripërtëri si një shtet.<br>- Ai i shkëputi Bosnjës, Podgoricën e Shpuzën, nënshtroi Malin e Zi dhe krahinat Elbasan-Tiranë.<br>- Sulltani e shfuqizoi, por ai nuk iu bind urdhrave.<br>- Në pranverën e vitit 1786  ai thirri  kuvendin  në Podgoricë ku  krijoi “Konfederatën  ilirike”.<br>- Porta e Lartë  nisi forca të Bosnjës e të Rumelisë kundër tij, por pësoi disfatë (25 nëntor 1787).<br>- Mahmuti shpalli hapur formimin e një shteti të pavarur, për krijimin e të cilit kërkoi ndihmën e Austrisë e të Rusisë.<br>-. Në vitin 1791, ai u hodh në një kryengritje të dytë dhe doli fitues.<br>- Ai u vra në një ekspeditë në Mal të Zi (1796) |
| Ibrahim pashë Bushatlliu | - mbronte interesat e zejtarëve e të tregtarëve vendas<br>- mbeti vasal i sulltanit dhe për këtë qëndrim, në vitin 1804, u emërua vali i Rumelisë.<br>- Ai i kërkoi Ali pashë Tepelenës që të hiqnin dorë nga mëritë personale e të bashkoheshin kundër  forcave franceze të Napoleon Bonapartit.<br>- Në vitin 1809, ai vdiq. |
| Mustafa pashë Bushatlliu | - Qeverisi i mbi sanxhakët shqiptarë të Shqipërisë së Veriut deri në Prizren e Prishtinë.<br>- Mbështeti sulltanin dhe mori pjesë në shtypjen e Pashallëkut të Janinës. |

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. rendit kohën e qeverisjes me ngjarjet përkatëse të secilit prej pashallarëve Bushatllinj;
2. evidenton rrugët që ndoqi Mehmet pasha për formimin e pashallëkut;
3. shpjegon qëllimet e Mahmut pashës dhe rrugët që ndoqi ai;
4. analizon lidhjen  e quajtur “Konfederata ilirike”.

| **Vlerësimi:**<br>*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna në aktivizimin në orën e mësimit, në bashkëpunimin në grup etj.* |
|---|
| **Detyrat dhe puna e pavarur**:<br>• Ndërto hartën e pashallëkut të Shkodrës gjatë qeverisjes së Mahmut pashë Bushatlliut. |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Pashallëku i Janinës (1787-1822)<br>Arsimi dhe kultura në shek. XVI-XVI | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi /ja shfaq në klasë sekuenca nga dokumentar mbi Ali pashë Tepelenën. Interesant është dokumentari i gjetur në adresën https://www.youtube.com/watch?v=rIL8kMH2U3o që flet për marrëdhëniet e Ali pashës me shtetet e tjera, veçanërisht me Napoleon Bonapartin. | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>**Kompetenca personale.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit.<br>**Kompetenca qytetare.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë qytetare për të shqyrtuar në mënyrë kritike sjelljet, motivet dhe veprimet e njerëzve në të shkuarën që mund të jenë rezultat i ndryshimit të qëndrimeve shoqërore dhe standardeve të ndryshme. | | **Fjalët kyçe:**<br>- *Ali pasha;*<br>- *pashallëku i Janinës;*<br>- *shtet monarkik kushtetues;*<br>- *arsimi;*<br>- *rapsoditë e kreshnikëve;*<br>- *letërsia;*<br>- *arkitektura.* | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.**<br>Nxënësi:<br>➢ rendit masat e Aliut për forcimin e pashallëkut, sipas fushave përkatëse; | | | |

| | |
|---|---|
| ➢ evidentoi elemente që tregojnë se pashallëku i Janinës funksiononte si një shtet më vete nga Perandoria Osmane;<br>➢ përshkruan pozitën ndërkombëtare të Pashallëkut të Janinës;<br>➢ evidenton elementet e reja në shkollën, letërsinë dhe artin e kësaj periudhe. | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi, botime letrare si p.sh.: “Ali pashë Tepelena” i autorit Sabri Godo, "Shtegtimet e Çajd Haroldit”, harta etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- letërsia;<br>- gjeografia;<br>- qytetarinë. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** diskutim, pyetje-përgjigje, hartë e konceptit.

**Organizimi i orës së mësimit:**

- Mësuesi/ja shfaq në klasë sekuenca nga dokumentari mbi Ali pashë Tepelenën. Interesant është dokumentari i gjetur në adresën https://www.youtube.com/watch?v=rIL8kMH2U3o që flet për marrëdhëniet e Ali pashës me shtetet e tjera dhe veçanërisht me Napoleon Bonapartin dhe Revolucionin Grek.

- Organizohet në klasë diskutimi rreth figurës së Ali pashës. Me qëllim që nxënësit të jenë të aftë të marrin pjesë në diskutim u kërkohet një orë më parë të hulumtojnë informacion rreth figurës së pashait të Janinës.

**Ndërtimi i njohurive**

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin dhe duke drejtuar pyetje të ndryshme zbulon informacionin e ri nga nxënësit.
  - Si erdhi në pushtet Ali pashe Tepelena?
  - Cilat ishin marrëdhëniet e tij me Portën e Lartë?
  - Me cilat shtete kishte marrëdhënie diplomatike Ali pasha?
  - Cilat ishin marrëdhëniet mes dy pashallëqeve më të fuqishme shqiptare?
  - Evidentoni reformat ekonomike, ushtarake dhe gjyqësore të Ali pashës.
  - Renditni elementet e reja në shkollën, letërsinë dhe artin, arkitekturën dhe pikturën e kësaj periudhe.
- Mësuesi/ja aktivizon nxënës për të ndërtuar në tabelë hartën e koncepteve të mësimit, si p.sh.: “Pashallëku i Janinës”, “ Arsimi dhe kultura në shek. XVI-XVI”.
- E rëndësishme është që gjatë prezantimit të informacionit të ri të punohet paralelisht dhe me hartën për të treguar shtrirjen e pashallëkut të Janinës.




- -Në këtë mënyrë ndërtohet dhe harta e konceptit "Arsimi dhe kultura në shek. XVI-XVI".

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. evidenton elementet që tregojnë se pashallëku i Janinës funksiononte si një shtet më vete nga Perandoria Osmane;
2. përshkruan pozitën ndërkombëtare të Pashallëkut të Janinës;
3. rendit elementet e reja në shkollën, letërsinë dhe artin e kësaj periudhe.

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

- Mblidhni të dhëna mbi objektet arsimore dhe kulturore në krahinën tuaj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Histori</th><th>Shkolla:</th><th>Klasa: 11</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Përsëritje</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Diskutim i drejtuar nga mësuesi/ja rreth besimeve fetare në vendin tonë, duke e vënë theksin në tolerancën fetare në shekuj si një virtyt i shqiptarëve.</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>• parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet, duke u bazuar në argumente dhe burime.<br>Kompetenca personale. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve qofshin këto dhe të ndryshme nga të tijat.<br>Kompetenca qytetare. Nxënësi:<br>• kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohëra.</td><td colspan="2" rowspan="2">Fjalët kyçe:<br>- parahistori;<br>- Ilirët;<br>- Krishterim;<br>- arbër;<br>- principata;<br>- Gjergj Kastrioti;<br>- islamizmi;<br>- pashallëqe.</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</u><br>Nxënësi:<br>➢ demonstron njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi periudhën parahistorike, avancimin e kulturave të para dhe mënyrën e jetesës në parahistori;<br>➢ gjykon për ndryshimet që solli lindja e bujqësisë dhe zbulimi i metalit në jetën e njeriut;<br>➢ analizon ilirët dhe qytetërimin e tyre, shtrirjen, mënyrat e jetesës, organizimin shtetëror, kulturën ilire dhe ndikimi e kulturave fqinje greke dhe romake;<br>➢ shpjegon vazhdimësinë ilire-arbërore, ndarjen e Perandorisë Romake dhe</td></tr>
</table>

ndryshimet që pësuan territoret shqiptare në Perandorinë Bizantine;

- ➢ përshkruan veçoritë kryesore të principatave arbërore gjatë shekujve XII-XV (Principata e Arbrit, Balshajve, Topiajve, Kastriotëve);
- ➢ evidenton momentet kryesore të qëndrimit të klasës feudale shqiptare dhe ballkanike ndaj sulmeve të para osmane;
- ➢ shpjegon momentet kryesore të jetës dhe veprimtarisë së Gjergj Kastriotit Skënderbeut, shkaqet e thirrjes së kuvendit të Lezhës, rëndësinë e tij, tiparet e shtetit nën drejtimin e Gjergj Kastriotit;
- ➢ analizon zhvillimin ekonomik e shoqëror të qyteteve shqiptare në shekujt XVII-XVIII dhe faktorët që ndikuan në përhapjen e islamizmit në tokat shqiptare.
- ➢ tregon rrugën e formimit të pashallëqeve (Shkodrës, Janinës) dhe reformat e ndërmarra nga ato, si dhe aspekte të jetës së përditshme në këto pashallëqe.
- ➢ përshkruan zhvillimin e artit, kulturës, arkitekturës, arsimit dhe fesë gjatë kësaj periudhe.

**Burimet:**

- Libri i nxënësit, hartë e tokave shqiptare.

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**

- gjeografia;
- qytetaria.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** diskutim, kubimi.

**Organizimi i orës së mësimit**

- Diskutim i drejtuar nga mësuesi/ja rreth besimeve fetare në vendin tone duke e vënë theksin në tolerancën fetare në shekuj si një virtyt i shqiptarëve

**Ndërtimi i njohurive:**

Mësuesi/ja përdor metodën e kubimit për të bërë më argëtuese orën e mësimit. Është përgatitur më parë një poster me pyetje të ndryshme ose mësuesi/ja i ka shkruar në format A-4 dhe ka vendosur për një çift nxënësish një fletë të tillë.
Hidhet kubi nga nxënësi që do të përgjigjet dhe gjendet pyetja sipas radhës në fletën A-4.

- Kjo metodë realizohet sipas figurës së mëposhtme:




**I. Përshkruaj:**

1) shfaqjen e shenjave të para të artit gjatë parahistorisë;
2) arsyet e kalimit të njeriut nga jeta endacake në atë me vendbanim të qëndrueshëm; shfaqjet e para të vendbanimeve të fortifikuara në parahistori;
3) popullsinë ilire si njësi etnokulturore të veçantë;
4) shtetin e Epirit, mbretërinë dardane;
5) veçori të mbretërisë ilire;
6) qëndrimin e pushtetit bizantin në kohëra të ndryshme ndaj trevave tona;
7) fshatrat shqiptare gjatë pushtimit osman;
8) rrugën e ndjekur nga Aliu për të ardhur në krye të pashallëkut të Janinës;
9) marrëdhëniet e Ali pashës me shtetet e tjera.

**II. Argumento:**

1) lidhjet mes ilirishtes dhe shqipes;
2) pse Iliria e Jugut i rezistoi dyndjeve sllave;
3) pse tokat arbërore u bënë arenë pushtimesh të vazhdueshme;
4) pse trevat tona ishin ndër territoret e para evropiane ku u përhap besimi i krishterë;
5) pse pikërisht principata e Shkodrës (Balshajve) konsiderohet ajo që hodhi themelet e një shteti unitar mesjetar arbëror;
6) pse fshatrat shqiptare gjatë pushtimit osman u ndanë në dy zona nga pikëpamja ekonomike.

**III. Analizo:**

1) kushtet që favorizuan krijimin e shteteve ilire;
2) arsyet pse Iliria e Jugut i rezistoi dyndjeve sllave;
3) ndryshimin e tipareve të qyteteve arbërore;
4) fazat nëpër të cilat kaloi pushtimi osman në Ballkan;
5) rrugët që përdori Skënderbeu për organizimin e sistemit të aleancave;
6) tiparet e Skënderbeut si monark;

7) disa nga arritjet që pati pashallëku i Janinës nën drejtimin e Ali Pashë Tepelenës.

***IV. Shoqëro:***

- Emrat me datat dhe ngjarjet:

| | |
|---|---|
| • Gjergj Arianiti | -1757 |
| • Murati I | - Traktati i Gaetës |
| • Alfonsi V | - 1786 |
| • Mahmut pashë Bushatlliu | - beteja e Buzurshekut |
| • Konfederata Ilirike | - beteja e Fushës së Mjellmave (Fushë-Kosovë) |
| • “Akademia e Re” | - Bajroni |
| • Ali pashë Tepelenë | - kuvende ballkanike |
| • Kuç | -Voskopojë |
| • Huniadi | - Shën Pali |
| • Apoloni | - Skënderbeu |

***V. Krahaso:***

1) timarin në Perandorinë Osmane me pronjën në Perandorinë Bizantine;
2) pashallëkun e Janinës me atë të Shkodrës duke evidentuar të përbashkëtat dhe të veçantat e tyre;
3) Ilirinë e jugut me atë të veriut pas dyndjeve sllave;
4) rrugët e përhapjes së krishterimit me ato të përhapjes së myslimanizmit ne vendin tonë;
5) zhvillimin e qyteteve gjatë pushtimit bizantin me ato të qyteteve nën pushtimin osman;
6) korporatat në perandorinë bizantine me esnafet në Perandorinë Osmane;
7) pushtimet e huaja, duke evidentuar se cili ishte pushtimi më i egër dhe që shkaktoi më shumë pasoja në trojet e Arbrit gjatë shek. IX – XIII.

***VI. Zbato (mësuesi /ja ka përgatitur disa harta skicë)***

1) Plotëso hartën e mbretërive ilire.
2) Plotëso hartën e principatave të shek. XIV.
3) Shëno në tabelë kufijtë veriorë, jugorë, lindorë, perëndimore të principatës së Arbrit.
4) Ngjyros hartën skicë të pashallëqeve shqiptarëve.

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre, në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime, në të menduarit kritik, në analizën që bën rreth fakteve të ndryshme, në plotësimin e hartave skicë.*

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkolla:</td><td>Klasa: 11</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Test</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi/ja:<br>• përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.<br>Kompetenca e të menduarit: Nxënësi/ja:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme.<br>Kompetenca e të nxënit: Nxënësi/ja:<br>• zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një detyrë që i kërkohet.<br>Kompetenca personale: Nxënësi/ja:<br>• zhvillon aftësitë personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit</td><td colspan="2" rowspan="2">Fjalët kyçe:<br>- Parahistori,<br>- Ilirët<br>- Krishterim,<br>- Arbër,<br>- Principata,<br>- Gjergj Kastrioti,<br>- Islamizmi,<br>- Pashallëqe.</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</u><br>Nxënësi/ja:<br>➢ Demonstron njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi periudhën parahistorike, avancimin e kulturave të para dhe mënyrën e jetesës në parahistori.<br>➢ Gjykon për ndryshimet që solli lindja e bujqësisë dhe zbulimi i metalit në jetën e njeriut<br>➢ Analizon ilirët dhe qytetërimin e tyre, shtrirjen, mënyrat e jetesës, organizimin shtetëror, kulturën ilire dhe ndikimi e kulturave fqinje greke dhe romake .<br>➢ Shpjegon vazhdimësinë ilire-arbërore, ndarjen e Perandorisë Romake dhe ndryshimet që pësuan territoret shqiptare në Perandorinë Bizantine.<br>➢ Përshkruan veçoritë kryesore të principatave arbërore gjatë shekujve XII-XV (Principata e Arbrit, Balshajve, Topiajve, Kastriotëve)</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| ➢ Evidenton momentet kryesore të qëndrimit të klasës feudale shqiptare dhe ballkanike ndaj sulmeve të para osmane.<br>➢ Shpjegon momentet kryesore të jetës dhe veprimtarisë së Gjergj Kastriotit Skënderbeut, shkaqet e thirrjes së kuvendit të Lezhës, rëndësinë e tij, tiparet e shtetit nën drejtimin e Gjergj Kastriotit.<br>➢ Analizon zhvillimin ekonomik e shoqëror të qyteteve shqiptare në shekujt XVII-XVIII dhe faktorët që ndikuan në përhapjen e islamizmit në tokat shqiptare.<br>➢ Tregon rrugën e formimit të pashallëqeve (Shkodrës, Janinës) dhe reformat e ndërmarra nga ato, si dhe aspekte të jetës së përditshme në këto pashallëqe.<br>➢ Përshkruan zhvillimin e artit, kulturës, arkitekturës, arsimit dhe fesë. | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, hartë ë tokave shqiptare | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>-Me gjeografinë<br>-Me qytetarinë<br>-Me gjuhën dhe letërsinë |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Testim (Punë individuale- kontroll i njohurive)
**Organizimi i orës së mësimit**
Mësuesi/ ja ka përgatitur fletat e testit për secilin nxënës. Më poshtë paraqitet një variant i sugjeruar për testin e tremujorit Shtator-Dhjetor.

**Klasa XI** **Emri**______________________________
**Testim tremujori Shtator- Dhjetor**

**Qarko alternativën e saktë**:

**1**- Në territorin e Shqipërisë, deri më sot:
a) nuk është gjetur asnjë fosile e paraardhësve të njeriut modern (homo sapiens).
b) nuk është gjetur asnjë gjurmë e veglave të punës të paraardhësve të njeriut modern (homo sapiens).
**c)** Periudha e paleolitit të ulët është shumë e dokumentuar nëpërmjet vendbanimeve të hapura dhe shpellave. **(1 pikë)**

**2**- Gjatë sundimit bizantin në ndarjen në kategori të pronave, pronia ishte:
a) pronë tokësore private jashtë qytetit.
b) pronë tokësore shtetërore e kushtëzuar me detyrim ushtarak.

c) pronë tokësore private e institucioneve fetare. **(1 pikë)**

**3**- Fillimi i një shteti unitar mesjetar arbëror u shënua veçanerisht në principatën e drejtuar nga:
a) Teodor II Muzaka.
b) Karl Topia
c) Balsha II.
d) Andrea II Muzaka.

**(1 pikë)**

**4**- Pas vdekjes së Pirros, Aleanca Epirote u riorganizua si një shtet:
a) mbi baza federative të njohur me emrin Aleanca Epirote.
b) mbi baza republikane dhe u quajt Lidhja Epirote.
c) mbi baza monarkike dhe u quajt Mbretëria Molose. **(1 pikë)**

**5-** Lidhni emrat me datat dhe ngjarjet:

| | |
|---|---|
| Voskopojë | - Mahmut pashë Bushatlliu |
| Besëlidhja e Lezhës | - Principata e Arbrit |
| Kuvendi i Podgoricës | - Akademia e Re |
| Familja e Skurajve | - 2 mars 1444 |

**(4 pikë)**

**6**- Plotësoni saktë fjalitë e mëposhtme në mënyrë që pohimi të jetë i vërtetë:
a) Traktati i Gaetës u nënshkrua ndërmjet Skënderbeut dhe________________________.
b) Zejtarët e tregtarët shqiptarë u bashkuan në disa organizata të quajtura *esnafe*, të cilat ishin të ndara sipas ________________________
c) Në pranverën e vitit 1432, nisi një kryengritje antiosmane e drejtuar nga______________________________.
d) Beteja e zhvilluar në Fushën e Mjellmave (Fushë-Kosovë) më 15 qershor 1389 përfundoi me fitoren e __________________ **(4 pikë)**

**7**- Renditni disa prej arsyeve pse Iliria e Jugut i rezistoi dyndjeve sllave:
a) ________________________________________________
b) ________________________________________________
c) ________________________________________________ **(3 pikë)**

**8**- Evidentoni elementet që tregojnë se pashallëku i Janinës funksiononte si një shtet më vete nga Perandoria Osmane.
a) ________________________________________________
b) ________________________________________________

c) ______________________________ **(3 pikë)**

**9-** Evidentoni disa prej faktorëve që ndikuan në vendosjen e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut në krye të Besëlidhjes së Lezhës:

a) ______________________________

b) ______________________________

c) ______________________________ **(3 pikë)**

**10**- Identifikoni ngjarjet, datat, dhe figurat e mëposhtme historike.

a) Aleksandrit Molos ______________________________

b) Moisi Golemi ______________________________

c) Konfederata Ilirike ______________________________

d) vitet 229-228 p.e.s. ______________________________ **(4 pikë)**

**11-** Analizoni shkaqet dhe zhvillimin e konflikteve iliro-romake. **(5 pikë)**

**12**- Shpjegoni të dhënat që na dëshmojnë për vazhdimësinë etno-kulturore nga ilirët-arbërit-shqiptarët . **(5 pikë)**

| Nota | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | Gjithsej/pikë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pikë | 0- 8 | 9 - 13 | 14- 18 | 19- 23 | 24-27 | 28-31 | 32-35 | |

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në saktësinë e përgjigjeve të dhëna në test, në analizën e fakteve dhe shpjegimin e ngjarjeve si dhe në të menduarit kritik.*

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Histori</th><th>Shkolla:</th><th>Klasa: 11</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore. Projekt: Shteti shqiptar, sa larg dhe afër Evropës<br><br>(ora e dytë)</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br><br>Diskutim rreth kritereve për anëtarësimin në BE, si dhe rreth ngjarjeve aktuale që lidhen me këtë qëllim.</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë;<br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>• parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime;<br>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. Nxënësi:<br>• harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë<br>Kompetenca personale. Nxënësi:<br>• kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave</td><td colspan="2" rowspan="2">Fjalët kyçe:<br>- Bashkimi Evropian,<br>- Liberalizim i vizave,<br>- Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit,<br>- Parlamenti evropian,<br>- Reforma në drejtësi.</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>.<br>Nxënësi/ja:<br>➢ evidenton rrethanat historike dhe pozitën e trojeve shqiptare në fillim të shek. XX;</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| ➢ analizon qëndrimet e Fuqive të Mëdha ndaj procesit të krijimit të shtetit të pavarur shqiptar;<br>➢ vë në dukje përpjekjet e qarqeve patriotike shqiptare për konsolidimin e pozitës së shtetit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris dhe qëndrimin e Fuqive të Mëdha;<br>➢ vlerëson politikën e jashtme të monarkisë shqiptare;<br>➢ evidenton pozitën e Shqipërisë dhe shtetit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore;<br>➢ analizon aleancat dhe pozicionin ndërkombëtar të shtetit komunist shqiptar pas luftës;<br>➢ përshkruan politikën e izolimit në marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë komuniste;<br>➢ identifikon hapat e Shqipërisë në procesin e integrimit evropian. | |
| **Burimet:**<br>• Teksti Historia 11, interneti, materiale të shkruara, materiale audiovizuale, biseda me specialistë etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- me qytetarinë<br>- me TIK-un<br>- me gjeografinë etj. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Punë në grup, hulumtim.

**Organizimi i orës së mësimit**

- Vendosen nxënësit ne sallën e informatikës dhe ndahen sipas grupeve përkatëse.
- Përveç punës që do të realizojnë në këtë orë, nxënësit duhet të kenë sjellë informacion mbi detyrat e ngarkuara.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi /ja kalon te secili grup dhe kërkon që nxënësit të raportojnë paraprakisht punën e bërë në faza të ndryshme të projektit, ndaj u këshillohet të tregojnë vëmendje të veçantë për origjinalitetin e punimit.
- Mësuesi diskuton me nxënësit rreth burimeve të besueshme të informacionit dhe kujdesit në përzgjedhjen e tyre.
- Evidentohet kontributi i secilit anëtar të grupit dhe shkalla e bashkëpunimit mes tyre.
- Materialet paraprake të sjella nga nxënësit vlerësohen si pjesë e portofolit të nxënësit, po ashtu dhe puna deri në këtë fazë të projektit.

| |
|---|
| **Pyetje për diskutim**<br>Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:<br>1. Ka identifikuar burimet e besueshme të informacionit.<br>2. Punon me materialin paraprak për një prezantim sa më të mirë dhe origjinal.<br>3. Lidh ngjarjet historike ma ato aktuale mbi temën e dhënë. |
| ***Vlerësimi:***<br>*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në bashkëpunimin në grup dhe në efikasitetin e shfrytëzimit të kohës, në përcaktimin e burimeve të besueshme, në pjesëmarrjen në diskutim.* |
| **Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>• Hulumtoni dhe përzgjidhni materialin sipas detyrave të caktuara brenda grupit. |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkolla: | Klasa: 11 |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Rilindja Kombëtare dhe tiparet e programit politik të rilindësve shqiptarë. | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja vendos në tabelë ose shfaq në monitor foto të rilindasve. Prezantimi i fotove mund të shoqërohet me një shpjegim të shkurtër të veprimtarisë së rilindasve të njohur si: Jeronim De Rada, Naum Veqilharxhi, Sami Frashëri, Pashko Vasa etj. Prezantimi i fotove mund të bëhet dhe më interesant i shoqëruar me recitimin e poezisë së Pashko Vasës "O moj Shqypni, e mjera Shqypni" (shih: https://www.youtube.com/watch?v=ZaClJ1iasuw) | |

| | |
|---|---|
| **<u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u>**<br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi/ja:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë;<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi/ja<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi/ja<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br><br>**<u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>**.<br>Nxënësi/ja:<br>➢ shpjegon kushtet historike të fillesave të Rilindjes Kombëtare Shqiptare;<br>➢ evidenton rolin e elitës intelektuale shqiptare në zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare;<br>➢ shpjegon tiparet e programit politik të rilindësve shqiptarë;<br>➢ analizon kushtet dhe shkaqet që çuan në lindjen e çështjes shqiptare. | **Fjalët kyçe:**<br>- *lëvizje kombëtare;*<br>- *Rilindje Kombëtare;*<br>- *nacionalizëm;*<br>- *ideologji*<br>- *autonomi* |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, biblioteka e shkollës, interneti etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Me letërsinë<br>- Me TIK |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | |

**Metodologjia:** Diskutim / lexim i drejtuar /hartë e koncepteve

**Organizimi i orës së mësimit**

- Mësuesi/ja vendos në tabelë ose shfaq në monitor foto të rilindasve. Prezantimi i fotove mund të shoqërohet me recitimin e poezisë së Pashko Vasës "O moj Shqypni, e mjera Shqypni" (shih: https://www.youtube.com/watch?v=ZaClJ1iasuw)
- Nxitet në klasë diskutimi i drejtuar nga mësuesi/ja nëpërmjet pyetjeve:
  - Ç'ju kujton termi "Rilindje"?
  - Kur u zhvillua Rilindja Evropiane?
  - Cilat ishin temat më të trajtuara të Rilindjes Evropiane?

- Cila ishte situata në vendin tonë në periudhën e Rilindjes Evropiane (gjysma e shek. XV deri në gjysmën e shek. XVI)?

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë mësimin dhe ndërkohë shkruan në tabelë pyetjet të cilave nxënësit do t'i duhet t'i japin përgjigje pas leximit. P.sh.
  - *Cila ishte koha në të cilën u zhvillua Rilindja Kombëtare Shqiptare?*
  - *Pse kjo periudhë mori emrin "Rilindje"?*
  - *Cilat ishin synimet e rilindasve?*
  - *Si u zhvillua Rilindja Kombëtare Shqiptare?*
  - *Ku i ka fillesat nacionalizmi shqiptar?*
  - *Cilët ishin pionierët e parë të Rilindjes Kombëtare Shqiptare?*
  - *Çfarë trajtonin veprat e tyre?*
  - *Kush ishte burimi i frymëzimit për rilindasit?*
  - *Cilat ishin pikat kryesore të programit politik të Rilindjes Kombëtare Shqiptare?*
- Pasi nxënësit kanë lexuar informacionin në tekst mbi Rilindjen Kombëtare Shqiptare, mësuesi/ja ndërton në tabelë hartën e konceptit, duke aktivizuar nxënës të ndryshëm ti përgjigjen pyetjeve të mësipërme.




- Me qëllim që nxënësit të arsyetojnë në mënyrë të pavarur rreth njohurive të tyre, u kërkohet të bëjnë krahasimin midis Rilindjes Evropiane dhe Rilindjes Shqiptare duke vënë në dukje ngjashmëritë dhe dallimet midis tyre. Më poshtë paraqitet krahasimi midis këtyre dy lëvizjeve në diagram Veni.

| Rilindja Evropiane | Të përbashkëtat | Rilindja Shqiptare |
|---|---|---|
| - U zhvillua në gjysmën e shek. XV deri në gjysmën e shek. XVI.<br><br>- Rilindja Evropiane ishte një lëvizje kulturore, shoqërore.<br><br>- Krahas letërsisë, gjuhës në Rilindjen Evropiane njohën zhvillim dhe piktura, skulptura dhe, arkitektura. (kujtojmë autorë italianë)<br><br>- Rilindja Evropiane synonte zhvillimin kulturor, politik dhe shoqëror të qytet shteteve italiane dhe evropiane. | -Ishin të dyja lëvizje që shënuan një kthesë të rëndësishme në zhvillimet e mëvonshme në Evropë dhe në Shqipëri (mund të komentohet më gjerë nga nxënësit).<br><br>- Si Rilindja Evropiane dhe Rilindja Shqiptare u mbështeten te borgjezia dhe intelektualët.<br><br>-Autorët e Rilindjes pasqyronin në veprat e tyre të kaluarën e lavdishme (në Itali periudha e Romës antike, në Shqipëri periudha e Skënderbeut.)<br><br>- Kultura e Rilindjes evropiane i zgjeroi konceptet e qytetërimit përtej kornizave teologjike edhe rilindasit shqiptarë megjithëse ishin fetarë të mirë kishin kuptuar se bashkimi i shqiptarëve mund të arrihej jashtë fesë dhe vetëm mbi fenë. | - U zhvillua në vitet '30 të shek. XIX-1912<br><br>- Rilindja Shqiptare krahas karakterit kulturor kishte dhe karakter politik. Lëvizje me pushkë dhe me penë që synonte zgjimin e ndjenjës kombëtare.<br><br>-Në Rilindjen Shqiptare rëndësi iu kushtua arsimit, gjuhës dhe letërsisë shqipe.<br><br>- Synimi kryesor i Rilindjes shqiptare ishte çlirimi i atdheut nga pushtuesit osmanë. |

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Shpjegon kushtet historike të fillesave të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.
2. Evidenton rolin e elitës intelektuale shqiptare në zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare.
3. Shpjegon tiparet e programit politik të rilindësve shqiptarë.
4. Krahason Rilindjen Evropiane dhe Rilindjen Shqiptare duke vënë në dukje ngjashmëritë dhe dallimet midis tyre.

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime, dhe në të menduarit kritik.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

- Nxënësve u jepet si detyrë të hulumtojnë rreth disa prej figurave më të njohura të Rilindjes Shqiptare dhe të bëjnë një prezantim të tyre në P.Point.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE**

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**: Shqiptarët në periudhën e tanzimatit<br>(vitet '30 - '70 të shek. XIX) | | **Situata e të nxënit:**<br>Për të nxitur kureshtjen e nxënësve mësuesi/ja lexon disa prej vargjeve që populli i këndonte për djemtë nizamë:<br>Dolli një karav nga deti,<br>kërkon ushtarë dovleti:<br>tetëmbëdhjetë vjeç djalë,<br>merr dyfeknë e gjerdanë.<br>Sa qe vanë, asnjë s'u kthie,<br>mbenë nënat kallogrie. | |
| **<u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u>**<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi/ja<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme.<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi/ja<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>**Kompetenca personale.** Nxënësi/ja<br>• zhvillon aftësitë personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve qofshin këto dhe të ndryshme nga të tijat. | | **Fjalët kyçe:**<br>- *Tanzimat*<br>- *Nizam*<br>- *Kryengritje*<br>- *Lidhja Kombëtare Shqiptare* | |
| **<u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</u>**<br>Nxënësi/ja<br>➢ evidenton reformat e Tanzimatit dhe ndikimin e tyre në çështjen shqiptare.<br>➢ shpjegon kërkesat kryesore të kryengritjeve shqiptare dhe arritjet e tyre<br>➢ analizon qëndrimin e osmanëve dhe fqinjëve ballkanikë kundrejt Lëvizjes | | | |

| | |
|---|---|
| Kombëtare Shqiptare. | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, harta e kryengritjeve të viteve ‘40 shek. XIX, interneti etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Me gjeografinë<br>- Me letërsinë etj. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** diskutim / tabela e koncepteve

**Organizimi i orës së mësimit**

- Për të nxitur kureshtjen e nxënësve mësuesi/ja lexon disa prej vargjeve që populli i këndonte për djemtë nizamë:

  Dolli një karav nga deti,
  kërkon ushtarë dovleti:
  tetëmbëdhjetë vjeç djalë,
  merr dyfeknë e gjerdanë.
  Sa qe vanë, asnjë s'u kthie,
  mbenë nënat kallogrie.

- Nxiten nxënësit në diskutim duke i kërkuar të rikujtojnë njohuri mbi perandorinë osmane në fillim të shek. XIX. (Njohuri të fituara në klasën X-të). Mësuesi orienton nxënësit duke kërkuar informacionin që lidhet me temën e mësimit nëpërmjet pyetjeve:
  - Kur perandoria e fuqishme osmane filloi të ndjehej në krizë?
  - Cilat ishin shkaqte e krizës?
  - Si funksiononte ushtria osmane?
  - Cili ishte pushteti i sulltanit?
  - Ç'dini për tanzimatin?
  - Cilat ishin fushat në të cilat u zbatua tannzimati?

**Ndërtimi i njohurive:**

Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë mësimin duke nënvizuar pjesët kryesore, si dhe të ndërtojnë në fletoren e tyre tabelën e koncepteve sipas skemës të ndërtuar në tabelë nga mësuesi/ja dhe ta plotësojnë atë.

- Pasi u lihet kohë nxënësve të punojnë në mënyrë individuale, plotësohet nga nxënës të ndryshëm tabela skicë e ndërtuar nga mësuesi. P.sh.

| KONCEPTI | KOMENTI |
|---|---|
| Kushtet që çuan në lindjen e Çështjes Shqiptare dhe kundërshtimin e Tanzimatit | 1. Zëvendësimi me nëpunës që nuk e njihnin gjuhën dhe psikologjinë e shqiptarit në administratë.<br>2. Ndarja e pushtetit civil nga ai ushtarak.<br>3. Vendosja e shërbimit ushtarak me pagesë për një periudhë 15-vjeçare.<br>4. Vendosja e taksave të reja që përdoreshin për ushtrinë e rregullt. |
| Kryengritjet e viteve ‘30 të shek. XIX | 1. Kryengritjet në zona të ndryshme të paorganizuara në vitin 1833.<br>2. Kryengritja në qytetin e Beratit që u përhap në të gjithë Shqipërinë e Jugut nën drejtimin e Tafil Buzit.<br>3. Kryengritje në Shkodër nën drejtimin e Hamza Kazazit që u përhap në gjithë Shqipërinë e Veriut |
| Shkaku i kryengritjeve të viteve ‘40 të shek. XIX | - Mosnjohja e shqiptarëve si komb më vete, identifikimi i popullsisë sipas përkatësisë fetare.<br>- Mohimi i të drejtës për të hapur shkolla në gjuhën shqipe. |
| Kryengritjet e viteve ‘40 të shek. XIX | - Kryengritja në Rrafshin e Dukagjinit, Prishtinë, Shkup, Pollog, Tetovë-Gostivar, Kumanovë udhehequr nga nga Dervish Cara.<br>- Në Shqipërinë e Jugut (1847) u formua besëlidhja me emrin “Lidhja Kombëtare Shqiptare”, e cila u drejtua nga një Komitet Kombëtar me në krye Zenel Gjolekën.<br>- Në 1856-1875 u organizuan një varg kryengritjesh si në Shkodër, Mirditë etj. |
| Qëndresa ndaj rrezikut të copëtimit të tokave shqiptare. | - Disa krerë dhe bajraktarë, si Bibë Dodadhe, Zenel Gjoleka luftuan së bashku me trupat osmane për të mbrojtur tërësinë territoriale (1852) nga trupat serbe.<br>- Krerët shqiptarë, si Çelo Picari, Halit bej Frashëri etj., organizuan qëndresën kundër çetave të formuara nga qeveria greke (1853-1856).<br>-Oso Kuka mori përsipër mbrojtjen e trojeve shqiptare nga sulmet e bandave malazeze në vitin 1861. |
| Planet për copëtimin e trojeve shqiptare | -Traktati midis qeverive serbe dhe greke për ndarjen e Shqipërisë, duke patur si kufi lumin Shkumbin.<br>-Konventa ushtarake ndërmjet Greqisë dhe Serbisë për ndarjen e Shqipërisë.<br>-Marrëveshja e fshehtë midis Austrisë dhe Rusisë (1877), në të cilën parashikohej copëtimi i tërësisë së tokave shqiptare midis Greqisë, Serbisë, Malit të Zi. |

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Evidenton kushtet që çuan në lindjen e Çështjes Shqiptare dhe kundërshimin e Tanzimatit .
2. Përcakton shtrirjen, udhëheqësit dhe kërkesat kryesore të kryengritjeve shqiptare kundër tanzimatit.

| |
|---|
| 3.Analizon qëndrimin e osmanëve dhe fqinjëve ballkanikë kundrejt Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. |
| ***Vlerësimi:***<br>*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime, në aftësinë për të punuar me hartën në shfaqjen e mendimit kritik.* |
| **Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>• Hulumtoni dhe sillni materiale se si i ka kënduar populli shqiptar udhëheqësve të kryengritjeve si Zenel Gjoleka, Oso Kuka, Tafil Buzi etj. |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Lidhja shqiptare e Prizrenit dhe veprimtaria e saj. | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja shfaq sekuenca nga dokumentari "Lidhja shqiptare e Prizrenit" shih: https://www.youtube.com/watch?v=I9tafUKI2kA, https://www.youtube.com/watch?v=VqdN4V0QQVE | |
| **<u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u>**<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi/ja<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme;<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi/ja<br>• ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike<br>**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.** Nxënësi/ja<br>• zhvillon aftësitë për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin për të identifikuar dhe vlerësuar burimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjes historike. | | **Fjalët kyçe:**<br>- *Lidhja e Prizrenit;*<br>- *Traktati i Shën Stefanit;*<br>- *Kongresi i Berlinit;*<br>- *Komiteti i Stambollit*<br>- *Autonomi;*<br>- *Fuqitë e Mëdha* | |
| **<u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</u>**<br>Nxënësi/ja<br>➢ gjykon mbi vendimet e Traktatit të Shën Stefanit dhe Kongresit të Berlinit; | | | |

| | |
|---|---|
| ➢ shpjegon organizmin dhe platformën e Lidhjes Shqiptare te Prizrenit;<br>➢ evidenton përpjekjet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për mbrojtjen e tërësisë tokësore shqiptare;<br>➢ gjykon mbi rolin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në ndërkombëtarizimin e çështjes kombëtare shqiptare dhe rritjen e vetëdijes kombëtare tek shqiptarët. | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, harta, biblioteka e shkollës, interneti. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Me gjeografinë.<br>- Me qytetarinë. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** pyetje- përgjigje / puno në dyshe.

**Organizimi i orës së mësimit**

- Mësuesi/ja shfaq sekuenca nga dokumentari "Lidhja shqiptare e Prizrenit" shih: https://www.youtube.com/watch?v=I9tafUKI2kA, https://www.youtube.com/watch?v=VqdN4V0QQVE.
- Nëpërmjet pyetjeve rikujtohen njohuri që nxënësit kanë mësuar në temat e mëparshme ose në klasën e dhjetë, si dhe bëhet lidhja e tyre me njohuritë e reja. Pyetjet që mund të drejtohen:
  - Pse perandoria osmane quhej "I sëmuri i Bosforit"?
  - Kur u zhvillua Kongresi i Berlinit?
  - Cilat ishin shtetet Ballkanike që Kongresi i Berlinit njohu pavarësinë?
  - Cila ishte gjendja e popullsisë shqiptare në fillim të shekullit të XIX?
  - Tregoni se si iu përgjigjën shqiptarët rrezikut të copëtimit të Shqipërisë?
  - Kur u zhvillua Kuvendi i Prizrenit dhe pse u thirr ai?

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja ndan klasën në grupe me nga dy nxënës dhe secilit prej grupeve i cakton nga një pjesë të mësimit (me qëllim që nxënësit ta lexojnë mësimin nuk thuhet paraprakisht se cili prej grupeve do të prezantojnë temën e mësimit). Brenda grupit njëri prej nxënësve do të luajë rolin e mësuesit dhe tjetri do të përgatitet për të drejtuar pyetje. Nxënësit lexojnë mësimin dhe përgatiten për të realizuar detyrat e ngarkuara.
- Mësuesi/ja ndjek veprimtarinë në klasë duke pasur kujdes që të prezantohen dhe sqarohen të gjitha njohuritë e reja.
- Pasi nxënësi-mësues dhe shoku i tij prezantojnë pjesët përkatëse të mësimit, mësuesi/ja kontrollon nëpërmjet pyetjeve pjesën tjetër të klasës si dhe ndërton një përmbledhje të mësimit në tabelë duke i vendosur në linjë kronologjike ngjarjet kryesore. Përmbledhja sugjerohet si më poshtë:

➢ <u>Ngjarje ndërkombëtare dhe ndikimi i tyre në çështjen shqiptare</u>.

- Vitet 1877-1778 → u zhvillua lufta ruso-turke → e cila tregoi se rreziku i copëtimit të trojeve shqiptare ishte real .
- 3 mars 1878 → u nënshkrua traktati i Shën Stefanit → tokat shqiptare u ndanë ndërmjet
  - Bullgarisë (Korça, të Pogradeci, Bilishti etj.)
  - Malit të Zi
  - Serbisë
  - Pjesa e mbetur Perandorisë Osmane.
- 10 qershor 1878 → u thirr një kuvend në Prizren
  - Vendimet kryesore
    - → krijimi i një Lidhjeje mbarëshqiptare
    - → krijimi i organeve
      - → këshilli i përgjithshëm (F.legjislativ)
      - → komitetit qendror (F.ekzekutiv)
  - U miratuan dy akte
    - → Akti i Vendimeve (Kararname)
    - → Urdhëresa (Talimat)
  - Programi i lidhjes synonte → krijimin e një vilajeti autonom shqiptar
  - Lidhja i bëri të qartë → mbrojtjen e tokave shqiptare pëllëmbë për pëllëmbë
- 13 qershor – 13 korrik 1878 → u thirr kongresi i Berlinit → i cili rishikoi vendimet e Traktatit të Shën Stefanit
  - riktheu Bullgarinë në kufijtë e saj.
  - Mali i Zi mori Tivarin, Podgoricën, Plavën, Gucinë, Rugovën e Kolashinin
  - Serbia do te merrte Pirotin, të Trenin, të Vranjën e të Nishin.
  - në jug do te arrihej nje marrëveshje greko-turke(vija kufitare Kalamas-Selemvria)

➢ <u>Veprimtaria e Lidhjes së Prizrenit</u>

- u ngritën 40 degë të Lidhjes në krejt tokat shqiptare
- trupat ushtarake të Lidhjes morën në kontroll tokat shqiptare pas largimit te trupave osmane .
- u mbrojt Plava dhe Gucia (janar 1879), Hoti, Ulqini.
- u luftua kundër flotës ndërkombëtare prej 17 anijesh, trupave malazeze, dhe atyre osmane më 23 nëntor 1880 për mbrojtjen e Ulqinit.
- u thirr një kuvend i jashtëzakonshëm në Prevezë (Janar 1879) i cili vendosi të mos prekeshin tokat shqiptare.
- u dërguan peticione dhe memorandume Fuqive të Mëdha.
- u dërgua një mision diplomatik, i përbërë nga A. Frashëri dhe M. Ali Vrioni, të cilët paraqitën kërkesat e tyre pranë Fuqive të Mëdha.

→ Në janar të vitit 1881 Lidhja shpalli Komitetin Kombëtar si Qeveri të Përkohshme me kryetar Y. Prizrenin dhe u organizua → ushtria, administrata, shtrirja e pushtetit
→ Më mars 1881 u luftua ekspeditës osmane të kryesuar nga Dervish Pasha.
→ Më 23 prill 1881, Lidhja Shqiptare e Prizrenit u shtyp

Mësuesi/ja për të treguar me qartë qëndrimin e fuqive të mëdha kundrejt tokave shqiptare, mund të lexojë në klasë materialin e mëposhtëm:

**Material shtesë:**
Me ftesën e Fuqive të Mëdha, shtetet ballkanike (Serbia, Greqia, Bullgaria, Rumania, Mali i Zi) dërguan në Berlin delegacionet e tyre qeveritare, të cilat parashtruan dhe mbrojtën në seanca të veçanta të Kongresit kërkesat e tyre politike e territoriale. Edhe shqiptarët, sidomos organizmat e Lidhjes së Prizrenit, i parashtruan Kongresit të Berlinit kërkesat e tyre. Megjithatë, Fuqitë e Mëdha, të mbledhura në Kongresin e Berlinit, nuk i morën parasysh këto kërkesa të shqiptarëve. Edhe pse në Berlin luhej fati i popullit shqiptar, Fuqitë e Mëdha e injoruan qenien e tij. Madje, delegacioni shqiptar, i ngarkuar nga Lidhja e Prizrenit, i cili shkoi në Berlin me nismën e vet për t'i parashtruar Kongresit të drejtat e Shqipërisë, nuk u përkrah nga askush. A. Frashëri, kryetari i delegacionit, u përpoq ta bindte kryetarin e Kongresit, kancelarin Bismark, në një takim që pati me të, që ta përfshinte në rendin e ditës së një seance edhe çështjen e kombit shqiptar. Por kancelari gjerman nuk pranoi, duke u shprehur brutalisht se "nuk ka një komb shqiptar".

**Pyetje për diskutim**
Situata quhet e realizuar nëse nxënësi /ja:
1. Gjykon mbi vendimet e Traktatit të Shën Stefanit dhe Kongresit të Berlinit.
2. Shpjegon organizmin dhe platformën e Lidhjes Shqiptare te Prizrenit.
3. Evidenton përpjekjet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për mbrojtjen e tërësisë tokësore shqiptare.
4. Gjykon mbi rolin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në ndërkombëtarizimin e çështjes kombëtare shqiptare.

***Vlerësimi:***
*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në pjesëmarrjen në orën e mësimit, në bashkëpunimin në grup, në argumentet e paraqitur rreth fakteve që u diskutuan, në formulimin e pyetjeve etj.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**
- Hartoni një ese të shkurtër rreth mbrojtjes së trojeve shqiptare nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkolla: | Klasa: 11 |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Përpjekjet e shqiptarëve për gjuhë dhe për shkollë shqipe gjatë shekullit XIX. | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja nxit kureshtjen e nxënësve duke shfaqur sekuenca nga filmi shqiptar "Kush vdes në këmbë" (Minuta 17-20)<br>Shih: https://www.youtube.com/watch?v=TfAyYmx2_dg | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**<br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi/ja<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë;<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi/ja<br>• parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime;<br>**Kompetenca personale.** Nxënësi/ja<br>• kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve;. | | **Fjalët kyçe:**<br>- *shkollë laike,*<br>- *Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip,*<br>- *diaspora shqiptare,*<br>- *alfabet unik i gjuhës shqipe,*<br>- *mësonjëtore.* | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**.<br>Nxënësi/ja:<br>➢ Evidenton tiparet që parashikonin rilindësit për shkollën dhe arsimin shqip.<br>➢ Krahason arsimin e kulturën gjatë dy periudhave, para dhe pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.<br>➢ Dallon rrugët e ndjekura nga patriotët rilindës për të nxitur arsimin në gjuhën | | | |

| | |
|---|---|
| shqipe.<br>➢ Evidenton disa prej figurave kryesore të kulturës e arsimit shqip gjatë Rilindjes Kombëtare | |
| **Burimet:**<br>• Teksti Historia 11, interneti, materiale të shkruara, materiale audiovizuale, biblioteka e shkollës. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Me qytetarinë<br>- Me TIK-un.<br>- Me gjuhën dhe letërsinë |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** shpjegim/ punë në grupe/diskutim

**Organizimi i orës së mësimit**

Mësuesi/ja nxit kureshtjen e nxënësve duke shfaqur sekuenca nga filmi shqiptar "Kush vdes në këmbë" (Minuta 17-20) .
Shih: https://www.youtube.com/watch?v=TfAyYmx2_dg.

**Ndërtimi i njohurive:**

• Mësuesi/ja shpjegon duke bërë një përmbledhje të shkurtër të mësimit, në të cilën prezanton figurat kryesore të Rilindjes si dhe veprimtarinë e tyre para dhe pas lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

• Udhëzohen nxënësit të lexojnë mësimin.
Ndahet klasa në dy grupe të mëdha dhe për të kontrolluar nëse është kuptuar mësimi, nxënësit e njërit grup i drejtojnë pyetje grupit tjetër dhe anasjelltas.
Në tabelë ngrihet një nxënës, i cili pas përgjigjeve të dhëna nga shokët plotëson skemën e ndërtuar më parë nga mësuesi.

-Skema mund të ndërtohet si më poshtë:



| | |
|---|---|
| Naum Veqilharxhi | - Kërkonte një shkollë të re, shqipe nga gjuha, laike nga përmbajtja dhe masive nga shtrirja<br>- botoi abetaren e parë të gjuhës shqipe me titull “Evëtor” më 1844 |
| Konstandin Kristoforidhi | - me nismën e tij u krijua një shoqëri kulturore, qëllimi i së cilës qe hapja e shkollave kombëtare.<br>- Më 1867, K. Kristoforidhi botoi “Abetaren e gjuhës shqipe” toskërisht dhe gegërisht. |
| Pashko Vasa | - botime të ndryshme letrare me karakter politik<br>- dha ndihmesën e tij për krijimin e një organizate patriotike. |
| Koto Hoxhi | - mësonte nxënësve gjuhën shqipe fshehurazi dhe u ngjallte atyre dashurinë për atdheun |
| Rilindas te tjerë si: Th. Mitko, Spiro Risto Dine etj.<br>Intelektualët arbëreshë si De Rada, Dhimitër Kamarda, Zef Serembe | - trajtuan tema patriotike në veprat e tyre letrare me synim zgjimin e ndërgjegjes kombëtare. |
| Lëvizja arsimore-kulturore gjatë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe pas saj | - u bënë përpjekje për miratimin e një alfabeti unik të gjuhës shqipe.<br>- u pranua “alfabeti i Stambollit” i S. Frashërit.<br>- Në tetor 1879, u krijua në Stamboll “Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip”<br>- lëvizjes kulturore rilindësit i dhanë përmbajtje laike.<br>- në letërsi mbizotëronte motivi politik.<br>- u botuan gazeta në shqip si “Interpret i Lindjes”, në Stamboll dhe një në Athinë.<br>- u hapën shkolla shqipe të pavarura në fshehtësi.<br>- u botuan disa tekste të hartuara nga Sami Frashëri dhe Naim Frashëri<br>- 7 mars 1887 u hap një shkolle fillore (mësonjëtore) në Korçë nën drejtimin e P. Sotirit.<br>- u hap shkolla për vajza nën kujdesin e Gjerasim Qiriazit dhe së motrës, Sevastisë.<br>- Më 1889, nën drejtimin e mësuesit Mati Logoreci u hap shkolla shqipe në Prizren |

- Mësuesi/ja nxit arsyetimin dhe të menduarit kritik te nxënësit duke drejtuar pyetje si:
  - Krahasoni arsimin e kulturën gjatë dy periudhave, para dhe pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.
  - Fakti është që gjuha shqipe flitej anekënd trojeve të banuara nga shqiptarë. Megjithatë, teza e turqve dhe fqinjëve grekë e sllavë ishte se "shqipja nuk ekziston si gjuhë". Përse propagandonin këtë tezë në lidhje me gjuhën shqipe? Si përpiqeshin ata të argumentonin këtë tezë?

**Pyetje për diskutim**
Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:
1. Evidenton tiparet që parashikonin rilindësit për shkollën dhe arsimin shqip.
2. Krahason arsimin e kulturën gjatë dy periudhave, para dhe pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.
3. Dallon rrugët e ndjekura nga patriotët rilindës për të nxitur arsimin në gjuhën shqipe.
4. Evidenton disa prej figurave kryesore të kulturës e arsimit shqip gjatë Rilindjes Kombëtare

***Vlerësimi:***
*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në bashkëpunimin në grup dhe formulimin e saktë të pyetjeve dhe përgjigjet e dhëna si dhe në të menduarit kritik.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**
- Mblidhni të dhëna rreth shkollave të para shqipe në krahinën tuaj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore.** Veprimtari praktike: Roli i gruas në Rilindjen Kombëtare Shqiptare. | | **Situata e të nxënit:** Vendosen në monitor disa sekuenca nga filmi shqiptar "Mësonjëtorja" . Shih: https://www.youtube.com/watch?v=JOZai_OJwqo | |

| | |
|---|---|
| **<u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u>**<br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi/ja<br>• përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.<br>**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.** Nxënësi/ja<br>- diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e të tashmes dhe perspektivat e të ardhmes.<br>**Kompetenca personale.** Nxënësi/ja<br>- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij**.**<br>**Kompetenca digjitale.** Nxënësi/ja<br>- zhvillon aftësitë digjitale për të kërkuar, për të përzgjedhur, për të analizuar dhe për të komunikuar informacion historik.<br><br>**<u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>**.<br>Nxënësi/ja<br>➢ vë në dukje kushtet ekonomiko – shoqërore të Shqipërisë në përgjithësi dhe gruas në veçanti, në periudhën e Rilindjes Kombëtare;<br>1. evidenton disa nga ngjarjet kryesore të periudhës ku gruaja shqiptare ka kontributin e saj;<br>2. dallon disa prej figurave të rëndësishme të grave në Rilindjen Kombëtare dhe vë në dukje rolin e tyre individual në të;<br>➢ analizon ndikimin e kontributit të grave gjatë Rilindjes Kombëtare në përparimin e pozitës së tyre shoqërore. | **Fjalët kyçe:**<br>- *Rilindja Kombëtare Shqiptare,*<br>- *gratë shqiptare,*<br>- *veprimtari arsimore,*<br>- *kryengritje e armatosur.* |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Me gjuhën dhe letërsinë<br>- Me sociologjinë<br>- Me qytetarinë<br>- Me TIK |

| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve |
|---|
| **Metodologjia:** Punë hulumtuese në grupe / diskutim në klasë<br>**Organizimi i orës së mësimit**<br>- Vendosen në monitor disa sekuenca nga filmi shqiptar "Mësonjëtorja". Shih: https://www.youtube.com/watch?v=JOZai_OJwqo.<br>- Udhëzohen nxënësit të lexojnë materialin orientues ne tekst.<br>- Ndahet klasa në grupe dhe secili prej tyre do të ketë për objekt pune një prej figurave të rëndësishme të grave që kanë dhënë kontribut në Rilindjen Kombëtare Shqiptare. Paraqitja të jetë në formën e një prezantimi sipas zgjedhjes së secilit grup. Të synohet që të ketë një ndarje mes pjesëmarrëseve në luftërat e armatosura për liri, me ato të angazhuarat në fushën e kulturës dhe arsimit.<br>- Nxënësit kërkojnë në internet ose shfrytëzojnë botime të ndryshme nga biblioteka e shkollës, gazeta, enciklopedi ose artikujt përkatës në wikipedia shqip sipas emrave të figurave kryesore.<br><br>**Ndërtimi i njohurive:**<br>• Grupet paraqesin punimet e tyre lidhur me figurat e përzgjedhura. Në varësi të kohës që kanë, mund të nxiten grupet e tjera që të bëjnë pyetje lidhur me prezantimet respektive.<br><br>**Pyetje për diskutim**<br>Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:<br>1. Vë në dukje kushtet ekonomiko – shoqërore të Shqipërisë në përgjithësi dhe gruas në veçanti, në periudhën e Rilindjes Kombëtare.<br>2. Evidenton disa nga ngjarjet kryesore të periudhës ku gruaja shqiptare ka kontributin e saj.<br>3. Dallon disa prej figurave të rëndësishme të grave në Rilindjen Kombëtare dhe vë në dukje rolin e tyre individual në të.<br>4. Analizon ndikimin e kontributit të grave gjatë Rilindjes Kombëtare në përparimin e pozitës së tyre shoqërore. |
| ***Vlerësimi:***<br>*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime.* |
| **Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>Ndërtoni dhe prezantoni në klasë një fotomontazh ose ekspozitë me foto të grave që kanë kontribuar në lëvizjen kombëtare shqiptare. |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkolla: | Klasa: 11 |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Xhonturqit dhe shqiptarët. | | **Situata e të nxënit:**<br>Shfaqen në monitor pjesë nga dokumentari mbi Kongresin e Manastirit. Shih: https://www.youtube.com/watch?v=90fcyQHZ45U | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**<br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi/ja<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi/ja<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës.<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi/ja<br>- zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit; trashëgiminë materiale dhe shpirtërore. | | **Fjalët kyçe:**<br>*-lëvizja xhon turke*<br>*-kongresi i Manastirit*<br>*-kongresi i Elbasanit*<br>*-Alfabeti shqip*<br>*-kryengritje*<br>*-memorandumi i Greçës* | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.**<br>Nxënësi/ja<br>➢ shpjegon ndikimin e Revolucionit të Turqve të Rinj në lëvizjen kulturore, arsimore dhe politike shqiptare.<br>➢ argumenton vlerat e Kongresit të Manastirit dhe faktorët që përcaktuan fitoren e alfabetit latin;<br>➢ gjykon mbi rëndësinë e Kongresit të Elbasanit (1909);<br>➢ shpjegon kushtet që çuan në kryengritjet antiosmane të viteve 1910-1912; analizon karakterin kombëtar dhe autonomist të Memorandumit të Greçës (1911); | | | |

| **Burimet:** | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| - Libri i nxënësit, interneti, studime historike, gjuhësore. | - Me gjuhën dhe letërsinë<br>- Me gjeografinë etj.<br>- Me qytetarinë |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim /Di -Dua të di - Mësoj

**Organizimi i orës së mësimit**.

- Shfaqen në monitor pjesë nga dokumentari mbi Kongresin e Manastirit. Shih: https://www.youtube.com/watch?v=90fcyQHZ45U
- Mësuesi/ja bën një prezantim te shkurtër të çështjeve kryesore që do të trajtohen në mësim p.sh.
  Në mësimin e sotëm do të flasim për ecurinë e lëvizjes kulturore shqiptare dhe dy kongreset të rëndësishme arsimore, atë të Manastirit dhe të Elbasanit. Gjithashtu do të flasim për Lëvizjen Xhonturke, se si u pritën reformat xhonturke nga popullsia shqiptare si dhe për kryengritjet e viteve 1910-1911.
- Mësuesi/ja ndërton tabelën dhe nxit diskutimin në klasë duke pyetur nxënësit:
- Ç'dini ju mbi çështjet që do të trajtohen në mësimin e sotëm?
- Çfarë doni të mësoni rreth këtyre ngjarjeve?
- Njohuritë që nxënësit kanë shënohen në kolonën" di", dhe pyetjet e tyre në kolonën "dua të di" në tabelë.

**Ndërtimi i njohurive:**

Mësuesja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin, si dhe rubrikën "fakte historike" dhe të plotësojnë në fletoret e tyre tabelën. Më poshtë jepet shembulli si mund të plotësohet tabela:

| Di | Dua të di | Mësoj |
|---|---|---|
| -Alfabeti i sotëm i gjuhës shqipe u miratua në kongresin e Manastirit. | -Kur u zhvillua kongresi i Manastirit dhe cilat ishin vendimet e tij? | -Kongresi i Manastirit (14-21 nëntor 1908) rekomandoi përdorimin e dy alfabeteve: atë të Stambollit dhe një tjetër me shkronja latine. |
| -Alfabeti i Stambollit u krijua nga S. | -Kur u zhvillua kongresi i Elbasanit | - Kongresi i Elbasanit (2-8 shtator 1909) vendosi hapjen e një shkolle të |

| | | |
|---|---|---|
| Frashëri.<br>-Në Elbasan u hap shkolla pedagogjike.<br><br>-Shumë shqiptarë e përkrahën lëvizjen xhonturke.<br><br>-Xhonturqit kërkonin miratimin e kushtetutës dhe ishin kundër absolutizmit të sulltanit.<br><br>-Xhonturqit pasi erdhën në pushtet nuk i mbajtën premtimet e tyre.<br><br>-Shqiptarët u përgjigjën me kryengritje përpjekjeve të xhonturqve për të rivendosur kontrollin në tokat shqiptare.<br><br>-Kërkesa e kryengritjeve ishte ajo për autonomi. | dhe cilat ishin vendimet e tij?<br><br>-Pse u mbështet lëvizja xhonturke nga shqiptarët.<br><br>-Pse populli shqiptar ishte i pakënaqur nga reformat xhonturke?<br><br>-Si u shpreh kjo pakënaqësi?<br><br>-Nga kush u udhëhoqën kryengritjet në vitet 1910-1911, cila ishte shtrirja e tyre.<br><br>-Cilat ishin kërkesat dhe shtrirja e këtyre kryengritjeve. | mesme pedagogjike, dhe për krijimin e një shoqërie që të kujdesej për shkollat dhe botimin e teksteve shqip.<br>- Te parulla xhonturke “Liri, barazi dhe vëllazërim” shqiptarët shikonin realizimin e aspiratave të tyre në fushën arsimore e kulturore.<br><br>- Turqit e rinj nuk u qëndruan gjatë premtimeve.<br>- Ata propagandonin se gjuha shqipe mund të shkruhej vetëm me shkronja arabe.<br>- u rritën taksat.<br>- u nxorën jashtë ligjit çetat e armatosura të shqiptarëve.<br>- mbyllën klubet kulturore dhe shkolla si në Pejë, në Gjilan.<br>- u ndalua mësimi i gjuhës shqipe në shkollat turke<br><br>- Pakënaqësia u shpreh me:<br>• Organizimin e mitingjeve në Elbasan, në Korçë e në Berat.<br>• Kryengritjen në Kosovë (1910) betejat kryesore ishin ajo e Kaçanikut me udhëheqës Idriz Seferin dhe e Carralevës me Isa Boletinin.<br>• Kryengritjen që filloi 24 mars 1911 dhe u shtri në krejt Malësinë e Madhe.<br>• Organizimin e Kuvendit të Përgjithshëm të krerëve shqiptarë (23 qershor 1911) në Greçë. Kërkesat u përpiluan në formën e një memorandumi që u quajt “Libri i Kuq” (nxënësit mund të rendisin disa prej kërkesave).<br>• Luftën që nisi në malësinë e Gjakovës nën drejtimin e Bajram Currit e cila u shtri edhe në Shqipërinë e Mesme dhe atë të Jugutsi dhe Dibër.<br>• Hasan Prishtina i drejtoi qeverisë turke kërkesa të moderuara për të siguruar të drejta të gjera kombëtare. |

- Në varësi të kohës në dispozicion mësuesi/ja mund t’u prezantojë nxënësve një material shtesë mbi pjesëmarrjen e shqiptarëve në lëvizjen Xhonturke.

**Material shtesë:**

Një nga themeluesit e komitetit të parë xhonturk “Bashkim e Përparim” (1899) ishte shqiptari nga Struga, Ibrahim Temo, student i shkollës së lartë

ushtarake-mjekësore të Stambollit. Edhe pas arratisjes së tij nga Turqia në Rumani (nëntor 1895), doktor Ibrahim Temo mbeti një nga veprimtarët më të dalluar të lëvizjes xhonturke dhe njëherazi një nga pjesëmarrësit më aktivë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Në lëvizjen e turqve të rinj morën pjesë gjithashtu Ismail Qemali, Dervish Hima, Hamdi Ohri, Hoxha Kadriu (Prishtina), Jashar Erebara dhe mjaft atdhetarë të tjerë brenda e jashtë atdheut. Qysh në vitet 1896-1897, kur shoqëria "Bashkim e Përparim" nuk kishte ngritur ende organizatat e saj në Rumeli, falë ndihmesës së degës së Kostancës, të kryesuar nga dr. Ibrahim Temoja dhe veprimtarëve të tjerë shqiptarë, ajo arriti të shtrinte ndikimin e vet në Shkodër, Durrës, Manastir, Ohër, Strugë, Dibër, Elbasan, Tiranë, Korçë, Starovë, Berat, Janinë dhe në qendra të tjera. Në disa nga këto qytete ishin ngritur edhe bërthama të shoqërisë "Bashkim e Përparim", ndërsa në Shkodër vepronte në vitet e fundit të shek. XIX një degë e organizuar e kësaj shoqërie.

**Pyetje për diskutim**
Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Rendit vendimet e kongreseve të lidhura me arsimin dhe gjuhën shqipe.
2. Shpjegon zhvillimin e kërkesave politike gjatë kryengritjeve të viteve 1910-1912.
3. Tregon në hartë shtrirjen e kryengritjeve gjatë viteve 1910-1912.
4. Analizon përmbajtjen e Librit të Kuq.

**Vlerësimi:**
*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit.*

**Detyrat dhe puna e pavarur**:

- Mblidhni material nga krahina juaj mbi ngjarjet e viteve 1908-1912.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Histori</th><th>Shkolla:</th><th>Klasa: 11</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Kuvendi i Vlorës dhe shpallja e pavarësisë së Shqipërisë.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Shfaqen në monitor sekuenca nga filmi artistik shqiptar "Nëntori i dytë" ose vendosen në tabelë foto nga shpallja e Pavarësisë.<br>Shih: https://www.youtube.com/watch?v=8SQNToKDFbQ<br>https://www.google.al/search?q=shpallja+e+pavaresise.</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**<br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi/ja<br>• përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi/ja:<br>• parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime.<br>**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.** Nxënësi/ja:<br>• zhvillon aftësitë për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin për të identifikuar dhe vlerësuar burimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjes historike.<br>**Kompetenca personale**: Nxënësi/ja:<br>• përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij. | **Fjalët kyçe:**<br>**-** *Lufta Ballkanike,*<br>- *vilajetet shqiptare,*<br>- *Kuvendi Kombëtar i Vlorës,*<br>- *autonomi,*<br>- *pavarësi,*<br>- *flamuri kombëtar.* |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**.<br>Nxënësi/ja:<br>➢ përcakton karakterin e Luftës së Parë Ballkanike dhe qëndrimin e shqiptarëve ndaj saj;<br>➢ shpjegon kalimin nga platforma autonomiste në atë të Pavarësisë;<br>➢ analizon vendimet e Kuvendit Kombëtar të Vlorës;<br>➢ vlerëson rëndësinë e Shpalljes së Pavarësi | |
| **Burimet:**<br>- Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi, harta, libri i mësuesit etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Me gjuhën dhe letërsinë<br>- Me gjeografinë<br>- Me qytetarinë etj. |
| | |

| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve |
|---|
| **Metodologjia:** Diskutim / INSERT/diskutim |

**Organizimi i orës së mësimit**

- Shfaqen në monitor sekuenca nga filmi artistik shqiptar "Nëntori i dytë" ose vendosen në tabelë foto nga shpallja e Pavarësisë.
Shih: https://www.youtube.com/watch?v=8SQNToKDFbQ, https://www.google.al/search?q=shpallja+e+pavaresise.
- Mësuesi/ja vendos në tabelë ose shfaq në monitor një hartë të Ballkanit gjatë Luftës së parë Ballkanike dhe shpjegon në të situatën e trojeve shqiptare gjatë kësaj lufte.







**Ndërtimi i njohurive:**

Pasi mësuesi/ja bën një prezantim të shkurtër të gjendjes në tokat shqiptare në Luftën e Parë Ballkanike udhëzon nxënësit të lexohet mësimi sipas teknikës INSERT duke i kërkuar të vendosin përbri secilës pjesë të lexuar shenjat të cilat kanë kuptimin e mëposhtëm.

"√" —— vendoset përbri informacionit që për ju është i njohur.
"-" —— vendoset përbri informacionit që ju e dinit ndryshe.
"+" —— vendoset përbri informacionit i cili është i ri për ju.
"?" —— vendoset përbri informacionit i cili është i paqartë ose doni të dini më shumë.

- Pas leximit organizohet në klasë bashkëbisedim ku nxënësit krahasojnë shenjat e vendosura dhe diskutojnë rreth fakteve të reja. (Këto veprimtari mund të zhvillohen në 25 minutat e para të mësimit dhe pjesën tjetër plotësohet tabela nga përgjigjet e nxënësve).

| √ | — | + | ? |
|---|---|---|---|
| -Nxënësit mund të shënojnë si informacion të njohur ditën e shpalljes së pavarësisë, figurat e njohura që drejtuan Kuvendin e Vlorës.<br><br>-Shqipëria ishte vendi i fundit që u shkëput nga sundimi osman. | -Nxënësit mund të dinë ndryshe territoret në të cilat përparuan forcat serbe, greke dhe malazeze.<br><br>-Nxënësit mund të dinë ndryshe dhe informacione të tjera të cilat shënohen nga mësuesja në kolonën përkatëse të tabelës. | - Lufta e Parë Ballkanike nisi në tetor të vitit 1912, qeveritë ballkanike filluan të zbatojnë planin e copëtimit të Shqipërisë.<br>- Serbët pushtuan Shkupin, kaluan në jug të Shkodrës dhe vazhduan drejt Tiranës, Elbasanit dhe Durrësit. Pushtimi u shoqërua me reprezalje.<br>- Ushtria malazeze rrethoi qytetin e Shkodrës.<br>- Ushtria greke mori Selanikun, Janinën, Sazanin, Himarën së bashku me fshatrat përreth.<br><br>- Në 14 tetor 1912, në Shkup u organizua një mbledhje, përmes së cilës u bëhej e ditur Fuqive të Mëdha se shqiptarët do të luftonin për të mbrojtur trojet e tyre.<br><br>- Ismail Qemali dhe Luigj Gurakuqi udhëtuan në kryeqytetet evropiane për të siguruar mbështetjen e Fuqive të Mëdha.<br><br>- Më 21 nëntor, grupi i atdhetarëve i kryesuar nga Ismail Qemali mbërriti në Durrës ku e priste një urdhër arresti i komandës turke.<br>- Disa qytete si: Elbasani, Tirana e Durrësi, Kavaja, Peqini dhe Lushnja ngritën flamurin, për të bërë fakt të kryer pavarësinë. | -Paqartësitë e nxënësve shpjegohen nga mësuesi/ja dhe shënohen në kolonë.<br>-Nxënësit mund të kërkojnë informacion shtesë rreth figurave të njohura si H. Prishtina, I. Boletini etj.<br>**Informacion shtesë**<br>*Hasan Prishtina* lindi më 1873 Vushtrri -13 gusht 1933, Selanik. Në vitet 1908-1912 u zgjodh tri herë deputet në Parlamentin osman si përfaqësues i vilajetit të Kosovës, të cilin e përdori si tribunë për mbrojtjen e të drejtave kombëtare të shqiptarëve. Ai u bë njëri ndër protagonistët kryesorë që do të godiste fuqishëm themelet e Perandorisë Osmane në tokat shqiptare.<br>Në kohën kur një deputet turk |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | - Më 28 Nëntor qeveria dalë nga kuvendi i Vlorës njoftoi kancelaritë e Fuqive të Mëdha se Shqipëria kishte shpallur pavarësinë.<br><br>- Në Shqipëri kishte grupe që nuk dëshironin shkëputjen e Shqipërisë nga perandoria osmane. | kishte folur keq për historinë e shqiptarëve, Hasan Prishtina kishte reaguar duke i thënë atij se "*Nuk e njeh ti historinë e tij.... dhe nuk zbres nga kjo tribunë pa e nxjerr gjithë mllefin e qenies kombëtare. Populli im, në asnjë shekull nuk ka vuajtur, siç po vuan sot. Mbi trungun e tij të hepuar derdhen stuhitë aziatike. Edhe rrahin ta shkulin me rrënjë. I mohohet ta ketë dhe ta ruajë botën e vet, e cila e ka zanafillën prej atëherë, kur ju nuk ishit fare......*". |

- Mësuesi/ja nxit nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike duke drejtuar pyetjen:

- Si mendoni ju pse Shqipëria ishte shteti që u shkëput i fundit nga perandoria osmane?

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Përcakton karakterin e Luftës së Parë Ballkanike dhe qëndrimin e shqiptarëve ndaj saj;
2. Tregon në hartë përparimin e ushtrive serbe, malazeze dhe greke në Shqipëri.
3. Shpjegon kalimin nga platforma autonomiste në atë të Pavarësisë;
4. Analizon vendimet e Kuvendit Kombëtar të Vlorës;
5. Vlerëson rëndësinë e Shpalljes së Pavarësisë.

**Vlerësimi:**

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit në të kuptuarit e fakteve dhe ngjarjeve.*

**Detyrat dhe puna e pavarur**:

- Grumbulloni informacione, fakte, foto dhe ndërtoni një poster me titullin "Shqipëria e pavarur"

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkolla: | Klasa: 11 |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore.** Veprimtari praktike: Roli i diasporës në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare. | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja bën një prezantim duke i njohur nxënësit shkurt me kushtet dhe veprimtarinë e diasporës shqiptare në botë. (Informacioni në tekst "Situata e të nxënit") | |
| **<u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u>**<br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi/ja:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi/ja:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës.<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi/ja<br>- zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>**Kompetenca qytetare.** Nxënësi/ja:<br>- shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore.<br>**Kompetenca digjitale.** Nxënësi/ja:<br>-komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet. | | **Fjalët kyçe:**<br>- *Diasporë,*<br>- *koloni shqiptare,*<br>- *mërgim,*<br>- *shoqëri kulturore,*<br>- *arbëreshë.* | |
| **<u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>.**<br>Nxënës/ja:<br>➢ evidenton situatën në të cilën ndodhej Shqipëria në periudhën e Rilindjes Kombëtare;<br>➢ identifikon komunitetet kryesore të diasporës shqiptare në vende të ndryshme me kontribut thelbësor në procesin e Rilindjes; | | | |

| | |
|---|---|
| ➢ dallon disa prej figurave të rëndësishme të diasporës me kontribut në Rilindjen Kombëtare, duke vënë në dukje rolin e tyre në të;<br>➢ argumenton rëndësinë e kontributit të diasporës shqiptare në zhvillimin e Rilindjes Kombëtare dhe arritjet e saj. | |
| **Burimet:**<br>- Interneti, libri i nxënësit, biblioteka e shkollës. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Me gjeografinë<br>- Me gjuhën dhe letërsinë. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Punë në grupe/prezantim.

**Organizimi i orës së mësimit**

- Mësuesi/ja bën një prezantim duke i njohur nxënësit shkurt me kushtet dhe veprimtarinë e diasporës shqiptare në botë. (Informacioni në tekst "Situata e të nxënit")
- Ndahet klasa në katër grupe dhe udhëzohet secili që të mbledhë materiale dhe të prezantojë kontributin e një prej kolonive shqiptare në diasporë dhe të evidentojë të paktën një prej figurave më përfaqësuese të kësaj kolonie me peshë në Rilindjen Kombëtare Shqiptare.
  - Grupi i parë - diaspora shqiptare në Rumani.
  - Grupi i dytë - diaspora shqiptare në Bullgari.
  - Grupi i tretë - diaspora shqiptare në Egjipt
  - Grupi i katërt - arbëreshët e Italisë.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Nxënësit zhvillojnë në grupe, hulumtime për të dhënat që vijnë nga burime të ndryshme lidhur me aspekte të jetës dhe veprimtarisë së diasporës shqiptare.
- grupet paraqesin punimet e tyre lidhur me veprimtarinë e kolonive dhe figurat e përzgjedhura. Në varësi të kohës së disponueshme, mund të nxiten grupet e tjera të bëjnë pyetje lidhur me prezantimet respektive.
- Në përfundim, në klasë zhvillohet një diskutim i shkurtër lidhur me Rilindjen Kombëtare dhe rëndësinë e saj në promovimin e kulturës dhe arsimit dhe, në përgjithësi, të interesave kombëtare shqiptare drejt krijimit të një shteti të pavarur.

**Pyetje për diskutim**
Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:
1. evidenton situatën në të cilën ndodhej Shqipëria në periudhën e Rilindjes Kombëtare;
2. identifikon komunitetet kryesore të diasporës shqiptare në vende të ndryshme me kontribut thelbësor në procesin e Rilindjes;
3. dallon disa prej figurave të rëndësishme të diasporës me kontribut në Rilindjen Kombëtare, duke vënë në dukje rolin e tyre në të;
4. argumenton rëndësinë e kontributit të diasporës shqiptare në zhvillimin e Rilindjes Kombëtare dhe arritjet e saj.

***Vlerësimi:***
*Vlerësimi i nxënësit mbështetet punën hulumtuese, aftësinë për të përzgjedhur burimet e informacionit, në prezantimin e materialit të përgatitur si dhe në pjesëmarrjen në diskutim dhe të menduarit kritik.*

**Detyrat dhe puna e pavarur**:
- Secili prej grupeve ndërton fletëpalosje të shoqëruara me foto ku prezanton veprimtarinë e diasporës mbi të cilën zhvilloi punën kërkimore.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Histori</th><th>Shkolla:</th><th>Klasa: 11</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Qeveria e përkohshme e Vlorës</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Qeveria e kryesuar nga Ismail Qemali, e dalë nga Kuvendi i Vlorës u përball që në hapat e parë me vështirësi të shumta, si në planin e brendshëm, ashtu edhe në atë të jashtëm.<br>Përpjekjet e Qeverisë së Vlorës ishin të shumta por, e mbetur pa përkrahje ndërkombëtare, e minuar nga brenda dhe e rrethuar nga vendet fqinje me synime aneksimi të trojeve shqiptare, ajo u detyrua të shpërbëhej brenda një kohe relativisht të shkurtër.<br>Megjithatë, ajo mbeti në histori si qeveria e parë e shtetit të pavarur shqiptar.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:<br>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit<br>• Përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, fjali komplekse për shpjegimin e koncepteve dhe ngjarjeve historike.<br>Kompetenca e të nxënit<br>• Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake.<br>Kompetenca personale<br>• Përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.<br>Kompetenca qytetare. Nxënësi/ja:<br>• shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore.</td><td colspan="2" rowspan="2">Fjalët kyçe:<br>- njohje ndërkombëtare<br>- KNK<br>- Separatizëm<br>- “Kanuni i Përtashëm”<br>- Pleqësia e Shqipërisë së Mesme”</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| - evidenton situatën e brendshme dhe të jashtme në të cilën duhet të vepronte Qeveria e Përkohshme e Vlorës;<br>- shpjegon veprimtarinë dhe masat e marra nga Qeveria e Vlorës për njohjen ndërkombëtare, mbrojtjen e integritetit territorial të Shqipërisë dhe tejkalimit të vështirësive të brendshme;<br>- vlerëson rëndësinë e krijimit dhe aktivitetit të Qeverisë së Vlorës dhe të Ismail Qemalit në ndërtimin e shtetit të pavarur shqiptar. | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>Me temat e mëparshme:<br>Kuvendi i Vlorës dhe Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë.<br>Me fusha të tjera:<br>Letërsia: Pasqyrimi në folklor i ngjarjeve të pavarësisë dhe figura e Ismail Qemalit. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:**

Harta e të pyeturit/ diskutim.

**Organizimi i orës së mësimit:**

Mësuesi paraqet në një idetë e rëndësishme të mësimit, të vendosura në një renditje logjike në trajtën e një skeme racionale pyetjesh, që lexohen dhe kuptohen me lehtësi nga nxënësit.
Në vazhdim, ai nxit diskutimin dhe mendimin logjik mes nxënësve.

**Ndërtimi i njohurive:**

Një skemë e sugjeruar për ndërtimin e njohurive për këtë tematikë mund të ishte:


QEVERIA E PËRKOHSHME E VLORËS
Kushtet e jashtme dhe të brendshme:
• Pushtimi i trojeve shqiptare nga vendet fqinje.
• Qëndrimi jomiqësor i Fuqive të Mëdha.
• Gjendja e vështirë ekonomike.
Detyrat kryesore të qeverisë
Njohja ndërkombëtare e pavarësisë së shtetit shqiptar.
Përcaktimi i kufijve të shtetit të ri shqiptar.
Shtrirja e autoritetit të qeverisë dhe administrimi i vendit.
Përpjekjet e qeverisë për tejkalimin e gjendjes së vështirë
Shtrirja e autoritetit të qeverisë.
- largimi i trupave pushtuese nga trojet shqiptare;
- kundërshtimi i prirjeve separatist të Esat Pashë Toptanit;
Administrimi i vendit
- legjislacioni, "Kanuni i Përtashëm i Administratës Civile" dhe "Kanuni i Jurisë".
- ndarje e re administrative e Shqipërisë.
- krijimi i gjykatave shtetërore, të ndara nga institucionet fetare.
- masa në fushën arsimore e kulturore.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja orienton nxënësit të diskutojnë mbi pikat kryesore të paraqitura në skemën e mësipërme.
  Theksi vendoset në:
  - Presionin nën të cilin e zhvilloi veprimtarinë e saj qeveria;
  - Aktivitetin diplomatik të qeverisë dhe Ismail Qemalit;
  - Masat e ndërmarra në planin e brendshëm, sidomos në raport me përpjekjet për pushtet të Esat Pashë Toptanit.
  - Mbështetjen popullore për qeverinë e Vlorës;
  - Rënia e qeverisë së Vlorës.

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Përshkruan situatën e brendshme dhe të jashtme me të cilën duhej të përballej qeveria e Vlorës.
2. Evidenton objektivat e veprimtarisë së qeverisë së Vlorës.
3. Analizon punën e qeverisë dhe përpjekjet e kësaj të fundit për të arritur objektivat e saj dhe për të tejkaluar problemet e shumta.
4. Vë në dukje rëndësinë e qeverisë së Vlorës dhe Ismail Qemalit në fillimet e jetës së shtetit të pavarur shqiptar.

**Vlerësimi:**

*Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

Argumentoni shkaqet e brendshme dhe të jashtme të rënies së qeverisë së Vlorës.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Konferenca e Ambasadorëve e Londrës | | **Situata e të nxënit:**<br><br>Konferenca e Ambasadorëve e Londrës mbetet një ngjarje themelore në historinë e shtetit shqiptar. Shumë nga ngjarjet negative që ka përjetuar Shqipëria si shtet dhe si komb pas vitit 1912 e kanë zanafillën tek kjo konferencë. Megjithatë, si çdo gjë e keqe, edhe Konferenca e Ambasadorëve e vitit 1913, pati diçka pozitive në lidhje me vazhdimësinë e shtetit të ri shqiptar. Këto aspekte të ndryshme duhet të vihen në dukje gjatë organizimit të orës mësimore | |
| <u>**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**</u><br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi:<br>• përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve;.<br>**Kompetenca personale.** Nxënësi:<br>• përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij. | | **Fjalët kyçe:**<br>- *sovranitet shtetëror*<br>- *parimi i etnisë*<br>- *pansllavizëm*<br>- *minoritet etnik*<br>- *Protokolli i Firences* | |

| | |
|---|---|
| **<u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>**.<br>Nxënësi:<br>➢ përcakton rrethanat historike në të cilat u mblodh Konferenca e Ambasadorëve e Londrës;<br>➢ shpjegon objektivat kryesore të saj;<br>➢ analizon raportet mes Fuqive të Mëdha që ishin aktorët kryesorë në këtë Konferencë dhe rolin e shteteve ballkanike;<br>➢ përshkruan kufijtë e shtetit shqiptar të dala nga Konferenca e Ambasadorëve;<br>➢ vlerëson ndikimin e konferencës mbi ecurinë e shtetit të ri shqiptar. | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, harte e kufijve politike të shtetit shqiptar, interneti, botime të ndryshme etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Me gjeografinë |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim / Lexim dhe mendim i drejtuar.

**Organizimi i orës së mësimit**

- Lexohet nga nxënësit rubrika "Pjesë leximi"
- Mësuesi/ja nxit pjesëmarrjen e nxënësve në mësim duke drejtuar pyetje dhe organizuar diskutimin në klasë.
  - Cila ishte pozita e Shqipërisë në fund të vitit 1912 dhe fillim të 1913?
  - A kishin filluar të shfaqeshin pretendime territoriale nga ana e shteteve fqinje të Shqipërisë?
  - Cilat mendoni se ishin Fuqitë e Mëdha që kishin qëndrim dashamirës ndaj Shqipërisë?
  - Duke parë kufijtë aktualë të shtetit shqiptar, a mund të evidentoni trevat e banuara nga popullsia shqiptare që mbetën jashtë këtyre kufijve?

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë pjesën e parë të mësimit dhe shkruan në tabelë pyetjet që nxënësit duhet t'u përgjigjen pas leximit.

  Pyetjet: - Përshkruani rrethanat historike në të cilat gjendej Shqipëria menjëherë pas shpalljes së pavarësisë?

- Cili ishte pozicioni i Shqipërisë në konferencë?
- A ishte pozicioni i saj i njëjtë me atë të vendeve të tjera fqinje?
- Cilat ishin interesat e Fuqive të Mëdha që u përplasën në këtë konferencë?
- Mbi bazën e cilit parim u zhvilluan diskutimet e konferencës?

- Përgjigjet e nxënësve mund të shënohen në mënyrë skematike në tabelë.

| | |
|---|---|
| Pozita e Shqipërisë | E saposhpallur e pavarur, por e panjohur si e tillë ndërkombëtarisht.<br>Qeveria shqiptare kishte autoritet në një territor shumë të kufizuar. |
| Pozita e shteteve fqinje | Fitues të Luftës I Ballkanike kundër Perandorisë Osmane.<br>Mbështetje nga Fuqi të Mëdha për aneksimin e tokave shqiptare si pjesë e Perandorisë Osmane. |
| Diskutimi mbi çështjen shqiptare | - statusi i Shqipërisë;<br>- organizimi i brendshëm i shtetit shqiptar;<br>- çështja e kufijve. |
| Përplasja e interesave të Fuqive të Mëdha lidhur me çështjen shqiptare. | - Në favor: Austro-Hungaria dhe Italia<br>- Kundër: Rusia dhe Franca<br>- Neutrale: Britania e Madhe |

- Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë pjesën e dytë të mësimit dhe shkruan në tabelë pyetjet që nxënësit duhet t'u përgjigjen pas leximit.

Pyetjet:
- Cilat ishin idetë që u diskutuan lidhur me statusin e Shqipërisë?
- Kur u mor vendimi përfundimtar për Shqipërinë?

- Cili ishte statusi dhe organizimi i brendshëm i Shqipërisë sipas Konferencës së Ambasadorëve?

Përgjigjet e nxënësve mund të shënohen në mënyrë skematike në tabelë.

Shqipëria sipas Konferencës së Ambasadorëve

**Statusi i Shqipërisë**
- Shqipëria shpallej principatë autonome, sovrane dhe trashëgimtare.
- Çdo lidhje varësie me Turqinë përjashtohej.
- Shqipëria bëhej shtet asnjanës nën garancinë e Fuqive të Mëdha etj.

**Kontrolli ndërkombëtar**
- Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit.
- 10 vjet do të ushtronte kontrollin e tij mbi administratën civile dhe mbi financat e Shqipërisë.
- Në krye të Shqipërisë do të qeveriste një princ i caktuar nga Fuqitë e Mëdha.

- Në vazhdim nxënësit lexojnë pjesët e mbetura të temës lidhur me përcaktimin e kufijve të Shqipërisë dhe përmbledhin:

**Kufijtë veriorë**
- nga trungu i Shqipërisë u shkëput Kosova dhe vise të tjera shqiptare si Tetova, Dibra e Madhe, Gostivari, Kërçova, Struga etj.
- Ato kaluan në favor të Serbisë dhe të Malit të Zi.

**Kufijtë jugorë**
- Konferenca vendosi që kufiri i Shqipërisë në jug të përfshinte brenda Korçën dhe të dilte në kepin e Stillos në perëndim dhe ishulli i Sazanit t'i mbetej Shqipërisë.
- Mbeti i papërcaktuar fati i Gjirokastrës.

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Liston synimet e Konferencës së Londrës lidhur me Shqipërinë;
2. Shpjegon pozicionet e Fuqive të Mëdha në lidhje me çështjen shqiptare;
3. Analizon tiparet e shtetit shqiptar të projektuar në Konferencën e Ambasadorëve;
4. Përshkuan procesin e përcaktimit të kufijve të shtetit shqiptar.

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

- Mblidhni fakte rreth përpjekjeve të patriotëve shqiptarë kundër vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në dëm të Shqipërisë.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td>Fusha: : Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkolla:</td><td>Klasa: 11</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Shqipëria në regjimin e princ Vidit</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Ardhja në Shqipëri e princit Vilhelm Vid ishte përpjekja e parë serioze për konsolidimin e shtetit të pavarur shqiptar. Vidi bëri disa hapa përpara në fushën e legjislacionit, administratës dhe përpjekjeve për kontrollin e territorit në kufijtë e Konferencës së Ambasadorëve. Megjithatë, vështirësitë e shumta me të cilat u përball, e bënë veprimtarinë e Vidit thuajse “një mision të pamundur” për të patur sukses.</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Nxënësi:<br>• përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.<br>Kompetenca e të menduarit. Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.<br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit; trashëgiminë materiale dhe shpirtërore.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>- Vorio- Epir<br>- organe ekzekutive<br>- “Statuti Organik i Shqipërisë”<br>- “kompani të shenjta”<br>- abdikim<br>- Haxhi Qamili</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**.<br>Nxënësi:<br>➢ Evidenton përbërjen e qeverisë Vidi dhe shpjegon grupimet e përfaqësuara në të.<br>➢ Analizon vështirësitë e brendshme dhe të jashtmeme të cilat u përball qeverisja e Vidit.<br>➢ Shpjegon hapat e ndërmarra në fushën e legjislacionit me theks të veçantë tek Statuti Organik i Shqipërisë?<br>➢ Analizon qëndrimin e qeverisë së Vidit ndaj lëvizjes "vorio-epirote" dhe kryengritjes së Shqipërisë së Mesme.<br>➢ Tregon arsyet e largimit të Princ Vidit nga Shqipëria | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme për periudhën historike. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Me qytetarinë |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Shpjegim/diskutim në klasë

**Organizimi i orës së mësimit**

- Lexohet në klasë pjesa "Material plotësues" dhe diskutohet rreth njohurive që nxënësit kanë rreth figurës së princit Vilhelm Vid.
- Shpjegimi i mësimit realizohet nga mësuesi duke e ndërthurur me pyetje të cilat u drejtohen nxënësve.
- Një pjesë e orës së mësimit i dedikohet shkëmbimit të mendimeve mes mësuesit dhe nxënësve lidhur me tematikën e orë së mësimit.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Shpjegimi i mësimit realizohet nga mësuesi duke e ndërthurur me pyetje të cilat u drejtohen nxënësve. Për ilustrim, pyetjet mund të ishin:
  - Kur erdhi në Shqipëri princi Vilhelm Vid?

- Si e priti populli shqiptar Vidin?
- Cilët ishin anëtarët kryesorë të qeverisë së Vidit dhe çfarë përfaqësonin ata nga pikëpamja ekonomiko-shoqërore?
- Shpjegoni grupimet që luftonin për influencë në qeverisjen e Vidit.
- Tregoni organizimin shtetëror sipas Statutit Organik të Shqipërisë.
- Çfarë e detyroi Vidin të hiqte dorë nga qeverisja dhe të largohej nga Shqipëria?

Një theks i veçantë vihet në:

- Analizën e strukturës kushtetuese shtetërore të shtetit shqiptar gjatë qeverisjes së Vidit. Në veçanti vihen në dukje pikat e dobëta të saj, si:
  - ruajta e kapitulacioneve të dhëna nga Perandoria Osmane;
  - ndërhyrja dhe tutela e KNK-së;
  - përqendrimi i pushtetit te princi dhe roli shumë i zbehtë i organit legjislativ;
  etj.
- Shpjegimin dhe analizën e faktorëve që pengonin veprimtarinë e qeverisë së princ Vidit, si në planin e brendshëm, ashtu edhe në atë të jashtëm:
  - Përçarjet e brendshme, ambiciet e Esat pashë Toptanit dhe roli i tij;
  - Përballja me synimet e vendeve fqinje, sidomos të Greqisë dhe Lëvizjes Vorio-epirote;
  - Shkaqet e shpërthimit dhe karakteri i Kryengritjes Fshatare të Shqipërisë së Mesme.

- Duke u nisur nga rubrika "Detyrë e pavarur", mësuesi nxit një debat në klasë duke u përqendruar në pikat e mëposhtme të diskutimit:
  - Cili mendoni se është vendi i princ Vidit në historinë e ndërtimit të shtetit të pavarur shqiptar?
  - Debatoni sa ishte në gjendje Vidi të ruante stabilitetin në Shqipëri.

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Përshkruan pritshmëritë e popullsisë për ardhjen e princ Vidit si sovran në Shqipëri.
2. Evidenton rolin e parisë shqiptare në qeverisjen e Vidit, disa prej qendrave kryesore urbane të Dardanisë, duke vënë në dukje lidhjen e tyre me qendrat e sotme në rajon.
3. Shpjegon kuadrin institucional të shtetit të Vidit.
4. Analizon situatën politike në Shqipëri, veprimet pozitive dhe vështirësitë me të cilat u përball qeverisja e princ Vidit.
5. Argumenton karakterin regresiv të Kryengritjes së Shqipërisë së Mesme.

***Vlerësimi:***

| |
|---|
| *Vlerësimi i nxënësit mbështetet në kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime .* |
| **Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>• Mblidhni fakte rreth qëndrimit të Fuqive të Mëdha kundrejt qeverisë së Vidit dhe shkaqet e largimit të tij nga Shqipëria. |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| Fusha: : Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkolla: | Klasa: 11 |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Shqipëria gjatë luftës së parë botërore | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë rubrikën "Grimcë historike"<br>*"Lufta e Parë Botërore, e ktheu Shqipërinë në një shesh beteje duke rritur rrezikun e copëtimit të mëtejshëm të trojeve shqiptare. Por përpjekjet qarqeve patriotike shqiptare ishin të shumta me objektiv rifitimin e pavarësisë së vendit pas lufte."*<br>Nxiten nxënësit në diskutim nëpërmjet pyetjeve të ndryshme. | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme.<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>**Kompetenca personale.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve qofshin këto dhe të ndryshme nga të tijat.<br>**Kompetenca qytetare.** Nxënësi:<br>• shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore. | | **Fjalët kyçe:**<br>*- front lufte*<br>*- Traktati i Fshehtë i Londrës*<br>*- Republika e Korçës*<br>*- demagogji*<br>*- federata "Vatra"*<br>*- Kongresi i Durrësit*<br>*- protektorat* | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.**<br>Nxënësi:<br>➢ evidenton shtrirjen e fronteve të Luftës së Parë Botërore në Shqipëri.<br>➢ analizon qëndrimet e fuqive pushtuese në zonat e tyre të kontrollit;<br>➢ tregon vendimet e marra prapa krahëve të shqiptarëve dhe në dëm të tyre gjatë periudhës së Luftës së Parë Botërore. | | | |

| | |
|---|---|
| ➢ argumenton rolin e patriotëve shqiptarë në rifitimin e pavarësisë dhe ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë. | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, hartë e Shqipërisë, interneti, botime të ndryshme etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Me gjeografinë |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim / pyetje –përgjigje /hartë e mendjes

**Organizimi i orës së mësimit**

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë rubrikën "Grimcë historike"
- Nxiten nxënësit në diskutim nëpërmjet pyetjeve të ndryshme si p.sh.:

  - Cila ishte situata e brendshme në Shqipëri dhe niveli i konsolidimit të shtetit shqiptar në prag të Luftës së Parë Botërore?
  - Cilat janë disa prej veçorive të zhvillimeve të Luftës së Parë Botërore në zona të ndryshme të Shqipërisë?
  - Shpjegoni thelbin e Traktatit të Fshehtë të Londrës dhe rrezikut që sillte ai për Shqipërinë?
  - Përshkruani qëndrimin e qarqeve patriotike shqiptare për mbrojtjen e interesave shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin rreth 10 minuta dhe ndërkohë shkruan në tabelë pyetjet të cilave nxënësit do t'u përgjigjen lidhur me informacionin e ri si p.sh:
  - Cilat ishin zonat e pushtimit të fuqive të ndryshme ndërluftuese në territorin e shtetit shqiptar?
  - A kishte ndonjë diferencim në trajtimin e popullsisë shqiptare nga këto fuqi pushtuese?
  - Cili ishte raporti i fuqive pushtuese me pavarësinë e Shqipërisë?
  - Ku konsistonte Traktati i Fshehtë i Londrës dhe çfarë parashikonte ai në lidhje me shtetin e pavarur shqiptar?
  - Evidentoni disa prej figurave të rëndësishme patriotike me kontribut në vitet e Luftës së Parë Botërore.
  - Cila ishte nisma më e rëndësishme e qarqeve patriotike shqiptare për ruajtjen e tërësisë territoriale dhe pavarësisë së shtetit shqiptar pas përfundimit të luftës?

• Pasi nxënësit u përgjigjen pyetjeve mësuesi/ja bën një përsëritje të koncepteve duke ndërtuar skemën në tabelë.

**Shqipëria në Luftën e Parë Botërore**

Fuqitë ndërluftuese:

- Blloku Qendror (Austro-Hungari, Bullgari);
- Antanta (Itali, Francë, Greqi)

Raporti me shqiptarët:

- Nënshkrimi i një protokoll midis komandës franceze dhe një delegacioni përfaqësues të popullsisë së krahinës së Korçës për krijimin e “krahinës autonome”. duke pranuar kështu karakterin etnik shqiptar të popullsisë së trevës së Korçës;
- Në janar të vitit 1917, qeveria e Vjenës bëri një shpallje publike në Shkodër, ku premtohej autonomia e Shqipërisë pas lufte, kur sipas saj, do të aftësohej për vetëqeverisje;
- Më 3 qershor 1917, qeveria italiane shpalli “pavarësinë e gjithë Shqipërisë” në Gjirokastër, por “nën hijen dhe mbrojtjen e Mbretërisë së Italisë”, por me përjashtim të Vlorës dhe krahinës së saj.

Shqiptarët në mbrojtje të interesave të tyre:

- U krijuan komitete të fshehta, grupime dhe organizata politike;
- Kolonitë shqiptare në ShBA, në Rumani, në Bullgari, në Turqi, në Zvicër, në Egjipt etj. , dhanë një ndihmesë të rëndësishme për pavarësinë dhe tërësinë territoriale të Shqipërisë;
- Kongresi i Durrësit hartoi një program politik, ku u shpreh për rifitimin e pavarësisë së vendit dhe për rishikimin e kufijve të vitit 1913.

Rreziku ndaj pavarësisë së Shqipërisë:

- ndërmjet fuqive të Antantës dhe Italisë.
- Qëllimi ishte tërheqja e Italisë në radhët e aleancës së Antantës;
- Sipas këtij Traktati:
  - Italia do të aneksonte territore shqiptare;
  - u vendos të krijohej një shtet i gjymtuar shqiptar në Shqipërinë e Mesme, nën protektoratin e Italisë.
  - krahinat e saj veriore dhe jugore, do të ndaheshin ndërmjet Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë.

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Evidenton situatën e trojeve shqiptare në Luftën e Parë Botërore.
2. Krahason qëndrimet e ushtrive pushtuese ndaj popullsisë shqiptare duke vënë në dukje të përbashkëtat dhe të veçantat.
3. Analizon veprimtarinë e patriotëve shqiptarë në mbrojtje të interesave të popullsisë, tërësisë territoriale dhe pavarësisë së vendit.
4. Shpjegon vendimet e Traktatit të Fshehtë të Londrës dhe pasojat që ai do të kishte mbi Shqipërinë, në rast se do të zbatohej.

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutim, dhe në shfaqjen e mendimit kritik.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

- Hulumtoni materiale rreth vendimeve të Kongresit të Durrësit dhe rëndësisë së tyre.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
| **Tema mësimore:** Çështja shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris dhe Kongresi i Lushnjës. | | **Situata e të nxënit:** Lexohet para nxënësve pjesë nga fjalimi i at Gjergj Fishtës në Konferencën e Paqes, si p.sh.:<br>*“**Tash, zotni, mbasi ju diftova** se kush janë dhe çka janë shqiptarët, më duhet t'ju flas për të drejtat e tyne. E po ju tham se shqiptarët kanë të drejtë*<br>*a) për nji pavarësi politike;*<br>*b) gjithnjë brenda kufijve gjeografikë e etnikë të Shqipnisë. Mbi pavarësi të kombit shqiptar nuk kam shumë fjalë me ju thanë. Dihet se kjo e drejtë ka qenë njohtë, sigurue dhe dorëzanue me nji traktat të Pushteteve të Mëdha të Antantës...Pavarësia e kombit shqiptar pra, në se do marrë si nji punë e kryeme dhe e dorëzanueme mbi erz të kombeve të mëdha të Europes... Pushtimet e hueja dhe intrigat e paemen të nji diplomacie bakalle të pashpirt e të pazemër, kaq fort ia kanë shndërrue dhe perçudnue fizionominë gjeografike dhe etnologjike Shqipnisë... Prandaj lypset të përcaktojmë ma përpara disa kritere të sigurta mbas të cilave mandej me përskajue kufijt e natyrshem të Shqipnisë. Sipbas parimit të autodeçizionit (vetëvendosjes) secili popull që mund të thotë se ka nji homogjenitet të pakëputun e të pandamë në vetvete, ashtu si ky përcaktohet prej klauzolave të **teorive ëillsonjane**, ka të drejtë, ose në mos tjetër do të kishte të drejtë që ai vetë me e nda kuvendin mbi sharte të veta politike e ekonomike dhe me u nderue si shtet i lirë dhe i pamvarshëm.... Simbas këtyne parimeve, asht punë e arsyeshme që shteti shqiptar të përshtrihet gjeografikisht deri ku mbërrin kombësia e popullit shqiptar e vijueshme dhe e pandame prej centrit të vet. Sepse tagri i autodeçizionit nuk asht e lidhun me individë ose me grupe të caktuem njerëzish, por me nji “avrom” të gjithëmbarshëm prej të cilit përbahet kombi. Prandaj çdo zvoglim që i bahet tokës së Shqipnisë, i pambështetun mbi këto parime, do me thanë se ai i bahet dhunshëm dhe me të padrejtë. “* | |
| **<u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u>**<br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës.<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet | | **Fjalët kyçe:**<br>- *“Statuti Organik i Lushnjes”*<br>- *Konferenca e Paqes në Paris*<br>- *Regjenca*<br>- *Protokolli i Kapshticës*<br>- *lëvizje esadiste*<br>- *parlamentarizëm* | |

| | |
|---|---|
| formave të ndryshme të të shprehurit;<br>trashëgimisë materiale dhe shpirtërore. | |
| **<u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>**.<br>Nxënësi/ja:<br>➢ evidenton vendin që zuri çështja shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris.<br>➢ analizon pozicionet e ndryshme të Fuqive të Mëdha ndaj Shqipërisë;<br>➢ vlerëson përpjekjet e autoriteteve shqiptare dhe patriotëve në mbrojtje të çështjet shqiptare;<br>➢ argumenton vendin dhe rëndësinë e Kongresit të Lushnjes në konsolidimin dhe mbrojtjen e interesave të Shqipërisë dhe popullit shqiptar. | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme, enciklopedi etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Letërsinë<br>- Me gjeografinë |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Rrjeti i diskutimit /lexim dhe mendim i drejtuar

**Organizimi i orës së mësimit**

- Lexohen pjesë nga fjalimi i at Gjergj Fishtës si pjesë e delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes
Shih: ***http: //www. radiokosovaelire.com/fjalimi-i-gjergj-fishtes-ne-konferencen-e-paqes-ne-paris-me-1919-nje-sage-shqiptare-i***

- Nxënësve u drejtohen pyetje duke i nxitur në diskutim
- Cilat ishin planet e Fuqive të Mëdha dhe vendeve fqinje për Shqipërinë dhe trojet shqiptare në Konferencën e Paqes?
- A u paraqitën shqiptarët me një pozicion të përbashkët në Konferencën e Paqes?

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën e parë të mësimit dhe të listojnë synimet e vendeve fqinje ndaj trojeve shqiptare.

- Lexohet pjesa e dytë dhe e tretë e mësimit dhe nxënësit plotësojnë një tabelë lidhur me vendimet dhe masat e marra nga Kongresi i Lushnjes dhe qeveria e Sulejman Delvinës.

| Në mbrojtje të tërësisë territoriale të Shqipërisë. | Për ndërtimin e institucioneve dhe legjislacionit shtetëror. | Për vendosjen e autoritetit dhe kontrollit mbi gjithë territorin. |
|---|---|---|
| - Kongresi i Lushnjës hodhi poshtë projektet e Konferencës së Paqes për Shqipërinë;<br>- Ai u shpreh ashpër kundër ndonjë protektorati të huaj;<br>- Kërkoi pavarësinë e plotë të vendit dhe tërësinë territoriale të Shqipërisë në kufijtë e saj etnikë;<br>- Nënshkrimi i Protokollit të Kapshticës (28 maj 1920);<br>- Protokolli i 2 gushtit 1920, midis qeverisë shqiptare dhe asaj italiane. | - Qeveria e Durrësit u zëvendësua me një qeveri të re të kryesuar nga Sulejman Delvina.<br>- U miratua "Statuti Organik i Lushnjës", një akt juridik i rëndësishëm;<br>- Sipas Statutit, u ruajt përkohësisht forma monarkike e qeverisjes, deri në thirrjen e një asambleje kushtetuese dhe hartimin e kushtetutës;<br>- U krijua një Këshill i Lartë prej katër vetash në formë regjence si kreu më i lartë i shtetit, i përbërë nga përfaqësues të katër komuniteteve kryesore fetare;<br>- Kongresi zgjodhi një Këshill Kombëtar, të quajtur Senat, me funksione legjislative;<br>- Ai i dha shtetit shqiptar karakter laik, përcaktoi barazinë e qytetarëve përpara ligjit, të drejtën e besimit, të pronës etj. | - Kongresi e shpalli të shkarkuar qeverinë e Durrësit dhe e cilësoi atë si antikombëtare dhe proitaliane;<br>- Qeveria e Sulejman Delvinës u përball në vend me lëvizjen e armatosur esadiste. |

- Mësuesja nxit të menduarit kritik te nxënësit duke drejtuar kërkuar nga nxënësit të:
  - Përse Kongresi i Lushnjes pati rëndësi të madhe duke u quajtur edhe "aleanca e shenjtë"?
  - Argumenton rëndësinë e tezave të presidentit të SH.B.A. Uillson lidhur me mbrojtjen e interesave të popullit shqiptar.

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Përshkruan rreziqet me të cilat u përball çështja shqiptare në Konferencën e Paqes ne Paris.

2. Tregon pozicionet e Fuqive të Mëdha kundrejt kësaj çështje.
3. Evidenton përpjekjet e qarqeve patriotike shqiptare në mbrojtje të interesave të popullit shqiptar në Konferencën e Paqes.
4. Analizon parimet mbi të cilat u ngritën institucionet e shtetit shqiptar në Kongresin e Lushnjes të materializuara në vendimet e këtij kongresi.
5. Vë në dukje veprimtarinë e qeverisë së Sulejman Delvinës në zbatim të vendimeve të Kongresit të Lushnjes.

**Vlerësimi:**

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit dhe në të menduarit kritik.*

**Detyrat dhe puna e pavarur**:

- Mësuesi/ja u jep nxënësve si detyrë të hulumtojnë dhe sjellin informacion rreth Luftës së Vlorës së vitit 1920.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkolla:</td><td>Klasa: 11</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Shteti shqiptar gjatë viteve 1921-1924</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Periudha pas Luftës I Botërore, ishte e mbushur me vështirësi ekonomike dhe mungesë të theksuar stabilitetit politik për shtetin shqiptar. Ndonëse, parimet e ndërtimit të tij mbështeteshin mbi parlamentarizmin perëndimor, ato u ndeshën me normat dhe zakonet tradicionale dhe luftën e paprinciptë dhe për interesa të ngushta politike e vetjake të një pjese të klasës politike. Tensionet e akumuluara me kalimin e kohës, gjetën momentin e tyre shpërthyes me ngjarjet e revolucionit apo kryengritjes së Qershorit 1924.</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e të menduarit. Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme;<br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi/ja:<br>• parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime<br>Kompetenca personale: Nxënësi/ja<br>• përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.</td><td colspan="2" rowspan="2">Fjalët kyçe:<br>- Këshilli Kombëtar<br>- votim i tërthortë<br>- ndarje e pushteteve<br>- Republika e Mirditës<br>- Shoqëria “Bashkimi”<br>- Revolucioni i Qershorit</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>.<br>Nxënësi/ja:<br>➢ Shpjegon gjendjen ekonomike dhe kuadrin politik në fillim të viteve ’20 të shek. XX;<br>➢ Përshkruan zhvillimet politike gjatë viteve 1921-1924 dhe shkaqet e mungesës së stabilitetit politik në këtë periudhë;<br>➢ Analizon arsyet e ngjarjeve të Qershorit 1924 dhe programin e qeverisë së dalë prej tij;<br>➢ Shpjegon shkaqet e dobësimit të pozitave dhe rënies së qeverisë së Nolit.</td></tr>
</table>

| Burimet: | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| • Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi. | - Me qytetarinë<br>- Me gjeografinë etj. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim / INSERT

**Organizimi i orës së mësimit**

1. Organizohet në klasë diskutimi lidhur me faktet që nxënësit njohin rreth jetës politiko – shoqërore gjatë viteve 1921 – 1924.

**Ndërtimi i njohurive:**

2. Mësuesja udhëzon nxënësit të lexohet mësimi duke i kërkuar te vendosin përbri secilës pjesë të lexuar shenjat të cilat kanë kuptimin e mëposhtëm.

"√" vendoset përbri informacionit që për ju është i njohur.
"-" —— vendoset përbri informacionit që ju e dinit ndryshe.
"+" —— vendoset përbri informacionit i cili është i ri për ju.
"?" —— vendoset përbri informacionit i cili është i paqartë ose doni të dini më shumë.

3. Pas leximit organizohet në klasë bashkëbisedim ku nxënësit krahasojnë shenjat e vendosura dhe diskutojnë rreth fakteve të reja . (Këto veprimtari mund të zhvillohen në 20 minutat e para të mësimit dhe pjesën tjetër plotësohet tabela nga përgjigjet e nxënësve)

| √ | — | + | ? |
|---|---|---|---|
| - Në vitet 1921 – 1924, Shqipëria kishte një mungesë të theksuar të stabilitetit politik.<br><br>- Shprehje e kësaj mungese stabiliteti ishte ndryshimet e shpeshta të qeverive dhe në legjislacion.<br><br>- Mungesa e stabilitetit theksohej edhe nga lëvizje të shumta antiqeveritare gjatë kësaj periudhe.<br><br>- Polarizim i theksuar i skenës politike dhe raporteve pozitë – opozitë. | -Nxënësit mund të dinë ndryshe rreth orientimeve apo programeve të forcave të ndryshme politike që vepronin në periudhën 1921 - 1924.<br><br>- nxënësit mund të kenë informacione të ndryshme lidhur me natyrën dhe shkaqet e ngjarjeve të Qershorit 1924.<br><br>Këto dhe informacione të tjera shënohen nga mësuesja në kolonen përkatëse të tabelës. | - Komiteti për Mbrojtjen e Kosovës u përfshi në zhvillimet politike në Shqipëri.<br>- Në Shqipëri ka patur edhe lëvizje me natyrë separatiste siç ishte shpallja e “Republikës së Mirditës”, gjithnjë nën ndikimin dhe nxitjen e faktorit të jashtëm.<br>- Sukses i rëndësishëm në planin ndërkombëtar ishte Deklarata e 9 nëntorit të vitit 1921 e Konferencës së Ambasadorëve në Paris që njohu Shqipërinë si shtet i pavarur si dhe tërësinë tokësore të saj.<br>- Lëvizja e Qershorit u ndihmua nga trupa ushtarake nga Veriu dhe Jugu i Shqipërisë. | Informacion shtesë<br>- diferencat mes forcave politike të periudhës.<br>- Noli nuk arriti të siguronte ndihmë ekonomike nga Lidhja e Kombeve dhe nuk u njoh ndërkombëtarisht.<br>-<br>(Mësuesi mund të përzgjedhë informacione të ndryshme) |

| |
|---|
| **Pyetje për diskutim**<br>Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:<br>1. Shpjegon situatën ekonomike dhe politike në Shqipërinë e viteve 1921 – 1924.<br>2. Përshkruan ngjarjet kryesore politike të periudhës.<br>3. Analizon shkaqet e Revolucionit të Qershorit dhe programin e qeverisë Noli.<br>4. Shpjegon arsyet e rënies së qeverisë Noli.<br>5. Shpjegon ndërhyrjet e vendeve fqinje në politikën shqiptare të periudhës. |
| **Vlerësimi:**<br>*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit në të kuptuarit e fakteve dhe ngjarjeve* |
| **Detyrat dhe puna e pavarur**:<br>• Zhvilloni hulumtime paraprake lidhur me karakterin e ngjarjeve të Qershorit 1924. |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Shqiptarët e Kosovës, Çamërisë dhe viseve të tjera. | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesja e nis orën e mësimit me një prezantim të figurës së Azem Bejtë Galicës dhe veprimtarisë së tij patriotike:<br>https://www.youtube.com/watch?v=euBORIeRb5U | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**<br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë; | | **Fjalët kyçe:**<br>- *kolonizim*<br>- *refugjat*<br>- *Komiteti "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës"* | |

| | |
|---|---|
| **Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës.<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;<br>trashëgiminë materiale dhe shpirtërore. | - *Xhemijeti*<br>- *lëvizje kaçake*<br>- *shkëmbim i popullsisë* |
| **<u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>**.<br>Nxënësi:<br>➢ evidenton gjendjen e popullsisë shqiptare në Kosovë, Çamërisë dhe viseve të tjera.<br>➢ Tregon rrugët dhe mënyrat e përdorura për të ushtruar presion mbi shqiptarët nga ana e autoriteteve serbe dhe greke;<br>➢ Shpjegon format e rezistencës dhe përpjekjet e qarqeve patriotike për t'i rezistuar përpjekjeve për shkombëtarizim dhe terrorit etnik kundër shqiptarëve. | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme, enciklopedi, hartë e Ballkanit Perëndimor në vitet 1912-1924 | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Me letërsinë<br>- Me gjeografinë |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Shpjegim /tabela e koncepteve

**Organizimi i orës së mësimit**

- Mësuesja e nis orën e mësimit me një prezantim të figurës së Azem Bejtë Galicës dhe veprimtarisë së tij patriotike:

  https://www.youtube.com/watch?v=euBORIeRb5U

- Mësuesi/ja shpjegon shkurt fatin e trojeve shqiptare pas tërheqjes së Perandorisë Osmane nga Ballkani duke e ilustruar me ndihmën e hartës.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin dhe ndërton në tabelë ditarin dypjesësh. Për plotësimin e tij aktivizon nxënës të ndryshëm.

| Fjala /fjalia | Komenti |
|---|---|
| Trojet nën Mbretërinë Serbe dhe, më pas, nën SKS. | - U vendos një regjim ushtarako-policor;<br>- U synua shndërrimi i strukturës etnike të popullsisë shqiptare dhe shkombëtarizimi i saj.<br>- Popullsisë shqiptare iu mohuan të drejtat e saj themelore, si mësimi i gjuhës shqipe, përdorimi i saj në administratë etj.<br>- U ushtrua dhunë dhe terror, pati presion për ndërrimin e fesë dhe dolën akte ligjore për shpronësimin e saj.<br>- Filloi procesi i kolonizimit sllav dhe i shpërnguljes së shqiptarëve myslimanë në Turqi, duke i identifikuar ato me turqit.<br>- Rezistenca kundër pushtimit serb → - rezistencë e armatosur (Kryengritja e Dibrës);<br>- lëvizja kaçake;<br>- organizimi i Komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës";<br>- Xhemijeti (në Maqedoni); |
| Shqiptarët e Çamërisë | - Në Çamëri to u vendos një pushtet ushtarako-policor;<br>- u shkelën të drejtat civile e kombëtare dhe u ndërmorën masa të egra terrori.<br>- u shkatërruan qindra shtëpi, u organizuan masakra mbi popullsinë shqiptare;<br>- u grabitën pasuritë e shqiptarëve;<br>- nën pretekstin e grumbullimit të armëve në Çamëri qindra shqiptarë u internuan në ishujt e Egjeut.<br>- nënshkrimi i Traktatit të Lozanës, ku pati një nen për shkëmbimin e popullsive greko-turke;<br>- Gjatë Luftës së Parë Botërore, shqiptarët e Çamërisë dërguan peticione e memorandume të shumta pranë qeverive evropiane, në mbrojtje të të drejtave të tyre dhe për bashkimin me Shqipërinë; |

- Mësuesi/ja nxit nxënësit në të menduarit kritik duke drejtuar pyetjen:
  - *A mund të identifikoni disa të përbashkëta dhe të veçanta të trajtimit të popullsisë shqiptare në Kosovë dhe Çamëri nga shteti serb (me pas*

| |
|---|
| *jugosllav) dhe ai grek?*<br><br>**Pyetje për diskutim**<br>Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:<br>1. Përshkruan gjendjen e të drejtave të shqiptarëve në Kosovë, Çamëri e në viset e tjera në vitet 1913-1918?<br>2. Tregon rolin e Komitetit të Mbrojtjes së Kosovës në rezistencën kosovare dhe në politikën shqiptare,<br>3. Shpjegon se çfarë përfaqëson lëvizja kryengritëse shqiptare në vitet 1920-24 dhe tregon disa prej figurave kryesore të saj?<br>4. Evidenton shkeljen e të drejtave të shqiptarëve të Çamërisë nga autoritetet greke.<br>5. Argumenton rëndimin e situatës së popullsisë shqiptare në Çamëri me nënshkrimin e Traktatit të Lozanës, janar 1923? |
| **Vlerësimi:**<br>*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit dhe në të menduarit kritik.* |
| **Detyrat dhe puna e pavarur**:<br>• Hartoni një prezantim mbi një prej figurave kryesore të rezistencës së popullsisë shqiptare jashtë kufijve të shtetit shqiptar. |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Republika shqiptare (1925-1928) | | **Situata e të nxënit:**<br><br>Lexohet nga nxënësit rubrika "Grimca historike"<br>*"Sipas historianit Joseph Swire, në zgjedhjet e prillit 1925, "qeveria doli fitimtare, por kjo ishte paravendosur, sepse në mungesë të të gjithë udhëheqësve kryesorë të opozitës në mërgim, nuk mund të pritej që ndonjë prej peshqve më të vegjël të kuturiste të luftonte për vende me mbështetësit e qeverisë. Nuk ishte për t'u befasuar që vetëm një pjesë e vogël e zgjedhësve mori mundimin të votonte..."*.<br>Mësuesi/ja nxit kureshtjen e nxënësve duke drejtuar pyetje dhe organizuar diskutimin në klasë. | |

<table>
<tr>
<td>

<u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Nxënësi:<br>
• përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.<br>
Kompetenca e të menduarit. Nxënësi:<br>
• zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve;.<br>
Kompetenca personale. Nxënësi:<br>
• përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.

</td>
<td rowspan="2">

Fjalët kyçe:<br>
- republikë presidenciale<br>
- shtet laik<br>
- shoqëri aksionare<br>
- monopol<br>
- paktet e Tiranës<br>
- KONARE

</td>
</tr>
<tr>
<td>

<u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>.<br>
Nxënësi:<br>
➢ tregon procesin e vendosjes së republikës në Shqipëri;<br>
➢ shpjegon ndryshimet kushtetuese që ndodhën gjatë këtij procesi;<br>
➢ evidenton situatën ekonomike dhe zhvillimet në këtë drejtim gjatë periudhës së monarkisë;<br>
➢ analizon drejtimet e politikës së jashtme të Republikës Shqiptare;

</td>
</tr>
<tr>
<td>

Burimet:<br>
• Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi, botime të ndryshme etj.

</td>
<td>

Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>
- Me qytetarinë

</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">

Metodologjia: Diskutim / Lexim dhe mendim i drejtuar.<br>
Organizimi i orës së mësimit

</td>
</tr>
</table>

- Lexohet nga nxënësit rubrika "Grimca historike"
- Mësuesi/ja nxit kureshtjen e nxënësve duke drejtuar pyetje dhe organizuar diskutimin në klasë.
  - Cilat ishin rrethanat e brendshme dhe të jashtme në të cilat u shpall forma republikane e qeverisjes?
  - Cili ishte kuadri kushtetues në prag të shpalljes së republikës?
  - Çfarë dini për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë në vitet '20 të shek. XX?
  - A dini se cili ishte pozicioni ndërkombëtar i Shqipërisë në të njëjtën periudhë?

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë pjesën e pare të mësimit dhe shkruan në tabelë pyetjet që nxënësit duhet ti përgjigjen pas leximit.
- Pyetjet: - Cila ishte forma e qeverisjes në Shqipëri me ardhjen në pushtet të A. Zogut pas largimit të qeverisë Noli?
  - Cili ishte tipi i republikës që u përcaktua në Statutin Themeltar të republikës?
  - Evidentoni disa prej rregullimeve kushtetuese pas shpalljes së republikës.

- Përgjigjet e nxënësve mund te shënohen në mënyrë skematike në tabelë.
-

| | |
|---|---|
| Forma ekzistuese e qeverisjes | Monarki me organ suprem Këshillin e Regjencës |
| Tipi i republikës | Formalisht republikë parlamentare, në realitet mori formë republike presidenciale me kompetenca të gjera të presidentit. |
| Kuadri kushtetues i republikës | - parlamenti me dy dhoma: senatin dhe dhomën e deputetëve;<br>- presidenti i vendit do të ishte njëkohësisht dhe kryetari i qeverisë;<br>- presidenti fitonte pushtet të fortë dhe kompetenca të gjera, si të drejtën e vetos pa apel, të drejtën e shpalljes së zgjedhjeve etj. |

- Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë pjesën e dytë të mësimit dhe shkruan në tabelë pyetjet që nxënësit duhet ti përgjigjen pas leximit.
  Pyetjet:
  - Evidentoni disa prej hapave kryesorë ekonomikë të ndërmarrë nga qeveria e presidentit A. Zogu?
  - Cili ishte partneri kryesor ekonomik i Shqipërisë?
  - Cilat ishin disa prej mangësive të qeverisjes në fushën ekonomike?

| Hapat në fushën e ekonomisë | - qeveria shqiptare ndoqi politikën e dyerve të hapura, duke i dhënë përparësi kapitalit italian;<br>- u nënshkruan dy marrëveshje shqiptaro-italiane në mars të vitit 1925;<br>o themelimi i Bankës Kombëtare;<br>o marrëveshja e huasë *SVEA* (Shoqëria për Zhvillimin Ekonomik të Shqipërisë);<br>- Qeveria shqiptare dha një sërë koncesionesh të tjera në shfrytëzimin e burimeve minerale në vend, të pyjeve etj. |
|---|---|

Qeveria nuk ishte në gjendje të përgatiste dhe të zbatonte një program reformash në bujqësi, sistemin bankar, pronësinë mbi tokën etj.

- Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë pjesën e dytë të mësimit dhe shkruan në tabelë pyetjet që nxënësit duhet ti përgjigjen pas leximit.
  Pyetjet:
  - Ku konsistonin lëvizjet në fushën e diplomacisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare të qeverisë së A. Zogut?
  - Si shpjegohet roli mbizotëruesi Italisë në marrëdhëniet në politikën e jashtme dhe të brendshme të Shqipërisë?

Përgjigjet paraqiten në mënyrë skematike në tabelë, sipas shembujve të mësipërm.

**Pyetje për diskutim**
Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:
1. Përcakton shkaqet që e shtynë A. Zogun të shpallte formën republikane të qeverisjes.
2. Shpjegon aspektet kryesore institucionale dhe kushtetuese të regjimit republikan në Shqipëri,
3. Bën dallimin mes formës së republikës së shpallur *de jure* dhe asaj *de facto.*
3. Identifikon shtyllat e politikës ekonomike të Republikës Shqiptare.
4. Analizon veçoritë e politikës së jashtme të qeverisë republikane të kryesuar nga A. Zogu.

***Vlerësimi:***
*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**
- Mblidhni fakte rreth arsyeve të rolit mbizotërues të Italisë në politikën e jashtme dhe të brendshme të Shqipërisë. Përse A. Zogu i dha këtë rol përcaktues Italisë? Argumentoni mendimin tuaj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Monarkia shqiptare | | **Situata e të nxënit:**<br>Për të nxitur interesin e nxënësve, mësuesja/si udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën "Material plotësues" dhe, më pas, nxit diskutimin rreth njohurive që nxënësit kanë në lidhje me figurën e Ahmet Zogut. | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**<br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë;<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës.<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit trashëgiminë materiale dhe shpirtërore;<br><br>**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**. Nxënësi:<br>➢ evidenton faktorët që favorizonin vendosjen e monarkisë;<br>➢ shpjegon tiparet kryesore kushtetuese dhe institucionale të monarkisë shqiptare sipas kushtetutës monarkiste;<br>➢ tregon reformat e ndërmarra në fushën legjislative, arsimore dhe kulturore;<br>➢ analizon ndikimin e krizës ekonomike botërore mbi ekonominë shqiptare;<br>➢ vë në dukje luhatjet e politikës së jashtme gjatë periudhës së monarkisë; | | **Fjalët kyçe:**<br>- *monarki parlamentare*<br>- *Statuti Themeltar i Mbretërisë*<br>- *falimentim*<br>- *reformë agrare*<br>- *Pakti Ballkanik*<br>- *martesë civile* | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, interneti, botime të tjera. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Me qytetarinë. | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

**Metodologjia:** Shpjegim/hartë e konceptit

**Organizimi i orës së mësimit**

- Lexohet në klasë pjesa "Material plotësues" dhe diskutohet rreth njohurive që nxënësit kanë rreth figurës së Ahmet Zogut.
- Mësuesja udhëzon nxënësit dhe ndërkohë ndërton në tabelë hartën e konceptit " Monarkia Shqiptare".
- Shpjegimi i mësimit realizohet nga mësuesi duke e ndërthurur me pyetje të cilat u drejtohen nxënësve.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Shpjegimi i mësimit realizohet nga mësuesi duke e ndërthurur me pyetje të cilat u drejtohen nxënësve si p. sh:

  - Përse u kalua nga forma republikane e qeverisjes, në atë monarkike?
  - Shpjegoni procesin dhe ndryshimet kushtetuese dhe institucionale që ndodhën në procesin e kalimit nga republika në monarki.
  - Cilat ishin disa prej reformave të ndërmarra nga monarkia?
  - Shpjegoni marrëdhëniet e monarkisë me Italinë fashiste.
  - Ku mbështetej zhvillimi i ekonomisë shqiptare dhe si u ndikua ajo nga kriza ekonomike botërore?
  - A ishte i aftë A. Zogu që të kryente reforma në planin shoqëror dhe cilat qarqe i pengonin ato?

**Monarkia shqiptare**

U shpall në
1 shtator 1928

Organizimi politiko-shoqëror:
- Shqipëria u shpall "Mbretëri demokratike, parlamentare dhe trashëgimore".
- Parlamenti përbëhej vetëm nga dhoma e deputetëve.
- Ai sanksionoi disa standarde demokratike, si: shtetin laik në Shqipëri, parimin e ndarjes së tri pushteteve, njihej liria e fjalës, e shtypit, e mbledhjeve dhe e krijimit të shoqatave, e pronës, liria e ndërgjegjes etj. Mbreti ishte kreu më i lartë i shtetit dhe komandant i përgjithshëm i forcave të armatosura. Statuti i jepte Zogut kompetenca të shumta mbi parlamentin.

Politika e jashtme:
- Në vitet ’30 u rrit shërbimi diplomatik i Shqipërisë me vendet e tjera;
- U nënshkruan një sërë marrëveshjesh me shtetet e huaja, ku më të rëndësishmet ishin ato me Italinë.
- qeveria shqiptare hodhi hapa për një politikë të pavarur nga Italia dhe për një afrim më të madh me vendet ballkanike.
- Zogu nuk e përtëriu Paktin e Parë të Tiranës të vitit 1926;
- Filloi një fazë e quajtur “kriza shqiptaro-italiane”, e cila u shoqërua me përkeqësim të marrëdhënieve me Italinë;
- Shqipëria mori pjesë me anë të një delegacioni në disa konferenca ballkanike të zhvilluara në vitet 1930;
- Duke parë mungesën e interesimit të vendeve ballkanike qeveria shqiptare hyri në bisedime me italianët dhe u nënshkrua një marrëveshje, e cila përfshiu disa aspekte, si: ato ekonomike, financiare, ushtarake etj.

Zhvillimet ekonomike:
- Në vitet 1929-1935 Shqipëria u përfshi në rrjedhat e krizës ekonomike botërore që shkaktoi probleme të mëdha ekonomike: falimentime, rënie të prodhimit, papunësi, rënie të investimeve etj;
- Qeveria e Zogut ndërmori një sërë masash antikrizë:
  - U nënshkrua një marrëveshje me Italinë për një hua financiare;
  - U shkurtua administrata dhe shpenzimet për oborrin mbretëror, por megjithatë shteti shqiptar u vu përballë vështirësive të mëdha financiare.
- Reforma ekonomike:
  - U ulën taksat doganore;
  - u përkrah eksporti i mallrave bujqësore dhe blegtorale;
  - u miratua ligji i Reformës Agrare;

Nga mesi i vitit 1935, si pasojë e daljes nga kriza botërore dhe të masave të ndërmarra, ekonomia nisi të gjallërohej.

**Pyetje për diskutim**
Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:
1. Identifikon disa prej faktorëve që ndikuan në vendosjen e monarkisë në Shqipëri.
2. Analizon karakteristikat e kuadrit kushtetues dhe institucional të monarkisë shqiptare.
3. Shpjegon reformat kryesore me karakter shtetformues të ndërmarra nga monarkia.
4. Argumenton ndryshimet në politikën e jashtme të monarkisë.

**Vlerësimi:**
*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit.*

**Detyrat dhe puna e pavarur**:
- Hulumtoni mbi Reformën Agrare të miratuar nga qeveria e A. Zogut dhe zbatimin e saj.

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Lëvizjet politiko-shoqërore në Shqipëri në vitet 1925-1939. | | **Situata e të nxënit:**<br>Për të nxitur kureshtjen e nxënësve lexohet në klasë rubrika "Grimcë historike".<br>*Më 20 shkurt 1931, kur Zogu për arsye mjekësore ndodhej në Vjenë, i vendosur në hotelin luksoz "Imperial", dy anëtarë të shoqërisë "Bashkimi", kapiten Azis Çami dhe toger Ndoc Gjeloshi e goditën atë disa herë. Zogu shpëtoi pa asnjë pasojë ndërsa adjutanti i tij mbeti i vrarë. Atentatorët dhe emigrantë politikë shqiptarë të Vjenës u arrestuan.* | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme.<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>**Kompetenca personale.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve qofshin këto dhe të ndryshme nga të tijat.<br>**Kompetenca qytetare.** Nxënësi:<br>• shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore. | | **Fjalët kyçe:**<br>- *grup komunist*<br>- *emigracion politik*<br>- *gjyq politik*<br>- *konservator*<br>- *sindikatë*<br>- *"Demonstrata e bukës"* | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.**<br>Nxënësi:<br>➢ dallon grupet e ndryshme politiko-shoqërore opozitare ndaj monarkisë;<br>➢ gjykon për platformat e ndryshme politike opozitare ndaj Zogut;<br>➢ evidenton lëvizjet me natyrë shoqërore dhe ndikimin e tyre në shoqërinë shqiptare të kohës së monarkisë. | | | |

| **Burimet:** | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| • Libri i nxënësit, internet, enciklopedi, botime të ndryshme etj. | - Me gjeografinë |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim/ tabela e koncepteve

**Organizimi i orës së mësimit**

- Mësuesi/ja për të nxitur kureshtjen e nxënësve cakton një nxënës që të lexoje rubrikën "Grimcë historike"
- Për të nxitur nxënësit në një diskutim paraprak mësuesi/ja shkruan në tabelë :
  grupime politike ilegale kundërzogiste - grupe komuniste - kryengritja e Fierit - KONARE - grevë - shoqëria "Puna" - "Demonstrata e Bukës".
- Mësuesi/ja pyet nxënësit :
  - A mund të shpjegoni termat e mëposhtëm?
  - Ç'ju kujton data 17 gusht 1935?
  - Cilët ishin grupimet kryesore opozitare në vitet '20 – '30?

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë mësimin duke i ndarë në grupe sipas pjesëve në të cilat është organizuar informacioni i ri.
- Ndërtohet tabela e koncepteve si më poshtë, mësuesi/ja pyet nxënësit sipas çështjeve përkatëse ose i ngre për të plotësuar në tabelë.

| Koncepti | Komenti |
|---|---|
| Organizata të fshehta antizogiste | 1- Vepronin në ilegalitet brenda Shqipërisë.<br>2- Grupet komuniste (Shkodër, Korçë), me ndikim të kufizuar.<br>3- Organizata me karakter republikan, të përbërë nga shtresa të ndryshme shoqërore ("Organizata e Fshehtë").<br>4- Disa prej tyre kishin ndikim nga Beogradi.<br>5- Veprimtari politike deri në kryengritje të armatosur (Kryengritjes e Fierit, Lëvizja e Delvinës). |
| | |

| | |
|---|---|
| Organizata të emigracionit politik. | - KONARE<br>○ U udhëhoq nga Fan Noli.<br>○ Programi përmbante<br>▪ rrëzimin e Zogut,<br>▪ vendosjen e një republike demokratike,<br>▪ zbatimin e reformës agrare<br>▪ një Shqipëri etnike dominohej nga elementë me bindje të majta<br>- "Bashkimi Kombëtar"<br>○ Ishte një organizatë me orientim të djathtë<br>○ synoi rrëzimin e regjimit të Zogut<br>○ shpallja e një republike me orientim perëndimor<br>○ zgjidhjen e çështjes së tokës<br>○ zhvillimin kapitalist të vendit. |
| Lëvizjet sociale në Shqipëri | - lëvizja fshatare kundër pagimit të taksave, sidomos në zonat malore të Shqipërisë. Konflikti i fshatarëve të Goricës (Korçë).<br>- organizata të reja sindikale. Në:<br>○ shtator të vitit 1933 u formua në Korçë shoqëria "Puna", ku u bashkuan punëtorët dhe mjeshtrit e ndërtimit etj.<br>○ në tetor të vitit 1935 u krijua në Kuçovë shoqëria tjetër punëtore "Puna".<br>○ "Demonstrata e Bukës" në Korçë. Ajo mori karakter të përgjithshëm dhe u shtyp me forcë. |

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Njeh format dhe organizatat e ndryshme të opozitës antizogiste.
2. Përshkruan natyrën dhe programet e grupimeve të ndryshme opozitare ndaj monarkisë.
3. Shpjegon ndikimet e huaja në gjirin e opozitës kundër monarkisë dhe mbretit Zog.
4. Analizon zhvillimin e lëvizjeve me natyrë shoqërore dhe ekonomike në periudhën e monarkisë.
5. Tregon qëndrimin e autoriteteve përkundër lëvizjeve dhe opozitës antizogiste.

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime dhe në shfaqjen e mendimit kritik.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

- Mblidhni materiale për lëvizjet e armatosura dhe ato shoqërore-ekonomike në periudhën e Zogut.

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Histori</th><th>Shkolla:</th><th>Klasa: 11</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Veprimtari praktike: Shqiptarët në Jugosllavi dhe Greqi në<br><br>vitet 1925-1941</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br><br>Për nxitur kureshtjen e nxënësve mësuesi/ja organizon ne klasë një veprimtari në formën e një quizi.<br>Nëpërmjet pyetjeve rikujtohen njohuri që nxënësit kanë mësuar në temat e mëparshme ose dhe në klasën e dhjetë si dhe bëhet lidhja e tyre me njohuritë e reja.</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e të menduarit. Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme;<br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>• ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike<br>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin për të identifikuar dhe vlerësuar burimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjes historike.</td><td colspan="2" rowspan="2">Fjalët kyçe:<br><br>- shkombëtarizim<br>- konfiskim<br>- spastrim etnik<br>- Komisioni Miks<br>- Vasa Çubrilloviçi</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</u><br>Nxënësi:<br>➢ evidenton tiparet e politikave diskriminuese të popullsisë shqiptare në Kosovë dhe Çamëri;<br>➢ përcakton format kryesore të mohimit të të drejtave njerëzore dhe etnike të shqiptarëve nga Jugosllavia dhe Greqia<br>➢ vlerëson qëndresën e popullsisë shqiptare në mbrojtje të identitetit dhe interesave të veta kombëtare dhe etnike;<br>➢ gjykon rolin që luajti shteti shqiptar në përkrahjen e popullsisë shqiptare në Kosovë dhe Çamëri.</td></tr>
</table>

| **Burimet:** | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| • hartë e Shqipërisë dhe Ballkanit, interneti, botime të ndryshme, enciklopedi. | - Me gjeografinë<br>- Me temat e mëparshme etj. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** quiz / punë në grupe.

**Organizimi i orës së mësimit**

- Për nxitur kureshtjen e nxënësve mësuesi/ja organizon ne klasë një veprimtari në formën e një quizi.
- Nëpërmjet pyetjeve rikujtohen njohuri që nxënësit kanë mësuar në temat e mëparshme ose në klasën e dhjetë si dhe bëhet lidhja e tyre me njohuritë e reja. Pyetjet që mund të drejtohen:
    - Si ishte i organizuar territori i banuar nga popullsia shqiptare në Ballkan në kuadër të Perandorisë Osmane?
    - Vini në dukje përpjekjet e shqiptarëve për shkëputje nga osmanët dhe ngjarjet kryesore në këtë kuadër.
    - Cilat ishin qëndrimet e shteteve fqinje dhe synimet e tyre ekspansioniste në kurriz të trojeve dhe popullit shqiptar?
    - Shpjegoni disa prej doktrinave me natyrë shoviniste ku mbështeteshin politikat e vendeve fqinje në dëm të shqiptarëve.
    - Në cilat rrethana historike u përcaktua mbetja e Kosovës dhe Çamërisë jashtë kufijve të shtetit shqiptar?
    - Cilat ishin marrëveshjet ndërkombëtare që përcaktuan fatin e popullsisë shqiptare?
    - Përshkruani qëndrimet e Fuqive të Mëdha kundrejt aspiratave shtet-formuese të popullit shqiptar.
    - Cilat ishin ndër figurat kryesore udhëheqëse të shqiptarëve të Kosovës dhe Çamërisë?
    - Evidentoni rolin e shtetit shqiptar në përkrahje të shqiptareve jashtë kufijve, kundër politikave diskriminuese të shteteve fqinje.

- Mësuesi/ja organizon nxënësit në tre grupe dhe i udhëzon të lexojnë duke i caktuar secilit grup nga një çështje të mësimit.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Nga secili prej grupeve një nxënës/e del në tabelë ku shpjegon dhe shkruan informacionin kryesor të pjesës përkatëse, nxënësit e tjerë të grupit plotësojnë ose korrigjojnë shokun.
- Mësuesi/ja ndjek veprimtarinë në klasë duke pasur kujdes që të prezantohen dhe sqarohen të gjitha njohuritë e reja.

***Grupi i parë***

*Thellimi i procesit të shpronësimit, kolonizimit dhe shpërnguljeve në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare*

- popullsia shqiptare nuk kishte asnjë të drejtë kombëtare (nuk pati shkolla shqipe, gazeta apo biblioteka në shqip);
- u thelluan gjithnjë e më shumë proceset e shpronësimit, të kolonizimit dhe të shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi;
- u vendos që të shtrihej konfiskimi në masë i tokës së atyre shqiptarëve, që nuk kishin tapi pronësie jugosllave;
- spastrim etnik i shqiptarëve nëpërmjet shpërnguljes sistematike të shqiptarëve myslimanë në Turqi, me forma të ndryshme të dhunës.

***Grupi i dytë***

*Rezistenca shqiptare* ⇒

- qëndresa e armatosur në Kosovë e vise të tjera vazhdoi edhe pas vrasjes së Azem Bejtes. Kjo qëndresë synonte mbrojtjen, rritjen e moralit të popullit, uljen e shpërnguljeve etj.;
- rezistenca brenda institucioneve nga një grup i deputetëve shqiptarë në parlamentin jugosllav;
- rezistenca ilegale nëpërmjet "Komitetit të Kosovës" në emigracion;
- rezistenca nga grupe të të rinjve të arsimuar në Beograd, Europë që zhvilluan një veprimtari në mbrojtje të të drejtave të popullsisë kosovare.

***Grupi i tretë***

*Situata e popullsisë çame, 1924-1941*

- Traktati i Lozanës për shkëmbimin e popullsive greko-turke;
- Mohim i të drejtave njerëzore dhe etnike:
  - heqje e të drejtës së votës;
  - mohim i të drejtave të të rinjve për të shkuar ushtarë;
  - heqje të të drejtave për të shitur pasuritë e patundshme, si dhe të luajtshme.
  - përdorim i Reformës Agrare për grabitjen e tokave të popullsisë shqiptare
- Mbështetur në ankesat e shqiptarëve çamë, qeveria shqiptare e ngriti disa herë zërin në Lidhjen e Kombeve.

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi /ja:

1. Evidenton format dhe mënyrat e përdorura për diskriminimin dhe mohimin e të drejtave të shqiptarëve në Kosovë dhe Çamëri.
2. Analizon presionin ekonomik për të bërë të pamundur jetën e popullsisë shqiptare në trojet e saja në Jugosllavi dhe Greqi.
3. Tregon format e rezistencës së shqiptarëve ndaj politikave diskriminuese nga ana e autoriteteve dhe shtetit grek e atij jugosllav.
4. Vë në dukje kontributin e shtetit shqiptar në mbështetje të shqiptarëve etnikë jashtë kufijve të tij

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në pjesëmarrjen në orën e mësimit, në bashkëpunimin në grup, në argumentet e paraqitur rreth fakteve që u diskutuan.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

- Krahasoni trajtimin e shqiptarëve në Kosovë e Çamëri duke evidentuar të përbashkëtat dhe të veçantat mes tyre.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkolla: | Klasa: 11 |
|---|---|---|---|
| Tema mësimore: Veprimtari praktike. Gruaja shqiptare në vitet 20-30. | | **Situata e të nxënit:**<br>*Shpallja e Pavarësisë në nëntor 1912 e gjeti gruan shqiptare në një pozitë të vështirë, si në familje dhe në shoqëri. Në këtë gjendje ndikonin shumë faktorë si: prapambetja e thellë ekonomike, shoqërore e kulturore e trashëguar nga sundimi i gjatë otoman; veprimi ende kudo i normave të së drejtës zakonore, që i vinin vajzat dhe gratë në pozita pabarazie ndaj burrit; analfabetizmi masiv në radhët e saj etj. Ajo nuk kishte të drejtë të zgjidhte bashkëshortin e saj dhe të drejtat e saj ishin shumë të kufizuara.*<br>*Përkundër kësaj situate, sidomos duke filluar nga vitet '20 të shek. XX, pati përpjekje nga shteti dhe nga vetë gratë për përmirësimin e gjendjes sidomos në lidhje me arsimimin dhe hartimin dhe zbatimin e ligjeve qe siguronin dhe mbronin të drejtat e grave.* | |

<table>
<tr>
<td>
<u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Nxënësi:<br>
• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>
Kompetenca e të menduarit. Nxënësi:<br>
• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës.<br>
Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>
• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>
Kompetenca qytetare. Nxënësi<br>
• shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore;<br>
Kompetenca digjitale. Nxënësi:<br>
komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet.
</td>
<td rowspan="2">
Fjalët kyçe:<br>
- lëvizje feministe<br>
- të drejtat e grave<br>
- “Sikur të isha djalë”<br>
- shoqëritë e grave
</td>
</tr>
<tr>
<td>
<u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>.<br>
Nxënësi:<br>
➢ Përshkruan situatën ekonomiko-shoqërore të Shqipërisë në vitet ’20-’30 duke u përqendruar te gjendja e gruas shqiptare.<br>
➢ Identifikon faktorët që kushtëzonin statusin e ulët shoqëror dhe juridik të gruas shqiptare që prej formimit të shtetit të pavarur shqiptar.<br>
➢ Evidenton përpjekjet e bëra nga shtetit shqiptar për përmirësimin e situatës shoqërore, arsimore dhe të drejtave të grave duke diferencuar mes veprimtarisë së qeverive të ndryshme në këtë drejtim.<br>
➢ Dallon organizata dhe figura të ndryshme me rol të veçantë në promovimin e të drejtave të grave dhe vajzave ne vitet ’20 – ’30.
</td>
</tr>
</table>

| **Burimet:** | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| • Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme etj. | Me letërsinë<br>Me qytetarinë<br>Me sociologjinë |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** punë individuale finalizuar me tryezë të rrumbullakët. Sugjerohet njohja dhe diskutimi mes nxënësve, në varësi të mundësive, me romanin "Sikur të isha djalë", i autorit Haki Stërmilli si një vepër e kohës mbi tematikën e veprimtarisë praktike.

**Organizimi i orës së mësimit**

- Nxënësit mbledhin paraprakisht informacione lidhur me tematikën e veprimtarisë. Sugjerohet që një pjesë e kërkimit të përqendrohet në faktet historike që lidhen me qytetin e tyre.
- Në klasë zhvillohet një tryezë e rrumbullakët ku diskutohet lidhur me historikun e lëvizjes feministe në Shqipëri në vitet '20 – '30 të shek. XX.

**Ndërtimi i njohurive:**
Mësuesi/ja e organizon orën e mësimit në dy pjesë.
Pjesa I (20 min.) – Organizohet në klasë diskutim rreth librit "Sikur të isha djalë" si një dëshmi autentike e problematikave të kohës lidhur me figurën e gruas në vitet '20 – '30.

Pjesa II (20 min.) - Organizohen diskutim rreth materialeve të grumbulluara nga nxënësit në lidhje me figura të shquara të lëvizjes për të drejtat e grave të periudhës dhe rolin e tyre në promovimin e të drejtave të tyre si në planin legjislativ, ashtu edhe në planin konkret me synim rritjen e rolit të grave në familje dhe shoqëri.

**Pyetje për diskutim**
Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Identifikon figura të rëndësishme me kontribut në promovimin e të drejtave të grave.
2. Analizon problematikën më të cilën përballej femra shqiptare në vitet '20-'30.
3. Vlerëson iniciativat e ndërmarra për afirmimin e të drejtave të grave dhe realizimin e tyre në praktikë.

| |
|---|
| ***Vlerësimi:***<br>*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në realizimin e detyrave, kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime.* |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Shqipëria nën pushtimin gjerman dhe qëndresa shqiptare<br><br>(shtator 1943 – maj 1944) | | **Situata e të nxënit:**<br><br>Për të nxitur kureshtjen e nxënësve lexohet në klasë rubrika “Grimcë historike”.<br>Mësuesi/ja shfaq ne monitor pamje të periudhës së pushtimit gjerman. Shih https://www.youtube.com/watch?v=rd97IxcfC44 | |

<table>
<tr>
<td><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e të menduarit. Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme.<br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>Kompetenca personale. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve qofshin këto dhe të ndryshme nga të tijat.</td>
<td rowspan="2">Fjalët kyçe:<br>- sovranitet relativ<br>- Këshilli i Lartë i Regjencës<br>- Lëvizja e Legalitetit<br>- misionet angleze<br>- kamp përqendrimi<br>- Operacioni i Dimrit</td>
</tr>
<tr>
<td><u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</u><br>Nxënësi:<br>➢ evidenton rrethanat dhe synimet e ardhjes së forcave gjermane në Shqipëri;<br>➢ përcakton qëndrimin gjerman në lidhje me organizimin e brendshëm në Shqipëri dhe në raport me forcat e ndryshme politike këtu;<br>➢ analizon zhvillimet politike në Shqipëri, marrëdhëniet mes forcave politike nacionaliste dhe partizane deri tek përplasjet e armatosura mes tyre;<br>➢ shpjegon ecurinë e Operacionit të Dimrit, pasojat e tij mbi lëvizjen nacionalçlirimtare dhe tejkalimin e tyre.</td>
</tr>
<tr>
<td>Burimet:<br>Libri i nxënësit, hartë e Shqipërisë, internet, botime të ndryshme etj.</td>
<td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>- Me gjeografinë etj.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td>
</tr>
</table>

**Metodologjia:** Brainstorming/ Hartë e konceptit

**Organizimi i orës së mësimit**

- Mësuesi/ja për të nxitur kureshtjen e nxënësve cakton një nxënës që të lexoje rubrikën “Grimcë historike”
- Shfaqet ne monitor pamje të ndryshme që i referohen periudhës së pushtimit gjerman. Shih: https://www.youtube.com/watch?v=rd97IxcfC44.
- Nxiten nxënësit te marrin pjesë në mësim duke i pyetur se ç’dinë rreth ngjarjeve dhe personazheve historike të periudhës shtator 1943 – maj 1944. Mendimet që shfaqin nxënësit shkruhen në tabelë pa i paragjykuar ato.




**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë mësimin duke nënvizuar pjesët kryesore.
- Ndërtohet në tabelë harta e konceptit “pushtim gjerman i Shqipërisë” dhe mësuesi/ja duke drejtuar pyetjet e mëposhtme e plotëson atë.
  - Përse erdhën trupat ushtarake gjermane në Shqipëri?
  - Cili ishte qëndrimi i ushtrisë pushtuese gjermane ndaj Shqipërisë?
  - Dalloni ndryshimet qe solli pushtimi gjerman në krahasim me atë italian? A pati ndonjë të përbashkët mes tyre?
  - Cilat ishin zhvillimet politike në Shqipëri në periudhën e pushtimit gjerman?
  - Shpjegoni qëndrimet e forcave nacionaliste ndaj pushtimit gjerman.
  - Evidentoni raportet mes forcave nacionaliste dhe atyre partizane, nën dritën e prishjes së Marrëveshjes së Mukjes.
  - Cilat ishin pasojat e Operacionit të Dimrit mbi lëvizjen nacionalçlirimtare dhe popullsinë civile?

**Gjermanët në Shqipëri**

***Ardhja e ushtrisë gjermane në Shqipëri:***
- paraprakisht që nga korriku 1943;
- masivisht në shtator 1943.

***Qëllimet:***
- Mbushja e boshllëkut të lënë pas kapitullimit të Italisë;
- Kontrolli i rrugëve të komunikacionit nëpër Shqipëri;
- Sigurimi i bregdetit shqiptar nga ndonjë zbarkim i mundshëm anglo-amerikan.

***Pushtimi gjerman solli:***
- Ndryshime në institucione dhe kuadrin ligjor;
- U manipulua me:
    - konceptin e "Shqipërisë së Madhe";
    - karakterin e "përkohshëm" të prezencës gjermane në Shqipëri;
    - "pavarësinë" e shpallur nën mbrojtjen e ushtrisë gjermane;

***Zhvillimet në skenën politike shqiptare:***
- Krijimi i Legalitetit pas daljes së zogistëve nga FNÇ pas prishjes së Marrëveshjes së Mukjes;
- Qëndrimi i Ballit Kombëtar ndaj pushtuesve gjermanë dhe rrymat e kristalizuara në gjirin e tij;
- Acarimi i raporteve mes nacionalistëve dhe forcave të FNÇ të drejtuar nga PKSh.

***Operacioni i Dimrit:***
- Synonte të eliminonte lëvizjen partizane në Shqipëri;
- Goditje e fortë ndaj UNÇ;
- Terror masiv mbi popullsinë civile;
- Forcat nacionalçlirimtare i mbijetuan operacionit dhe kaluan në kundërmësymje. U forcua pushteti i këshillave nacionalçlirimtare.

- Për të përcaktuar veprimet e Operacionit të Dimrit, punohet me hartën e Shqipërisë.
- Për të nxitur të menduarit kritik të nxënësve, mësuesi/ja shtron pyetjet për diskutim.

- Si u zhvillua armiqësia mes forcave politiko-ushtarake nacionaliste dhe FNÇ nën drejtimin e Partisë Komuniste dhe krahut të saj të armatosur, Ushtrisë Nacionalçlirimtare? Argumentoni mendimin tuaj .
- A mendoni se Operacioni i Dimrit i arriti qëllimet e tij?

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Shpjegon qëllimet e ardhjes së ushtrisë gjermane në Shqipëri dhe pozicionimin e saj ndaj institucioneve dhe popullsisë shqiptare.
2. Identifikon ndryshimet në kuadrin kushtetues dhe institucional me ardhjen e forcave të armatosura gjermane.
3. Evidenton gjeografikisht shtrirjen e veprimeve luftarake të Operacionit të Dimrit dhe pasojat e tij mbi lëvizjen antifashiste në Shqipëri.
4. Analizon marrëdhëniet mes forcave politike në Shqipëri duke evidentuar përkeqësimin e tyre deri në përplasje të armatosur mes tyre.

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime, në aftësinë për të punuar me hartën në shfaqjen e mendimit kritik.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

- Hulumtoni mbi krimet dhe masakrat ndaj popullsisë civile të kryera prej ushtrisë gjermane në zonën tuaj.

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Rritja e lëvizjes antifashiste në Shqipëri (1941-shtator 1943) | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja për të nxitur kureshtjen e nxënësve shfaq në monitor sekuenca mbi Konferencën e Mukjes.<br>https://www.youtube.com/watch?v=f5wkXeimzag<br>Mësuesi/ja nxit kureshtjen e nxënësve duke drejtuar pyetje dhe organizuar diskutimin në klasë. | |
| **<u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u>**<br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi:<br>• përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.<br>**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.** Nxënësi:<br>• diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e të tashmes dhe perspektivat e të ardhmes.<br>**Kompetenca personale.** Nxënësi:<br>• përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij. | | **Fjalët kyçe:**<br>- *zogist*<br>- *nacionalist*<br>- *Komintern*<br>- *Front Antifashist Nacionalçlirimtar*<br>- *këshill nacionalçlirimtar*<br>- *Balli Kombëtar*<br>- *Konferenca e Mukjes* | |

| | |
|---|---|
| **<u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>**.<br>Nxënësi:<br>➢ Evidenton format e rezistencës antifashiste në Shqipëri;<br>➢ Analizon procesin e formimit të forcave politike të organizuara me karakter antifashist.<br>➢ shpjegon të përbashkëtat dhe dallimet mes forcave të ndryshme politike antifashiste në Shqipëri;<br>➢ argumenton arsyet e thirrjes së Konferencës së Mukjes dhe qëndrimin e Partisë Komuniste ndaj saj.<br>➢ vlerëson zhvillimin e lëvizjes antifashiste në Shqipëri në prag te kapitullimit të Italisë fashiste. | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, hartë e Shqipërisë, interneti, enciklopedi etj | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Me gjuhen dhe letërsinë<br>- Me gjeografinë |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim / Lexim dhe mendim i drejtuar.

**Organizimi i orës së mësimit**

- Shfaqet për nxënësit pamjet filmike lidhur me Konferencën e Mukjes.
- Mësuesi/ja nxit kureshtjen e nxënësve duke drejtuar pyetje dhe organizuar diskutimin në klasë.
  - Cilat ishin forcat apo organizatat kryesore politike antifashiste në Shqipëri?
  - Çfarë kishin të përbashkëta dhe të veçanta këto forca politike?
  - A ekzistonte bashkëpunim apo kundërvënie mes forcave të ndryshme antifashiste në Shqipëri në deri në shtator 1943?
  - Cila mendoni se ishte forca më e organizuar politikisht dhe ushtarakisht?
  - Vini në dukje përpjekjet për krijimin e një fronti të përbashkët antifashist.
  - Përse dështuan këto përpjekje?

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë pjesën e pare të mësimit dhe shkruan në tabelë pyetjet që nxënësit duhet t'u përgjigjen pas leximit.
- Pyetjet:
  - Cilat ishin format e shprehjes së ndjenjave antifashiste të popullsisë në fillimet e pushtimit fashist?
  - Me çfarë vështirësish u përballën përpjekjet e mbretit Zog për të dalë në krye të rezistencës së organizuar të shqiptarëve?
  - Cilat ishin rrymat e tjera politike antifashiste dhe cilat ishin përpjekjet e tyre për organizim?

- Përgjigjet e nxënësve mund të shënohen në mënyrë skematike në tabelë.

| | | |
|---|---|---|
| Rezistenca e popullit shqiptar ndaj pushtuesit fashist | shprehej | - Antentati mbi mbretin Viktor Emanueli III nga ana e të riut antifashist Vasil Laçi.<br>- Organizimi i demonstrave dhe formave të tjera të shprehjes së ndjenjave kundër pushtuesit fashist.<br>- Krijimi i çetave të armatosura që kryenin veprime luftarake ndaj forcave italiane. |
| Rrymat kryesore antifashiste | ishin | Zogistët, - u dëmtuan nga mossuksesi i Zogut për organizimin dhe drejtimin e lëvizjes antifashiste<br>Nacionalistët - ishin të paorganizuar mirë.<br>Komunistët – pas sulmit të Gjermanisë naziste ndaj BRSS nisin organizimin e shpejtë dhe efikas. |

- Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë pjesën e dytë të mësimit dhe shkruan në tabelë pyetjet që nxënësit duhet t'u përgjigjen pas leximit.
- Pyetjet:
  - Evidentoni procesin e organizimit të forcave politike antifashiste në Shqipëri?
    - A paraqiste programi i PKSh elemente të doktrinës marksiste. Si u munduan komunistët shqiptarë që të paraqisnin një qasje sa më gjithëpërfshirëse në luftën e armatosur antifashiste?
    - Cili ishte programi i "Ballit Kombëtar" dhe ku mbështetej ai?
- Përgjigjet e nxënësve mund të shënohen në mënyrë skematike në tabelë.

**Rezistenca antifashiste**

**Partia Komuniste e Shqipërisë**

Detyra:
- çlirimi i vendit nga pushtuesit fashistë,
- rivendosja e pavarësisë kombëtare
- ndërtimi i një rendi demokratik.

Rrugët:
- krijimi i një fronti antifashist, (Konferenca e Pezës)
- organizimi i një kryengritjeje të armatosur.

**Balli Kombëtar**
- bënin pjesë nacionalistë të rrymave të ndryshme, me bindje kryesisht republikane, demokratike, antifashiste dhe antikomuniste.
- programi i tij politik, “Dekalogun”: rivendosja e pavarësisë së vendit; vendosja e një regjimi demokratik në vend dhe bashkimi i Kosovës me Shqipërinë.
- përvijuan shpejt dy rryma: njëra për aksione luftarake aktive ndaj pushtuesve dhe tjetra, për një angazhim kundër okupatorit, por “kur të vinte koha”, kur aleatët të zbarkonin në Ballkan.

- Po kështu vazhdohet dhe me pjesën tjetër të mësimit.

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:
1. përshkruan situatën dhe frymën e rezistencës antifashiste në gjirin e popullit shqiptar;
2. shpjegon proceset e krijimit të forcave të ndryshme antifashiste dhe programet e veprimet e tyre konkrete;
3. evidenton zgjerimin e luftës antifashiste dhe konsolidimin e organizatave antifashiste sidomos të FNÇ dhe ushtrisë së tij?
4. analizon vendimet e Konferencës së Mukjes dhe faktorët që ndikuan në hedhjen poshtë të tyre nga Partia Komuniste Shqiptare.

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**
- Mblidhni fakte rreth pikëpamje të ndryshme për rëndësinë e Konferencës së Mukjes dhe ndikimin e mosnjohjes së vendimeve të saj nga P.K.SH. në ecurinë e mëtejshme të situatës në Shqipëri.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Histori</th><th>Shkolla:</th><th>Klasa: 11</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Shqipëria nën pushtimin fashist italian</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br><br>Mësuesi/ja për të nxitur kureshtjen e nxënësve shfaq në monitor sekuenca mbi pushtimin fashist italian në Shqipëri: https://www.youtube.com/watch?v=RTk0tunwtYs</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Nxënësi/ja<br>• përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.<br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi/ja:<br>• parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime.<br>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. Nxënësi/ja:<br>• zhvillon aftësitë për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin për të identifikuar dhe vlerësuar burimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjes historike.<br>Kompetenca personale: Nxënësi/ja:<br>• përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.</td><td colspan="2" rowspan="2">Fjalët kyçe:<br>- bashkim personal<br>- fashistizim i shkollës<br>- trakte<br>- akte sabotimi<br>- Mujo Ulqinaku<br>- internim</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>.<br>Nxënësi/ja:<br>➢ evidenton situatën e marrëdhënieve italo-shqiptare në prag të pushtimit fashist të Shqipërisë;<br>➢ përshkruan përpjekjet e mbretit Zog për gjetjen e një rrugëdalje kundrejt</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| kërkesave të Italisë fashiste.<br>➢ tregon dinamikën e pushtimit dhe rezistencën e shqiptarëve ndaj tij.<br>➢ shpjegon ndryshimet kushtetues, në organizimin shtetëror dhe ekonomi pas pushtimit të Shqipërisë.<br>➢ vë në dukje fillesat e qëndresës së shqiptarëve ndaj pushtimit fashist. | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi, botime të ndryshme. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Me gjeografinë |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim / INSERT

**Organizimi i orës së mësimit**

4. Mësuesi/ja për të nxitur kureshtjen e nxënësve shfaq në monitor sekuenca mbi pushtimin fashist italian të Shqipërisë.

Shih. https://www.youtube.com/watch?v=RTk0tunwtYs.

5. Organizohet në klasë diskutimi lidhur me faktet që nxënësit njohin rreth pushtimit fashist të Shqipërisë dhe tipareve të tij.

**Ndërtimi i njohurive:**

6. Mësuesja udhëzon nxënësit të lexohet mësimi duke i kërkuar te vendosin përbri secilës pjesë të lexuar shenjat të cilat kanë kuptimin e mëposhtëm.

"√" —— vendoset përbri informacionit që për ju është i njohur.
" - " —— vendoset përbri informacionit që ju e dinit ndryshe.
" + " —— vendoset përbri informacionit i cili është i ri për ju.
" ? " —— vendoset përbri informacionit i cili është i paqartë ose doni të dini më shumë.

7. Pas leximit organizohet në klasë bashkëbisedim ku nxënësit krahasojnë shenjat e vendosura dhe diskutojnë rreth fakteve të reja. (Këto veprimtari mund të zhvillohen në 15 - 20 minutat e para të mësimit dhe pjesën tjetër plotësohet tabela nga përgjigjet e nxënësve).

| √ | — | + | ? |
|---|---|---|---|
| - Italia fashiste kishte një ndikim të madh në Shqipërinë e viteve ’20 – ’30.<br><br>- Mbreti Zog nuk mundi ta mbante nën kontroll këtë ndikim.<br><br>- Populli shqiptar përkrahte qëndresën ndaj pushtimit fashist.<br><br>- Rezistenca ndaj pushtimit nuk ishte e organizuar siç duhej.<br><br>- Shqipëria nuk mori përkrahje ndërkombëtare kundër pushtimit fashist.<br><br>- Pas pushtimit, Shqipëria e humbi pavarësinë dhe u kthye në një provincë italiane.<br><br>- Përfaqësuesit italianë kontrollonin të gjitha levat e pushtetit në Shqipërinë e | -Nxënësit mund të kenë informacione të ndryshme lidhur me organizimin e rezistencës ndaj pushtimit fashist.<br><br>-Nxënësit mund të dinë ndryshe dhe informacione të tjera të cilat shënohen nga mësuesja në kolonën përkatëse të tabelës. | - Italia fashiste i drejtoi disa ultimatume mbretit Zog përpara se të niste sulmin. Këto ultimatume përmbanin kërkesa thuajse të pamundura për t’u plotësuar nga ana e tij.<br><br>- Bashkimi i Shqipërisë me Italinë u bë në formën e një “bashkimi personal”, nën kurorën mbretërore të Viktor Emanuelit III.<br><br>- Për shkakun e mësipërm, kur Italia fashiste sulmoi Greqinë, edhe Shqipëria “i shpalli” luftë kësaj të fundit. Shqiptarët e përfshirë në forcat e armatosura italiane dezertuan në masë. | - Informacion shtesë lidhur me kuptimin dhe thelbin real të krijimit të “Shqipërisë së Madhe” nën influencën italiane.<br><br>(Mësuesi mund të përzgjedhë informacione të ndryshme) |

| | | | |
|---|---|---|---|
| pushtuar.<br><br>- Italianët synuan fashistizimin e gjithë jetës së vendit.<br><br>- Që në fillim, pushtimi u kundërshtua nga populli shqiptar në forma të ndryshme.<br><br>(nxënësit mund të kenë dhe informacione të tjera të njohura) | | | |

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Shpjegon rrethanat e krijuara në prag të sulmit italian mbi Shqipërinë.
2. Përshkruan zhvillimin e pushtimit italian dhe organizimin e rezistencës ndaj tij.
3. Evidenton pozicionin e mbretit Zog dhe qeverisë së tij në raport me pushtimin fashist.
3. Tregon ndryshimet institucionale dhe kushtetuese që solli pushtimi italian mbi shtetin shqiptar.
4. Shpjegon rrugët e përdorura prej pushtuesit për të shtrirë parimet dhe politikat fashiste në çdo fushë të jetës në Shqipëri.
6. Identifikon disa prej formave dhe ngjarjeve fillestare të rezistencës shqiptare ndaj pushtimit fashist. .

**Vlerësimi:**

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit në të kuptuarit e fakteve dhe ngjarjeve.*

**Detyrat dhe puna e pavarur**:

- Zhvilloni hulumtime paraprake për të dhënat që vijnë nga burime të ndryshme lidhur me aspekte të jetës së rinisë shqiptare nën regjimin fashist italian.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Historì | Shkolla: | Klasa: 11 |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Çlirimi i vendit dhe pasojat e luftës (maj-nëntor 1944) | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesja e nis orën e mësimit duke bërë një përmbledhje të shkurtër të rrugës së PKSh-së drejt pushtetit. | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**<br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës.<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;<br>trashëgiminë materiale dhe shpirtërore. | | **Fjalët kyçe:**<br>- *Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar*<br>- *Operacioni i Qershorit*<br>- *regjim diktatorial*<br>- *besëlidhje*<br>- *"Deklarata mbi të Drejtat e Qytetarëve"*<br>- *Kongresi i Përmetit* | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**.<br>Nxënësi:<br>➢ Vë në dukje raportin e forcave në Shqipëri në gjysmën e dytë të vitit 1944;<br>➢ Analizon hapat e bëra nga PkSh, nën ombrellën e FNÇ për të konsoliduar pozitat e saj drejt marrjes së pushtetit pas lufte;<br>➢ Shpjegon vendimet e Kongresit të Përmetit dhe Mbledhjes së Beratit dhe rëndësinë e tyre në rrugën e komunistëve drejt pushtetit;<br>➢ Evidenton ecurinë e luftës në muajt e fundit të 1944 deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë. | | | |

| Burimet: | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| • Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme, enciklopedi, hartë e Shqipërisë. | - Me gjeografinë |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Shpjegim /tabela e koncepteve

**Organizimi i orës së mësimit**

- Mësuesja e nis orën e mësimit me një përmbledhje të shkurtër të ngjarjeve kryesore që karakterizojnë rrugën ë PKSh dhe Enver Hoxhës drejt marrjes së pushtetit pas përfundimit të luftës dhe çlirimit të vendit.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin dhe ndërton në tabelë ditarin dypjesësh. Për plotësimin e tij aktivizon nxënës të ndryshëm.

| Fjala /fjalia | Komenti |
|---|---|
| Në pranverën e vitit 1944 kishte nisur të shtrohej më qartë çështja e pushtetit në Shqipërinë e pasluftës. | - Në pranverën e vitit 1944, situata e luftës po shkonte dukshëm në disfavor të Gjermanisë naziste. Në këtë periudhë kishte kuptim të planifikohej e ardhmja e vendit.<br>- Kishte plane të ndryshme të aleatëve anglo-amerikanë për zbarkim në Evropë. Një prej tyre ishte zbarkimi në Ballkan nëpërmjet Shqipërisë.<br>- Raportet mes forcave nacionalçlirimtare dhe atyre nacionaliste ishin përkeqësuar shumë, duke shkuar në armiqësi të hapur.<br>- FNÇ dhe krahu i saj i armatosur kishin konsoliduar pozitat e tyre në aspektin ushtarak, duke treguar aftësi të larta mbijetese (Operacioni i Dimrit) dhe epërsie në organizim ndaj forcave nacionaliste. |
| Hapat kryesore të Partisë Komuniste drejt pushtetit. | o Kongresi i Përmetit:<br>o krijohet Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar (KANÇ), si organi më i lartë legjislativ dhe ekzekutiv;<br>o formohet Komiteti ANÇ, me atributet e një qeverie të përkohshme;<br>o njësohet komanda ushtarake, ndërsa Enver Hoxha u zgjodh komisar politik e komandant i përgjithshëm i Ushtrisë NÇ; |

| | |
|---|---|
| | ○ ndalohet ardhja e mbretit Zogu I në Shqipëri;<br>○ vendoset që forma e regjimit të vendosej pas lufte, me votën popullore; të mos njihej asnjë qeveri tjetër, brenda ose jashtë vendit dhe të rishikoheshin të gjitha marrëveshjet e lidhura më parë me vendet e tjera, deri në anulimin e tyre.<br><br>○ Mbledhja e Beratit<br>○ vendoset shndërrimin e Komitetit ANÇ në qeveri të përkohshme, me E. Hoxhën në krye;<br>○ miratohet "Deklarata mbi të Drejtat e Qytetarëve", e cila parashikonte të drejtën e fjalës, të shtypit, të zgjedhjeve, të drejta të barabarta midis burrit e gruas etj. |
| Veprimet luftarake në Shqipëri në verë-vjeshtën e 1944. | ○ Operacioni i Qershorit (maj-qershor) përfshiu krahas trupave të shumta gjermane dhe forca të xhandarmërisë, formacione të ndryshme balliste etj. Forcat partizane, me gjithë dëmet e humbjet njerëzore, i shkaktuan humbje forcave gjermane;<br>○ kalimi i Divizioni I Sulmues në Veri me objektiv shkatërrimin e forcave balliste, zogiste dhe forca të tjera nacionaliste të përqendruara atje pas disfatës së Operacionit të Qershorit;<br>○ duke filluar nga shtatori i vitit 1944 lufta hyri në fazën përfundimtare për çlirimin e qyteteve dhe të mbarë vendit;<br>○ beteja për çlirimin e Tiranës që zgjati 19 ditë, e mbështetur dhe nga populli i Tiranës, është konsideruar si një nga betejat më të mëdha dhe më të rëndësishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.<br>○ pas mesnatës së 28 nëntorit, në të gdhirë të 29-s, u çlirua Shkodra, që shënoi çlirimin e plotë të Shqipërisë |
| Shqipëria në përfundim të luftës në territorin e saj. | ○ Lufta çlirimtare antifashiste përbën një ngjarje të rëndësishme të historisë kombëtare, si pjesë përbërëse e luftës antifashiste botërore.<br>○ populli shqiptar përballoi në luftë 15 divizione armike, ndërsa në raport me numrin e popullsisë, pësoi humbje të rënda materiale dhe njerëzore. |

- Mësuesi/ja nxit nxënësit në të menduarit kritik duke drejtuar pyetjet:
  - Cili ishte ndikimi i pozicionit të Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore në zhvillimet diplomatike rreth saj në vitet e pasluftës?
  - A u arritën objektivat kryesore të rezistencës shqiptare në Luftën e Dytë Botërore?

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Analizon rrethanat e brendshme dhe të jashtme në Shqipëri në pranverën e vitit 1944.
2. Tregon hapat e ndërmarra në përpjekjet e komunistëve për marrjen e pushtetit pas lufte.
3. Shpjegon raportet mes komunistëve dhe nacionalistëve në muajt e fundit të luftës.

| |
|---|
| 4. Analizon pasojat e luftës si në planin njerëzor e material, ashtu edhe në atë politik. |
| **Vlerësimi:**<br>*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit dhe në të menduarit kritik.* |
| **Detyrat dhe puna e pavarur**:<br>• Hartoni një përmbledhje të ngjarjeve kryesore të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri. |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Veprimtari praktike: Shqiptarët e Kosovës dhe të Çamërisë gjatë Luftës II Botërore. | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja për të nxitur kureshtjen e nxënësve shfaq në monitor sekuenca mbi Çamërinë dhe dëbimin e çamëve pas Luftës së Dytë Botërore:<br>https://www.youtube.com/watch?v=Fpxd9wdwgEI | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**<br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë | | **Fjalët kyçe:**<br>- *çetnikë*<br>- *lëvizje antifashiste*<br>- *PKJ* | |

| | |
|---|---|
| aspekte të së shkuarës.<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>**Kompetenca qytetare.** Nxënësi<br>• shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore. | *- Lidhja e Dytë të Prizrenit*<br>*- parimi i vetëvendosjes*<br>*- spastrim etnik* |
| **<u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>**. Nxënësi:<br>➢ Përshkruan situatën popullsisë shqiptare të Kosovës dhe Çamërisë në prag të Luftës së Dytë Botërore duke u përqendruar te gjendja e të drejtave njerëzore dhe etnike të saj.<br>➢ Evidenton lëvizjet e administratës fashiste dhe naziste për të bërë për vete shqiptarët e trojeve etnike jashtë Shqipërisë<br>➢ Identifikon rrymat dhe e ndryshëm politikë në gjirin e shqiptarëve të Kosovës dhe Çamërisë.<br>➢ Shpjegon organizimin dhe shtrirjen e luftës antifashiste në territorin e Kosovës dhe Çamërisë duke krahasuar të përbashkëtat dhe të veçantat e kësaj lëvizje.<br>➢ Vë në dukje marrëdhëniet e lëvizjes antifashiste në Kosovë dhe Çaméri me atë në Shqipëri dhe influenca e kësaj të fundit mbi zhvillimet atje. | |
| **Burimet:** Interneti, botime mbi Kosovën dhe Çamërinë në Luftën e Dytë Botërore si p.sh: "Ç'po bëhet me çështjen çame" - Miranda Vickers, "Kosova në Luftën e dytë botërore (1941-1945) – Muhamet Shatri, teksti mësimor etj.<br>Shih: https://www.youtube.com/watch?v=Fpxd9wdwgEI | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Me gjeografinë<br>- Me letërsinë<br>etj. |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | |

**Metodologjia:** punë hulumtuese në grup, diskutim në klasë.

**Organizimi i orës së mësimit**

- Mësuesja/si e ndan klasën në dy grupe që përqendrohen respektivisht në analizën e gjendjes dhe zhvillimeve gjatë Luftës së Dytë Botërore në Kosovë dhe Çamëri, si dhe në pasqyrimin e tyre deri në ditët tona.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesja/si mund të sugjerojë disa pika orientuese si ndihmë për nxënësit në punën e tyre hulumtuese:
  - Shqiptarët e Kosovës dhe të Çamërisë nën shtypjen dhe persekutimin etnik nga monarkitë jugosllave dhe greke në prag të shpërthimit të Luftës së Dytë Botërore.
  - Shpallja e bashkimit të pjesës më të madhe të trojeve shqiptare në Jugosllavi me shtetin shqiptar, nën kuadrin e pushtimit fashist, si mënyrë për të fituar mbështetjen e popullsisë shqiptare në këto vite.
  - Organizimi i lëvizjes antifashiste, vështirësitë dhe veçoritë e saj në trojet shqiptare në Jugosllavi dhe në Çamëri.
  - Zgjerimi i qëndresës antifashiste, intensifikimi i kontakteve dhe bashkëpunimit me lëvizjen antifashiste në Shqipëri. Marrëdhëniet me organizatat e rezistencës në Jugosllavi dhe Greqi.
  - Konferenca e Bujanit dhe rëndësia e vendimeve të saj.
  - Paslufta në Kosovë dhe Çamëri, përndjekja dhe dëbimi kolektiv i çamëve dhe vendosja e regjimit ushtarak në Kosovë si paralajmërim i ditëve të errëta për shqiptarët jashtë kufijve të Shqipërisë.

- Nxënësit prezantojnë materialin e përgatitur prej tyre sipas orientimeve të dhëna nga mësuesi/ja.

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Evidenton situatën ku e gjeti Lufta e Dytë Botërore, popullsinë shqiptare në Kosovë e Çamëri.
2. Përshkruan gjendjen e krijuar në Kosovë dhe viset e tjera të banuara nga shqiptarët jashtë kufijve të Shqipërisë.
3. Analizon veçoritë e lëvizjeve antifashiste në Kosovë e Çamëri.
4. Shpjegon procesin e dëbimit të popullsisë çame pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në punën hulumtuese, aftësinë për të përzgjedhur burimet e informacionit, në prezantimin e materialit të përgatitur si dhe në pjesëmarrjen në diskutim dhe të menduarit kritik.*

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Vendosja e regjimit komunist | | Situata e të nxënit:<br>*“Për të zhvilluar inisiativën e masave punonjëse në fushën e organizimit dhe aktivitetin e tyre politik, shteti u siguron shtetasve të drejtën që të bashkohen në organizata shoqërore:.., kooperativa, organizata sportive, shoqata kulturore, etj. Shtetasit më aktivë dhe më të ndërgjegjshëm të klasës punëtore dhe të masave të tjera punonjëse bashkohen në Partinë e Punës së Shqipërisë, pararoja e organizuar e klasës punëtore dhe…masave të tjera punonjëse në luftën e tyre për ndërtimin e bazave të socializmit dhe bërthama udhëheqëse e të gjitha organizatave të punonjësve, si shoqërore, ashtu dhe shtetërore. ”*<br>Kushtetuta e RP Shqipërisë, Neni 21.<br><br>Mësuesi/ja nxit kureshtjen e nxënësve duke drejtuar pyetje dhe organizuar punën në grupe në klasë. | |
| **<u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u>**<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme.<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi:<br>• ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.<br>**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin për të identifikuar dhe vlerësuar burimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjes historike. | | **Fjalët kyçe:**<br>- *ekonomi të centralizuar*<br>- *luftë e klasave*<br>- *Republikë Popullore*<br>- *punë vullnetare*<br>- *Reformë Agrare*<br>- *tatim i jashtëzakonshëm mbi fitimet e luftës* | |

| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. | |
|---|---|
| Nxënësi:<br>➢ vë në dukje hapat që u hodhën për vendosjen e sistemit njëpartiak socialist pas Luftës së Dytë Botërore;<br>➢ gjykon mbi alternativat politike për zhvillimin politiko-ekonomik të Shqipërisë.<br>➢ përcakton institucionet kryesore të shtetit komunist;<br>➢ analizon tiparet ekonomike të shtetit socialist dhe evidenton reformat fillestare në fushën e ekonomisë. | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme, enciklopedi. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Me gjeografinë<br>- Me temat e mëparshme etj. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** shpjegim / punë në grupe.

**Organizimi i orës së mësimit**

- Lexohet në klasë pjesa "Grimca Historike" dhe diskutohet rreth njohurive që nxënësit kanë nga klasat e kaluara mbi parimet e organizimit politik dhe ekonomik të regjimeve komuniste.
- Mësuesja udhëzon nxënësit dhe ndërkohë ndërton në tabelë hartën e konceptit "vendosja e regjimit komunist".
- Shpjegimi i mësimit realizohet nga mësuesi duke e ndërthurur me pyetje të cilat u drejtohen nxënësve.
- Mësuesi/ja organizon nxënësit në tre grupe dhe i udhëzon të lexojnë, duke i caktuar secilit grup nga një çështje të mësimit.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Nga secili prej grupeve një nxënës/e del në tabelë ku shpjegon dhe shkruan informacionin kryesor të pjesës përkatëse, nxënësit e tjerë të grupit plotësojnë ose korrigjojnë shokun.
- Mësuesi/ja ndjek veprimtarinë në klasë duke pasur kujdes që të prezantohen dhe sqarohen të gjitha njohuritë e reja.

*Grupi i parë*: Alternativa socialiste

Pritshmëritë nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare

- çlirimi i vendit;
- vendosja e një regjimi demokratik;

PKSH i imponoi Shqipërisë rrugën socialiste të zhvillimit:

- shtet njëpartiak diktatorial;
- ekonomi e centralizuar;
- industrializimi dhe kolektivizmi socialist;
- prona shoqërore dhe përjashtimi i pronës private dhe tregun e lirë;

Platforma politike demokratike si alternativë e asaj socialiste, mbështetur në zhvillimin e Shqipërisë sipas modelit të demokracive perëndimore. U godit ashpër prej PKSh.

Rruga socialiste u bë publike në Kongresin I të PK (nëntor 1948) ku u ndryshua emri i saj në Parti e Punës e Shqipërisë (PPSh). Në fillim të viteve '50 u sanksionua në Kushtetutë roli i PKSh si forcë e vetme drejtuese e vendit, kurse luftën e klasave e konsideroi si forcë lëvizëse të shoqërisë.

*Grupi i dytë:* Vendosja e pushtetit popullor

Pas përfundimit të Luftës Antifashiste nacionalçlirimtare shtroheshin për zgjidhje disa detyra kryesore:
- përcaktimi i formës se regjimit;
- ngritja e organeve të reja të pushtetit;
- ndërmarrja e reformave ekonomike;

Rruga ligjore:

- 2 dhjetor 1945, u zhvilluan zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese që u fituan nga Fronti Demokratik, me rreth 93% të vendeve;
- 11 janar 1946 Asambleja Kushtetuese e shpalli Shqipërinë, Republikë Popullore.
- Kushtetuta sanksionoi regjimin republikan të qeverisjes që buronte nga populli dhe i përkiste popullit, për këtë arsye u quajt pushtet popullor.

Bazat e shtetit të ri:

- Rolin e organit përfaqësues e luante Kuvendi Popullor (Parlamenti);
- Bazën ekonomike të shtetit e përbënte prona shtetërore;
- Shteti e drejtonte ekonominë me plan unik;
- Formalisht, Kushtetuta njihte edhe të drejtat e liritë e shtetasve:

*Grupi i tretë:* Tranzicioni socialist në ekonomi

Situata ekonomike e pasluftës:
- krizë të thellë ekonomike;
- jetë ekonomike e paralizuar.
- populli kërcënohej nga kriza e urisë;

Detyra emergjente të pasluftës:
- rindërtimi i ekonomisë së shkatërruar nga lufta;
- u bazua tek puna vullnetare;
- gradualisht u vunë në shfrytëzim, burimet vajgurore, kantieret e ndërtimit etj.;
- filloi riparimi i shtëpive, urave, objekteve industriale etj.;
- një rol të madh në rindërtim, dha UNRRA;

Reformat e para ekonomike:
- u hartua një kuadër i plotë ligjor për të vënë nën kontroll shoqëritë sipërmarrëse;
- u vendos monopoli i shtetit mbi tregtinë e jashtme dhe tregun e drithërave;
- u rekuizuan, e më vonë u shtetëzuan pa shpërblim mjetet private të transportit;
- mbi tregtarët e mëdhenj u vendos një tatim i jashtëzakonshëm mbi fitimet e luftës;
- në fshat u zbatua Reforma Agrare që shpronësoi pa shpërblim pronarët e mëdhenj, entet fetare, çifligjet, ndërtesat, kafshët e punës. Kjo e fundit konsiderohej si një masë e përkohshme pasi zgjidhja e çështjes agrare shikohej nëpërmjet kolektivizimit socialist.

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi /ja:
1. Evidenton pritshmëritë kryesore të pasluftës në Shqipëri.
2. Analizon tiparet e sistemit politik që u vendos në Shqipëri pas Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.
3. Shpjegon procesin e krijimit të institucioneve të shtetit komunist.
4. Evidenton parimet e sistemit socialist në ekonomi dhe procesin e tranzicionit.
5. Vë në dukje qëndrimin e PKSh ndaj mendimit alternativ opozitar duke filluar menjëherë pas përfundimit të luftës.

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në pjesëmarrjen në orën e mësimit, në bashkëpunimin në grup, në argumentet e paraqitur rreth fakteve që u diskutuan.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**
- Hulumtoni rreth sekuestrimeve të kryera nga pushteti menjëherë pas luftës në qytetin tuaj dhe pasojat e tyre.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Histori</th><th>Shkolla:</th><th>Klasa: 11</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Ekonomia socialiste dhe tiparet e saj</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë rubrikën “Grimcë historike”<br>“Planifikimi ishte thellësisht i centralizuar dhe ekonomia rreptësisht e kontrolluar. Çdo dyqan, fabrikë, kooperativë, bankë dhe profesion ishte pronë e shtetit. Çdo doktor, avokat, mësues dhe artist ashtu sikurse çdo kasap, bukëpjekës, zgjidhej, përgatitej dhe punësohej nga shteti, si edhe duhet të jepte llogari para tij. Pagat e tyre caktoheshin nga shteti, Të gjitha të ardhurat e punës së tyre i kalonin shteti”. Edwin Jacques, Shqiptarët,<br>Gjithashtu rekomandohet nga interneti:<br>https://www.youtube.com/watch?v=ymwTKpAIScA<br>(min. 18 – 21)<br>Nxiten nxënësit në diskutim nëpërmjet pyetjeve të ndryshme.</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e të menduarit. Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme.<br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>Kompetenca personale. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve qofshin këto dhe të ndryshme nga të tijat.<br>Kompetenca qytetare. Nxënësi:<br>• shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>- shtetëzim i pronës private<br>- centralizim shtetëror i ekonomisë<br>- plane pesëvjeçare<br>- kulak<br>- kolektivizim i bujqësisë<br>- kooperativë bujqësore<br>- Komisioni i Planit të Shtetit</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td><u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</u><br>Nxënësi:<br>➢ evidenton hapat e para të hedhura në drejtim të vendosjes së themeleve të ekonomisë socialiste;<br>➢ analizon qëndrimin e shtetit komunist ndaj pronës private;<br>➢ shpjegon orientimet kryesore të politikës ekonomike të shtetit komunist;<br>➢ analizon ecurinë e fshatit gjatë regjimit komunist dhe argumenton aspektet pozitive dhe negative të procesit të kolektivizimit.</td><td></td></tr>
<tr><td>Burimet:<br>• Libri i nxënësit, botime të ndryshme, internet.</td><td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>- Me gjeografinë<br>- Me ekonominë</td></tr>
<tr><td colspan="2" align="center">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td colspan="2">Metodologjia: Diskutim / pyetje –përgjigje /hartë e mendjes<br><br>Organizimi i orës së mësimit<br>Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë rubrikën “Grimcë historike” dhe materiale nga interneti:<br>https://www.youtube.com/watch?v=ymwTKpAIScA (min. 18 – 21)<br>• Nxiten nxënësit në diskutim nëpërmjet pyetjeve të ndryshme si p.sh:<br>- Cili ishte niveli i zhvillimit ekonomik të Shqipërisë së paraluftës?<br>- Cilat ishin pasojat kryesore të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri?<br>- A lejohej prona private në Shqipëri dhe në çfarë shkalle?<br>- Cilat janë disa prej veprave kryesore industriale të ndërtuara në Shqipëri gjatë periudhës komuniste?<br>- Si e siguronin jetesën fshatarët gjatë periudhës komuniste?<br><br>Ndërtimi i njohurive:<br>• Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin rreth 10 minuta dhe ndërkohë shkruan në tabelë pyetjet të cilave nxënësit do t’u përgjigjen lidhur me informacionin e ri p.sh:<br>- Cilat ishin bazat ekonomike të Shqipërisë në vitin 1945?<br>- Ku mbështetej shteti komunist nga pikëpamja e pronës?<br>- Cili ishte qëndrimi i regjimit ndaj investimeve të huaja?</td></tr>
</table>

- A mendoni se procesi i zhvillimit të industrisë së rëndë ishte i përshtatshëm për zhvillimin e Shqipërisë?
- Cili ishte vendi i bujqësisë në strukturën ekonomike të Shqipërisë socialiste?
- A mendoni se Reforma Agrare e vitit 1946 ishte një politikë afatgjatë apo thjeshtë një masë e përkohshme?
- Cili ishte kuptimi i planeve pesëvjeçare dhe drejtimit të centralizuar të ekonomisë socialiste?

• Pasi nxënësit u përgjigjen pyetjeve, mësuesi/ja bën një përsëritje të koncepteve duke ndërtuar skemën në tabelë.

Ekonomia socilaliste

**Qëndrimi ndaj pronës**
- kundër pronës private për arsye ideologjike (element kapitalist);
- kundër investimeve të huaja nga ana e kapitalit privat e shtetëror.
- baza e pronës është ajo shtetërore;

**Fshati socialist**
- reforma agrare si hap i përkohshëm;
- kolektivizimi i bujqësisë si zgjedhje strategjike për zhvillimin e bujqësisë;
- modelet e zbatuara në procesin e kolektivizimit;
- rrugët e ndjekura në këtë proces;

**Organizimi ekonomik**
- industria e rëndë si bazë e zhvillimit të ekonomisë;
- drejtimi nëpërmjet planifikimit të centralizuar;
- shteti përcakton zhvillimin e degëve të ekonomisë;
- planet 5-vjeçare;
- aspektet pozitive dhe negative të industrializimit.

Modeli i ekonomisë së centralizuar
- vendimmarrje qendrore për ekonominë;
- planifikim i thellë në nivel makro dhe mikro-ekonomik;
- eleminim thuajse i plotë me iniciativës private në ekonomi;

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Evidenton drejtimet kryesore të zhvillimit të ekonomisë socialiste.
2. Analizon thelbin e drejtimit të ekonomisë në mënyrë të centralizuar.

3. Tregon qëndrimin e shtetit komunist ndaj pronës private në qytet dhe fshat.
4. Argumenton, sipas mendimit të tij, arritjet dhe të metat e ekonomisë së planifikuar dhe centralizuar.

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime, dhe në shfaqjen e mendimit kritik.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

- Hulumtoni shprehje dhe koncepte të ekonomisë socialiste nëpërmjet familjarëve apo të afërmve tuaj.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Histori</th><th>Shkolla:</th><th>Klasa: 11</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Opozita shqiptare ndaj vendosjes së regjimit komunist</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Mësuesi/ja lexon pjesën “Grimcë historike”dhe, për të nxitur mendimin dhe reflektimin e nxënësve, shfaq sekuenca nga vido e mëposhtme: https://www.youtube.com/watch?v=9Ez6hqU7hog</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>Kompetenca e të menduarit. Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>- punë e detyruar<br>- konfiskim i pasurisë<br>- kryengritja e Postribës<br>- opozita politike<br>- emigracion politik<br>- Komiteti Kombëtar “Shqipëria e Lirë”</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.</td><td rowspan="2"></td></tr>
<tr><td><u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>.<br>Nxënësi:<br>➢ përcakton tipologjinë e ndryshme të opozitës kundër regjimit komunist;<br>➢ shpjegon lëvizjet kryesore të armatosura antikomuniste;<br>➢ analizon konceptin “luftë e klasave” dhe zbatimin e tij në terrenin shqiptar;<br>➢ vlerëson natyrën e përplasjeve brenda regjimit komunist dhe ndikimin e tyre në zhvillimet politike në Shqipëri.</td></tr>
<tr><td>Burimet:<br>• Libri i nxënësit, interneti, botime të tjera.</td><td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>- Me qytetarinë<br>- Me gjeografinë etj.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

**Metodologjia:** Shpjegim/hartë e konceptit

**Organizimi i orës së mësimit**

- Lexohet në klasë pjesa “Grimca Historike” dhe, më pas, shfaqen edhe sekuenca nda filmime sipas linkut të mëposhtëm. Në vazhdim, diskutohet rreth njohurive që nxënësit kanë lidhur me rezistencën e kryer nga grupime të ndryshme kundër regjimit komunist.

https://www.youtube.com/watch?v=9Ez6hqU7hog

- Mësuesja udhëzon nxënësit dhe ndërkohë ndërton në tabelë hartën e konceptit “rezistencë antikomuniste”.
- Shpjegimi i mësimit realizohet nga mësuesi duke e ndërthurur me pyetje të cilat u drejtohen nxënësve.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Shpjegimi i mësimit realizohet nga mësuesi, duke e ndërthurur me pyetje të cilat u drejtohen nxënësve, si p.sh:
  - Si u vendos regjimi komunist në Shqipëri?
  - Cilat ishin tiparet kryesore të tij në fushën politike?
  - Po në atë ekonomike?
  - Cili ishte qëndrimi i pushtetit komunist kundrejt kundërshtarëve të tij politikë dhe mendimit ndryshe në përgjithësi?

- Ku u mbështet shteti komunist në procesin e konsolidimit të tij?
- Si do ta përshkruanit fillimet e procesit të tranzicionit drejt ekonomisë së tipit socialist?

**Rezistencë antikomuniste**

Tipologjia e rezistencës antikomuniste në Shqipëri:
- Kundërshtarët e regjimit;
- Shtresat shoqërore të prekura nga reformat;

Opozita politike brenda Frontit;
Lëvizja e armatosur kundër regjimit;
Spastrimet në gjirin e regjimit komunist;
Veprimtaria e emigracionit politik.

Rezistenca e armatosur:
- E përqendruar në zonat e Shqipërisë veriore;
- Kryengritja e Koplikut;
- Kryengritja e Postribës
- Represion i vendosur i regjimit komunist;

Grupi i deputetëve të Asamblesë Kushtetuese
- Figura të lidhura me lëvizjen antifashiste;
- Opozitë politike;
- Likujduar menjëherë nga regjimi komunist;

Lufta politike brenda gjirit të Partisë Komuniste:
- Individë me prirje më liberale se vija e partisë;
- Ndikimi i Kongresit XX të PK BS – Konferenca e Tiranës;
- Grupet e ndryshme në gjirin e Partisë Komuniste – jo opozitë reale ndaj regjimit.

Përpjekjet e emigracionit politik
- krijimi i komitetit "Shqipëria e Lirë".
- nuk patën sukses për shkak të kontrollit të plotë komunist ne vend.

**Pyetje për diskutim**
Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:
1. Identifikon format kryesore të rezistencës antikomuniste dhe grupet kryesore.
2. Rendit disa prej ngjarjeve të rëndësishme të rezistencës antikomuniste dhe disa prej figurave të rëndësishme të saj.
3. Shpjegon domethënien e luftës politike në gjirin e regjimit komunist.
4. Analizon zhvillimet në gjirin e emigracionit politik antikomunist dhe përpjekjet e tij për ndryshimin e gjendjes politike në Shqipëri.

**Vlerësimi:**
*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit.*

**Detyrat dhe puna e pavarur**:
- Hulumtoni dhe sillni në klasë informacion rreth ngjarjeve apo figurave të rezistencës antikomuniste gjatë viteve 1945-1990.

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Histori</th><th>Shkolla:</th><th>Klasa: 11</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Arsimi, kultura, shkenca, artet</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë rubrikën “Grimcë historike”:<br>Gjatë epokës 40-vjeçare të Hoxhës, analfabetizmi u zhduk plotësisht. Shqipëria kishte arritur të nxirrte një numër të madh kuadrosh teknikë, të cilët ishin në gjendje të drejtonin çdo aspekt të jetës... Në vitin 1965 kishte 56.000 specialistë të lartë. Femrat përbënin 47 % të numrit të studentëve dhe mbi 32% të specialistëve të lartë. Ishte mahnitës fakti që 1/3 e popullsisë shqiptare ishte e angazhuar në njërin apo tjetrin cikël shkollor. Ky sistem i gjerë arsimor u sigurohej studentëve falas nga shteti.<br>Edwin Jacques, Shqiptarët, f. 589<br>Nxiten nxënësit në diskutim nëpërmjet pyetjeve të ndryshme.</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>Kompetenca personale. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve qofshin këto dhe të ndryshme nga të tijat.<br>Kompetenca qytetare. Nxënësi:<br>• shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore.</td><td colspan="2" rowspan="2">Fjalët kyçe:<br>- analfabetizëm<br>- arsim laik<br>- bosht ideologjik<br>- realizmi socialist<br>- censurë<br>- Lidhja e Shkrimtarëve<br>- njesimi i gjuhës shqipe</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</u><br>Nxënësi:<br>➢ tregon përpjekjet për vendosjen e bazave të sistemit arsimor dhe përhapjen e shpejtë të tij;<br>➢ shpjegon tiparet e sistemit arsimor në Shqipëri pas vitit 1945;<br>➢ evidenton themelimin dhe hapat e bërë nga arsimi i lartë në Shqipëri;<br>➢ vë në dukje arritjet në fushën e letërsisë dhe shpjegon konceptin “realizëm socialist”.</td></tr>
</table>

| **Burimet:** | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| • Libri i nxënësit, botime të ndryshme, internet etj. | - Me gjeografinë<br>- Me letërsinë |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim / pyetje –përgjigje

**Organizimi i orës së mësimit**

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë rubrikën "Grimcë historike":

*Gjatë epokës 40-vjeçare të Hoxhës, analfabetizmi u zhduk plotësisht. Shqipëria kishte arritur të nxirrte një numër të madh kuadrosh teknikë, të cilët ishin në gjendje të drejtonin çdo aspekt të jetës... Në vitin 1965 kishte 56. 000 specialistë të lartë. Femrat përbënin 47 % të numrit të studentëve dhe mbi 32% të specialistëve të lartë. Ishte mahnitës fakti që 1/3 e popullsisë shqiptare ishte e angazhuar në njërin apo tjetrin cikël shkollor. Ky sistem i gjerë arsimor u sigurohej studentëve falas nga shteti.*

**Edwin *Jacques, Shqiptarët, f. 589***

Nxiten nxënësit në diskutim nëpërmjet pyetjeve të ndryshme si p.sh.:

- Cila ishte situata e arsimit në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore?
- A e dini sa ishte niveli i analfabetizmit në Shqipëri deri në vitin 1945?
- Vini në dukje gjendjen e shërbimit shëndetësor në Shqipërinë e paraluftës.
- A mund të listoni disa prej veprave më të njohura letrare të periudhës mes dy luftërave?

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin, duke i ndarë në grupe sipas pjesëve kryesore të mësimit.
- Secili prej grupeve cakton një ose dy përfaqësues për të ndërtuar në tabelë një skicë përmbledhëse.
- Punohet në mënyrë të tillë që puna e secilit grup të ruhet në tabelë me qëllim që pas përfundimit të përsëritet edhe një herë informacioni nga nxënësit.

## Arsimi

**Sistemi parauniversitar**

- problem kryesor në fushën e arsimit ishte analfabetizmi, që përfshinte 80% të popullsisë;
- kurse kundër analfabetizmit;
- gusht 1946, ligji për Reformën Arsimore, shpalli karakterin laik, shtetëror dhe unik të arsimit; arsimin 7-vjeçar të detyruar.
- Progres njohu edhe arsimi i mesëm i përgjithshëm dhe tekniko-profesional;
- Zhvillimi i arsimit u shoqërua me ngritjen e nivelit të mësimdhënies;
- në viteve “60, qeveria shpalli reformë të re arsimore, e cila theksoi përmbajtjen klasore të shkollës;
- boshti ideologjik dhe përbëhej nga tre komponentë: mësim - punë prodhuese - edukim fizik e

**Sistemi universitar**

- për herë të parë në Shqipëri lindi dhe sistemi i arsimit të lartë.
- në vitin 1957 u themelua Universiteti Shtetëror i Tiranës për përgatitjen specialisteve të lartë;
- mori zhvillim dhe kërkimi shkencor;
- Në vitet ’60 u shënuan arritjet e para studimore. Në fusha të ndryshme: shkenca shoqërore, njësimi i gjuhës letrare shqipe, albanologji, në fushën e shkencave teknike (hidrocentralet, harta gjeologjike dhe zbulimi shtresa të reja minerarë të dobishme);
- Ngjarja më e rëndësishme në fushën e kërkimit shkencor, ishte krijimi i Akademisë së Shkencave (tetor 1972);

## Letërsia dhe artet

- masa për gjallërimin e jetës kulturore:
  - u krijuan disa trupa artistike;
  - u çelën shkolla artistike dhe shtëpi kulture;
  - u gjallëruan shtypi, bibliotekat, kinematë, etj.;
- në vitin 1945 u formua Lidhja e Shkrimtarëve;
- duke filluar nga gjysma e dytë e viteve 50, letërsia njohu zhvillime të vrullshme;
- Arritje cilësore shënoi skulptura, arti skenik dhe ai figurativ, simfonia, kinematografia dhe sidomos baleti.
- metoda e realizmit socialist, censura, ndëshkimi i shkrimtarëve modernist etj.;
- Organet partiake shpallën përparësi kërkesën për letërsi e art të partishëm.

## Shëndetësia

- u ngritën dhe u kompletuan e institucionet shëndetësore si: ambulanca, spitale, qendra të kujdesit të nënës e fëmijës.
- ofrohej shërbim dhe mjekim falas;
- u nxit rritja e lindshmërisë së fëmijëve;
- detyrë emergjente ishte lufta kundër turbekulozit e malaries:
  - u ngritën qendra diagnostikimi në zonat më të prekura;
  - filloi puna për tharjen e kënetave e moçaleve që shërbenin si epiqendra infeksioni.
- Një kujdes i posaçëm iu kushtua edhe sistemit të sigurimit në punë.

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Evidenton politikat arsimore dhe punën për përhapjen e arsimit në periudhën komuniste.
2. Identifikon disa nga hapat kryesore të ndërmarra në fushën e arsimit dhe shkencës.
3. Përshkruan masat për gjallërimin e jetës kulturore pas luftës.
4. Shpjegojnë procesin e politizimit të letërsisë gjatë komunizmit.
5. Analizon masat e marra në kudër të krijimit she shtrirjes së sistemit shëndetësor dhe të sigurimeve shoqërore në Shqipëri.

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime,*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

- Hartoni një ese të shkurtër mbi figura të njohura të arsimit dhe shkencës në Shqipëri pas Luftës së dytë Botërore dhe kontributin e tyre.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkolla:</td><td>Klasa: 11</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Mësuesja për të nxitur kureshtjen e nxënësve, shfaq sekuenca materialesh filmike që trajtojnë tematikën e orës së mësimit si p.sh:<br>https://www.youtube.com/watch?v=71qf-mFxDaw<br><br>https://www.youtube.com/watch?v=ed1SsJnJdqg<br><br>Më pas, mësuesja drejton pyetje për nxënësit.</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>Kompetenca personale. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit.<br>Kompetenca qytetare. Nxënësi:<br>• shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore.</td><td colspan="2" rowspan="2">Fjalët kyçe:<br>- Incidenti i Kanalit të Korfuzit<br>- Konventa Ekonomike<br>- njohja e qeverisë shqiptare<br>- KNER<br>- konflikti sovjeto - jugosllav<br>- marrëdhënie diplomatike<br>- Mbledhja e 81 partive në Moskë</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</u><br>Nxënësi:<br>➢ analizon pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore;<br>➢ shpjegon procesin e integrimit të Shqipërisë në Bllokun e vendeve socialiste;<br>➢ vlerëson marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike dhe arsyet e prishjes së tyre;<br>➢ vë në dukje thelbin e marrëdhënieve shqiptaro-kineze dhe dimensionin ideologjik në prishjen e tyre;</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| ➢ evidenton tiparet e politikës së jashtme të shtetit komunist pas shkëputjes nga aleanca me Kinën komuniste. | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi, botime të ndryshme. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Me gjeografinë<br>- Me ekonominë<br>- Me letërsinë |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim / pyetje –përgjigje

**Organizimi i orës së mësimit**

- Lexohet në klasë rubrika "Grimca historike"
- Shfaqet në projektor pjesë të cilat përzgjidhen nga mësuesja nga dokumentarët e mëposhtëm. Shih :

https: //www. youtube. com/watch?v=71qf-mFxDaw
https: //www. youtube. com/watch?v=ed1SsJnJdqg

- Mësuesi/ja organizon diskutimin në klasë, duke i nxitur nxënësit të marrin pjesë nëpërmjet pyetjeve:

- Cilat ishin marrëdhëniet e drejtuesve komuniste me misionet aleate gjatë luftës?
- Si u zhvilluan këto marrëdhënie në përfundim të luftës?
- Cilat ishin detyrat kryesore që shtroheshin para politikës së jashtme të Shqipërisë menjëherë pas lufte?
- A kishte një orientim pak a shumë të qartë politika e shtetit komunist në lidhje me marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë?

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin, duke i ndarë në dy grupe sipas pjesëve kryesore të mësimit. Nxënësit sipas grupeve organizohen për të prezantuar mësimin në tabelë, duke ndarë pjesë të ndryshme sipas problemeve të trajtuara në pjesën përkatëse. Ndarjen brenda grupit mund ta organizojë dhe mësuesja sipas skemës së mëposhtme:

*Grupi i parë*: Politika e jashtme dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë nga paslufta deri në vitet '60.

**Periudha menjëherë pas pas luftës** ⇒

- BS dhe vendet aleate si dhe Franca e njohën qeverinë e E. Hoxhës;
- SHBA dhe Anglia e kushtëzuan njohjen me zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945;
- Incidenti i Korfuzit, 22 janar 1946. SHBA e Anglia hoqën dore nga njohja, duke tërhequr dhe misionet e tyre diplomatike;
- Konferenca e Paqes në Paris korrik 1946 për nënshkrimin e Traktatit të Paqes me Italinë;
- Shqipëria mori pjesë në Konferencë, por jo me të drejta të barabarta si shtetet e tjera;
- Fitoi dëmshpërblime në masën 5 milionë dollarë;
- Më 20 shtator 1955, Asambleja e Përgjithshme vendosi pranimin e saj në OKB;
- Anëtarësimi në OKB pati rëndësi të madhe, për pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë.

**Shqipëria si pjesë e Bllokut të Vendeve socialiste** ⇒

- në politikën e jashtme prioritet marrëdhëniet me Bllokun Lindor;
- forcim i bashkëpunimi me Jugosllavinë;
    - Konventa Ekonomike e nënshkruar nga dy palët (nëntor 1946), parashikonte koordinimin e planeve ekonomike, bashkimin doganor dhe njësimin e monedhës.
- Pas vitit 1948, Shqipëria vendosi marrëdhënie partneriteti me vendet e Bllokut Lindor;
- Me këto vende ajo nënshkroi disa marrëveshje në kuadër të Këshillit të Ndihmës Ekonomike e Reciproke (KNER). Nga këto marrëveshje;
- Në vitin 1955, Shqipëria u bë anëtare e Traktatit të Varshavës.

*Grupi i dytë:* Marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë pas prishjes me Bllokun Lindor

**Miqësia me Kinën** ⇒

- Prishja e marrëdhënieve me BS e Bllokun Lindor krijoi një situatë teje të vështirë ekonomike;
- qeveria shqiptare iu drejtua qeverisë kineze për ndihmë me pajisje teknike, specialistë, kredi;
- Kina u bë partneri kryesor ekonomik e tregtar i Shqipërisë.
- Në fillim të viteve '70, kur Kina nisi kursin e afrimit politik më ShBA, udhëheqja shqiptare shfaqi pakënaqësitë e saj;
- Në korrik 1978, qeveria kineze njoftoi ndërprerjen e bashkëpunimit ekonomik me Shqipërinë, duke e lënë të izoluar tërësisht nga bota.

**Marrëdhëniet me Perëndimin** ⇒

- Pas pushtimin e Çekosllovakisë (1968), Tirana denoncoi edhe Traktatin e Varshavës dhe doli prej tij;
- qeveria amerikane dërgoi e para mesazhe afrimi. Qeveria e Tiranës e refuzoi për arsye ideologjike;
- Londra propozoi bisedime për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Këtë propozim, Tirana e kushtëzoi me kthimin e arit të bllokuar pas incidentit të Korfuzit;
- Franca ngriti nivelin e pranisë diplomatike në Shqipëri në rang ambasade;
- Edhe Italia shfaqi dëshirën për afrim me Shqipërinë por u intensifikuan vetëm shkëmbimet tregtare;
- Në këtë nivel mbetën edhe marrëdhëniet më Gjermania Federale, sepse pala shqiptare e lidhi me çështjen e dëmshpërblimeve të Luftës II Botërore.

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Dallon diferencimin që qeveria komuniste i bëri marrëdhënieve me shtetet komuniste dhe atyre perëndimore pas Luftës së Dytë Botërore.
2. Evidenton procesin e integrimit politik, ekonomik dhe ushtarak të Shqipërisë në Bllokun komunist lindor.
3. Shpjegon shkaqet e prishjes së marrëdhënieve dhe largimin e Shqipërisë nga Blloku komunist.
4. Argumenton arsyet e aleancës me Kinën komuniste deri në fundin e saj.
5. Analizon raportet e Shqipërisë komuniste me vendet perëndimore dhe ato fqinje, arsyet e ftohtësisë në këto raporte dhe përpjekjet për përmirësimin e tyre.

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime .*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

- Hulumto dhe siguro informacion shtesë rreth marrëdhënieve shqiptaro – sovjetike, prishjes së tyre dhe ngjarjeve që e shoqëruan këtë proces.  .

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkolla: | Klasa: 11 |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Tiparet e represionit komunist | | **Situata e të nxënit:**<br>Shfaqen sekuenca nga filmime lidhur me tematikën e mësimit https://www.youtube.com/watch?v=DOOwU2W_Z5U<br>Në vazhdim, mësuesja nxit diskutimin e nxënësve me pyetje të ndryshme. | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**<br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës.<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**.<br>Nxënësi:<br>➢ analizon kuptimin e shprehjes "politika në plan të parë" në kontekstin e Shqipërisë komuniste;<br>➢ përshkruan tiparet kryesore të futjes së frymës ushtarake në jetën e vendit;<br>➢ analizon reformat në gjirin e forcave të armatosura dhe politikës së mbrojtjes;<br>➢ vlerëson ndikimin e ndalimit të fesë dhe prishjes së institucioneve fetare;<br>➢ Shpjegon zbatimin e luftës së klasave në art e kulturë dhe represionin ndaj artistëve shqiptarë. | | **Fjalët kyçe:**<br>- *politika në plan të parë*<br>- *zbor ushtarak*<br>- *bunkerizim*<br>- *shfaqje të huaja borgjeze*<br>- *propagandë ateiste*<br>- *kontroll punëtor* | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme, enciklopedi etj. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Me qytetarinë<br>- Me letërsinë | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

**Metodologjia:** Rrjeti i diskutimit /lexim dhe mendim i drejtuar

**Organizimi i orës së mësimit**
Shfaqen sekuenca nga filmime lidhur me tematikën e mësimit
https://www.youtube.com/watch?v=DOOwU2W_Z5U

- Nxënësve u drejtohen pyetje duke i nxitur në diskutim.

- Si shprehej ndikimi dhe kontrolli i partisë komuniste në jetën e vendit?
- Çfarë vendi zinte përgatitja ushtarake në jetën e popullit dhe cilat ishin arsyet e zgjerimit të këtij aktiviteti?
- A mund të dalloni mes preteksteve dhe shkaqeve lidhur me mbylljen e institucioneve fetare dhe ndalimit te fesë?
- A mund të dalloni presionin që ushtrohej kundër përhapjes së kulturës perëndimore në Shqipëri?

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë pjesët dhe të rendisin konceptet kryesore të hasura në të.
- Mund të ndërtohen tabela si më poshtë nga mësuesi/ja dhe një nxënës ngrihet për ta plotësuar.

*Pjesa e parë*

| Koncepti | Kuptimi | Ndikimi |
|---|---|---|
| Politika në plan të parë | Çdo veprim duhet të kryhej duke marrë për bazë kushtet dhe pasojat politike të tij. | Nëpërmjet zbatimit të këtij koncepti, popullsia mësohej që të shikonte te partia komuniste, faktorin kryesor udhëheqës të jetës së vendit. Gjithashtu, kjo i hapte rrugë cënimit të të drejtave dhe lirive të njeriut për shkak të ndërhyrjes dhe dominimit politik mbi ligjet. |
| Rrethimi imperialisto-revizionist | Supozohej që Shqipëria, si vend i vetëm “vërtet” socialist ishte në shënjestrën e vendeve kapitaliste dhe revizioniste për t’u goditur. | Futej një frymë që legjitimonte kryerjen e sakrificave apo pranimin e kushteve ekonomike të vështira me synim për të përballuar rrethimin. Krijohej një psikozë që detyronte shoqërinë të mbyllej dhe fuste farën e spiunimit për mbrojtjen e sistemit. |
| Kontrolli punëtor | Kontroll i ushtruar nga grupe punëtorësh mbi organet administrative të shtetit shqiptar. | Tentohej të paraqitej se në pushtet ishte klasa punëtore që luftonte burokratizimin e administratës. |

*Pjesa e dytë*

| Koncepti | Kuptimi | Ndikimi |
|---|---|---|
| Militarizim i jetës civile | Kërkesat e mbrojtjes dhe organizmit ushtarak prekin mënyrën e jetesës së popullsisë dhe kthehen në pjesë të saj. | Fryma ushtarake dhe bërja e saj pjesë e mënyrës së jetesës së popullsisë i shërbente një kontrolli më të mirë të shoqërisë nga regjimi, mobilizonte atë në mbështetje të partisë dhe siguronte burime njerëzore me kosto të ulët për mbrojtjen. |
| Bunkerizim | Ndërtimi i veprave mbrojtëse statike. | Kjo ishte një strategji mbrojtëse që u nxit shumë në fillim të viteve ’70 të shek. XX si rrugë për të rritur aftësinë mbrojtëse të vendit kundrejt rrezikut të një sulmi nga vendet kapitaliste dhe revizioniste. U çua në ekstrem me ndërtimin e qindra mijëra objekteve mbrojtëse me kosto shumë të madhe për ekonominë. |
| Ushtri popullore | Ushtri që nuk mbështetet në hierarkinë e gradave. Kontrollohet nga partia. Nuk funksionon mbi konceptin e përqendrimit në kazerma, por shpërndahet në të gjithë territorin e vendit. | Nën shembullin e Revolucionit Kulturor në Kinë, u hoqën gradat në ushtri, u vendos funksioni i komisarëve (përfaqësues të partisë) dhe ushtria u shpërnda në mijëra pika me justifikimin për të qenë më afër dhe më e lidhur me popullin. Synimi ishte që të mbahej një kontroll i rreptë politik mbi ushtrinë për të mos lejuar kundërvënien e saj ndaj partisë dhe E. Hoxhës. |
| Zbor ushtarak | Proces i përgatitjes ushtarake të popullsisë në moshë aktive. | U bë një pjesë standard e jetës shqiptare si formë e stërvitjes ushtarake për një periudhë kohore të caktuar. |

*Pjesa e tretë*

| Koncepti | Kuptimi | Ndikimi |
|---|---|---|
| Feja – opium për popullin | Theksohej roli i fesë për mbajtjen e popullit në injorancë dhe skllavëri (analogjia me drogën). | Luftim i fesë, koncepteve, formave te shprehjes dhe institucioneve fetare duke e parë atë si një element prapambetjje shoqërore dhe kulturore të popullsisë. |
| Shtet ateist | Shtet që lufton fenë dhe nuk e njeh atë si komponent të jetës shoqërore të popullit. | Eliminimi i plotë i fesë, objekteve të kultit dhe klerikëve dhe spastrimi i jetës nga konceptet fetare. |
| Dalje e fesë nga mbrojtja ligjore e shtetit | Mos-konsiderimi i fesë si një ideologji dhe institucion legjitim që meriton të mbrohet nga legjislacioni dhe organet e shtetit. | Shënon sinjalin për fushatën e shkatërrimit të objekteve të kultit në vitin 1967. |

*Pjesa e katërt*

| Koncepti | Kuptimi | Ndikimi |
|---|---|---|
| Shfaqje e huaj | Sjellje apo veprim i frymëzuar nga ndikimet e huaja nëpërmjet kulturës, artit, propagandës etj. | Lufta ndaj shfaqjeve të huaja ishte një veprimtari e vazhdueshme dhe gjithnjë e pranishme kudo: ne shkolle, qendër pune apo qendër banimi. Luftohej çdo tentativë antikonformizmi dhe tendence për t'i ikur rregullave strikte të përcaktuara nga regjimi. |
| Njeriu i ri socialist | Krijimi i njeriut të brumosur me ideologji marksiste dhe i mbrojtur nga ideologjitë e huaja perëndimore. | Kultura, artet, arsimi si dhe sistemi i propagandës ishin vazhdimisht të angazhuar për të përçuar idetë e partisë për jetën, punën, veprimtarinë shoqërore dhe çdo sferë të jetës. Synimi ishte që sistemi i vlerave të shtetit diktatorial të ngulitej në mendjet e njerëzve dhe të përqafohej pres një numri sa më të madh të tyre. Sillte realizimin e veprave artistike skematike dhe një propagandë të bezdisshme. |
| Liberalizëm në art e kulturë | Tendencë për të rritur numrin e rrymave kulturore dhe artistike si dhe zgjerim të hapësirave ideore dhe shprehëse prezente në jetën e vendit. | Me gjithë censurën dhe autocensurën në art e kulturë, herë pas here artistët tentonin të dilnin nga kornizat e kohës për të realizuar vepra ndryshe nga forma dhe përmbajtja. Shteti diktatorial i konsideronte këto prirje si të dëmshme dhe i luftonte ato me ashpërsi. |
| Antena bllokuese | Mjet për të bllokuar sinjalin e stacioneve te huaja televizive | U vendosën për të penguar shikimin e televizioneve të huaja nga popullsia. Ishin pjesë e përpjekjes për izolimin e vendit nga bota e jashtme dhe ndikimet qe kjo mund të sillte për stabilitetin e regjimit komunist. Në gjuhën popullore quheshin edhe "zhurmues". |

- Mësuesja nxit të menduarit kritik te nxënësit duke drejtuar kërkuar nga nxënësit të:
  - argumentojnë politizimin dhe militarizimin e vazhdueshëm të gjithë sferave të jetës së vendit.
  - shpjegojnë logjikën dhe pasojat e luftës në fushën ideologjike (kundër fesë, shfaqjeve të huaja, për edukimin e njeriut të ri) nga ana e shtetit diktatorial.

| |
|---|
| **Pyetje për diskutim**<br>Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:<br>1. Përshkruan kontrollin e ushtruar nga regjimi mbi jetën e popullsisë dhe praninë e politikës së partisë komuniste në të gjitha aspektet.<br>2. Analizon masat e marra në fushën ushtarake dhe karakterin e reformës për kthimin e ushtrisë shqiptare në “ushtri popullore”.<br>3. Evidenton përpjekjet e shtetit diktatorial për luftën ndaj fesë dhe shpjegon arsyet reale te kësaj lufte.<br>4. Argumenton arsyet e kundërshtisë së regjimit ndaj çdo tentative për liberalizim dhe hapje ndaj botës së jashtme.<br>5. Evidenton dhe shpjegon koncepte kryesore që përshkruajnë format e shfaqjes së represionit komunist ndaj popullit. |
| **Vlerësimi:**<br>*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit dhe në të menduarit kritik.* |
| |

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Histori</th><th>Shkolla:</th><th>Klasa: 11</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Veprimtari praktike: Fotomontazh mbi përdorimin e dhunës gjatë regjimit komunist.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Dhuna dhe terrori janë dy prej karakteristikave më tipike të çdo regjimi diktatorial. Ato janë mjete të rëndësishme për të kontrolluar popullsinë dhe për të mbytur çdo tentativë disidence apo kundërshti ndaj regjimit.<br>Edhe në Shqipëri, dhuna dhe terrori ishin prezente duke filluar menjëherë pas ardhjes në pushtet të Partisë Komuniste pas Luftës së Dytë Botërore. Dhuna u shtri në çdo fushë të jetës dhe preku thuajse të gjitha shtresat e popullsisë. Ajo u reflektua deri në udhëheqjen e lartë komuniste.<br>Fotografia është një mjet i fuqishëm i pasqyrimit të realitetit. Për fat të keq, nuk ka shumë dëshmi te tilla të dhunës dhe terrorit të regjimit komunist. Gjithsesi, fotografitë e diktaturës të fusin në mendime. Kjo është si një antidot kundër harresës!</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>Kompetenca e të menduarit. Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës.<br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>Kompetenca qytetare. Nxënësi<br>• shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore.<br>Kompetenca digjitale. Nxënësi:<br>komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>- fotomontazh<br>- forma të torturës<br>- kampe internimi</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| **<u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>**.<br>Nxënësi:<br>➢ Identifikon format e dhunës së përdorura gjatë regjimit komunist;<br>➢ Vlerëson rëndësinë e kujtesës historike sidomos tek të rinjtë nëpërmjet fotove të ndryshme,<br>➢ Diskuton për teorinë dhe praktikën e dhunës në diktaturë. | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>Me qytetarinë |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** punë në grupe/ tryezë e rrumbullakët.

**Organizimi i orës së mësimit**

Zhvillimi i orës së veprimtarisë synon që të shndërrojë klasën në një mjedis diskutimi dhe debate lidhur me dhunën, format e saj, viktimat dhe xhelatët gjatë periudhës së diktaturës komuniste në Shqipëri. Fotot e përfshira në këtë veprimtari kanë rol ndihmës dhe nxitës për diskutimin. Natyrisht që nxënësit janë të lirë dhe të ftuar që të paraqesin sa më shumë dëshmi lidhur më dhunën dhe terrorin në diktaturë.
Mësuesi/ja udhëzon paraprakisht nxënësit duke i ndarë ata në grupe. Secili prej grupeve i ngarkohet detyra që të mbledhin materiale lidhur me tematikat e mëposhtme:

- Burgjet dhe kampet e burgimit dhe internimit
- Gjyqet e diktaturës
- Persekutimi i intelektualëve
- Dënimet e diktaturës.
- Goditja e fesë dhe klerit
- Dhuna mbi artin dhe letërsinë
- Survejimi i popullsisë
- “Lufta brenda llojit”

**Ndërtimi i njohurive:**

Mësuesi/ja e organizon orën e mësimit në dy pjesë.
Pjesa I (20 min.) – Organizohet në klasë diskutim rreth materialeve të grumbulluara nga nxënësit në lidhje me tematikat sipas grupeve të punës lidhur me dëshmi autentike të dhunës së ushtruar gjatë regjimit komunist në Shqipëri. Diskutim rreth librit “Sikur të isha djalë” si një dëshmi autentike e problematikave të kohës lidhur me figurën e gruas në vitet ’20 – ’30.

Pjesa II (20 min.) - Bëhet një diskutim i përgjithshëm duke integruar tematikat në një kuadër më të gjerë si pjesë e politikave represive të shtetit komunist.

**Pyetje për diskutim**
Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

6. Identifikon forma të torturës dhe represionit të përdorura ndaj grupeve të ndryshme të popullsisë gjatë regjimit komunist.
7. Analizon politikat e përgjithshme të shtetit komunist në drejtim të të drejtave dhe lirive të njeriut.
8. Vlerëson punën e bërë për evidentimin dhe promovimin e njohjes së karakterit represiv të regjimit komunist në Shqipëri dhe figurave të ndryshme të persekutuara prej tij.

***Vlerësimi:***
*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në realizimin e detyrave, kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime,*

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Histori</th><th>Shkolla:</th><th>Klasa: 11</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Kriza e regjimit komunist</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Mësuesi/ja për të nxitur kureshtjen e nxënësve shfaq në monitor sekuenca mbi Shqipërinë e viteve 1981 - 1989.<br><br>https://www.youtube.com/watch?v=kbaOs_2Sw24</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Nxënësi/ja<br>• përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.<br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi/ja:<br>• parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime.<br>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. Nxënësi/ja:<br>• zhvillon aftësitë për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin për të identifikuar dhe vlerësuar burimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjes historike.<br>Kompetenca personale: Nxënësi/ja:<br>• përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.</td><td colspan="2" rowspan="2">Fjalët kyçe:<br>- tufëza dhe arëza<br>- mekanizëm i ri ekonomik<br>- agjitacion-propagandë<br>- pronë shoqërore<br>- plani i shtetit<br>- mbështetje në forcat e veta</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>.<br>Nxënësi/ja:<br>➢ shpjegon natyrën e ndryshimeve të bëra në Kushtetutën e vitit 1975;<br>➢ evidenton vështirësitë ekonomike dhe analizon masat e marra në për kapërcimin e tyre;<br>➢ vlerëson efektshmërinë e politikës ekonomike të shtetit komunist në vitet ’80 – ‘90.<br>➢ tregon ndikimin e krizës ekonomike në luftën për pushtet në gjirin e partisë komuniste;<br>➢ analizon politikën e regjimit pas vdekjes së E. Hoxhës dhe dallon karakterin e ndryshimeve të zbatuara nga pasardhësi i tij R. Alia në përpjekje për të ruajtur pushtetin.</td></tr>
</table>

| Burimet: | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: |
| --- | --- |
| • Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi, botime rreth mbretërve ilirë. | - Me qytetarinë<br>- Me ekonominë |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim / INSERT

**Organizimi i orës së mësimit**

1. Mësuesi/ja për të nxitur kureshtjen e nxënësve shfaq në monitor sekuenca mbi Shqipërinë e viteve 1981 - 1989.

https://www.youtube.com/watch?v=kbaOs_2Sw24

2. Organizohet në klasë diskutimi lidhur me faktet që nxënësit njohin rreth ngjarjeve dhe zhvillimeve të dhjetëvjeçarit 1980-1990.

**Ndërtimi i njohurive:**

3. Mësuesja udhëzon nxënësit të lexohet mësimi duke i kërkuar te vendosin perbri secilës pjesë të lexuar shenjat të cilat kanë kuptimin e mëposhtëm.

“√” —— vendoset përbri informacionit që për ju është i njohur.
“ - ” —— vendoset përbri informacionit që ju e dinit ndryshe.
“ + ” —— vendoset përbri informacionit i cili është i ri për ju.
“ ? ” —— vendoset përbri informacionit i cili është i pa qartë ose doni të dini më shumë.

4. Pas leximit organizohet në klasë bashkëbisedim ku nxënësit krahasojnë shenjat e vendosura dhe diskutojnë rreth fakteve të reja. (Këto veprimtari mund të zhvillohen në 20 minutat e para të mësimit dhe pjesën tjetër plotësohet tabela nga përgjigjet e nxënësve).

5. Ndër informacionet që mund të merren në diskutim në bazë të pikës 4. Mund të renditen:

   - Kushtetuta e vitit 1975 forcoi karakterin ideologjik të shtetit.
   - Vendosja si element kushtetues i rolit udhëheqë së PPSH njohje formale e realitetit konkret politik në vend.
   - Në Shqipëri ndaloheshin me kushtetutë investimet e huaja.
   - Zhvillimi i ekonomisë nëpërmjet mbështetjes tërësisht në forcat e veta.

- Më 17 dhjetor 1981, Kryeministri i Shqipërisë M. Shehu u gjet vrarë në shtëpinë e vet.
- Grupi armiqësor i M. Shehut, K. Hazbiu etj.
- Racionim në furnizimin e popullsisë.
- Kursi i vazhdimësisë enveriste.
- Masa "kozmetike" për reformim.
- "Mekanizmi i Ri ekonomik".
- Tufëza dhe arëza.
- Elemente liberalizimi në politikën e jashtme:
    - Gatishmëri për marrëdhënie diplomatike me SHBA, BS dhe Tregun e Përbashkët Evropian, për të zgjidhur mosmarrëveshjet mbi arin monetar dhe për aderimin në Konferencën e Helsinkit (OSBE).

**Pyetje për diskutim**
Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:
1. Shpjegon arsyet dhe natyrën e ndryshimeve të bëra me Kushtetutën e vitit 1975.
2. Përshkruan gjendjen ekonomike në Shqipëri në fund të viteve '80 duke evidentuar indikatorët e krizës së ekonomisë.
3. Evidenton masat e marra për tejkalimin e krizës duke analizuar karakterin dhe efektshmërinë e tyre.
4. Tregon ndikimin e gjendjes së vështirë në përplasjet politike brenda kupolës komuniste
5. Shpjegon thelbin e kursit të vazhdimësisë enveriste me gjithë krizën e hapur të sistemit politik dhe ekonomik diktatorial.
6. Identifikon hapat e bëra për vendosjen dhe përmirësimin e marrëdhënieve me vendet perëndimore.

**Vlerësimi:**
*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit në të kuptuarit e fakteve dhe ngjarjeve*

**Detyrat dhe puna e pavarur**:
- Zhvilloni hulumtime lidhur me masat konkrete që përmbante "Mekanizmi i Ri ekonomik" dhe bëni krahasime me politika të ngjashme të zbatuara në vende të ndryshme.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkolla: | Klasa: 11 |
|---|---|---|---|
| Tema mësimore: Jeta e përditshme | | **Situata e të nxënit:**<br>*Pas viteve '90, jeta e përditshme në Shqipëri ka ndryshuar diametralisht krahasuar me atë të periudhës komuniste. Shkolla, koha e lirë por edhe gjërat e rutinës së përditshme kanë marrë tashmë një karakter dhe tipare të tjera si pasojë e ndryshimit të kushteve politike, ekonomike dhe shoqërore pas vendosjes së pluralizmit politik. Të rinjtë e sotëm e kanë të vështirë që të kuptojnë aspektet e ndryshme të jetës në diktaturë. Megjithatë, njohja e realitetit të përditshëm dhe diferencave nga diktatura në demokraci merr rëndësi të veçantë pasi ky realitet përfaqëson një pasqyrë të sistemeve me gjërat e tyre negative dhe pozitivet.*<br>*https://www.youtube.com/watch?v=o_38xpC6CrQ*<br>*(min. 3: 50-9: 50)*<br>*https://www.youtube.com/watch?v=888VajYfefk* | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**<br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës.<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>**Kompetenca qytetare.** Nxënësi:<br>• shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore.<br>**Kompetenca digjitale.** Nxënësi:<br>komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet. | | **Fjalët kyçe:**<br>- *tallon*<br>- *norma shoqërore në komunizëm*<br>- *marrëdhënie shtet – individ në komunizëm* | |

| | |
|---|---|
| **<u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>**.<br>Nxënësi:<br>➢ Evidenton mënyrën e jetesës në familjen dhe shoqërinë shqiptare duke u përqendruar te rinia;<br>➢ Vë në dukje mënyrën sesi kalohej koha e lirë dhe kufizimet që sistemi kishte vendosur në këtë drejtim;<br>➢ Tregon përpjekjet që bëheshin për sigurimin e elementeve bazë të jetës dhe përpjekjet e mëdha të prindërve apo gjyshërve për to;<br>➢ Shpjegon rolin e shoqërisë dhe pushtetit komunist në jetën e individit lidhur me qëndrimin dhe normat e moralit dhe të sjelljes;<br>➢ Analizon përpjekjet për indoktrinimin e rinisë me ideologjinë komuniste;<br>➢ Krahason jetën e përditshme para dhe pas vitit ’90 duke evidentuar aspekte të ndryshme në sensin pozitiv dhe negative. | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>Me qytetarinë |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Rrjeti i diskutimit/ Vështrim krahasues.

**Organizimi i orës së mësimit**

Zhvillimi i orës së veprimtarisë synon që të shndërrojë klasën në një mjedis diskutimi dhe debati lidhur me tiparet e jetës së përditshme në diktaturë. Shih:
[https://www. youtube.com/watch?v=o_38xpC6CrQ](https://www.youtube.com/watch?v=o_38xpC6CrQ)
*(min. 3:50-9:50)*
[https://www.youtube.com/watch?v=888VajYfefk](https://www.youtube.com/watch?v=888VajYfefk)

Mësuesi/ja udhëzon paraprakisht nxënësit lidhur me pika të sugjeruara për të cilat këta të fundit duhet të dokumentohen me qëllim krijimin e një mjedisi nxitës për diskutim të mëtejshëm lidhur me tematikën e orës.

**Ndërtimi i njohurive:**

Mësuesi/ja e organizon orën e mësimit në disa hapa:

*Hapi I*

Paraprakisht nxënësit mbledhin informacion dhe të intervistojnë të afërm apo familjarë për përvojat e tyre jetësore.

1. Si ndërtoheshin marrëdhëniet prindër-fëmijë apo marrëdhëniet mes brezave? Cilat ishin modelet e sjelljes në familje?
2. Cilat ishin veprimtaritë që kryheshin në kohën e lirë? Çfarë mundësish ofroheshin për të rinjtë në kohën e lirë?
3. A ndërhynte shtetin në kohën e lirë të individëve ?
4. Si ishte një ditë standarde e një familje në diktaturë?
5. Cilat ishin vështirësitë e përditshme me të cilat përballeshin familjet? A kanë ardhur ato duke u shtuar me kalimin e kohës?
6. Si reagonte shoqëria në lidhje me veprimet e individit? Jepni informacione lidhur me normat shoqërore gjatë jetës në sistemin komunist.
7. Kush mendoni se kishte përparësi, individi apo shoqëria?
8. A mendojnë se jeta e përditshme ka qenë gjithmonë njëlloj? Nëse jo, cilat janë disa arsye?
9. Cilat mendoni se janë disa prej ndryshimeve kryesore në jetën e përditshme në kalimin nga diktatura në demokraci?

*Hapi II*

Mësuesi nxit nxënësit që të vënë në përdorim aftësinë e tyre të krahasuese, duke marrë në analizë aspekte të caktuara të jetës (të diskutuara më sipër ose të tjera) mes periudhës së diktaturës dhe ditëve të sotme. Krahasimi synon që të nxisë aftësinë për mendim kritik te nxënësit, duke nxjerrë në pah ndryshimet si në sensin pozitiv, ashtu edhe atë negativ.

Ndarja e minutazhit në dispozicion mes hapave të ndryshëm, varet nga vendimmarrja e mësuesit.

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

**9.** Evidenton aspekte të jetës së përditshme në Shqipërinë komuniste.
**10.** Argumenton rolin mbizotërues të shtetit diktatorial në jetën e individit.
**11.** Shpjegon politizimin ekstrem të jetës së përditshme nën regjimin komunist në Shqipëri.

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështete në realizimin e detyrave, kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime,*

<table>
<tr><th>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</th><th>Lënda: Histori</th><th>Shkolla:</th><th>Klasa: 11</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Regjimi i pushtimit serb në Kosovë. Procesi i diferencimit etnik e politik të shqiptarëve</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Pas vitit 1981, qeveria jugosllave e forcoi dhunën dhe represionin ndaj shqiptarëve. Ajo tkurri në vijimësi liritë politike dhe të drejtat njerëzore e kombëtare të tyre. Për diskriminimin etnik të tyre u iniciua i ashtuquajturi “proces i diferencimit ideopolitik”. Qëllimi i tij ishte likuidimi i institucioneve vetëqeverisëse të tyre.<br>Arbitrariteti i regjimit serb kaloi në ekstrem, me ardhjen në fuqi të Sllobodan Milosheviçit. Ai i cilësoi të gabuara lëshimet në statusin politik të Kosovës dhe programoi masa për korrigjimin e tyre, me qëllim që të ringrihej autoriteti federal i Serbisë.<br>Shqiptarët e Kosovës nuk pajtuan kurrsesi me politikën asimilimit kombëtar Ata rritën përgjegjësinë qytetare, përsosën cilësinë e format e qëndresës antiserbe dhe i dhanë asaj edhe përmasë antikomuniste.</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>Kompetenca e të menduarit. Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës.<br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>Kompetenca qytetare. Nxënësi<br>• shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore;<br>Kompetenca digjitale. Nxënësi:<br>komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>- proces i diferencimit ideopolitik<br>- Sllobodan Milosheviçit<br>- administrimit ushtarak<br>- suprimimin e autonomisë</td></tr>
</table>

**<u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>**.

Nxënësi:

- ➢ Evidenton qëllimet e synuara nga regjimi serb i Milosheviçit ndaj Kosovës.
- ➢ Përshkruan reagimin e popullsisë shqiptare ndaj masave diskriminuese të ndërmarra nga shteti jugosllav.
- ➢ Shpjegon procesin e eliminimit të autonomisë së Kosovës në vitet 1989 – 1990.
- ➢ Analizon rrugët dhe mënyrat e rezistencës së shqiptarëve ndaj politikave shtypëse të autoriteteve jugosllave.
- ➢ Vë në dukje natyrën demokratike të lëvizjes së rezistencës së popullsisë shqiptare të Kosovës.
- ➢ Tregon qëndrimin e regjimit serb kundrejt përpjekjeve të shqiptarëve për t'ju kundërvënë politikave shtypëse dhe diskriminuese të tij.

**Burimet:**

- Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme etj.

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**

Me qytetarinë

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** harta e mendimeve.

**Organizimi i orës së mësimit**

Paraprakisht, mësuesi i ka kërkuar nxënësve që të mbledhin informacione dhe të dhëna lidhur me tematikën e veprimtarisë. Në fillim të orës, me qëllim nxitjen e e diskutimit në klasë, mësuesi paraqet një kllaster dhe më pas fton nxënësit që të japin informacionet e tyre në lidhje me pikat e diskutimit.

**Ndërtimi i njohurive:**

- *Si hap të parë*, mësuesi/ja ndërton një kllaster lidhur me problematikën e hasur nga shqiptarët e Kosovës në vitet 1981 – 1990. Një shembull i çështjeve që mund të paraqiten në këtë kllaster mund të jenë:

- *Background* historik i çështjes së Kosovës deri në fillim të viteve ’80;
- Ndryshimet kushtetuese dhe institucionale që u ndërmorën nga Serbia me synim suprimimin e autonomisë së gjerë që gëzonte Kosova sipas Kushtetutës së vitit 1974;
- Goditja e arsimit, kulturës dhe shkencës si komponente e rëndësishme e sulmit ndaj elitës intelektuale të Kosovës;
- Aspektet politike që lidhen me procesin e diferencimit, heqjes nga puna dhe persekutimit në përgjithësi të kosovarëve nga pushteti serb;
- Dhuna dhe terrori mbi popullsinë e thjeshtë nga organet policore dhe të sigurisë serbe;
- Rezistenca ndaj qëndrimit kolonial serb ndaj Kosovës, format e rezistencës, figurat udhëheqëse të saj;

- *Si hap të dytë*, mësuesi nxit nxënësit që të paraqesin mendimit e tyre dhe të diskutojnë lidhur me pikat e prezantuara në kllaster, duke dhënë secili mendimin e tij. Diskutimi synon që të nxisë aftësinë për punë të pavarur dhe mendim kritik te nxënësit.

Ndarja e minutazhit në dispozicion mes hapave të ndryshëm, varet nga vendimmarrja e mësuesit.

**Pyetje për diskutim**
Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:
1. Evidenton rëndësinë e demonstratave të vitit 1981 dhe përgjigjen e dhunshme të faktorit jugosllav/serb ndaj tyre.
2. Shpjegon thelbin dhe praktikën e procesit të diferencimit ideopolitik si mjet presioni dhe spastrimit të administratës shtetërore nga elementi shqiptar.
3. Vë në dukje ndryshimet kushtetuese dhe institucionale të imponuara prej Serbisë për të hequr autonominë e Kosovës.
4. Analizon qëndrimin e shqiptarëve dhe rrugët e zgjedhura prej tyre për t’i rezistuar dhunës së pushtetit jugosllav dhe ai serb më pas.

***Vlerësimi:***
*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në realizimin e detyrave, kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime.*

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkolla: | Klasa: 11 |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Lëvizja studentore e dhjetorit (1990) dhe rrëzimi i regjimit komunist. | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesja e nis orën e mësimit me një material filmik mbi protestat studentore të dhjetorit 1990:<br>https://www.youtube.com/watch?v=Ohww934D3pA | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**<br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës.<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;<br>trashëgiminë materiale dhe shpirtërore. | | **Fjalët kyçe:**<br>- *pluralizëm politik*<br>- *azilkërkues*<br>- *organizatat e masave kulti i individit*<br>- *shteti i së drejtës*<br>- *Qeveria e Stabilitetit*<br>- *ndihma humanitare* | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.**<br>Nxënësi:<br>➢ evidenton gjendjen e trazuar ekonomike dhe sociale të Shqipërisë në prag të shpalljes së pluralizmit politik;<br>➢ përshkruan fillimin e përplasjeve më regjimin komunist dhe të lëvizjes antikomuniste;<br>➢ shpjegon zhvillimet politike dhe ekonomike pas zgjedhjeve të 31 marsit 1991.<br>➢ analizon zhvillimin e lëvizjes kundër regjimit komunist deri në zgjedhjet e 22 marsit 1992 dhe fitores së forcave demokratike. | | | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme, enciklopedi etj. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Me qytetarinë | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

**Metodologjia:** Shpjegim /tabela e koncepteve

**Organizimi i orës së mësimit**

- Mësuesja e nis orën e mësimit me një material filmik mbi protestat studentore të dhjetorit 1990: https://www.youtube.com/watch?v=Ohww934D3pA

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin dhe ndërton në tabelë ditarin dypjesësh. Për plotësimin e tij aktivizon nxënës të ndryshëm.

| Fjala /fjalia | Komenti |
|---|---|
| Procesi i ardhjes së pluralizmit politik | - Në mesin e vitit 1990, gjendja ekonomike e vendit hyri në kolaps të plotë;<br>- Kriza i hapi rrugën kaosit dhe çorganizimit të përgjithshëm (hyrja në ambasada në 2 korrik 1990 dhe eksodi masiv i shqiptarëve drejt vendeve të Perëndimit);<br>- përpjekjet e Ramiz Alisë për të zbutur situatën dhe për t'i dhënë asaj një veshje reformiste:<br>o largimi nga udhëheqja e disa prej drejtuesve të vjetër;<br>o pajisja e qytetarëve azilkërkues me pasaporta;<br>o shpallja e një plani për rishikimin e rendit kushtetues;<br>o inkurajimi i organizatave të masave për të dalë me kandidatë të pavarur në zgjedhje;<br>- këto masa nuk e qetësuan gjendjen;<br>- Protestat studentore për lejimin e pluralizmit politik në 8 dhjetor 1990, në qytetin "Studenti;"<br>- në 11 dhjetor, pranohet kërkesa për lejimin pluralizmit politik;<br>- në 12 dhjetor, u shpall krijimi i Partisë Demokratike të Shqipërisë (PDSH), partia e parë politike opozitare në Shqipëri. Krijimi i partive të tjera opozitare;<br>- në qershor 1991, PPSH, i dha fund veprimtarisë së saj dhe ndryshoi emrin në Parti Socialiste e Shqipërisë. |
| Pluralizmi në praktikë | - Shpallja e pluralizmit politik – fitorja e parë e demokracisë;<br>- fushata për zgjedhjet elektorale të 31 marsit 1991;<br>- paraqitja e platformave dhe programeve politike të forcave të ndryshme;<br>- ngurrimi i udhëheqjes së PPSH për tu shkëputur nga e kaluara - pengesë seriozë për proceset demokratike në Shqipëri;<br>- revolta e studentëve e pedagogëve që u kthye në një grevë urie për heqjen e emrit e diktatorit nga Universiteti i Tiranës. Rrëzimi me forcë i monumentit e diktatorit në qendër të Tiranës;<br>- Prag lufte civile. R. Alia pranon kërkesat e studentëve duke shkarkuar nga detyra kryeministrin Adil |

| | |
|---|---|
| | Çarçanin dhe duke caktuar në vend të tij Fatos Nanon;<br>- Zgjedhjet u mbajtën më 31 mars 1991. Ato ishin zgjedhjet e para pluraliste në vendin tonë. |

- Mësuesi/ja nxit nxënësit në të menduarit kritik duke drejtuar pyetjen:
  - Përse mendoni se fundi i viteve ’80 dhe fillimi i viteve ’90 solli pjekjen e kushteve për përmbysjen e regjimit komunist?

**Pyetje për diskutim**
Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Evidenton kushtet e brendshme dhe të jashtme në vitet 1989-1990 në Shqipëri.
2. Tregon ngjarjet kryesore që çuan në organizmin e protestave studentore në vitin 1990.
3. Evidenton përfaqësuesit kryesorë të lëvizjes antikomuniste.
4. Shpjegon programet politike të forcave të ndryshme të djathta dhe të majta në kuadër të procesit të pluralizmit politik.
5. Analizon qëndrimin e regjimit komunist dhe presidentit R. Alia në fazën e fundit të procesit të liberalizimit politik dhe ekonomik në Shqipëri.

**Vlerësimi:**
*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit dhe në të menduarit kritik.*

**Detyrat dhe puna e pavarur**:

- Siguroni informacione shtesë mbi protestat studentore të dhjetorit 1990 nga protagonistë të këtyre protestave.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkolla: | Klasa: 11 |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Tranzicioni demokratik në Shqipëri 1990-2014. | | **Situata e të nxënit:**<br>Për të nxitur reflektimin dhe interesin e nxënësve, mësuesja shfaq materiale filmike lidhur me tematikën e orës së mësimit si p.sh:<br>https://www.youtube.com/watch?v=1l1Q1iWPg0I (min. 11:00 – 17:00) | |
| **<u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u>**<br>**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.** Nxënësi:<br>• përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.<br>**Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.<br>**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.** Nxënësi:<br>• diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e të tashmes dhe perspektivat e të ardhmes<br>**Kompetenca personale.** Nxënësi:<br>• përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij. | | **Fjalët kyçe:**<br>- *qeveri koalicioni*<br>- *jetë politike e polarizuar*<br>- *skemë piramidale*<br>- *OSBE*<br>- *investime të huaja*<br>- *evazion fiskal*<br>- *proces zgjedhor transparent*<br>- *kompromis* | |
| **<u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>**.<br>Nxënësi:<br>➢ Evidenton procesin e kalimit të pushtetit dhe prioritetet politike dhe ekonomike të qeverisë së Partisë Demokratike pas zgjedhjeve të vitit 1992;<br>➢ Shpjegon arsyet e klimës së polarizuar politike dhe kontestimet e opozitës në lidhje me procesin e votimit dhe rezultatin e | | | |

| | |
|---|---|
| zgjedhjeve të vitit 1996;<br>➢ Analizon ngjarjet e vitit 1997 dhe pasojat e tyre në planin politik dhe ekonomik në Shqipëri;<br>➢ Vë në dukje detyrat kryesore që shtroheshin përballë qeverisë socialiste pas ardhjes në fuqi në zgjedhjet e vitit 1997;<br>➢ Analizon arritjet dhe dështimet e qeverisë demokratike pas rikthimit në pushtet pas zgjedhjeve të vitit 2005;<br>➢ Argumento faktorët që ndikuan në ardhjen përsëri në pushtet të Partisë Socialiste në vitin 2013. | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi, botime të ndryshme etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Me qytetarinë |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | |

**Metodologjia:** Diskutim / Lexim dhe mendim i drejtuar.

**Organizimi i orës së mësimit**

- Për të nxitur reflektimin dhe interesin e nxënësve, mësuesja shfaq materiale filmike lidhur me tematikën e orës së mësimit si p.sh.:

  https://www.youtube.com/watch?v=1l1Q1iWPg0I (min. 11:00 – 17:00)

- Mësuesi/ja nxit kureshtjen e nxënësve, duke drejtuar pyetje dhe organizuar diskutimin në klasë.
  - Cila ishte gjendja ekonomike e Shqipërisë në prag të zgjedhjeve të vitit 1942?
  - Cilat ishin forcat kryesore që konkurronin në këto zgjedhje?
  - Cilat ishin drejtimet kryesore të reformave që shtroheshin përpara forcave në pushtet?

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë pjesën e parë të mësimit dhe shkruan në tabelë pyetjet të cilave nxënësit duhet t'u përgjigjen pas leximit.
- Pyetjet: - Cila forcë politike u shpall fituese e zgjedhjeve të vitit 1992?
  - Cilat ishin pikat kryesore të programit të saj të reformave?
  - A kishte efekte afatshkurtra negative të këtyre reformave sidomos në planin ekonomik?

- Cila ishte klima politike në Shqipëri në vitet 1992-1994?
- Identifikoni disa prej ngjarjeve kulmore ku shprehet konfliktualiteti politik?

• Përgjigjet e nxënësve mund të shënohen në mënyrë skematike në tabelë.

**Forcat demokratike në pushtet** →

- ardhja në fuqi e demokratëve shënoi një etapë të re në historinë e vendit;
- detyrë e ngutshme ishte ngritja e institucioneve demokratike.
- qeveria ndërmori një program reformash të rëndësishme drejt ekonomisë së tregut:
    - u privatizua toka bujqësore, njësitë artizanale e tregtare, banesat;
    - u liberalizuan çmimet dhe gradualisht u ul inflacioni;
- situata politike u zhvillua në kushtet e një konflikti të ashpër politik midis partive politike;
- konflikte u shfaqën dhe gjirin e PD;
- referendumi për aprovimin e kushtetutës së re mbajtur më 6 nëntor 1994 i tha jo Kushtetutës;
- afrimi i zgjedhjeve polarizoi jetën politike;
- zhvillimi i zgjedhjeve të 26 majit 1996, u shoqërua me parregullsi.

• Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë pjesën e dytë të mësimit dhe shkruan në tabelë pyetjet që nxënësit duhet t'u përgjigjen pas leximit.
• Pyetjet: - Cili ishte ndikimi i zgjedhjeve të maji 1996 mbi situatën politike dhe sociale në Shqipëri?
  - Çfarë dini për skemat piramidale dhe pasojat e tyre?
  - Analizoni rolin e politikës në krizën e vitit 1997.
  - A mendoni se kjo krizë mund të tejkalohej pa ndërhyrjen e vendosur të komunitetit ndërkombëtar?
• Përgjigjet e nxënësve mund te shënohen në mënyrë skematike në tabelë.

**Kriza e vitit 1997 dhe ardhja e socialistëve në pushtet**

- Me gjithë akuzat për manipulimin e zgjedhjeve, presidenti S. Berisha ngarkoi serish A. Meksin të formonte qeverinë e re. Kontestimi i legjitimitetin e zgjedhjeve solli bojkotin e parlamentit nga opozita;
- bojkoti i saj u gërshetua me krizën e skemave piramidale, që nxiti shpërthimin e trazirave popullore;
- mungesa e kompromisit midis forcave politike solli përfshirjen e vendit nga kaosi dhe anarkia;
- në 9 mars 1997, me ndërmjetësimin e OSBE-së partitë politike nënshkruan një marrëveshje kompromisi që solli krijimin e një qeverie koalicioni dhe mbajtjen e zgjedhjeve të reja parlamentare, më 29 qershor 1997.
- zgjedhjet u ftuan nga opozita e majtë e kryesuar nga Fatos Nano, që rinisi ngritjen me shpejtësi të institucioneve të shtetit;
- qeveria nisi vendosjen e rendit e të sigurisë në vend;
- për rimëkëmbjen e ekonomisë u hartua dhe një program investimesh 1998-2001;
- pas fitores së socialistëve, situate politike mbeti e nderë që u rëndua edhe më shumë me vrasjen e deputetit demokrat Azem Hajdari,
- në zgjedhjet elektorale të 24 qershorit 2001, socialistët morën një mandate të dytë.

- Po kështu vazhdohet dhe me pjesën tjetër të mësimit.

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Analizon programin e qeverisë demokratike për reforma të thella të shtetit dhe ekonomisë shqiptare dhe administratës publike.
2. Shpjegon efektet pozitive dhe negative të këtyre reformave.
3. Identifikon faktorët nxitës të situatës së polarizuar politike në vend dhe ndikimin e saj në krizën e vitit 1997.
4. Argumenton efektet e krizës së firmave piramidale dhe procesin e tejkalimit të saj me ndërhyrjen e faktorit ndërkombëtar.

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

- Mblidhni fakte rreth ngjarjeve të ndodhura në vitet 1996-1997 dhe krizës politike dhe ekonomike të këtyre viteve.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkolla:</td><td>Klasa: 11</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Procesi i integrimit euroatlantik të Shqipërisë 1990-2014</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br><br>Mësuesi/ja lexon grimcën historike dhe nxit diskutimin e nxënësve nëpërmjet pyetjeve të ndryshme.</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë;<br>Kompetenca e të menduarit. Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës.<br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;<br>trashëgiminë materiale dhe shpirtërore;</td><td colspan="2" rowspan="2">Fjalët kyçe:<br>- integrimi evropian<br>- Fondi Monetar Ndërkombëtar<br>- Operacioni “Pelikan”<br>- Partneriteti për Paqen<br>- Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit<br>- liberalizimi i vizave<br>- Statusi i vendit kandidat<br>- Reforma në Drejtësi</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>.<br>Nxënësi:<br>➢ Tregon thelbin dhe kuptimin e termit “integrim euroatlantik”;<br>➢ Përshkruan hapat kryesorë në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian;<br>➢ shpjegon të drejtat dhe detyrimet që i lindin Shqipërisë nga pjesëmarrja në NATO;</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| ➢ analizon sfidat që dalin në procesin e çeljes së negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian; | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, interneti, botime të tjera. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Me qytetarinë |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Shpjegim/hartë e konceptit

**Organizimi i orës së mësimit**

- Lexohet në klasë pjesa "Grimca Historike" dhe diskutohet rreth njohurive që nxënësit kanë rreth proceseve të integrimit euroatlantik të Shqipërisë.
- Mësuesja udhëzon nxënësit dhe ndërkohë ndërton në tabelë hartën e konceptit " integrim euroatlantik".
- Shpjegimi i mësimit realizohet nga mësuesi duke e ndërthurur me pyetje të cilat u drejtohen nxënësve.

**Ndërtimi i njohurive:**

- Shpjegimi i mësimit realizohet nga mësuesi duke e ndërthurur me pyetje të cilat u drejtohen nxënësve si p. sh:
  - Cila ishte pozita ndërkombëtare e Shqipërisë në prag të rrëzimit të regjimit komunist?
  - Rendisni parimet drejtuese në procesin e integrimit të Shqipërisë në strukturat euroatlantike.
  - Cilat ishin hapat e para në procesin e integrimit në institucionet euroatlantike?
  - Dalloni aspektet pozitive dhe sfidat e Shqipërisë në integrimin euroatlantik të saj?
  - Evidentoni rëndësinë e marrjes së statusit të "vendit kandidat" për anëtarësim në Bashkimin Evropian.
  - Përshkruani disa nga kontributet e Shqipërisë në kuadër të sigurisë ndërkombëtare si anëtare e NATO-s.
  - Çfarë dini për institucionet kryesore të Bashkimit Evropian?

**INTEGRIMI EUROATLANTIK**

Filloi në vitin 1991

Aspektet pozitive

**Integrimi në institucionet financiare**

- Nënshkrim i një marrëveshje dypalëshe (bilaterale) me FMN-në (Fondi Monetar Ndërkombëtar), me Bankën Botërore, me Bankën Evropiane të Zhvillimit dhe me organizma të tjerë ndërkombëtarë.

**Integrimi në Bashkimin Evropian**

- ndihma emergjente menjëherë pas rënies së komunizmit (Operacioni Pelikan);
- nënshkrimi me BE dhe vendet anëtare të saj të një varg marrëveshjesh të karakterit politik, ekonomik, shkencor, kulturor etj.
- Pakti i Stabilitetit me qëllim të nxiste integrimin evropian të vendeve të Evropës Juglindore.
- Në vitin 2009 hyri në fuqi Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me BE;
- në nëntor 2010, Bashkimi Evropian vendosi liberalizimin e vizave për Shqipërinë;
- në qershor 2014, Shqipëria mori statusin e vendit kandidat;
- dhjetor 2016, pas aprovimit të Reformës në Drejtësi, BE rekomandoi çeljen e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë.

**Integrimi në NATO**

- në vitin 1992, Shqipëria u bë *anëtare e Këshillit të Atlantikut Verior*;
- pas dy vjetësh, u nënshkrua marrëveshja e *Partneritetit për Paqen* e ofruar nga NATO-ja. Në bazë të programit të partneritetit, filloi procesi për reformimin dhe modernizimin e ushtrisë shqiptare në përputhje me standardet e ushtrive të Aleancës;
- me shpërthimin e luftës së Kosovës, Shqipëria fitoi një status të veçantë në marrëdhënie me Aleancën;
- pas vizitës së presidentit amerikan Xhorxh Bush në Shqipëri, në qershor të vitit 2007 u përshpejtuan ritmet për plotësimin e standardeve dhe marrjen e ftesës së pranimit në NATO në Samitin e Bukureshtit.
- Vendimi për pranimin si anëtare me të drejta të plota në NATO u mor më 4 prill 2009, në kuadrin e festimeve të 60-vjetorit të saj.

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Evidenton frymën konsensuale politike dhe popullore në favor të proceseve të integrimit euroatlantik të Shqipërisë.
2. Rendit disa prej hapave kryesorë në këto procese.
3. Shpjegon kushtet që duhet të plotësojë Shqipëria për tu anëtarësuar në Bashkimin Evropian.
4. Analizon sfidat me të cilat përballet Shqipëria në përpjekjet e saj për çeljen e negociatave me Bashkimin Evropian për anëtarësim në këtë organizatë.

**Vlerësimi:**

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit.* .

**Detyrat dhe puna e pavarur**:

- Hulumtoni dhe sillni në klasë informacion rreth institucioneve të Bashkimit Evropian dhe marrëdhënieve të Shqipërisë me këtë organizëm ndërkombëtar.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkolla: | Klasa: 11 |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Kosova dhe shqiptarët në Republikën Jugosllavisë (1945-1989) | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi /ja shfaq në klasë sekuenca nga dokumentarë që trajtojnë tematikën e Kosovës në periudhën e pas luftës II Botërore.<br><br>https://www.youtube.com/watch?v=mKjDmMslRmI<br><br>https://www.youtube.com/watch?v=wsrnKJVOwBw (min. 6:19 – 9.46) | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**<br>**Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>**Kompetenca personale.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit.<br>**Kompetenca qytetare.** Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë qytetare për të shqyrtuar në mënyrë kritike sjelljet, motivet dhe veprimet e njerëzve në të shkuarën që mund të jenë rezultat i ndryshimit të qëndrimeve shoqërore dhe standardeve të ndryshme.<br><br>**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.**<br>Nxënësi:<br>➢ Evidenton gjendjen politike dhe etnike në Kosovë menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.<br>➢ Përshkruan terrorin e ushtruar mbi popullsinë shqiptare në Jugosllavi dhe shkeljen e të drejtave të saj.<br>➢ Shpjegon thelbin dhe format e shfaqjes së rezistencës shqiptare ndaj diskriminimit politik, etnik e ekonomik të ushtruar nga pushteti jugosllav dhe ai serb në veçanti.<br>➢ Analizon zhvillimet që solli aprovimi i Kushtetutës së Kosovës e vitit 1974 dhe synimet e lëvizjes për Kosovën-Republikë. | | **Fjalët kyçe:**<br>- *e drejta për vetvendosje*<br>- *federatë*<br>- *UDB*<br>- *spastrim etnik*<br>- *masakra e Tivarit*<br>- *status politik* | |
| **Burimet:**<br>• Libri i nxënësit, interneti, enciklopedi, botime të ndryshme etj. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>- Me letërsinë.<br>- Me gjeografinë | |

| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve |
| --- |
| **Metodologjia:** Diskutim / pyetje –përgjigje/hartë e konceptit<br><br>**Organizimi i orës së mësimit**<br><br>1. Mësuesi /ja shfaq në klasë sekuenca nga dokumentarë që trajtojnë tematikën e Kosovës në periudhën e pas luftës II Botërore.<br><br>https://www.youtube.com/watch?v=mKjDmMslRmI<br><br>https://www.youtube.com/watch?v=wsrnKJVOwBw (min. 6:19 – 9.46)<br><br>**2.** Organizohet në klasë diskutimi rreth ngjarjeve historike në Kosovën e viteve 1945 - 1989.<br><br>**Ndërtimi i njohurive**<br>• Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin dhe duke drejtuar pyetje të ndryshme zbulon informacionin e ri nga nxënësit.<br>- Cila ishte gjendja e popullsisë shqiptare në Mbretërinë Jugosllave?<br>- Cila ishte ecuria e Luftës së Dytë Botërore në Kosovë dhe trojet e tjera të banuara nga shqiptarët në Jugosllavi?<br>- Identifikoni forcat kryesore politike që vepruan në Kosovë gjatë luftës dhe cili ishte pozicioni i tyre në periudhën e pasluftës?<br>- A pati ndonjë përparim pozita kushtetuese e Kosovës në periudhën menjëherë pas luftës?<br>- A kishte popullsia shqiptare në Jugosllavi hapësira për afrimin e identitetit të saj etnik e kulturor?<br>- Vini në dukje reagimin e shqiptarëve në mbrojtje të të drejtave te tyre dhe kundër diskriminimit që ushtrohej mbi ta prej pushtetit.<br><br>• Mësuesi/ja aktivizon nxënës për të ndërtuar në tabelë hartën e koncepteve të mësimit si p.sh. “Ecuria e pozitës kushtetuese të Kosovës në RSFJ”, “Rezistenca shqiptare ndaj diskriminimit nga pushteti jugosllav dhe serb”. |

**Pozita kushtetuese e Kosovës në RSFJ**

- **Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore** shpallet Rajoni Autonom i Kosovës e Metohisë, si pjesë integrale Republikës Socialiste të Serbisë. Vartësi dyfishe, nga Serbia dhe Federata jugosllave;
- shqiptarët trajtohen si pakicë kombëtare;
- Në shkurt 1974 u aprovua Kushtetuta së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës që:
  - çonte në minimum varësinë e organeve të Kosovës nga Serbia;
  - forconte autonominë e qeverisjes krahinore në të gjitha fushat;
  - garantonte barazi në të drejtat kombëtare, për gjuhën, kulturën, flamurin dhe simbole të tjera.

**Rezistenca shqiptare ndaj diskriminimit nga pushteti jugosllav dhe serb.**

- terrori i ushtruar nga Administrata Ushtarake menjëherë pas aneksimit të Kosovës prej Serbisë (p.sh. aksioni për mbledhjen e armëve, masakra e Tivarit etj.);
- pas vitit 1950, terrori serb u gërshetua me spastrimit etnik në Kosovës (shpërngulja në Turqi);
- Ekonomikisht Kosova mbeti rajoni më i prapambetur në Jugosllavi. e përdorur kryesisht si burim për lëndë të para dhe treg për shitjen e mallrave të gatshme;
- të ardhurat kombëtare për frymë në Kosovë, më 1979, ishin sa ¼ e mesatares jugosllave ndërsa papunësia ishte 2,5 herë më e madh se mesatarja jugosllave;
- Politika serbe e spastrimit etnik, ndeshi në qëndresën e vendosur të popullsisë kosovare.
  - organizata të fshehta si, ajo Nacional-Demokratike, Besa Kombëtare;
  - programi i tyre vuri si detyre, çlirimin e Kosovës dhe bashkimin me Shqipërinë;
  - tetor-nëntor 1968, qytetarë e student të Prishtinës organizua demonstrate masive me domethënie politike;
  - mars-prill 1981, Kosova u përfshi nga një valë e gjerë demonstratash më pjesëmarrje të gjerë popullore në themel të të cilave qëndronte kërkesa Kosova-Republikë.

- **Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:
1. Evidenton tiparet e diskriminimit të shqiptarëve në Federatën jugosllave.
2. Shpjegon pozitën kushtetuese të Kosovës në RSFJ.
3. Analizon rezistencën shqiptare ndaj diskriminimit dhe ngjarjet kryesore në këtë drejtim.

***Vlerësimi:***
*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime.*

**Detyrat dhe puna e pavarur:**
- Mblidhni të dhëna mbi bashkëpunimin mes Kosovës dhe Shqipërisë pas miratimit të Kushtetutës së vitit 1974.

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkolla:</td><td>Klasa: 11</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Shpallja e Pavarësisë dhe ngritja e shtetit demokratik të Kosovës<br><br>1990-2014</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Shfaqen sekuenca nga dokumentarë për luftën e Kosovës 1998 – 1999.<br>Shih: https://www.youtube.com/watch?v=YAT0oWdogtU<br>https://www.youtube.com/watch?v=x0OpYoDbI-I</td></tr>
<tr><td colspan="2"><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>Kompetenca e të menduarit. Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës.<br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;<br>trashëgiminë materiale dhe shpirtërore.<br><br><u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>.<br>Nxënësi:<br>➢ vë në dukje përpjekjet për ndërtimin dhe konsolidimin e institucioneve të shtetit paralel të shqiptarëve të Kosovës;<br>➢ përshkruan nisma e dështuara për dialog mes Prishtinës dhe Beogradit;<br>➢ shpjegon evoluimin e situatës në Kosovë dhe rolin e UÇK-së në afirmimin e interesave të shqiptarëve;<br>➢ vlerëson rëndësinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe rolit të faktorit të brendshëm dhe atij të jashtëm në këtë ngjarje historike.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>- institucionet ilegale në Kosovë<br>- UÇK<br>- Adem Jashari<br>- UNMIK<br>- plani Ahtisaari<br>- Çështja Kosovës.<br>- Serbi në GJND<br>- njohje ndërkombëtare</td></tr>
</table>

| **Burimet:** | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| • Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme, enciklopedi etj. | - Me gjeografinë |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Rrjeti i diskutimit /lexim dhe mendim i drejtuar

**Organizimi i orës së mësimit**

- Shfaqen sekuenca nga filmime dhe dokumentarë që lidhen me luftën e Kosovës të vitit 1998 - 1999

Shih: https://www.youtube.com/watch?v=YAT0oWdogtU
https://www.youtube.com/watch?v=x0OpYoDbI-I

- Nxënësve u drejtohen pyetje duke i nxitur në diskutim

- Cila ishte gjendja në Kosovë në fillim të viteve ’90 dhe raportet shqiptaro – serbe si ballafaqim mes aspiratave të shqiptarëve dhe përpjekjeve të shtetit serb për mohimin e tyre?
- A mendoni se rezistenca paqësore e shqiptarëve në vitet ’90 ishte zgjidhja më e mirë për afirmimin e interesave të tyre në kuadër të shpërbërjes së Jugosllavisë?

**Ndërtimi i njohurive:**

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën e parë të mësimit dhe të diferencojnë qëndrimin e shqiptarëve dhe serbëve përballë realitetit kosovar të viteve ‘90.
- Mund të ndërtohet një tabelë si më poshtë nga mësuesi/ja dhe një nxënës ngrihet për ta plotësuar. Tregohen diferencat mes qëndrimeve të faktorëve serbë dhe shqiptarë.

| Faktori | Qëndrimi/ Drejtuesi | Veçori |
|---|---|---|
| Shqiptar | Rezistencë paqësore pasive.<br><br>Dr. Ibrahim Rugova | - punë për konsolidimin e institucioneve vetëqeverisëse;<br>- kërkesë për ndërhyrjen e faktorit ndërkombëtar për parandalimin e dhunës e të terrorit serb;<br>- qeveria e B. Bukoshit e zhvilloi veprimtarinë në emigracion, duke financuar me taksat e emigrantëve, institucionet ilegale, organizimin e arsimit ilegal shqip, shpërndarjen e ndihmave, shërbimin shëndetësor etj.<br>- presidenti Rugova u përcaktua prerë për zgjidhjen me dialog të çështjes së Kosovës; |

| | | |
|---|---|---|
| Serb | Dhunim sistematik i të drejtave të popullsisë shumicë në Kosovë.<br><br>Slobodan Milosheviç | - qeveria serbe përfitoi nga qëndrimi neglizhues i bashkësisë ndërkombëtare ndaj interesave të shqiptarëve dhe i shpërndau me forcë institucionet e saj;<br>- ajo nuk pranonte të ulej në tryezë, pasi nuk i njihte shqiptarët si palë e barabartë.<br>- E vetmja marrëveshje mbi arsimin shqip e nënshkruar nga Rugova e Milosheviçi në shtator 1996 mbeti në letër. |

- Lexohet pjesa e dytë e mësimit dhe nxënësit plotësojnë në tabelë.

Çlirimi i Kosovës

- thellimi i konfliktit shqiptaro-serb e bëri të pashmangshëm fillimin e konfliktit të armatosur;
- bartëse e këtij misioni u bë UÇK-ja që nisi të organizonte aksione guerile kundër njësiteve policore e ushtarake serbe;
- platforma e saj për liri dhe për ndërtimin e një shoqërie demokratike u përkrah nga i gjithë populli shqiptar;
- reagimi i regjimit serb u shpreh në ndërmarrjen e sulmeve kundër popullsisë civile, shoqëruar me vrasje, reprezalje e masakra, si dhe me shkatërrim masiv të pronave;
- ngjarje të përgjakshme (Prekazi, mars 1998), (Reçak e Rugovë, fillim të vitit 1999) etj.
- pas refuzimit të marrëveshjes së Rambujesë nga Serbia, zgjidhjen e konfliktit në Kosovë e mori në dorë NATO.
- më 24 prill 1999, NATO filloi sulmet ajrore mbi objektet ushtarake serbe në Kosovë e në Serbi;
- gjatë luftës ushtria jugosllave vrau mbi 15 mijë shqiptarë dhe dëboi nga Kosova mbi 1 milionë vetë;
- më 9 qershor 1999, nënshkruhet marrëveshja për tërheqjen e trupave serbe nga Kosova.
- më 12 qershor 1999, në Kosovën e çliruar hynë trupat e NATO-s (KFOR).
- Sipas rezolutës 1244, të Këshillit të Sigurimit të OKB-s, Kosova u vendos nën protektorat ndërkombëtar, që u quajt UNMIK.

- Në mënyrë të njëjtë veprohet edhe me pjesët e tjera të mësimit.

- Mësuesja nxit të menduarit kritik te nxënësit duke kërkuar nga nxënësit të:
  - krahasojnë politikën e rezistencës paqësore pasive të udhëhequr nga Rugova dhe luftën e armatosur të drejtuar nga UÇK;
  - vlerësojnë rolin e faktorit ndërkombëtar në Kosovë pas çlirimit nga Serbia duke diferencuar periudhat para dhe pas shpalljes së pavarësisë;

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Përshkruan ecurinë e marrëdhënieve mes popullsisë shqiptare të Kosovës dhe shtetit të Serbisë në vitet ’90 dhe krahason qëndrimet respektive të tyre

| |
|---|
| në kuadër të procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë.<br>2. Tregon dinamikën e rezistencës së armatosur të drejtuar nga UÇK dhe rolin e saj në aktualizimin e çështjes së Kosovës.<br>3. Shpjegon ndryshimin e qëndrimit të bashkësisë ndërkombëtare ndaj Kosovës drejt ndërhyrjes ushtarake për largimin e forcave serbe prej saj.<br>4. Argumenton rolin e luajtur nga ndërkombëtarët në ndërtimin e shtetësisë së pavarur të Kosovës.<br>5. Evidenton zhvillimin e jetës politike dhe institucionale në Kosovë që prej çlirimit të saj nga sundimi serb. |
| **Vlerësimi:**<br>*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit dhe në të menduarit kritik.* |
| **Detyrat dhe puna e pavarur**:<br>• Mësuesi/ja u jep nxënësve si detyrë të hulumtojnë dhe sjellin informacion rreth vendimit të GJND-së lidhur me shpalljen e pavarësisë së Kosovës. |

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkolla:** | **Klasa: 11** |
|---|---|---|---|
| Tema mësimore: Veprimtari praktike. Qytetari në demokraci | | **Situata e të nxënit:**<br>*Demokracia është një sistem që nxjerr në plan të parë lirinë e individit. Në këtë kuadër, roli i këtij të fundit si qytetar është esencial në dy drejtime kryesore:*<br>- *qytetari duhet të japë kontributin e tij në respektimin e rregullave dhe ligjeve që hapësira e lirisë të mos kthehet në anarki;*<br>- *Qytetari duhet të luajë gjithashtu një rol në gjykimin dhe presionin pozitiv ndaj politikës për rritjen e përgjegjësisë së kësaj të fundit.*<br><br>*Edukimi është një nga proceset më të rëndësishme dhe kyçe në forcimin e këtij roli esencial të individit si qytetar në një shoqëri dhe shtet demokratik.* | |

<table>
<tr>
<td><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</u><br>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.<br>Kompetenca e të menduarit. Nxënësi:<br>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës.<br>Kompetenca e të nxënit. Nxënësi:<br>• zhvillon aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>Kompetenca qytetare. Nxënësi<br>• shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore.<br>Kompetenca digjitale. Nxënësi:<br>komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet.</td>
<td rowspan="2">Fjalët kyçe:<br>- komunitet<br>- pluralizëm<br>- jetë shoqërore<br>- OJQ</td>
</tr>
<tr>
<td><u>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</u>.<br>Nxënësi:<br>➢ Tregon tiparet kryesore të rolit të qytetarit në demokraci.<br>➢ Shpjegon raportin e qytetarit me komunitetin ku ai zhvillon veprimtarinë e tij jetësore, shoqërore dhe profesionale.<br>➢ Krahason ndryshimin e rolit të qytetarit mes një sistemi diktatorial dhe atij demokratik duke u thelluar në të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarit.<br>➢ Analizon zhvillimin e raportit mes qytetarit dhe pushtetit në demokraci.</td>
</tr>
<tr>
<td>Burimet:<br>• Libri i nxënësit, interneti, botime të ndryshme etj.</td>
<td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>Me qytetarinë<br>Me sociologjinë</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td>
</tr>
</table>

**Metodologjia:** Punë në grup/Vështrim krahasues

**Organizimi i orës së mësimit**

Nxënësit ndahen në grupe të vogla dhe secilit grup i jepet një tematikë që duhet kërkuar dhe zhvilluar në formën e një prezantimi final. Grupet e punës mund të vendosen në konkurrencë mes tyre me qëllim nxitjen e cilësisë së prezantimeve të përgatitura nga nxënësit.

**Ndërtimi i njohurive:**

Ndër temat që sugjerohen si tematika të punës në grupe mund të jenë:

- **Individi dhe komuniteti**
  - *Bashkëjetesa*
  - *Diversiteti dhe pluralizmi*
  - *Konflikti*
- **Përgjegjësia shoqërore.**
- **Pjesëmarrja në jetën shoqërore**
- **Pushteti dhe kompetencat**

Në përfundim, nxënësit paraqesin prezantimin e tyre në klasë. Në bazë të këtij prezantimi nxitet një diskutim i shkurtër, ku nxënësit e tjerë shprehin mendimet e tyre lidhur me tematikën.

Mësuesi bën konkluzionet e diskutimit dhe vlerëson nxënësit lidhur me argumentet e paraqitura dhe pjesëmarrjen në diskutim.

**Pyetje për diskutim**

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

1. Shpjegon thelbin e raporteve mes individit dhe komunitetit dhe kontributit të çdo qytetari në favor të komunitetit ku ai jeton.
2. Argumenton rëndësinë e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në jetën shoqërore.
3. Analizon raportin e qytetarit me pushtetin dhe rolin nxitës dhe kontrollues ndaj këtij të fundit.

***Vlerësimi:***

*Vlerësimi i nxënësit mbështetet në realizimin e detyrave, kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime.*